

**Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Instituti i Studimeve Albanologjike**

**SHKODRA, ARBËRESHËT
DHE
LIDHJET ITALO-SHQIPTARE**

Studime shqiptare 20
Shkodër, 2013

Bordi shkencor:

- 1. Prof.dr.Artan Haxhi**
- 2. Akad. Kolec Topalli**
- 3. Prof.dr. Tomor Osmani**
- 4. Prof.dr.Francesko Altimari**
- 5. Prof.dr.Tefë Topalli**
- 6. Prof.as.dr.Mimoza Priku**
- 7. Prof.dr.Gjovalin Shkurtaç**
- 8. Prof.as.dr.Aljula Jubani**
- 9. Prof.dr. Matteo Mandala**
- 10. Prof.dr. Bardh Rugova**

Përgatitën botimin:

- 1. Prof.dr. Tomor Osmani**
- 2. Prof.dr.Tefë Topalli**
- 3. Prof.as.dr.Mimoza Priku**

ISBN 978 - 9928 - 4135 - 3 - 6

© Copyright:

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Instituti i Studimeve Albanologjike (ISA) dhe Departamenti i gjuhësisë i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me Universitetin e Kalabrisë dhe me mbështetjen e kryetarit të komunës së Vakaricit z. Aldo MORINO, organizuan më 14 tetor 2010 konferencën shkencore “*Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo - shqiptare*”. Morën pjesë ambasadori i Italisë në Shqipëri Saba D’ELIA, si dhe të ftuar nga Italia, Prishtina, Tirana, Gjirokastra etj. Ishte i pranishëm edhe prefekti i Shkodrës z. Maxhid CUNGU, si dhe përfaqësues të tjerë nga pushteti vendor.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i ISA prof.dr. T.OSMANI. Në emër të qeverisë italiane përshëndeti ambasadori i Italisë në Shqipëri z. Saba D’ELIA, i cili vuri në dukje rëndësinë e lidhjeve italo-shqiptare të këtyre marrëdhënieve në kulturë dhe shkencë. Në emër të komunës së Vakaricit përshëndeti kryetari i saj z. Aldo MORINO. Më pas u lexuan dy referate: Referati i parë me titull “*Kolegji i Shën Adrianit - vatër edukimi e dijeje*”, u mbajt nga Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, prof.dr. Artan HAXHI dhe prof.dr. Tefë TOPALLI, referati i dytë “*Kolegjet arbëreshe në marrëdhëniet italo - shqiptare. Roli i Seminarit të Palermos*”, nga prof.dr. Matteo MANDALA i Universitetit të Palermos. Më pas vazhdoi leximi i kumtesave të ndara në dy seanca paralele.

PËRMBAJTJA E LËNDËS:

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

Kolegji i Shën Adrianit vatër edukimi e dijeje.....9

Kolec TOPALLI

Të folmet arbëreshe në studimet dialektologjike të Martin Camajt.....19

Françesko ALTIMARI

Çështja alfabetike tek arbëreshët e Italisë para dhe gjatë Rilindjes:
historia e “ë”-së.....25

Tomor OSMANI

Studimet gjuhësore për arbëreshët në vështrimin e
prof. Jup Kastriotit. Vlerësime dhe interpretime.....37

Matteo MANDALA

Prejardhja e mitit pellazgjik: Jeronim de Rada dhe
Giovanni Emanuele Bidera.....47

Jani THOMAI

Fjalori i një gramatike në syrin e një studiuesi.....73

Miaser DIBRA

Mendimi kritik i studiuesve shkodranë në vitet 1939-1944 për
letërsinë arbëreshe.....81

Emil LAFE

Fjalori arbërisht – shqip i Kolë Kamsit si burim për vëzhgime
gjuhësore.....91

Shaban SINANI

Bota arbëreshe dhe vendlindja në veprën e M. Camajt99

Bardh Rugova

Studiuesit shkodranë të arbërishtes, vështruar nga Erik Hamp113

David LUKA

“Shkrimtari më i vjetri i italo-shqiptarëve, Lukë Matranga (1592)”
në vizionin e Atë Justin Rrotës.....117

Aljula Jubani-BENGU- Emilia CONFORTI

De Rada – Camaj, shqyrtime gjuhësore rreth gjuhës së
njësuar shqipe.....125

Vehbi HOTI

Luigj Gurakuqi tek arbëreshët dhe për arbëreshët.....129

Gjovalin SHKURTAJ

Dialektologët shkodranë për të folmet dhe ligjërimet arbëreshe.....145

Imri BADALLAJ

Pikëpamjet e Kolë Kamsit mbi italo-arbëreshët dhe gjuhën e tyre.....165

Domenico CASSIANO

Il contributo degli albanesi di Calabria al Risorgimento

Kontributi i arbëreshëve të Kalabrisë gjatë Rilindjes.169

Francesco FABBRICATORE

Terenzio Tocci. Un esempio di mazzinianesimo rivoluzionario
arbëresh per l'Albania (1897-1901

Terenc Toçi, një shembull mazzianizimi revolucionar arbëresh
për Shqipërinë (1897- 1901)).....207

Begzad BALIU

Tipologjia e kontributit të prof. Jup Kastratit në studimin e botës materiale
dhe shpirtërore arbëreshe.

(Studime, vepra, komunikime, imazhe, vlerësime,
dokumente, dorëshkrime).....235

Thoma DHIMA

Prof. Gj. Shkurtaj për dialektologjinë dhe sociolinguistikën

arbëreshe.....263

Mimoza PRIKU

“Luigj Marlekaj dhe kontributet e tij në studimet arbëreshe”.....273

Valbona KARAKAÇI

Ernest Koliqi dhe Kangjelet e Rilindjes pikëtakim me botën

arbëreshe dhe De Radën.....281

Rrezarta DRAÇINI, Rezearta MURATI

“Hylli i Dritës” për arbëreshët.....291

Orjeta BAJA, Merita HYSA

Shtresa e huazuar në fjalorin “Arbërisht-shqip” të Kolë Kamsit.....299

Arben PRENDI

Kolë Kamsi për folklorin arbëresh në veprën “Shqiptarët e Italisë”.....309

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

(Shkodër)

**KOLEGJI I SHËN ADRIANIT VATËR
EDUKIMI E DIJEJE**

“Roli i Kolegjit të Shën Adrianit në marrëdhëniet shqiptaro-arbëreshe”


Arbëreshët e Italisë, të shpërngulur në Gadishullin Apenin para e pas vdekjes së heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, kanë arritur të ruajnë si gjënë më të çmuar, si trashëgiminë më të shenjtë të etërve të tyre, shenjën kryesore të kombësisë, gjuhën amtare, gjuhën e të parëve të vet. Në kolonitë e Kalabrisë së mesme e të Sicilisë kanë dalë kohë pas kohe prej klasës së këtyre njerëzve të kulturuar studiues e lëvrues të mirë të gjuhës shqipe, të cilët me veprat e tyre letrare përveç se i kanë dhënë popullit arbër ushqimin mendor e shpirtëror, i kanë shërbyer njëherësh edhe dialektit të vendit, duke e zhvilluar me gjithë dije e vullnet të mendjes, për ta ruajtur të pastër e të paprekur. Shërbimet që këta mjeshtra të palodhur i kanë bërë gjuhës e rilindjes së letërsisë shqipe me shkrimet e vlefshme të tyre, janë mjaft të mëdha.

Midis shkrimtarëve shqiptarë të Italisë nuk kanë munguar edhe përpjekjet për të hapur shkolla në arsimin shqip, me qëllim që të mbajnë të ndezur kultin për traditat e atdheut të moçëm e dashurinë për gjuhën amtare, të ruajnë të pastër karakterin e shpirtit të tyre, doket e zakonet e të parëve. Për këtë qëllim ata dëshironin t’u jepnin bijve të tyre atë kulturë e edukatë që kërkonin kohët e atëhershme për të mos mbetur prapa vendasve me arsim e me qytetërim.

Kështu, kërkesat dhe dëshirat e tyre për t'u integruar në jetën e vendit nisën më së pari në vitin 1577, kur Papa Gregori XIII mori nismën për hapjen në Romë të Kolegjit të Shën Atanasit, i cili ndër të tjera kishte qëllim që të përgatiste klerikë që do të ushtronin meshtarinë në ritin greko-katolik në vise të ndryshme të Italisë. Këtu përfituan edhe disa nxënës arbëreshë, mes të cilëve u shqua Shtjefën Rodota, bir i një familjeje të përmendur bujare nga Shën Benedikt Ulano-ja.

Pasi përfundoi studimet në kolegji dhe nisi ushtrimin e detyrës, ai filloi të mendonte për të themeluar edhe në Kalabri një kolegji të tillë, i cili do të mund të formonte priftërinjtë e ardhshëm edhe në kolonitë italo-shqiptare, por edhe me synimin që të mund të shërbente për arsimimin e popullatës së kësaj zone. Për këtë qëllim ai iu drejtua me një lutje Papës Klementi XI (papë me origjinë shqiptare, nga fisi Albani), kërkesë që u pëlqye nga Kryetari Kishës Katolike dhe u materializua, duke caktuar për këtë funksion ndërtesën e Badisë në katundin arbëresh të Shën Benedikt Ulanos. Por Papa ndërroi jetë shpejt dhe qëllimi nuk u realizua, deri kur në krye të Kishës erdhi një tjetër papë me origjinë shqiptare (nga nëna), Papa Klementi XII. Ndërkohë, vëllai i Shtjefën Rodotës, Felice, i cili kishte studiuar së bashku me Papa Klementin në Kolegjin e Propagandës Fide dhe kishte pasur rastin t'i tregonte gjendjen e mjeruar të klerit italo-shqiptar të ritit grek në zonat me popullsi arbëreshe, i kërkoi hapjen e një kolegji të tillë. Kjo kërkesë gjeti vëmendjen e Papës, i cili, me **5 tetor të vitit 1732**, me vendim të veçantë shpalli krijimin e kolegjit, që mori emrin Kolegji italo - grek "*Corsini*" (nisur nga mbiemri i familjes së papa Klementit XII) dhe drejtor i tij u emërua **Felice Rodota**, që mbante njëkohësisht edhe detyrën e Ispeshkvit të krahinës. Ai u mundua me mish e me shpirt të fuqizonte institutin jo vetëm nga ana ekonomike e financiare, por edhe nga ana pedagogjike e arsimore. Fatkeqësisht vdes i ri (në moshën 40 vjeçare), duke i lënë kolegjit gjithë trashëgiminë e tij, së bashku me bibliotekën e pasur. Brenda pak vitesh u pa se kolegji kishte përgatitur një gjeneratë studentësh elitare që ra në sy menjëherë në fushë të dijes e të virtytit.

Drejtor i dytë i kolegjit u emërua *Imzot Nikola de Markis*, nga katundi Lungro, i njohur për kulturën e tij të gjerë, për t'u pasuar më vonë nga *Imzot Giacinto Archiopoli*, prej Shën Mitër Korones, i cili e drejtoi me sukses këtë institucion për plot 18 vite. Më 1792 kolegjin e udhëhoqi *Imzot Francesko Buljari*, një njeri i shquar e i njohur për dije të thella e plot cilësi të përsipirtshme, që gjatë gjithë viteve, punoi plot zell e vullnet për përparimin dhe zgjerimin e kolegjit. Kështu, me ndërmjetësinë dhe mbështetjen e miqve dhe të bashkatdhetarëve të vet, Angelo Masci-t (këshilltar shteti aso kohe) dhe Pasquale Baffi-t (i njohur si latinisti më i madh i Evropës), ai arriti të nxjerrë në mars të vitit 1794 një dekret prej



Kolegji i Shën Adrianit

Mbretit Ferdinandi IV për ndryshimin e selisë së Kolegjit nga Shën Benedikt Ulano në Mungaden Basiliane të Shën Adrianit, pranë katundit të Shën Mitrit dhe fshatit të Makias, ku gjendet edhe sot e kësaj dite.

Gjatë këtyre viteve kolegji pati arritje në të gjitha drejtimet, duke ngritur më tej cilësinë në drejtim të mësimdhënies, të edukatës e të disiplinës dhe duke pasuruar më tej edhe bibliotekën e tij. Për fat jo të mirë, në atë kohë turbullirash politike e sociale në Itali, Kolegji i Shën Adrianit u bë objekt sulmi e shkatërrimi të pashembullt, ndërsa drejtuesi i saj përfundoi në mënyrë tragjike. Kjo shkaktoi mbylljen e tij për gati 8

vjet me radhë.¹

Me 31 janar 1807, me vendim qeveritar kolegji rifillon punën nën drejtimin e **Imzot Domenik Bellushit**, nga Franscineto, një njeri me formim të gjithanshëm e mendjehollë, atdhetar e me kulturë të gjerë. Falë përkushtimit e vullnetit të mirë të tij, ai arriti të rigjallëronte kolegjin, duke u orvatur në mënyrë të posaçme për mbarëvajtjen didaktike e mësimore të institutit, me qëllimin e lartë të formonte një “*djelmni me kulturë të shëndoshë e me karakter atdhetar të mirë*”². Rezultat i kësaj pune ishte formimi i një brezi të denjë, prej të cilit dolën veprimtarë të shquar të Rilindjes italiane dhe edukatorë të brezit të ri, në mes tyre: arbëreshi i madh Jeronim de Rada, Antonio Marchiano (nënkryetar i kolegjit dhe pjesëmarrës aktiv i revolucionit të 1848), Vinçenc Dorsa (profesor i liceut, gjuhëtar, folklorist, shkrimtar e dijetar i njohur), gjeneral Domenik Damisi (një nga bashkëluftëtarët e Garibaldit), Domenik Mauro (poet, kritik letrar, studiues i njohur i Dantes), Paskal Skura (Ministër drejtësie në Napoli në kohën e Garibaldit), Guljelm Tocci (deputet i parlamentit italian e atdhetar i zjarrtë) etj.; të cilët lanë gjurmë të pashlyera në kulturën shqiptare, në lëvizjen garibaldine, por edhe si drejtues të aftë e përfaqësues të arbëreshëve në parlamentin italian.

Pas vdekjes së Bellushit, drejtimin e kolegjit e merr **Imzot Gabriel de Marchis**, i cili edhe për aq kohë sa shërbeu, u shqua për ruajtjen e origjinalitetit të këtij institucioni. Më pas kolegji vihet nën drejtimin e **prof. Anton Marchianoit** nga Makji, njeri i ditur e me horizont, mësues i gjuhëve klasike, i cili i dha prestigj të ri kolegjit. Është koha e lëvizjeve kryengritëse në Itali dhe Marchiano i përfshihet, së bashku me mjaft nxënës të këtij kolegji, në luftë kundër Burbonëve, çka çoi në burgosjen e tij dhe, për pasojë, edhe mbylljen e kolegjit për dy vjet.

Më 1850 kolegji rihapet nën drejtimin e **Vinçenc Rodotës**, në kushte kur qeveria nuk e shihte me sy të mirë këtë institucion dhe kërkonte ta mbyllte këtë vatër kulture e atdhetarizmi, duke e quajtur

¹ Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 128 – 130.

² Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 131.

“farka e djemenvet” (demonëve, djajve) dhe “çerdhe gjarpijsh”³.

Më 1854 Mbreti Ferdinand II jep urdhër që kolegji të mbyllet, me akuzën që “po përgatiste një djelmni kryengritëse”. Ndonëse vendimi nuk u zbatua (pas lutjeve të qeveritarit të vendit, Giuseppe Bellushi, mik i Ferdinandit), përsëri kolegji nuk funksionoi deri më 1858, kohë kur emërohet drejtues **Imzot Agostino de Franco**, i cili nuk shkëlqeu fort në punë të drejtimit të kolegjit dhe për këtë arsye, në këmbë të tij u vendos Arqipeshkvi i Rossano-s.

Një kthesë të madhe mori kolegji, pas fitores së garibaldinëve kundër burbonëve, për çlirimin e vendit e bashkimit të Italisë, kur vetë udhëheqësi Giuseppe Garibaldi, duke njohur meritat e luftëtarëve arbëreshë, vendosi të mbështeste zgjerimin dhe forcimin e kolegjit përmes një dekreti të veçantë.⁴

Për një periudhë të gjatë kohe (gati 25 vjet) Kolegji i Shën Adrianit u drejtua nga **Antonio Marchiano**, i cili tashmë i ishte përveshur punës në liri të plotë, duke i dhënë një zhvillim edhe më të madh dhe një emër akoma më të mirë atij. Ky institucion me shumë traditë tashmë ishte shndërruar në një qendër kulture e arsimit, prej së cilës dolën djem të vlefshëm për kah zgjuarsia, guximi e mendjemprehtësia, me dituri e karakter, të zotë të mendimit e të gjykimit, që i dhanë zë të mirë kolegjit

³ Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 133.

⁴ Po ai, po aty, f. 134.: *Në vjetin 1860 Giuseppe Garibaldi, mbasi liroi të dy Siçiljet prej Burbonvet e i bashkoi me mbretin t'Italis, qiti, me 20 tetuer, dekretin e famshëm nga Caserta, ku kish informue Ministrin e përkohshme në të cilën kishin marrë pjesë tre italo-shqiptarë: Françesk Crispi, Paskual Skura e Luigj Giura: “Diktatori i Italis së Jugut, tue marrë në kujdes shërbimet e nalta që i u dhanë çështjes kombtare prej shqiptarvet trima e bujarë dekretin:*

“Krye nevojët e luftës e themelue Italija me Viktor Emanuelin, Thesari i Napulit detyrohet të japë Shumen e dymbëdhjetë mijë skudavet për zmadhimin e Kolegjës Italo - Greke të Sh’Adrianit. Unë e ve nen garancin e Kombit dhe të madhit Sovran të tij zbatimin e këtij dekreti.

Giuseppe Garibaldi”

dhe arbëreshëve në veçanti.

Kështu ka ndodhur edhe më pas kur në krye të kolegjit u vu **Imzot Zef Skiroi**, nën drejtimin e të cilit dhe falë insistimit e punës së palodhur të Jeronim de Radës, në prill të 1892, u arrit të themelohej katedra e literaturës shqipe, duke u bërë vetë arbëreshi i madh (J. de Rada – shën. ynë) përgjegjës dhe lektor për ligjëratat mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe e kombit shqiptar.

Shekulli i ri, që përkon edhe me ngritjen e vetëdijes sonë kombëtare këtej e përtej detit, do të shënojë edhe një kthesë të dukshme në të mirë të zhvillimit dhe të përvijimit të një fytyre të re të këtij institucioni në të gjithë treguesit, pasi më 1900 drejtues i shkollës (dhe Komisar Mbretëror) u caktua **Angelo Scalabrini**, i cili u përkujdes dhe arriti që Kolegji të zgjerohet edhe me shkollën normale, që u hap më 1905 dhe pati nxënës vetëm nga Shqipëria. Për këtë qëllim qeveria italiane e asaj kohe akordoi edhe bursa për nxënës shqiptarë të cilët do të formoheshin si mësues të ardhshëm. Kështu, kolegji mori karakter mbarëkombëtar, duke u shndërruar në një qendër kulture, edukimi e arsimit edhe për djemtë shqiptarë, në një kohë që vendi i tyre ishte nën pushtimin e rëndë e të gjatë osman.

Kolegji arbëresh i Shën Adrianit zë një vend të merituar në historinë e arsimit tonë kombëtar. Ai ka mbajtur të gjallë gjuhën ndër vëllezërit tanë arbëreshë, u ka kultivuar vazhdimisht dashurinë e pakufishme për atdheun e të parëve, Shqipërinë, për traditat e shquara kulturore të shqiptarëve. Ky institut ka përgatitur breza të tërë të inteligjencies arbëreshe: dijetarë, gjuhëtarë, arsimtarë, etnografë, folkloristë, historianë, shkrimtarë dhe studiues të përmendur, të cilët i kanë sjellë kontribute shumë të vyera kulturës kombëtare shqiptare, çështjes shqiptare në periudha të caktuara historike. Mjafton të përmendim se në Kolegjin e Shën Adrianit është organizuar më 1895 i pari Kongres gjuhësor shqiptar; se në këtë Institut dhe prej intelektualëve të formuar këtu, ka nisur udhën e gjatë e të vështirë edhe shtypi në gjuhën shqipe, si organet: *L'Albanese d'Italia* (1848), *Fjamuri Arbërit* (1883 –

87), *Arbri i Ri* (1887), *Ili i Arbreshvet* (1896), *La Nazione Albanese* (1897-1924), *Flamuri i Shqiperis* (1904), *La Gazzetta Albanese* (1904), etj..

Nisur edhe prej ndriçimit të Kolegjit arbëresh të Shën Adrianit, dy shkrimtarët e studiuesit e mëdhenj shkodranë, Arshi Pipa e Martin Camaj, kanë nxjerrë në pah (në sa e sa shkrime) jo vetëm kontributin shqiptar, por edhe kontributin arbëresh për kulturën evropiane gjatë Mesjetës e më tej.

Falë kësaj qendre dhe të tjerave si ajo - thekson Camaj -

*“nga përfaqësuesit e diasporës shqiptare në Itali, që përdoren italishten si gjuhë shkrimi, tue përkthye në këtë gjuhë disa prej vargjeve poetike, Shqipnia dhe populli shqiptar, deri atëherë thuejse të panjohtun dolën në skenën europiane. Nëpërmjet tyre kultura shqipe lidhet me kulturën prendimore tue u ba pjesë e saja.”*⁵

Poeti dhe gjuhëtari M. Camaj, që ka bërë studime të drejtpërdrejta dialektologjike në hapësirën shqipfolëse të diasporës arbëreshe, ka nënvizuar me të madhe rëndësinë e qendrave mësimore në Jug të Italisë.

Vite më parë ai shprehet:

*“Ata që mërguan n’Italinë e Jugut, shumica e tyre ortodoksë, disa prej të cilëve erdhën nga Greqia, ruejtën gjuhën shqipe tue mbajtë gjithashtu fenë e tyre ortodokse si uniatë. Kta arbëreshë në vitet ’30 të shekullit XVIII qenë të zotët me themelue qendrat e veta arsimore: Kolegjin Corsini (ma vonë Kolegji Shën Adriano), në rrethet e Cosenza-s, dhe Seminarin italo-grek në Palermo... Prej këtyne qendrave kulturore arbëreshe dolën dijetarët e letrarët arbëreshë të cilët, nën ndikimin, në fillim, t’iluminizmit dhe ma vonë të romantizmit, prodhuen veprat e para erudite mbi gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar....”*⁶

Një fakt mjaft interesant mbi lidhjet e dijetarëve dhe të intelektualëve të Shkodrës me botën arbëreshe e vë në dukje poeti e përkthyesi Lazër

⁵ Martin Camaj, ALBANICA, Special Issue, Winter, 1992, Number 3 – 4, f. 48 – 49.

⁶ Martin Camaj, ALBANICA, Special Issue, Winter, 1992, Number 3 – 4, f. 49.

Shantoja, kur shkruan:

*“një kontribut të madh e të fuqishëm i kan dhanë zgjimit kombëtar e intelektual të vendit t’onë edhe shkollat italjane ashtu n’Itali si në Shqipni. Nga Kolegjat San Demetrio Corone e nga ato Saverjane e Papnore e Françeskane të Shkodrës ka dalun ai grup intelektualësh qi muerën një pjesë aq të madhe e të shkëlqyeshme në lëvizjen kombëtare politike e letrare të vendit”.*⁷

Prej krahinave e qyteteve të ndryshme të Shqipërisë mjaft të rinj shqiptarë morën rrugën drejt kolegjit të Shën Adrianit në Shën Mitër Korone, nëpër auditoret e të cilit frynte era e dashurisë së flaktë për atdheun e të parëve; prej këtyre shkollave u futën në damarët e tyre ndjenjat më të mira të rilindjes kombëtare dhe të atdhetarizmit të pashoq.

Që nga viti 1898 e deri më 1919 nga bankat e këtij kolegji kanë dalë mbi 100 djem shqiptarë, të cilët i shërbyen atdheut të tyre me devocion e entuziazëm. Nuk janë të pakët shkodranët që u formuan në këtë kolegji, por edhe që punuan në përhapjen e arsimit shqip e që më vonë u bënë edhe pionierë të studimeve arbëreshe në Shqipëri, për ngulimet e para, për qëndresën kulturore dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, si: Luigj Gurakuqi (1900), që do të punojë e do të drejtojë arsimin kombëtar në vendin e tij, duke dhënë një shembull flamurtari për shkollat e para shqipe, për tekstet shkollore dhe në shumë ngjarje aq të rëndësishme për gjuhën tonë e demokratizimin e jetës në fillimet e shekullit të 20-të; Kolë Kamsi (1907), Pjetër Trashani (1907), Ndoc Martin Zamaj (1907), Luigj Kodeli (1907), Ndreka Ashiku (1907), Lazër Prenushi (1907), Luigj Prela (1911), Zef Kurti (1912), Simon Prendi (1912), Gjon Guga (1912), Rexhep Dizdari (1918) etj..

Ndërkohë pati edhe mjaft shqiptarë që dhanë kontributin e tyre si mësimdhënës në këtë kolegji, mes të cilëve edhe disa nga Shkodra, si: Gaspër Jakova – Merturi dhe Nikollë Martin Zamaj e pas tyre, Mehdi

⁷ L.Shantoja, *Vepra*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. 490.

Frashëri (1915 -1918) – politikan dhe kryeministër i Shqipërisë më 1936. Në këtë mënyrë mund të themi se Kolegji i Shën Adrianit ishte një nga institutet më serioze në Italinë e Jugut. Ky Kolegj ishte vatër lirie dhe drite, fidanishte djemsh të frymëzuar nga ndjenjat e lirisë, me ideale të larta atdhetare, me dëshira fisnike për të përhapur dijen dhe arsimin në gjuhën amtare, për t'i shërbyer kombit të tyre. Dhe nëse kolegji ishte bërë i tillë, një meritë e madhe u takonte drejtuesve të tij në vite, pjesëtarëve të trupit mësimor, pedagogëve atdhetarë arbëreshë, të cilët nuk u zbrapsën as përpara situatave më të rënda, por qëndruan me një trimëri shembullore. Ndaj ne sot i kujtojmë me nderim e respekt të veçantë.

BIBLIOGRAFI :

1. *Gjovalin Shkurtaj, Gjaku i arbërit rron*, Tiranë, 1980.
2. *Kolë Kamsi, Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, 2006.
3. *Albanica, Special Issue*, Winter, 1992, Number 3 – 4.
4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar* – 1, 2, Tiranë, 2008, vëll.III, 2009.
5. *Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini (Tiranë-Pejë), 1997.
6. *At Giuseppe (Zef) Valentini, Vepra* -1, 2, 3, Plejada, Tiranë, 2005.
7. *Enver Muhametaj, Mendimi letrar shqiptar (1939-1944)*, Bota shqiptare 7, Tiranë, 2008.
8. *Gaetano Petrota, Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Tiranë, 2008.
9. *Lazer Shantoja, Vepra*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
10. *Vehbi Hoti, Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar*, Shkodër, 2002.

Kolec TOPALLI

(Tiranë)

TË FOLMET ARBËRESHE NË STUDIMET DIALEKTOLOGJIKE TË MARTIN CAMAJT

Duke kërkuar pikat e kontaktit ndërmjet qytetit tim të lindjes dhe arbëreshëve të Italisë, e gjeta të udhës që në këtë tubim shkencor të kumtoj për dijetarin e madh shqiptar, poetin, shkrimtarin dhe gjuhëtarin Martin Camaj, i cili për arbëreshët e Italisë, në veçanti për studimin e të folmeve të tyre, ka dhënë kontribute më shumë se asnjë tjetër. Me këto studime ai zë kryet e vendit jo vetëm në dialektologjinë arbëreshe, por edhe në studimet shqiptare, edhe pse kontributi i tij në këtë lëmë dhe në fusha të tjera nuk u njoh nga shteti i diktaturës, që hodhi mbi të baltë e gurë vetëm pse ai kërkoi udhën e lirisë në botën perëndimore, ku mundi të zhvillojë talentin e tij dhe t'i shërbejë shkencës e atdheut, që ishte i mbërthyer në tela me gjemba.

Si një shqiptar i mirëfilltë, i lidhur me rrënjë të forta me vendlindjen, fillesat e punës së Martin Camajt si dialektolog lidhen me të folmet e atdheut, me të cilat mundi të kishte kontakte të drejtpërdrejta dhe të mblidhte materiale në vitet e rinisë. Të tillë janë artikujt e parë që botoi në këtë fushë, njëri: "*Lautliche Parallelentwicklungen in montenegrischen und nordalbanischen Mundarten*" ("Zhvillime fonetike paralele në të folmet e Malit të Zi dhe të Shqipërisë së Veriut", të botuar gjermanisht në revistën "Die Welt der Slaven" (Bota e sllavëve), dhe tjetri "*Osservazioni sullo svilppo storico della parlata della Matja*" ("Vëzhgime rreth zhvillimit historik të së folmes së Matjes"), të botuar italisht në "Aktet e Kuvendit V të Studimeve Shqiptare".

Por largimi nga atdheu ia bëri të pamundur vijimin e studimeve në këtë fushë, për të cilën kontakti me njerëzit dhe me gjuhën e gjallë është i

domosdoshëm. Kjo është arsyeja që për mungesë të kontakteve me vendlindjen, duke i pasur portat e vendit të tij të mbyllura përgjithmonë, ai iu drejtua diasporës shqiptare të arbëreshëve të Italisë, vendit ku u vendos në një fazë të rëndësishme të jetës së tij, ku mbaroi studimet universitare, ku u doktorua dhe ku zhvilloi aktivitetin e tij shkencor e letrar-artistik. Arsyeja tjetër është se studimi i të folmeve arbëreshe përputhej edhe me prirjet e tij për historizëm në studimin e gjuhës. Në këto të folme ai hulumtoi dukuri të lashta të gjuhës shqipe, të ruajtura prej mërgimtarëve, të cilët, duke u larguar para disa shekujsh nga trugu i përbashkët, kishin marrë me vete tipare të lashta të gjuhës amtare. Madje, në studimet e tij për të folmet arbëreshe gjuhëtari ynë kishte gjetur tipare dhe dukuri gjuhësore edhe më të lashta se ato të teksteve më të hershme të shkruara në gjuhën shqipe, çka flet për vlerën e paçmueshme të materialit gjuhësor të këtyre të folmeve për historinë e gjuhës shqipe. Këtë lidhje të ngushtë ndërmjet dialekteve dhe teksteve të vjetra Camaj e kishte vënë në dukje që në fillimet e studimeve të tij gjuhësore, në Kongresin e parë Ndërkombëtar të Dialektologjisë së Përgjithshme, të mbajtur në Luven të Belgjikës më 1964, ku mbajti kumtesën “*Il problema dello studio dei testi antichi albanesi in rapporto coi dialetti*” (Problemi i studimit të teksteve të vjetra shqipe në lidhje me dialektet).

Konturet e projekteve për studimin e dialektit arbëresh u formuluan nga Martin Camaj që në vizitat e para që bëri në komunitetin italo-shqiptar bashkë me mjeshterin e madh të letrave shqipe dhe përkrahësin e tij të vazhdueshëm, poetin Ernest Koliqi, eksponenti më i rëndësishëm kulturor i emigracionit shqiptar, themelues i revistës “Shejzat”. Në këto vizita, duke kuptuar vlerën e madhe të të folmeve arbëreshe, Camaj bëri regjistrimet e para të materialit dialektor të mjedisit arbëresh, që i shërbyen për disa dekada më vonë për hartimin e veprave dialektologjike për këto të folme.

Pas një artikulli studimor për këto të folme, “*Gjurmë të popullsisë shqiptare në Provincën e Pjaçencës*” të botuar në revistën “Shejzat” më 1969, Camaj shkruan e publikon studimet “*Zur albanischen Mundart von*

Barile in der Provinz Potenza” (“Për të folmen shqipe të Barilit në krahinë të Potencës”), të botuar gjermanisht në Mynhen më 1971; “*Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell’Italia meridionale*” (“Dygyhësia në oazet gjuhësore shqipe të Italisë së Jugut”), të botuar italisht në Piza më 1974; “*Sprachresten der albanischen Mundart von Villa Badessa in der Provinz Pescara*” (“Mbetje gjuhësore të së folmes shqipe të Vila Badesas në krahinë të Peskarës”), të botuar gjermanisht më 1975; “*Per una tipologia dell’arbëresh*” (“Për një tipologji të arbërishtes”), të botuar italisht më 1983. Veç këtyre, të folmeve arbëreshe ai u kushtoi disa studime me karakter monografik, si: “*La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino*” (“E folmja shqipe e Gréqit në krahinë të Avelinos”), e botuar italisht në Firenze më 1971; “*Die albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza*” (“E folmja shqipe e Falkonarës shqiptare në krahinë të Kozencës”, e botuar gjermanisht në “*Indogermanische Forschungen*” më 1977; dhe “*La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza*” (“E folmja arbëreshe e Shën Kostantinit shqiptar në krahinë të Potencës”), e botuar italisht më 1993.

Të gjitha këto punime, që shquhen për volumin e madh të punës dhe cilësinë e tyre, e vënë Camajn në radhën e parë të dialektologëve më të mirë. Punimet në fjalë janë frut i vëzhgimeve dhe studimeve disavjeçare, të kryera në pika të ndryshme ku vijon të ruhet arbërishtja. Ato përbëjnë një kontribut të mirëfilltë shkencor jo vetëm për studimet arbëreshe, por edhe për dialektologjinë shqiptare, gramatikën, historinë e gjuhës e më tej. Në to janë zbatuar metodat strukturaliste në një fushë ku mbizotëronin metodat tradicionale të përshkrimit të materialit dialektor. Studimi i këtyre të folmeve shtrihet në të gjitha sistemet e nënsistemet e gjuhës duke e konceptuar atë si një njësi organike të mvetësishme, që funksionon si një tërësi e pandarë dhe zhvillohet në të gjitha rrafshet e saj. Studimi i këtyre të folmeve plotësohet edhe me materialin folklorik dhe glosarin, të mbledhur prej tij me kujdes të veçantë. Ato shërbejnë për të ilustruar dukuritë e shpjeguara në pjesën e fonologjisë dhe të gramatikës

së këtyre të folmeve, dhe përbëjnë një fond pasurie jo vetëm për dialektologjinë arbëreshe, por edhe për gjuhën shqipe. Madje, për natyrën e tij, edhe tradicional, edhe modern, Camaj e ndoqi zhvillimin e të folmeve arbëreshe edhe tek emigrantët e Amerikës, me materialet e të cilëve botoi studimet “*Aspetti del plurilinguismo presso gli arbëresh d’America*” (“Dukuri të shumëgjuhësisë tek arbëreshët e Amerikës”, të botuar në dy numra të revistës “Zjarri” në vitet 1986, 1989.

Pikat dialektore që zgjodhi për studim, janë ndër më përfaqësueset e mjedisit arbëresh, duke hulumtuar të folme krahinash të izoluar dhe përgjithësisht konservative, që paraqesin interes të veçantë nga ana gjuhësore. Tipike për këtë është e folmja e Shën Kostantinit, një fshat që ndodhet ndërmjet Kalabrisë dhe Lukantias, e folmja e të cilit dallohet për karakterin arkaik falë izolimit natyror. Studimin e kësaj së folmeje albanologu i shquar e realizoi duke punuar në terren për dekada të tëra me vullnet dhe energji të pashembullt, duke mos e hequr punën nga dora as në ditët e vështira të sëmundjes së tij të rëndë, që i mori jetën. Kontaktet e para me këtë të folme Camaj i pati qekur ishte student, dhe ç’prej atëherë e deri sa arriti të mbarojë monografinë zhvilloi katër ekspedita në kohë të ndryshme, të cilat së bashku me vizitat e herpashershme që bëri për të verifikuar të dhënat e mbledhura, kapin një periudhë kohore prej 30 vjetësh. Edhe parathënia e veprës për këtë të folme është shkruar në janar të vitit 1992, pak kohë para se të ndërronte jetë autori i saj.

Por për gjuhëtarin që ka hartuar edhe një gramatikë të shqipes, të folmet arbëreshe nuk ishin vetëm ishuj gjuhësorë ku ruheshin dukuritë e lashta të shqipes mesjetare. Ai i konsideronte ato si një pjesë organike të trungut të madh gjuhësor të shqipes së përbashkët, e cila gjallon në dy dialekte në brigjet lindore të Adriatikut e Jonit dhe në dialektin arbëresh në brigjet e tyre perëndimore. Me këtë pikëpamje është trajtuar gramatika e gjuhës shqipe, ndoshta e para gramatikë që mbështetet jo në një dialekt të vetëm, por në tre të tillë, njëri ndër të cilët është arbërishtja, duke rrokur kështu tërë pasurinë gramatikore, sintaksore e leksikore të gjuhës shqipe. Ky konceptim përshkon tejndanë librin

“*Albanian Grammar*” (“Gramatika e shqipes”), si përpunim i një botimi më të hershëm të një libri për mësimin e gjuhës shqipe të botuar gjermanisht, ku krahas shembujve nga dy dialektet e folur këndeje Adriatikut, janë integruar edhe shumë tekste nga të folmet arbëreshe për të ilustruar rregullat gramatikore. I bindur për vlerën e këtyre teksteve, Camaj iu përkushtua edhe mbledhjes së thesarit popullor, kryesisht përrallave e letërsisë gojore, që i shërbyen si material ilustrues për monografitë e tij me karakter dialektologjik. Frut i kësaj pune janë botimet: “*Racconti popolari di Greci in provincia di Avellino e di Barile in provincia di Potenza*” (“Tregime popullore të Greqit në krahinë të Avelinos e të Barilit në krahinë të Potencës”), të botuar italisht në Romë më 1972; si edhe “*Albanische Märchen*” (“Përralla shqiptare”), të botuar gjermanisht më 1974, në bashkëpunim me Uta Schier-Oberdorffer. Në këtë hulli janë edhe studimet për këtë fushë: “*Sugli elementi dei canti popolari nelle rapsodie dello Schirò*” (“Rreth elementeve të këngëve popullore në rapsoditë e Skiroit”) dhe “*Ein italo-albanisches Lied aus dem Skanderbeg - Zyklus*” (“Një këngë italo-shqiptare nga cikli i Skanderbegut”). Në vazhdë të kërkimeve gjuhësore italo-shqiptare është edhe interpretimi që Camaj i bën një fraze arbëreshe të vitit 1483, të gjetur brenda një teksti latin, analizën e së cilës e botoi në revistën “*Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung*” dhe më vonë edhe në revistën “*Zjarri*”, në bashkëpunim me dijetarin gjerman Ludwig Braun, që e kishte gjetur.

Të gjitha këto studime, së bashku me shumë të tjera, të botuara si monografi dhe artikuj shkencorë në katër gjuhë të huaja përveç shqipes, presin ditën të mblidhen, të kthehen në gjuhën me të cilën i sendërtoi dhe t’i jepen në dorë edhe studiuesit shqiptar. Le të shpresojmë.

Françesko ALTIMARI

(Itali)

**ÇËSHTJA ALFABETIKE TEK ARBËRESHËT E
ITALISË PARA DHE GJATË RILINDJES:
HISTORIA E “Ë”-SË**

Historia e alfabetit të shqipes, siç dihet, ka qenë një histori e vështirë dhe e mundimshme, e lidhur ngushtë me ngjarjet historike, politike dhe kulturore të kombit shqiptar. Mungesa gjatë shekujve të kaluar e një Shteti të pavarur kombëtar dhe sundimet e huaja të pandërprera kanë qenë pengesa objektive për procesin e forcimit etnik, gjuhësor dhe kulturor të këtij populli, proces ky që kishte pasur çaste përparimi të rëndësishme dhe konkrete qysh në mesjetë, me formimin e Shtetit të parë feudal të *Arbanonit*, në fund të shekullit XII, dhe sidomos në kohën e Skënderbeut, në shekullin XV, kur shqiptarët, për herë të parë në historinë e tyre, arritën bashkimin politik me krijimin e një shteti kombëtar. Por ajo që vetëm një provë e shkurtër historike, që u ndërpre përnjëherë nga sundimi turk, i cili, duke futur dhe duke përhapur në Vend islamizmin, për më shumë se katër shekuj i theksoi edhe më shumë ndarjet fetare dhe krahinore dhe natyrisht mbyti që në lindje çdo përpjekje për bashkimin gjuhësor, kulturor dhe aq më tepër politik të kombit shqiptar.

Janë këto arsye që deri në fillimin e shekullit XX nuk u krijuan kushtet për të arritur një gjuhë letrare kombëtare; jo vetëm kaq, por, për të njëjtat arsye, para Kongresit të Manastirit (1908), nuk u arrit të përcaktohej dhe të zbatohet një alfabet i vetëm për të gjithë shqiptarët, edhe pse gjatë këtyre shekujve nuk munguan përpjekje të spikatura për

këtë çështje, falë veprimtarisë së grupeve të zjarrta intelektuale, qoftë në mëmëdhe, qoftë në diasporë.

Në fakt, në arealet e ndryshme shqipfolëse, të paktën që nga fillimi i shekullit XIV, rregjistrohen tradita shkrimi të qëndrueshme të bazuara në sistemet alfabetike të të dy gjuhëve më shumë të përhapura në atë kohë: të latinishtes në Veri dhe të greqishtes në Jug. Kësaj tradite alfabetike, që pasqyronte edhe traditat e ndryshme fetare dhe kulturore të Vendit (ajo katolike latine në krahinat gege dhe ajo ortodokse greke në krahinat toske), në shekujt e sundimit turk dhe veçanërisht në shekujt XVIII – XIX, iu shtuan edhe sisteme shkrimi të kombinuara, disa të bazuara mbi germa të veçanta, disa heterogjene, edhe me shkronja glagolitike dhe cirillike sllave, si ashtu edhe alfabeti arab.

Duhet thënë se ky i fundit, megjithëse gjatë sundimit të gjatë turk paraqitej edhe si sistemi shkrimor i pushtetit në fuqi, që e përdorte edhe për shkrimin e turqishtes, që ishte gjuha e pushtetit-politik, fetar dhe kulturor -osman, qoftë për shkak të kushtëzimeve fetare, qoftë për shkak të papërshtatshmërisë së shkronjave arabe për të pasqyruar sistemin fonetik të shqipes, nuk pati kurrë një përhapje të gjerë në ambientin shqiptar, jashtë disa qarqeve të ngushta intelektuale islamike⁸.

Por, në Shqipëri, që sidomos alfabeti latin ai që në këtë spektër të gjerë alfabetesh pati historikisht një rëndësi të dukshme dhe një përhapje më të gjerë, falë edhe mbështetjes së pandërprerë të siguruar atij nga Kisha katolike përmes veprave të shumta fetare të priftërinjve katolikë gegë që prej shekullit XVII patën një qendër të madhe dhe të fuqishme shpërndarjeje nga “Propaganda Fide”, e cila qysh nga gjysma e parë e shekullit XVII e deri në fund të shekullit XIX shtypi në Romë me këto

⁸ “Autorët e ndryshëm që kanë përdorur alfabetin arabo-turk e kanë pasur të vështirë t’u shkëputeshin plotësisht veçorive të tingujve të arabishtes. Në shume raste ata kanë futur në punë grafi të ndryshme, kanë shtuar shkronja ose kanë stilizuar disa germa të alfabetit arab. Gjithashtu nuk janë dalluar në mes tyre disa tinguj-fonema, si dhe nuk janë pasqyruar me përpikëri të gjithë tinguj-fonemat e gjuhës shqipe”, në Artan Haxhi-Tefë Topalli, *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 1999, f.133.

shkronja të gjitha veprat didaskaliko-fetare të caktuara për Shqipërinë katolike. Me këtë alfabet, të plotësuar me pak shenja të alfabetit cirilik të ambientit dalmatin, u botuan veprat e shkrimtarëve të vjetër kishtarë të Veriut të traditës letrare gege (Buzuku, Bogdani, Bardhi, Budi etj.)

Përkundrazi, me shkronja greke u shkrua pjesa shqip e perikopesë së Ungjillit të Mateut që ruhet edhe sot në një dorëshkrim të vjetër në Bibliotekën Ambroziane në Milano, e cila sipas mendimit të disa studiuesve i takon fundit të shekullit XIV, megjithëse duket paraqitet më e bindshme teza që e konsideron atë të fundit të shekullit XVI. Për të takuar vepra të tjera të shkruara në gjuhën shqipe me alfabetin grek duhet të arrijmë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, dhe pikërisht më 1770, kur u botua në Venezia vepra *Πρωτοπειρία* e Teodor Kavaliotit.

Këto dy tradita alfabetike kryesore – ajo italo-latine në zonën gege dhe ajo greke në zonën toske – janë plotësisht të pranishme edhe në zonën arbëreshe dhe sidomos në rrethin e bashkësive siciliano – shqiptare, duke nisur të paktën që nga fillimet e shekullit XVII.

Por duhet të vëmë në dukje se në Itali mund të flitet për një “traditë alfabetike arbëreshe”, e bazuar në alfabetin italian, e cila, edhe pse është e ndryshme shpeshherë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri shkrimtar tek tjetri, ka tipare të përbashkëta karakterizimi, si p.sh. futja në sistemin grafik me bazë latine të disa shkronjave (ose dyshkronjave) të alfabetit grek.

Ky kombinim në sistemin e shkrimit arbëresh, është shprehje e gjendjes dykulturore që kanë pasur në të kaluarën – dhe pjesërisht kanë edhe sot – bashkësitë shqiptare të ritit fetar bizantin, të ndikuara nga njëra anë nga modeli kulturor italian dhe, nga ana tjetër, nga veçoria fetare greko-bizantine, që gjithnjë ka qenë një çast i rëndësishëm, edhe pse jo vendimtar, për identifikimin qoftë të brendshëm, qoftë të jashtëm, të këtyre bashkësive.

Pastaj prania e alfabetit latin të shkrimtarëve të vjetër gegë në rrethin arbëresh sigurisht merr një rëndësi të veçantë në historinë e kulturës shqiptare, sepse tregon kontaktet e vazhdueshme që kanë pasur

në shekujt e kaluar intelektualët arbëreshë me intelektualët e mëmëdheut, edhe në kushtet e vështira të pushtimit turk të Shqipërisë.

Duke u kthyer shkurtimisht në sistemet e ndryshme alfabetike të përdorura në mjedisin arbëresh të Sicilisë, duhet të themi se me alfabetin e shkrimtarëve të vjetër gegë Nilo Katalano, italian që mësoi arbërishten në Munxifs dhe shqipen në Himarë kur shkoi atje si misionar bazilian, shkroi një fjalor shqip dhe Nikollë Keta në vitin 1763 një fjalor i njohur si *Lessico albanese-italiano*. Por me alfabetin që mund ta quajmë tradicional arbëresh, të mbështetur mbi alfabetin italian dhe i plotësuar nga shenja kritike të veçanta, dyshkronja ose shkronja greke, u shkrua pjesa më e madhe e veprave, dorëshkrim dhe të botuara, të shkrimtarëve arbëreshë të Sicilisë dhe të Kalabrisë, duke u nisur nga *E mbësuarë e Krështerë* (La Dottrina Cristiana) e Lekë Matrëngës (1592).

Në të vërtetë, ndërsa për alfabetin grek – të përdorur midis të tjerash, tashmë nga Nilo Katalano (Nilo Catalano) (1637-1696), nga autori i traktatit *Urtësia e kërshhtë* të vitit 1755 dhe nga Nikollë Keta (Nicola Chetta) (1740-1803) në disa vepra të tij – mund të bëhet fjalë jo me domosdo për një ndikim të jashtëm, por për një traditë të brendshme të këtyre bashkësive, të cilat kishin të njëjtin rit fetar greko-bizantin, nuk është kështu për alfabetin e shkrimtarëve gegë, që pati një përhapje të gjerë edhe në Sicili, falë veprave të botuara në gjuhën shqipe me këtë alfabet nga shtypshkronja shumëgjuhëshe e Institutit papnor “Propaganda Fide”.

Kështu, prania e dy institucioneve të rëndësishme fetare, siç ishin manastiri bazilian i Munxifsit, (Mezozjuso) themeluar nga Andrea Reresi më 1609 dhe seminari greko-shqiptar i Palermos, i kërkuar dhe i realizuar nga P. Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzetta) më 1734, u siguroi bashkësive shqiptare të Sicilisë një qarkullim të dobishëm dhe nxitës të veprave dhe të ideve me grupet e tjera të intelektualëve shqiptarë si dhe një trashëgimi të madhe kulturore që na lejon, midis të tjerash, edhe të kuptojmë ndihmesën e kualifikuar që kanë dhënë në mënyrë të pandërprerë intelektualët kishëtarë siciliano-arbëreshë për nxjerrjen në dukje të

veçorisë kombëtare, fetare dhe gjuhësore të etnisë së tyre.

Seminarit greko-arbëresh të Palermos, në Sicili, të cilit duhet t'i njihet merita se ka qenë inkubatori i parë formativ dhe ideologjik i kulturës italo-shqiptare gjatë shekullit XVIII, duhet t'i njihet gjithashtu merita se ka zhvilluar, megjithëse brenda një sistemi alfabetik jo shumë unitar, që paraqiste qoftë një traditë grafemike me bazë latine, qoftë një traditë grafemike me bazë greke – të dy të pranishme në menyrë domethënëse më parë në veprën e Nikollë Ketës dhe pra në veprën e Dhimitër Kamardës – disa drejtime homogjene që nënkuptonin një qarkullim dhe një ndarje të dendur veprash dhe zgjidhjesh midis intelektualëve me autoritet që vinin njëri pas tjetrit në krye të Institutit. Një nga këto tendenca, që u poq brenda Seminarit, ka qenë adoptimi i grafemës <ë>, me të cilën për herë të parë, u tregua në shqipe zanorja neutrale ose “schwa”.

Në sajë të punës së vyer shkencore të katedrës së shqipes të Universitetit të Palermos, nën drejtimin e kolegut dhe mikut Matteo Mandalà, që nisi botimin sistematik të dorëshkrimeve të shumta dhe të rëndësishme për kulturën arbëreshe të prodhuara në ambientin e Seminarit greko-arbëresh të Sicilisë, në gjuhë të ndryshme – latinisht, italisht dhe arbërisht – që ruhen sot pjesërisht në Arkivin e Seminarit, të transferuar pas Luftës së dytë botërore në Horën e Arbëreshëve, dhe pjesërisht në Bibliotekën mbretërore të Kopenhagës, dhe duke u bazuar mbi rezultatet e arritura nëpërmjet analizës së këtij materiali të pasur shkrimor të shekullit XVIII, që i referohet ambientit intelektual arbëresh sicilian, që sot jemi në gjendje të përshkruajmë më hollësisht dhe me objektivitet, dhe jo më me hamendje si ishte më parë, mund të themi se i pari intelektual që e përdori shkronjën “arbëreshe” <ë> në sistemin e vet alfabetik për ta shkruar arbërishten ka qenë themeluesi i Seminarit, Atë Gjergj Guxeta, me të cilin, për herë të parë u tregua në botën arbëreshe dhe në botën shqipe zanorja neutrale ose “schwa”.

Papas Gjergj Guxeta e përdori këtë shkronjë për herë të parë në veprën e tij mbi historinë civile dhe fetare të arbëreshëve, *De*

*Albanensium Italiae ritibus excolendis ut sibi totique S.Ecclesiae prosint*⁹, që u gjet kohët e fundit në arkivin e famullisë së Shën Mitrit në Horën e Arbëreshëve, që me sa mund të supozohet nga përmbajtja mund të jetë përpunuar në periudhën 1730-1756.

Mund ta konsiderojmë si një ndikim direkt nga kjo vepër, e mbetur dorëshkrim, përdorimi edhe i grafemës <ë> në veprën e Pal Maria Parrinos, , që e adoptoi në veprën e tij monumentale, *In septem perpetuae consensionis libros Albanensis Ecclesiae cum Romana omnium Mater et Magistra* (1765), edhe kjo e mbetur dorëshkrim.

Parrino, që pas vdekjes së Guxetës, qe pasardhës i tij në drejtorinë e Seminarit greko-arbëresh, e mbaroi veprën e tij pak kohë para vdekjes. Aty ai e përdori për schwanë, me gjase për ndikim direkt nga vepra e Guxetës, e mbetur dorëshkrim deri në vitin 2007, edhe një variant i grafemës së adoptuar nga Guxeta që paraqitet si një e me një pikë përsipër <ë>. Të njëjtin variant, domethënë një <ë> me një pikë përsipër, e ndoqi Nikollë Filja në Dorëshkrimin e Qeftit (1733-1739), për të cilën vepër disponojmë sot edicionin filologjik të përsosur të përgatitur nga Matteo Mandalà.

Sipas modelit grafemik të papas Gjergj Guxetës e përdori pra ë-në Nikollë Brankati¹⁰, i cili përdori më shumë se një shkronjë për schwanë: krahas ë-së, Brankati përdori edhe 8¹¹, që tek tuk e gjejmë edhe te

⁹ Kjo vepër u botua kohët e fundit në përkthimin italisht të përgatitur nga Pina Ortaggio: Padre Giorgio Guzzetta, *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, Palermo, 2007, f.78.

¹⁰ Këtë dëshmi ma dha gojarisht kolegu Matteo Mandalà që e gjeti në një fletë dorëshkrimi.

¹¹ Përpos Brankatit, edhe gjyshi i Gavril Darës (Gavril Dara plaku) e ka përdorur këtë shkronjë <8>, me tri pika përsipër .: për të treguar shvanë: shihet qartë kjo nga dorëshkrimi i ti, i gjetur në bibliotekën e Kopenahes dhe botuar kohët e fundit nga Mateu Mandalà (shih Gabriele Dara junior, *Kënga e sprasëme e Ballës* (Il canto ultimo di Bala). Edizione critica di Matteo Mandalà, Palazzo Adriano, 2007, f.228). Me gjase kjo 'rrugë' mund të na ndihmojë të shpjegojmë praninë e një grafeme të ngjashme, që përkon me një farë <a> të anasjelltë, edhe në autorë të kohës të ambientit arbëresh të Kalabrisë: e kam

Parrino, krahas e-së me një pikë sipër.

Por ai që në mënyrë më konsekuente dhe të vetëdijshme e mori dhe e përhapi shkronjën <ë> që gjeti nga vepra e Guxetës, që si veprat e tjera të shkruara nga intelektualët kishtarë të Seminarit, megjithëse mbeti dorëshkrim, qarkullonte brez pas brezi në qarkun e inteligencjes italo-shqiptare, ka qenë Nikollë Keta. Studiuesi kuntisjot që për kontributin e madh që dha me traktatet e tij filozofike si *Tesoro di Notizie su de' Macedoni* (1777) dhe me veprat e shumta dhe të rëndësishme dhe të vyera letrare dhe gjuhësore duhet konsideruar si parardhësi i vërtetë i Rilindjes shqiptare, e njihte dhe e konsultoi veprën e Guxetës *De Albanensium Italiae ritibus excolendis ut sibi totique S.Ecclesiae prosint*, që citoi pra në veprën leksikografike *Lessico italian'e macedone* (1779), i njohur edhe si fjalori “etimologjik”.

Ky intelektual i shquar, deri sot shumë pak i njohur meriton një vëmendje të posaçme nga studiuesit e albanologjisë sepse ka qenë autori i një serie të jashtzakonshme veprash – kulturore, letrare dhe gjuhësore – që mbetën deri sot të pabotuara, që na japin një profil të lartë studiuesi, që, siç vërente i ndjeri linguist i shquar shqiptar Eqrem Çabej, tregonte një përjasje moderne ndërdisiplinore në trajtimin e çështjeve që përballonte, edhe në fushën e kulturës arbëreshe.

Si studiues Nikollë Keta meriton një konsideratë të re brenda historisë së kulturës, të letërsisë dhe të gjuhësisë shqiptare. Ndër veprat e shumta ku Keta e përdori ë-në , përmendim këtu: fjalorin *Leksiko liti kthiellë arbërisht* (1763), pjesërisht *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*

fjalën për Jul Varibobën, i cili në shtypjen e veprës së tij të famshme *Gjella e Shën Mëris'së Virgjër* (1762) adoptoi këtë <a> që dëftohet shumë e afërt grafikisht me shkronjën e Brankatit sidomos në versionin kursiv që na ofron gërma e madhe, gjithashtu e anasjelltë. Meqenëse vepra e Brankatit mbeti dorëshkrim, mbetet për të shpjeguar ‘rruga’ e këtij ndikimi, megjithëse siç dimë nuk mungonin në Romë atëherë klerikë arbëreshë të Sicilisë me të cilët vet Variboba mund t’u ketë takuar, si del qartë nga recensentët e *Gjellës* ku figurojnë Tomaso Nicolò Masaracchi dhe Joseph Stassi, priftërinj arbëreshë të kishës katolike lindore arbëreshe të Sicilisë.

(1777)¹² dhe atë që ai quan fjalor “etimologjik”, domethëne veprën leksikografike madhore në 680 faqe *Lessico italian'e macedone* (1779).

Kjo traditë shkrimore, e përdorimit të ë-së deri në fillim të shekullit XIX mbeti e kufizuar vetëm në veprat e shkruara të mbetura dorëshkrim të intelektualëve arbëreshë të Seminarit të Palermos, por nga ky laborator u përpunua dhe u përhap pra në tërë botën arbëreshe dhe shqiptare.

Nga ky kontekst i veçantë fetar-kulturor-gjuhësor kjo shkronjë pati pra një përhapje më të gjerë që u zyrtarizua për herë të parë në një vepër shtypi më 1787, kur doli në versionin sikulo-arbëresh të lutjes “Ati ynë” të librit *Saggio pratico delle lingue*, vepër enciklopedike dhe erudite mbi gjuhët e botës e përgatitur dhe e botuar nga jezuiti Lorenzo Hervas y Panduro¹³.

I pari arbëresh që e përdori këtë gërmë në një vepër të botuar me sa duket ka qenë Imzot Zef Krispi, edhe ky rektor i Seminarit arbëresh të Sicilisë dhe ungji i Kryeministrit italian Françesko Krispi. E gjejmë të përdorur shkronjën <ë> në veprat e tija, të dy të botuara në Palermo, *Memoria sulla origine e fondazione di Palazzo Adriano colonia greco-albanese in Sicilia* (1827) dhe *Memoria sulla lingua albanese* (1831).

Botimi i saj në veprat e Zef Krispit natyrisht që favorizoi përhapjen e kësaj shkronje në traditën shkrimore arbëreshe edhe në qarqet e tjera arbëreshe: atë e gjejmë kështu në ambientin intelektual arbëresh të Napolit në sajë të botimit të një ish-nxënësi të Ketës, Emanuel Bidera, *Quaranta secoli : racconti su le due Sicilie del Pelasgo Matr-eer* (1846), në ambientin arbërishtfolës të Kalabrisë nëpërmjet veprave të Frangjisk Anton Santorit, *Il Canzoniere Albanese* (1846), Vinçenc Dorsës, *Su gli*

¹² Tomor Osmani (shih *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f.147) duke cituar Mandalà, jep e me një pikë sipër <ë>shkronjën për "schwane"-n e përdorur nga Keta në këtë vepër.

¹³ Për këtë vepër, dhe posaçërisht për tekstet arbëreshe që aty u botuan nga Hervas y Panduro shih kontributin tim “Testi albanesi di Calabria e di Sicilia nelle opere di Hervas” (pp.61-86) në *Studi linguistici arbëreshë*, Quaderni di Zjarri, 12, Cosenza, 1988.

Albanesi. Ricerche e Pensieri (1847) dhe *Studi etimologici della lingua albanese* (1862) dhe përsëri në qarkun arbëresh-sicilian përmes alfabeve të ndryshme të përdorura nga Dhimitër Kamarda.

Edhe De Rada, duke botuar gramatikën e vet të parë arbëreshe (1870), e pranoi këtë inovacion që pra, duke u integruar në modelet e tija shkrimore që patën një përhapje të gjerë qoftë përmes letërsisë së tij të krijuar pas viteve '70, qoftë përmes prodhimit didaktiko-gjuhësor që u shtua me hapjen e shkollës arbëreshe dhe me vendimet e Kongreseve linguistike panarbëreshe të Kurëlanës (1895) dhe të Ungrës (1897), u konsiderua në botën intelektuale shqiptare si 'gërmë' e De Radës!

Edhe vetë Luigj Gurakuqi, nxënësi i fundit i De Radës në Kolegjin e Shën Adrianit dhe element bashkimi midis komunitetit arbëresh dhe atij shqiptar në fillimin e shekullit XX, e përdori ë-në alfabetin e vet të vitit 1901, sipas përshkrimit që na jep Tomor Osmani.

Meqenëse Gurakuqi përfaqësoi në Kongresin e Manastirit edhe Arbëreshët e Italisë dhe duke marrë parasysh atë që shkroi Justin Rrota për alfabetin e Manastirit si alfabet koalicioni¹⁴, me një 'përqindje' të Bashkimit, një përqindje të Stambollit dhe një përqindje Arbëreshe, mund të ketë qenë ndërhyrja e tij që në këtë mënyrë dëshironte ta nderonte kujtimin të Poetit tonë të madh dhe veprën titanike të tij në shërbim të kulturës kombëtare, elementi vendimtar që bindi Komisionin e ngarkuar të zgjidhte alfabetin e bashkuar të gjithë shqiptarëve, të zgjidhte ë-në brenda sistemit të alfabetit të njësuar që sot njohim si alfabeti i Monastirit.

Brenda këtij kuadri të përgjithshëm që deri sot njihej vetëm pjesërisht për shkak të mosnjohjes së dokumentacionit të gjetur vetëm kohët e fundit nëpër arkivat, italiane dhe të huaja, jemi orvatur të rindërtojmë këtu shkurtimisht historinë e ë-së, që më shërbeu si metaforë për të përshkruar lidhjet e gjata dhe të ngushta që karakterizojnë raportet

¹⁴ Justin Rrota, *Për historinë e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1936, f.90: "Që element kryesorë që përmbanë këtë alfabet koalicioni: 'Bashkimi': dh, th, ll, rr, sh: alfabeti i Stambollit: y, c, ç, q, z, x; alfabeti i De Radës: ë, gj, një".

midis të dy bashkësive tona, asaj arbëreshe dhe asaj shqiptare, gjatë shekujve të kaluar, që dëftohen kështu jo shekujt e heshtjes dhe të izolimit, siç janë trajtuar gabimisht, por shekujt e vazhdimësisë dhe të rigjenerimit të një identiteti të përbashkët por të ndryshëm, që edhe në kohë të vështira gjeti ushqim shpirtëror nëpërmjet marrëdhënieve që këto grupe intelektuale u përpoqën të mbanin gjallë dhe të pasuronin, edhe në kontekstet gjeografike dhe kombëtare të ndryshme ku ata u ndodhën për shkak të stuhive të historisë.

Historia e ë-së, në fjalë të tjera, na sintetizon në mënyrë emblematike këto kontakte kulturore dhe shkencore, që rigjeneruan nëpër shekujt një identitet shumë që mbetet edhe sot një tipar i veçantë i bashkësisë sonë arbëreshe dhe që përfaqëson një element force të tërë komunitetit shqiptar, të ndarë nga feja, nga historia dhe nga gjeografia, por të bashkuar nga gjuha dhe nga kultura.

Dhe kjo gjermë e alfabetit të përbashkët me të cilën jemi marrë në këtë ekskursion të shpejtë në historinë e shkrimit të gjuhës sonë në mjedisin arbëresh, mund të themi se në mënyrë shumë domethënëse përmbledh si shkronjë-flamur të gjitha këto përpjekje të intelektualëve tanë për t'u njohur në një alfabet të përbashkët panshqiptar.

BIBLIOGRAFIA:

1. *Abecedario della lingua albanese approvato ed adottato dal Congresso Nazionale unito in Corigliano Calabro nell'Ottobre del 1896*, edito a spese del Cav.Uff.Anselmo nobile Lorecchio, Vice Presidente della Società Albanese, Corigliano Calabro, 1896.
2. F. Altimari, "Testi albanesi di Calabria e di Sicilia nelle opere di Hervás" (pp.61-86) in *Studi linguistici arbëreshë*, Quaderni di Zjarri, 12, Cosenza 1988.
3. N. Chetta, *Testi letterari in albanese*, a cura di M. Mandalà, Albanica 22, Caltanissetta 2004.
4. N. Chetta, *Leksiko liti kthiellë arbërisht*. Edizione critica a cura di G. Cerniglia, Prefazione di M. Mandalà, Albanica 28, Palermo, 2008.
5. N. Chetta, *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*, Introduzione di M. Mandalà, Trascrizione di G. Fucarino, Palermo-Contessa Entellina, 2002.
6. G. Dara junior, *Kënga e sprasëme e Ballës* (Il canto ultimo di Bala). Edizione critica di Matteo Mandalà, Palazzo Adriano, 2007.
7. N. Figlia, *Il Codice Chieutino*. Edizione critica e concordanza a cura di M. Mandalà, Comune di Mezzoiuso, 1995.

8. G. Guzzetta, *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, Palermo, 2007.
9. A.Haxhi-T.Topalli, *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 1999
10. T. Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999.
11. J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1936.
12. L. Scutari, *Amor del patrio loco o ricordi italo-albanesi*, Roma, Tipografia di G. Balbi, 1899.
13. Dh. S.Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976.
14. F. Solano, *Il Catechismo Albanese di San Basile*. Edizione del manoscritto con trascrizione e interpretazione linguistica, Quaderni di Zjarri, n.8, Roma, 1983.

Tomor OSMANI

(Shkodër)

**STUDIMET GJUHËSORE PËR ARBËRESHËT NË
VËSHTRIMIN E PROF. JUP KASTRATIT.
VLERËSIME DHE INTERPRETIME**

Prof. dr. Jup Kastrati ishte një personalitet i shquar i kulturës shqiptare, që i dha asaj vepra dhe studime me shumë vlerë që e ruajnë edhe sot aktualitetin shkencor. Ai është çmuar nga studiues të kulturës shqiptare në lëmin e gjuhësisë, si nga M. Domi, Sh. Demiraj, Dh. S. Shuteriqi, R. Qosja, K. Topalli, E. Lafe, T. Osmani etj., duke përfshirë edhe botuesin e veprës së tij në Kosovë B. Baliun. Prof. Eqrem Çabej shkruante: *“Punimet e prof. Kastratit dallohen për një kujdes dhe akribi të madhe në gjurmim të çështjeve gjuhësore.”*

Tematika e studimeve të Jup Kastratit ka një diapazon të gjerë, që përfshijnë studime me karakter gjuhësor, kryesisht për historinë e gjuhësisë shqiptare dhe të albanologjisë, për historinë e letërsisë shqiptare, veçanërisht për Rilindjen tonë Kombëtare, për shkollën shqipe dhe për mendimin e qytetërimin shqiptar.

Me shumë zell studiuesi ynë është marrë me kulturën e arbëreshëve të Italisë e në veçanti me De Radën, që e kishte për zemër, por një vëmendje u ka kushtuar studimeve gjuhësore për shumë autorë dhe personalite arbëreshe, që vepra e tyre mund të vlerësohet edhe në aspektin gjuhësor, disa prej të cilëve do t'i evidentojmë në këtë kumtesë, si: Engjëll Mashi, Gjon Skiroi, Mikel Skutari, Pal M. Parrino etj. Me të drejtë është çmuar nga bota arbëreshe për këtë ndihmesë që ka dhënë Kastrati në këtë rrafsh. Studiuesi arbëresh Antonino Belushi shkruante: *“Profesor Kastrati është konsideruar si njëri nga studiuesit më të mëdhenj*

të kohëve tona për Jeronim de Radën dhe për tekstet gramatikore të gjuhës shqipe.”

Dy janë veçoritë e studimeve të J. Kastratit: së pari, të popullarizojë dhe t’u bëjë të njohur opinionit shqiptar dhe të huaj vlerat e studiuesve arbëreshë për shqipen dhe kulturën shqiptare dhe së dyti, të evidentojë veprimtarinë shkencore të shumë personaliteteve arbëreshe të njohur pak ose aspak në botën shqiptare, duke gjurmuar, hulumtuar, interpretuar dhe sintetizuar punën e tyre shkencore dhe duke i dhënë vendin që i takon edhe në historinë e albanologjisë. Mund të ketë edhe kritika, por ai ka ditur me ato mundësi që ka pasur, larg mjedisit arbëresh arkivor dhe bibliotekar, me një vizitë vetëm disa ditore në Kalabri, të ushqehet me një informacion të mjaftueshëm, që pak studiues mund ta bëjnë. Ka qenë pasioni nga njëra anë dhe bibliografi nga ana tjetër që prof. Kastrati të trajtojë radhazi në shkrimet e tij disa nga figurat më të spikatura të kulturës arbëreshe, duke veçuar ndihmesën në fushën e gjuhës shqipe.

Në monografinë “*Historia e albanologjisë*”, vëll. I, 802 f. Tiranë, 2002, një vepër me vlera enciklopedike, që analizon rreth 100 autorë veprash e studimesh, Kastrati ka dhënë një informacion shkencor për shumë autorë që u përkasin edhe trojeve arbëreshe dhe janë marrë me gjuhën shqipe.

Me interes nga vëllimi i parë i kësaj monografie për kumtimin tonë janë dy krerë: I pari ia kushton lëvizjes mendore gjuhësore në mjedisin arbëresh të Italisë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Në këtë periudhë vëren Jup Kastrati zhvillohet një lëvizje e mirë mendore në lëmin e studimeve historiko-gjuhësore-etnografike, folklorike dhe letrare. Dijetarët arbëreshë vazhduan traditën në të mirë të gjuhës dhe të kombit shqiptar. Në këtë periudhë parashkencore të studimeve albanologjike Kastrati ndalet në kontributet me vlerë, por jo aq të njohura në mjedisin shqiptar, si të Gjergj Guxetës, punimet historike-gjuhësore të Pal Maria Parinos, veprat etnografike, leksikografike dhe gramatikore të Nikollë Ketës. Autori shtron detyrën që dijetarët bashkëkohorë të gjurmojnë në

thellësi të shekujve për të nxjerrë në dritë ndihmesat e vyera të autorëve të hershëm arbëreshë. Është një konstatim i drejtë për një periudhë më të hershme, pasi studiuesit e sotëm arbëreshë kanë ecur përpara si me gjurmime, kërkime, hulumtime, por edhe me gjetje të reja të cilat i kanë publikuar në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëruar me botime monografish. Autori lëvizjen mendore arbëreshe e ka parë të shkallëzuar sipas periudhave historike, të ndara sipas shekujve. Për gjuhësinë shqiptare, në gjysmën e parë të shekullit XIX, ndër arbëreshët e Italisë, veprimtarinë e studiuesve të këtij mjedisi e lidh me rritjen e lëvizjes çlirimtare në Shqipëri, pasi një pjesë e kësaj letërsie u frymëzua nga idetë e lëvizjes sonë. Objekt studimi është bërë veprimtaria shkencore-botuese, kryesisht në fushën gjuhësore të E.Mashit, A.Darës, M.Skutarit, Z.Krispit, E.Biderës, V. Dorsës etj.

* * *

Edhe ne në vazhdim të kësaj kumtese do të ravijizojmë kontributin e J.Kastratit për disa figurat më të rëndësishme të kulturës arbëreshe , si dhe për lëvizjen mendore pas Luftës së Dytë Botërore në këto troje. Do të ndalemi te vlerësimet e interpretimet e Kastratit për Engjëll Mashin (1758-1821). Mikel Skutarin (1762-1830), Vinçens Dorsën, G.Petrotën, Marco la Pianën.

* * *

Engjëll Mashi ishte një dijetari shquar arbëresh, që u dallua si gjurmues e studiues i flaktë i gjuhës shqipe dhe i historisë së Shqipërisë, i etnografisë dhe i të drejtave shqiptare. Në vitin 1807 botoi librin “*Ligjerata për zanafillen, doket dhe gjendjen aktuale të kombit shqiptar.*” Është i pari kontribut nga një autoritet shkencor që në fillim të shekullit XIX del në mbrojtje të identitetit të kombit e të popullit shqiptar. Sipas Kastratit, merita e tij qëndron pikërisht këtu që në mënyrë të matur, duke njohur mirë autorët klasikë dhe duke mos u ndalur gati fare në etimologji, hartoi një vepër serioze për kohën. Ai përpiqet të argumentojë me të dhëna

historike, gjuhësore, toponomastike dhe etnografike, ndonëse të pamjaftueshme tezën e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre dhe të prejardhjes së shqipes nga ilirishtja.

Botimi dhe ribotimi në italisht i veprës së E.Mashit, përkthimi në frëngjisht dhe riprodhimi i saj në disa të përkohshme franceze, ndihmoi mjaft për t'i bërë të njohur shqiptarët në Evropë. Vlera e veprës me kalimin e kohës u rrit dhe jehona që e gjerë. Përsëri, sipas J.Kastratit, kjo vepër pati edhe një fat të veçantë. Ajo u fut në rrethet intelektuale italiane dhe të huaja franceze dhe daneze. Vepra që me dobi për popullarizimin e kombit dhe të gjuhës sonë. Këtë vepër Kastrati e zbërthen me detaje, duke veçuar vlerat e saj, në radhë të parë se autori kishte bindjen e plotë se shqiptarët rridhnin prej ilirëve dhe të gjuhës shqipe prej ilirishtes. Përpyekjet e E.Mashit për të përcaktuar prejardhjen e popullit dhe të gjuhës shqipe prej ilirishtes janë në vazhden e punës së bërë gjatë shek.XVIII nga dijetarët e tjerë arbëreshë e paraadhësit e tij, si Gj.Guxeta, Pjetër Pompil Rodotà, Pal Maria Parrino dhe Nikollë Keta. Tezën e tij për prejardhjen e shqiptarëve, E.Mashi përpiqet ta argumentojë me veprat e shkrimtarëve të antikitetit, si dhe me anën e të dhënave historike dhe gjuhësore, etnografike dhe toponomastike. *“Teoria e prejardhjes ilire, shkruante akad. Mahir Domi, gjeti parashtim të plotë e të argumentuar në veprën e arbëreshit E.Mashit.”* Ai mbron vijimin e gjuhës së maqedonëve, të epirotëve, të ilirëve nëpërmjet të shqipes. Mashi pohon se shumë emra të përveçëm maqedonë përkojnë me apelativa të shqipes së sotme. Kastrati thekson se Mashi pa u njohur me mendimet e Tunmanit, 35 vjet pas tij mbron me një shqyrtim më të shumanshëm se ai, prejardhjen e shqiptarëve prej ilirëve dhe prej fiseve epirote e maqedone farefise me ta, autoktoninë e tyre në vendbanimet e sotme, në një kohë kur qarkullonin mjaft teori të pasakta. Studimet shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore me të dhëna nga arkeologjia historike, gjuhësore, etnografike dhe toponomastike kanë argumentuar shkencërisht dhe afirmuar plotësisht tezën e origjinës ilire të shqiptarëve dhe të shqipes.

* * *

Mikel Skutari ishte një personalitet i kulturës arbëreshe që i përket gjysmës së dytë të shek.XVIII dhe fillimit të shek.XIX për të cilin në vendin tonë nuk është shkruar. Ai qe historian, etnograf, gjuhëtar dhe folklorist. Ai, sipas J.Kastratit, ka qenë ndër studiuesit e parë që mbrojti autoktoninë shqiptarëve në viset të sotme, individualitetin kombëtar, lashtësinë e gjuhës shqipe, historinë tonë të lavdishme, pasurinë e krijimtarisë popullore.

M. Skutari në vitin 1825 botoi librin në italisht *”Të dhëna historike mbi origjinën dhe vendosjen e arbëreshëve Mbretërinë e Dy Sicilive, mbi natyrën, gjuhën dhe ritmet e tyre* (Notizie storiche sull’origine e stabilimento degli albanese nel Regno delle Due Sicilie sulla loro indole linguaggio e rito), një vepër shumë e rrallë. Kastrati thekson se M.Skutari mbron me një stil të matur, të mprehtë, por edhe me pjesë sulmuese *“fisnikërinë e origjinës së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe.”* E përlij veten M.Skutari, duke qenë i ndërgjegjshëm se nuk ka arritur të hartojë një vepër shkencore, pasi pengesë ka qenë gjuha, sepse italishtja nuk është gjuha amtare e tij. Ashtu si edhe për arbëreshët e tjerë edhe veprën e Skutarit e analizon Kastrati me hollësi. Po ndalemi te kreu IV që titullohet *“Gjuha shqip.”* Ai mbron tezën se gjuha shqipe *“është e ilire, epirotike, maqedone.”* Sipas Kastratit, M.Skutari pas E.Mashit *“është i pari dijetar shqiptar që sheh në shqipen një pasardhëse të drejtpërdrejtë të ilirishtes.”* Si përfundim, mund të themi se në historinë e studimeve albanologjike deri më sot nuk është vënë re ky mendim i arbëreshit tonë të ditur.

M. Skutari me këtë vepër qëndron në mes dijetarëve të përmendur të lëvizjes mendore të arbëreshëve të Italisë të mbarimit të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX. Ai dëshironte të zgjonte ndërgjegjen kombëtare të të rinjve, t’u kujtonte atyre prejardhjen e lashtë ilire të mbronte autoktoninë e shqiptarëve në viset e tyre të sotme, duke e konsideruar bijë të ilirishtes. Kontributet e tij janë shënuar edhe për etnografinë shqiptare, ngulimet arbëreshe etj.

* * *

Vinçens Dorsa. Duke analizuar veprën e V. Dorsës, prof. Kastrati thekson se është ndër personalitetet më pak të popullarizuar të kulturës shqiptare, por i njohur për veprimtarinë e tij në shërbim të kulturës kombëtare. Ai ka hyrë në historinë e kulturës sonë si i pari estet shqiptar, studiues i historisë së mendimit letrar dhe historian i letërsisë shqipe. Mendimet dhe analizat për krijimtarinë e Jul Varibobës dhe të De Radës lëvrojnë për herë të parë këtë fushë të studimeve tona. Personalitet poliedrik, Dorsa na shfaqet si një figurë komplekse: kritik letrar, historian, filolog, etimolog, folklorist, etnograf, studiues i thellë i traditave të shëndosha letrare.

Ai iu vu hartimit të veprave gjuhësore, duke u mbështetur vetëm në përgatitjen shkollore të marrë në Kolegjin Arbëresh të Shën Adrianit që ishte shkollë e mesme dhe në atë të kolegjit të Propogandës Fide, që ishte institucion i lartë fetar. Në veprat me karakter gjuhësor është për t'u shënuar "*Mbi shqiptarët, kërkime e mendime*", shoqëruar me një citat frëngjisht. "*I lumtur është shkrimtari që i ngre një përmendore vendit të vet.*"

Vepra mbi shqiptarët është një libër i pasur, me njohuri historike, gjuhësore, folklorike, etnografike, letrare etj. mbi Shqipërinë, shqiptarët dhe arbëreshët. Ai merret veçanërisht edhe me origjinën e popullit tonë dhe atë e gjen te popujt e lashtë jogrekë të Ballkanit, te maqedonët, ilirët e epirotët, ashtu siç kishin bërë përpara tij Nikollë Keta, Engjëll Mashii, Zef Krispi, Gjon Skiroi, De Rada etj. Vepra është cilësuar si një manifest i fortë arbëresh i kohës në favor të lëvizjes kombëtare të Shqipërisë. Kjo vepër, sipas prof. Kastratit, tërhoqi vëmendjen e dijetarëve të kohës për pasurinë e të dhënave historike, gjuhësore, folklorike, etnografike, letrare etj. Interes të veçantë kanë shënimet që bëjnë fjalë për historinë e ngulimeve arbëreshe të Italisë, për njerëzit e tyre të shquar, për gjuhën dhe historinë e popullit shqiptar, si dhe të dhënat e zakonet e këngët popullore arbëreshe. J. Kastrati ndalet edhe te vepra tjetër "*Studime etimologjike*"(1862), duke u përqendruar në tezat për lashtësinë e gjuhës shqipe që e përfshin në familjen indoevropiane.

Si i tillë, thekson dijetari ynë, ajo paraqet përkatësinë e vet farefisnore me të tjerat të së njëjtës origjinë, si me sanskritishten, greqishten e vjetër, latinishten etj. Në historinë e studimeve albanologjike nuk është theksuar një pohim i tillë. Ai ishte përkrahës i popullit tonë dhe shqyrtues i etnogjenesës së tij.

* * *

Le të ndalemi edhe në dy personaliteve të arbëreshëve të Italisë që i përkasin, kryesisht gjysmës së parë të shekullit XX në vlerësimin e Kastratit: **Gaetano Petrotta** (1882-1952) dhe **Marco la Piana** (1883-1958.)

* * *

G.Petrota ishte një dijetar i mirënjohur arbëresh, erudit dhe me kulturë të gjerë filologjike. Vlerësohet në fushën e studimit të historisë së letërsisë dhe të gjuhësisë shqiptare. Janë veprat që e lartësojnë këtë figurë, si: *Fonetika krahasimtare e gjuhës shqipe, Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare* (1931, 1932), që është kryevepra e tij, *Zhvillimi historik i kulturës dhe i letërsisë shqiptare* etj. etj., të cilat tregojnë bagazhin e gjerë gjuhësor dhe letrar të Petrotës, ndonëse fillimisht u mor me publicistikë.

Në fushën e albanologjisë, çeli këtë hulli me studimin “*Në lidhje me një katekizëm të shqip të shek.XVIII*” dhe vazhdoi me punime të tjera të natyrës gjuhësore. Sipas J.Kastratit G. Petrota ka hyrë në historinë e kulturës kombëtare si një nga mendimtarët më të shquar të viteve 1910-1952. Ishte studiues i mirënjohur i historisë sonë letrare, lëvrues i përmendur i gjuhës dhe i gjuhësisë shqiptare, shkencëtar i dalluar e i çmuar i lëvizjes mendore arbëreshe të Italisë, dijetar me njohuri të shumta e me kulturë të gjerë, epigon i shkëlqyer i lavdisë sonë.

* * *

Me **Marko la Pianën**, sipas Kastratit, nis ai brez i autorëve arbëreshë që zbatojnë metodat e gjuhësisë moderne, por që mund të kritikohet për

mungesën e një metode të rreptë shkencore, për disa teza gjuhësore si për një shqipe të përzier në të shkruar etj. Një kontribut ka dhënë për tekstet shkollore të fillores me tekstet e tij gramatikore shqipe, ashtu edhe për studimet shqiptare me karakter filologjik. Karakteristikë e punës së tij ka qenë se *“punoi i vetmuar, pa përkrahjen e askujt, duke sakrifikuar gjithçka për idealin e tij.”* Shkroi shumë, por botoi pak. I nis shkrimet gjuhësore me botimin *“Doktrina e Krishterë e Lukë Matrëngës”* (1912). ndërsa pesë vjet më vonë, më 1917 botoi në Vlorë librin italisht-shqip *“Gjuha shqip”*. Pastaj përsëri në Vlorë, si broshura nga 15-25 faqe botoi *“Mësime të shkurtë të gramatikës shqype për klasën e dytë fillore”*(Pjesa e parë) *“Mësime të shkurtë të gramatikës shqype për klasën e dytë fillore”*(Pjesa e dytë) *“Mësime të shkurtë të gramatikës shqype për klasën e dytë fillore”*(Pjesa e tretë).

La Piana në vitin 1937 botoi veprën *“Rreth refleksit të zanores “O” të gjatë nga indoevropianishtja dhe latinishtja në shqip”*.

Kur ishte në një moshë të pjekur, botoi vëllimin e parë *“Prelegomen në studimin e gjuhësisë shqiptare”* (1939) dhe 10 vjet më vonë pjesën e dytë. Së fundmi duhet të përmendet *“Shënime për gramatikë e gjuhës shqipe”* që, për J. Kastratin është fillimi i morfologjisë historike të shqipes. Duke qenë një dashamirës i kulturës arbëreshe dhe personaliteteve të saj që janë marrë me shqipen, ai i vlerëson studimet e Marko la Pianos për mendime origjinale dhe për qendrimet kritike ndaj disa zgjidhjeve të mëparshme, duke u radhitur ndër dijetarët dhe gjuhëtarët tanë të shquar, si dhe të albanologëve të përmendur të shekullit të kaluar.

* * *

J. Kastrati një kujdes të veçantë u ka kushtuar edhe studiuesve arbëreshë pas Luftës së Dytë Botërore. Në klimën e re historike të këtyre pesë dekadave të fundit plejada e shkrimtarëve bashkëkohorë arbëreshë lëvron me dinjitet gjuhën shqipe. Ata, po e mbajnë gjallë gjuhën e të parëve të tyre ndër veprat e literaturës reflekse artistike. Sipas Kastratit që

ishite një bibliograf i rrallë, ai vë në dukje se një bibliotekë e tërë shqipe me afro 100 libra janë botuar gjatë viteve 1946-1992.

Veprat poetike, prozaike dhe dramaturgjia arbëreshe ka bërë që të lulëzojë letërsia artistike dhe në të njëjtën kohë të zhvillohet, të përpunohet, pastrohet, pasurohet dhe të limohej më tej gjuha e shkruar shqipe ndër italo-arbëreshët. Kastrati pohon se në fushën e gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë, në këto dekadat e fundit, është lëvruar me sukses leksikografia, leksikologjia, dialektologjia toponomia, tekstologjia, historia e gjuhësisë, gramatologjia dhe gjuha shqipe e shkrimtarëve arbëreshë të traditës dhe e letrarëve bashkëkohës. Të gjitha këto disiplina autori i ka shoqëruar me veprat që janë botuar, duke rreshtuar edhe një galeri autorësh të cilët kanë kontribuar në këto fusha. Për J. Kastratin lëvizja mendore e arbëreshëve të Italisë është në një zhvillim të mbarë dhe në kulmet e saj, ndonëse bien në sy dy rryma kryesore gjuhësore në të shkruarit e shqipes, dy korrente divergjente. Ndonëse opinionet janë të ndryshme, ka përpjekje për një konvergencë gjuhësore për “*diglosinë*” dhe për “*bilinguizmin*.” Arbëreshët e kanë ndjerë prej kohësh nevojën e një gjuhe letrare kombëtare shqipe të përbashkët për të gjithë italo-shqiptarët. Kujtojmë përpjekjet e Dh.Kamardës, De Radës, Santorit, Serembes etj. Janë disa studiues të cilët mendojnë se krijimet e tyre duhet të shkruhen e të botohen në gjuhën standarde që përdoret në Shqipëri, ndërsa rryma tjetër të shkruhet në të folmet e ndryshme arbëreshe, duke arsyetuar se ato ligjërime paraqesin “*një gjuhë të vjetër të mërgimtarëve të hershëm, të ruajtur me xhelozë.*”

Arbëreshët, megjithëse në një mjedis të huaj, kanë ruajtur për pesë shekuj, disa nga tiparet e identitetit kombëtar. Ajo që i mbajti të bashkuar dhe të lidhur shpirtërisht me Shqipërinë amë qe gjuha shqipe.

Françesko Altimari ka argumentuar shkencërisht se gjuha dhe kultura arbëreshe duhet të mbrohen me lidhje sa më të plotë me gjuhën e kulturën e mëmëdheut të të parëve. Ekzistojnë elemente të përbashkëta të arbërishtes me shqipen standarde. Koineja letrare e arbërishtes së restauruar, sipas Kastratit, ka ndryshime të pakta me gjuhën letrare

kombëtare shqipe të sotme. Megjithatë Kastrati i referohet edhe një thënie të J.Ferrarit që shkruan: *“Po le të vëmë re që nga entuziazmi i njësisë së gjuhës të mos mbyten dialektet tona të mëdha shumë shpejt, pse do të ishte një rrezik i fortë të varfërohet gjuha, duke u shkëputur nga të folurit e popullit dhe do të shuhej një fletë e historisë sonë gjuhësore.”* J.Kastrati shpreh mendimin se *“Porsa i takon koinesë së tyre letrare, unë jam me mendimin e F.Solanos që “nuk ka rrugë tjetër për të pasuruar e përmirësuar gjuhën e kulturën arbëreshe, përveçse me lidhje sa më të plota me gjuhën e kulturën e mëmedheut”*. Por nuk duhet harruar edhe postulati i F.A. Santorit që *“gjithë trashëgimia gjuhësore e kombit është pronë e shkrimtarit”*.

BIBLIOGRAFI:

1. Jup Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë, 1980.
2. Po ai, *Gjuhësia shqiptare në shekullin XVIII (II)*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 1983, nr.2, f.13-20.
3. Po ai, *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shek.XIX ndër arbëreshët e Italisë (II)*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 1985, nr.1, f.20-40.
4. Po ai, *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shek.XIX ndër arbëreshët e Italisë (III)*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 1985, nr.2, f.21-40.
5. Po ai, *Rreth disa pikëpamjeve të Engjëll Mashit për gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, 1987, nr.4, f. 73-84.
6. Po ai, *Të dhëna për jetën dhe veprën e Mikel Skutarit*, “Studime filologjike” 1989, nr.2, f.163-170.
7. Po ai, *Ndihmesa e arbëreshëve dhe e studiuesve të tjerë në Itali për gjuhësinë shqiptare*, “Gjuha jonë”, 1-4, 1996, f.72-77.
8. Po ai, *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 2002, vëll.I.
9. Po ai, *Marko la Piana*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 2002, nr.52, f, 15-28.
10. Po ai, *Gjuha e shkruar shqipe ndër arbëreshët e Italisë pas Luftës së Dytë Botërore*, në “Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot” (Tiranë, 20-21 nëntor1992), Tiranë, 2002, f. 189-208.
11. Po ai, *Gaetano Petrotta*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 2003, nr.53, f.13-23.

Matteo MANDALA

(Itali)

**PREJARDHJA E MITIT PELLAZGJIK:
JERONIM DE RADA DHE
GIOVANNI EMANUELE BIDERA**

1.– Parashtrësë e problemit

1.1.– Problemi që synojmë të trajtojmë në këto faqe ka të bëjë me prejardhjen dhe përhapjen e të ashtuquajturit “mit pellazgjik”. Siç dihet, ky mit, sikundër ata që lidhen me bëmat e heronjve të panteonit shqiptar – Skënderbeu, Pirro, Aleksandri i Madh – ka pasur fatin e madh, edhe letrar, të mbisundojë gjatë shekullit XIX, me pasoja domethënëse që shtrihen deri në gjysmën e dytë të shekullit pasardhës. Edhe sot e kësaj dite ky mit ngre kokën herë pas here, jo vetëm në format e vjetra, me po ato metoda parashkencore, por madje me po ato synime e pretendime që pati qysh kur u shfaq në krye të herës: të dëshmojë se shqiptarët nuk ishin (a nuk janë) tjetër veçse pasardhësit e drejtpërdrejtë të pellazgëve “të shenjtë e të lavdishëm” për të cilët shkroi së pari Homeri.

Duke lënë mënjanë karakterin joshkencor të disa botimeve të kohëve të fundit që, s’do mend, nuk do t’i marrim parasysh këtu, është rasti të theksojmë se interesi i sotëm ndaj këtij miti përlligjet, në rrafshin e historisë kulturore shqiptare, nga ndikimi i padiskutueshëm që ky mit ka ushtruar mbi procesin e krijimit të identitetit kombëtar që zuri fill me veprat e intelektualëve arbëreshë gjatë shekujve XVIII e XIX dhe, në rrafshin mirëfilli historiografik, nga nevoja për t’u dhënë një përgjigje më të mbështetur dhe më të dokumentuar dy pyetjeve themelore: 1) ku dhe kur lindi miti “pellazgjik”? 2) kemi të bëjmë me një mit të krijuar për të parën herë nga arbëreshët apo thjesht me një përpunim të ri të po atij miti që përshkonte historinë kulturore europiane qysh prej shek. XVIII? Është e qartë se dy pyetjet janë të lidhura mes tyre dhe se, parë në këndvështrimin e rindërtimit historik të evolucionit ideologjik të kulturës shqiptare, ato pleksen pashmangshëm me një pyetje të tretë: përmes cilave vepra u përhap ky mit në Ballkan? Meqenëse kësaj të fundit tashmë i është dhënë një përgjigje e kënaqshme, do të nisemi pikërisht prej saj për t’iu përgjigjur dy pyetjeve të para.

1.2.– Miti pellazgjik shfaqet për të parën herë në mjedisin ballkanik aty nga gjysma e parë e shek. XIX, shumë vite para botimit të veprës së njohur *Albanesische*

Studien të Johann Georg von Hahn-it¹⁵, e cila shpesh përmendet si vepra që i dha shtysën vendimtare përhapjes së këtij miti. Ka shumë të dhëna që na ndihmojnë të përcaktojmë kohën dhe modalitetet e kësaj shfaqjeje. Të dhënën e parë kronologjike e gjejmë në pjesën përmbyllëse të një shkrimi të shkurtër, botuar në Lipsia nga Hermann Buchholtz, që Jeronim de Rada risjell në formë parathënieje në libërthin *Conferenze su l'antichità della lingua albanese e grammatica della medesima*¹⁶. Buchholtz e siguronte lexuesin se poeti arbëresh kishte botuar

«Gjurmimin dhe argumentimin e tij mbi Pellazgët e lashtë dhe shqiptarët... për të parën herë në vitin 1843 në Napoli në *Lucifero* dhe një herë tjetër në *Passeggiate* të Emmanuele Biderës. Në vitin 1845 e botoi për të tretën herë Tommaso Pace në Athinë në të përkohshmen me titull *Minerva*; dhe në vitin 1850 këtë tezë e pranoi Hahn-i, e mbështeti më tej dhe ia bëri të njohur gjithë Europës»¹⁷.

Duke pohuar se ky rindërtim bazohet mbi sa thotë De Rada njëzet vjet më parë në libërthin me titull *Antichità della Nazione Albanese e sue affinità con gli Elleni e i Latini*¹⁸ e më pas në artikullin *Pelasgi ed Elleni* botuar në *Fiamuri Arbërit* në vitin 1885¹⁹, përkthimi i Tommaso Pace-s (1807-1885), arbëresh nga fshati San Costantino

¹⁵ Shih Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, F. Mauke, Jena, 1854.

¹⁶ Girolamo de Rada, *Conferenze su l'antichità della lingua albanese e grammatica della medesima*, Tipografia di Francesco Mormile, Napoli, 1893.

¹⁷ «la sua inquisizione e argomentazione su gli antichi Pelasgi e gli Albanesi... per la prima volta nel 1843 in Napoli nel *Lucifero* e ancora una volta nelle *Passeggiate* di Emmanuele Bidera. Nel 1845 le stampò per la terza volta Tommaso Pace in Atene nel periodico intitolato *Minerva*; e nel 1850 le accettò Hahn, le appoggiò ancora e le fece conoscere in tutta l'Europa» në "Girolamo De Rada su i Pelasgi e gli Albanesi. Critica di Ermanno Buchholtz" botuar në *Letteratura internazionale* di Lipsia su l'operetta di Girolamo De Rada *Pelasgi e Albanesi* edita in Napoli nel 1890" premeo a Girolamo De Rada, cit., f. 1-4.

¹⁸ Shih Girolamo De Rada, *Antichità della Nazione Albanese e sue affinità con gli Elleni e i Latini*, Napoli, Stamperia dell'Industria, 1864.

¹⁹ Shih Girolamo De Rada, "Pelasgi ed Elleni" në *Fiamuri Arbërit*, anno II, 20 settembre 1885, n. 5, Cosenza, 1885, f. III-VIII. De Rada në shënimin (2) të faqes V shkruan: «Nel 1843 pubblicai nel *Lucifero* e poi in una nota alle *Passeggiate intorno Napoli* di Emm. Bidera quelle che a me parvero divinazioni d'un passato preistorico. Le quali il mio connazionale Tommaso Pace da S. Costantino ripubblicò in Athene nella *Minerva* nell'ottobre del 1845. Dopo il 1859 l'Europa poté considerarle illustrate e confortate da Hahn».

Albanese, i detyruar të mërgojë në Greqi për shkak të veprimtarisë së tij patriotike²⁰, luajti një rol vendimtar për depërtimin e mitit të prejardhjes pellazge të shqiptarëve në Ballkan, fillimisht në Greqi, pastaj në Rumani e së fundi në Shqipëri, ku pati sukses dhe jehonë të gjerë te shkrimtarët shqiptarë të gjysmës së dytë të shek. XIX. E vetmja pikë e paqartë mbetet data e botimit të përkthimit të Pace-s që, siç thotë Dhimitër S. Shuteriqi, duhet vendosur në vitin 1846 dhe jo, siç pohon De Rada, në 1845:

«De Rada lajthit kur na thotë se artikulli [i Paçes] u botua në të përkohshmen “Minerva” më 1844 [sic!]. Këtë e dinte edhe Thimi Mitkoja, porse ky e vendoste botimin tek e përkohshmja “Athina” më 24 mars 1846, në nr. 1304, gjë që del të jetë e saktë, se në po atë vit e vendos edhe arbëreshi Vinçenc Dorsa në një shkrim të vetin më 1847»²¹.

Këtë rrjedh edhe rindërtimi sqarues i Francesco Altimarit:

«Në fakt eseja e De Radës, që u rimor nga revista athinase, u ribotua e përkthyer një vit më pas nga revista e Bukureshtit “Curieru Român” nga Eliade Rudulescu. Shqiptarët e Rumanisë në kontekstin ballkanik ishin ndër më të përparuarit nga pikëpamja politike dhe mes tyre ishte edhe ai që sot konsiderohet si pararendësi i Rilindjes shqiptare, Naum Veqilharxhi. Vetë intelektualët arbëreshë, të nxitur nga sukcesi që pati eseja e De Radës ndër shqiptarët e Rumanisë, morën zemër të vijonin në po atë udhë: në një artikull që u botua në revistën e Kozencës “Il Calabrese” në vitin 1847, De Rada në një letër të hapur drejtuar të riut Vincenzo Dorsa nga Frasnita, shkruan se Pace kishte marrë një pako me libra shqip nga Vllahia bashkë me një letër ku thuhet: “Lajmi se në Itali ruhet gjuha jonë na i mbushi zemrat me gëzim këtu në Shqipëri” dhe e këshillon të riun Dorsa të nxisë Santorin të botojë sa më shpejt një vepër të tijën. Ndërsa në *Autobiologjinë* e tij shkruan: “Këto suksese dhe kjo letër më shtynë përfundimisht t’ia kushtoj krijimet e mia poetike lartësimi të jetës dhe të gjuhës së Kombit tim sa fisnik aq edhe fatkeq»²².

²⁰ Shih Francesco Altimari, “Il ruolo degli intellettuali arbëreshë nella *rilindja* albanese e nella storia culturale del Mezzogiorno” në *Riflessioni sul mezzogiorno. Comunità arbëreshe e risorgimento italiano*, a cura di Mario Brunetti, Collana dell’Istituto Mezzogiorno-Mediterraneo, 3, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2004, f. 87.

²¹ Dhimitër S. Shuteriqi, “Një rilindës e botues i parë i folklorit arbëresh në shek. XIX, Thoma Paçe” në *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1987, f. 169.

²² Shih Francesco Altimari, “Il ruolo degli intellettuali arbëreshë”, cit., f. 88.

Saktësimet e Shuteriqit dhe rindërtimi i Altimarit nuk ia ulin vlerën rolit që luajti De Rada në përhapjen e “mitit pellazgjik” e as nuk cenojnë rëndësinë që ai pati gjatë asaj faze kyçe për afirmimin e lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Përkundrazi, nëse Rilindja fitoi atë lloj homogjeniteti ideologjik që, siç e ka vënë në dukje Francesco Altimari, i lejoi jo vetëm të kërkonte «të drejtën për emancipimin kulturor dhe politik të bashkësisë së vet kombëtare»²³ e të dëshmonte se shqiptarët kishin një histori të lashtë që i përlligjte përpara mjediseve intelektuale europiane, por edhe të shndërrohej në një lëvizje aq të gjerë sa të bashkonte rreth një projekti kombëtar të përbashkët të gjitha bashkësitë shqiptare në mërgim e sidomos bashkësitë më aktive të Greqisë, Rumanisë dhe të Italisë, merita për këtë i takon kryesisht veprës së De Radës.

Pika kyçe e kësaj çështjeje ka të bëjë me dy aspekte të tjera: së pari, me aspektin kronologjik, që nuk është aq i parëndësishëm sa ç’mund të duket në vështrim të parë, sepse ndikon mbi aspektin e dytë që ka të bëjë me fazat e ndryshme të zhvillimit të motiveve ideologjike që pësoi miti qysh nga lindja në shek. XVIII deri në lulëzimin e plotë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX.

1.3.– Në vitin 1899 De Rada, duke shkruar periudhën e dytë të *Autobiologjisë* së tij, jo vetëm që konfirmoi në thelb çka thotë Buchholtz-i, por shtoi edhe disa hollësi të tjera:

«Disperando della celebrità che può aversi dal teatro, tentai altri studi; publicai pur in quell’anno [1843] nel Giornale il *Lucifero* le *Divinazioni* pelasge riprodotte di seguito in altre pubblicazioni; e dalle quali era messo in evidenza stare a fondo unico del Politeismo ellenico-latino e spiegarlo la lingua albanese, sola. Il prof. Dorotea della Università di Napoli l’ammise pel primo, ed attribui a me la scoperta della identità de’ Pelasgi con gli Albanesi: scoperta accetta poscia dalla Scienza europea»²⁴.

Referimi implicit ndaj teorive mbi bazë të të cilave Vincenzo Gioberti shpalli për italianët një *primat* që do t’i shquante nga popujt e tjerë të krishterë jokatolikë të Evropës (që ai jo rastësisht i quan gjermanikë), falë gjoja prejardhjes së tyre nga fiset greko-latine, si pjesë e një trangu të përbashkët pallazg, i hap shtegun një pandehme magjepsëse: De Rada, që nuk e fshehu kurrë mbështetjen ndaj ideve politike të Giobertit, mund të ketë mbërritur te “zbulimi i identifikimit të Pellazgëve me Shqiptarët” nën ndikimin e manifestit të famshëm të neoguelfizmit të Rilindjes italiane²⁵.

²³ Shih Francesco Altimari, “Il ruolo degli intellettuali arbëreshë”, cit., f. 88.

²⁴ Girolamo De Rada, *Autobiologia. Secondo Periodo*, Napoli, 1899, f. 18.

²⁵ Shih Vincenzo Gioberti, *Del primato morale e civile degli italiani*. Tomo I. Dalle stampe di Meline, Cans e compagnia, Brusselle, 1843.

Kjo pandehmë që nuk është pa bazë, vlen vetëm nëse shihet e lidhur me idetë politike që De Rada zhvilloi pas vitit 1848, por jo me përpunimin rinor të “mitit pelazgjik”. Edhe sikur poeti arbëresh të kishte lexuar botimin e parë belg të veprës së Giobertit, vështirë të ketë pasur kohë të shkruajë e të botojë shkrimin *divinazioni pelasghe* gjatë muajve të fundit të vitit 1843, posaqë vepra e Giobertit e pa dritën e botimit pas majit të atij viti²⁶. Këtë rrjedh se, po të ketë pasur vërtet një ndikim, ky mund të jetë ushtruar vetëm pas vitit 1848, kur doli nga shtypi botimi i parë napolitan i veprës²⁷, pra pesë vjet pas shpalljes së “zbulimit” që, sipas prof. Lionardo Dorotea-s (1797- 1865), De Rada kishte bërë i pari.

Atëherë lind natyrshëm pyetja: nga e mori De Rada shtysën a idenë fillestare për të përpunuar atë «zbulim që pastaj do të pranohej nga shkenca europiane»? A mund ta gjejmë me vend mendimin e prof. Dorotea-s apo thjesht duhet të pranojmë, përtej lëndave të rastit që ky mund t’i bënte të riut De Rada, se profesori nuk kishte njohuri mbi përhapjen e gjerë të mitit pellazgjik në mbarë Europën?

Për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve do të duhej të shqyrtoheshin shënimet që De Rada thotë se ka botuar në vitin 1843 e që Buchholtz konfirmon se ka lexuar po atë vit, fillimisht në të përkohshmen *Il Lucifero* e një vit më vonë, në 1844 në faqet e librit *Passeggiata per Napoli e contorni*, shkruar nga Giovanni Emmanuele Bidera (1784-1858), arbëresh sicilian prej fshatit Palazzo Adriano. Fakti është se atyre shënimeve deri më sot nuk u është kushtuar vëmendje, madje janë cituar vetëm mbi bazën e pohimeve të vetë De Radës, pa u studiuar kurrë drejtpërdrejt. Përse? Thjesht sepse askush nuk mori mundimin të shqyrtojë burimet për të dëshmuar vërtetësinë e të dhënave që De Rada i moshuar sjell si kujtime të periudhës rinore. Në të vërtetë, sapo ia hymë kësaj pune lëmshi që ngatërronte gjithë çështjen zuri të ftillohej dhe na u shfaq para syve pamja e plotë jo vetëm e burimeve që zënë ngoje De Rada e Buchholtz, por edhe e një rrjeti të jashtëzakonshëm marrëdhëniesh të frytshme shkëmbimi kulturor mes studiuesve më në zë të bashkësive arbëreshe të Kalabrisë dhe të Sicilisë, që gjatë çerekut të parë të shek. XIX e shndërruan Napolin në kryeqendrën intelektuale të albanologjisë së kohës.

E dhëna e parë për t’u verifikuar është data 1843. Pas një shqyrtimi të vëmendshëm të koleksionit të së përkohshmes napolitane *Lucifero* të periudhës 1843-1846, që ruhet në Bibliotekën Qendrore të Palermos, nuk kemi gjetur asnjë gjurmë të shkrimit *divinazioni pelasghe* a së paku mund të themi se nuk gjendet asgjë për periudhën që përmend De Rada (1843-44).

²⁶ Vincenzo Gioberti, *Il gesuita moderno*, Tomo primo, Dalla stamperia del Vaglio, in Napoli, 1848, f. CXVII: «venticinque di maggio del 1843, cioè mentre il mio Primato era sotto i torchi».

Ky fakt në vetvete nuk është shumë habitës, sepse siç e thamë më lart, poeti arbëresh kur rreket në moshë të thyer të sjellë ndër mend çaste të periudhës së rinisë, shpesh herë ngatërron data e fakte²⁷. Kështu që mendojmë se, me gjasa, shënimi me *divinazioni pelasghe* mund të gjendet në numra të tjerë të gazetës, që ndoshta i përkasin një periudhe pararendëse asaj që kujton autori. Francesco Altimari supozon se botimi në *Il Lucifero* mund t'i përkasë vitit 1840 dhe jo, siç thotë më se një herë De Rada, vitit 1843²⁹. Sipas mendimit tim, mund të bëhet fjalë për të njëjtin tekst që De Rada ribotoi në shënimin që i bëri shkrimit të Thimi Mitkos *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora* botuar në disa numra të *Fiamurit të Arbërit*³⁰, pikërisht atje ku poeti duke folur për “etimologjitë e tij pellazge”, thotë se «ne ripet[eva] talune di queste, traendole dalla nostra Divinazione del 1842»³¹.

Ky pohim i fundit që, gjithsesi mbetet për t'u verifikuar, nga njëra anë konfirmon të dhënë sipas së cilës shkrimi i De Radës ishte përfshirë në librin e Biderës, për të cilin u botua një recension shkruar nga Emmanuele Rocco në shtyllat e gazetës *Il*

²⁷ Shih Vincenzo Gioberti, *Del primato morale e civile degli italiani*. Tomo primo. Prima edizione napoletana fatta sulla seconda belgia. A spese di Saverio Matarazzo editore, Napoli, 1848.

²⁸ Në lidhje me këtë çështje De Rada, jep një version të kundërt me ato që zëmë ngoje më lart: «Io pubblicai nel 1843 nel Matneer di Em. Bidera i chiari rincontri de' nomi delle Divinità elleniche con parole albanesi che segnavano il loro ufficio»: Girolamo De Rada, *Principi di estetica*, Stabilimento Tipografico de' Fratelli De Angelis, Napoli, 1862, tani ribotuar në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. X *Opere filosofiche e politiche*, introduzione di Anton Nikë Berisha, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007, f. 73, shën. Matn-eer i Bidera-s, siç dihet e siç do ta shohim edhe më poshtë, i përket vitit 1846. Më i paqartë është referimi që gjejmë në *periudhën* e fundit të *Autobiologjisë*: «Or Tommaso Pace conosceva il greco moderno e nella effemeride di Atene *La Minerva* diede un sunto delle mie *Divinazioni pelasghe* su lo sfondo del *Politeismo*»: Girolamo De Rada, *Un periodo della Autobiologia*, s.l. (Cosenza ?), s.d. (pas 1898 ?), f. 6. Po të kemi parasysh se ky episod është vendosur në të njëjtën “stinë” kur Lamartine i dërgoi De Radës nga Ischia një letër që mban datën 8 shtator 1844, del se De Rada në kujtimet e tij ngatërron dhe gabon kohën, sepse në fakt Tommaso Pace u kthye nga Greqia pas botimit të përkthimit që i bëri veprës “divinazioni pelasghe”, pra pas vitit 1846.

²⁹ Shih Francesco Altimari, “Il ruolo degli intellettuali arbëreshë”, cit., f. 87.

³⁰ Shih Thimi Mitko, “Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora” në *Fiamuri Arbërit*, anno III, 20 aprile 1886, n. 12, Cosenza, 1886, f. VIII; n. 5, 15 maggio 1886, f. I-IV; n. 7, 15 novembre 1887, f. V-VII.

³¹ Girolamo De Rada, *Nota a Thimi Mitko*, “Vestigia”, cit., n. 7, 15 novembre 1887, f. VII.

*Lucifero*³², nga ana tjetër, teksti që De Rada quajti “divinazioni pelasghe” del se nuk përputhet plotësisht me çka është menduar prej shumë vitesh, pra, nuk është i njëjtë me ato që poeti botoi gjatë dhjetëvjeçarëve që pasuan vitet ’40 të atij shekulli.

1.4.– Libri *Passeggiata...* i Biderës u botua në Napoli në dy vëllime, i pari në vitin 1844 e i dyti një vit më vonë. Në vëllimin e dytë, pikërisht në kreun me titull *La religione Cumana*, Bidera përmend De Radën në një paragraf që po e sjellim këtu poshtë:

«Il primo che disse: *Questo terreno ove mi siedo è mio*, stabilì il dritto di proprietà; e quegli che disse: *Quel ch'io vi dico è vero*, inventò la prima religione. Ma né quel terreno era suo, né quel vero era l'eterno che Iddio solo il poteva rivelare agli uomini. La forza si oppose alla forza, l'opinione all'opinione, e la terra s'imporporò più volte di umano sangue, e fu d'uopo venire ai patti; ed ecco il primo contratto sociale che sottomise gli uomini al principio legislativo e alla prima credenza. Le fontane, i fiumi, gli antri, le foreste, limiti delle possessioni, furono tenute per cose inviolabili e sacre. Una pietra bastava ad indicare il termine, e queste pietra divenne poi il Dio Termine. La religione naturale fu la religione de' salvati dalle acque, cioè de' Deucalioni. E sempre dappoi i simboli pagani e le credenze ebbero per fondamento l'amore di questa vita leggiadra che come l'antico Paradiso si perde con la morte. L'adorazione della natura è stato il fondo dal politeismo, come la brama di non mai uscire dalla vita ha fatto sorgere l'idea della trasmigrazione delle anime: due immaginazioni che si baciavano in questo placido asilo, ove in quest'ora noi sereni fisiamo in quelle la mente come un sogno dopo la notte.

Io mi ricordo i versi di De Rada, mio connazionale, e amato da me quanto i miei figli; versi, che descrivono la prima felice abitazione di quel popolo, e ne' quali i nomi propri si allogano col loro significato, in una maniera luminosa.

“La gioja, egli dice, pari al vino fortissimo, fu data in porzione a' Pelasgioti nel testamento che dispose la Terra. E tosto al pensiero del vivere eterni, eglino alzarono le tende ne' piani di Kak-emire (molto giocondo), come si levano in Agosto al lido del mare, che infresca e guarisce. Ivi il fiume Bchati (Ricco) diveniva nelle poppe delle vacche un latte salutare ne' giorni caldi; tantoché la pianta della vita delle matrone che ne bevevano e de' figliuoli di esse, vi si

³² Shih Emmanuele Rocco, “Recensione a *Passeggiata per Napoli e contorni* di Emmanuele Bidera, Napoli, 1844” në *Il Lucifero. Giornale scientifico, letterario, artistico, industriale*, anno VII, n. 28, mercoledì 1844, Stabilimento poligrafico S. Fergola e F. Cirelli Napoli, 1844, f. 224.

educava così leggiadra che chiamarono quelle piagge Bucheria (bellezza). Ed anche ora un sospiro di quei giorni felici, si sente quando risuona nell'acre il nome della città che aveano sopra il fiume (simbolo del passaggio !) Samracanda (il cuore qui gode).

Can[to] XXIV Ser[afina] Top[hia]”.

Quando Virgilio volle che il suo Enea partisse dalla terra, soggiorno del sole, per le grotte degli inferi, lo fece accadere da questo sito ridente, ove forse in mezzo alla più bella calma dei sereni giorni, egli veniva a presentire il destino de' mortali, e si levava così dolce e malinconico che altro poetico cigno non modulò così sublimemente il suo mesto canto. Egli adorò la bella natura, e vago più che altro d'immortalità, veniva ad ispirarsi in questi luoghi come Numa al fonte della Ninfa Egeria; egli sentiva nel suo caldo immaginare responsi della Sibilla che *ab immemorabili* venne solitaria e non veduta nella spelonca di Cuma. Ma donde era venuta questa donna mirabile e sola, a fermarsi appresso questa laguna e in vicinanza del sempre vigile mare, come si esprime Eschilo ? Essa aveva altre sorelle che abitavano com'ella o monti prossimi al cielo, o la sponde dell'Oceano, ed erano le conscie sentinelle di questa terra. Così alla guisa di un piccol seme che caduto in fecondo suolo si alza poi con rami ad adombrare il sole, del pari le verità che seguirono l'uomo fuori dalle mani di Dio spiegarono nel corso del tempo, dalla sua solitaria immaginazione, le forme più cupe, o più pompose. E noi vediamo che i Pelasgi onoravano Zea (il principio), Hera (l'ora), Dieli (il Sole), Etëna (il verbo, la sapienza), Dëti (il mare), Urano (il cielo), Diana (chi guarda a' due lati), e che gli Elleni, ossia la gente fusa co' Camiti idolatri onorava dipoi Zea (Giove), Hera (Giunone), Dieli (Apollo), Atina (Minerva), Dëti (Teti), Urano (il cielo), Diana (Diana o Giano). Vediamo sotto questa brillante scorsa di divinità vivere la speranza di sopravanzare alla morte e goder sempre quarto mondo divinizzato: così Omero che compose le più grandi e belle forme di Dei, porta Ulisse nell'Epiro a fargli conoscere la sede de' trapassati. Ivi è un lago Averno come questo che qui stagna cinto da ameni colli: ivi è un altro Acheronte, le cui acque come quelle che qui pone il Mantovano, fanno cadere gli uccelli che vi passano sopra; là due querce danno immortali responsi, e qui da una grotta vengon essi fuori affigurati in foglie di alberi; ed un medesimo Genio si sente spirare sotto i due cieli, a cui Virgilio auspica eterna pace ed amicizia con versi divini [...]»³³.

³³ Giovanni Emmanuele Bidera, *Passeggiata per Napoli e contorni*, all'insegna di Aldo Manuzio, Napoli, 1845, f. 93-101. Vepra pati një botim të dytë: *Passeggiata per Napoli e contorni di Giovanni Emmanuele Bidera*. Per uso di guida a' forestieri,

Ky paragraf i gjatë nxjerr në pah faktin se “divinazioni pelasghe” ishin thjesht vargje që fillimisht duhej të përfshiheshin në poemën *Serafina Thopia*, më saktë, në botimin e dytë që do të dilte në Napoli në vitin 1843³⁴. Nuk e dimë me siguri pse De Rada vendosi t’i fshinte nga vepra këto vargje, por me gjasa kjo do të ketë ndodhur gjatë përpunimeve të ndryshme e të vazhdueshme që autori i bëri poemës me synimin për t’i dhënë asaj koherencë dhe qëndrueshmëri. (Në parim, nuk përjashtohet që fshirja të ketë ndodhur ndërkohë që vepra ishte në shtyp e njëkohësisht me shumë ndryshime të tjera që pësoi teksti i botuar në vitin 1843³⁵). Kjo jo vetëm që ndihmon në shpjegimin e kuptimit të fjalës “divinazione”, që në italishten e De Radës donte të thoshte “vargëzim” dhe jo “hyjnizim”, por të bën të mendosh se “analizat” gjuhësore të De Radës nuk kishin sjellë “zbulime” të mëdha, a së paku, nuk i shtonin asgjë të re dhe origjinale mitit pellazgjik. Me gjithë dëshirën e mirë për t’i njohur De Radës autorësinë jo vetëm të katër paraetimologjive që shfaqen në fragmentin që përmend Bidera: (<Kak-emire> [kaq e mirë], me gjasa marrë nga spekulimet gjuhësore të vëllezërve Schlegel; <Bchati>[bgati / bëgat] dhe <Bucheria> [bukëria / bukuria]; <Samracanda> [zamra ka (ë)nda / zëmra ka ënda], por edhe edhe atyre që Bidera i sjell në mënyrë të tillë që dalin sikur të jenë të tijat dhe jo të De Radës, vështirë të mos vihet re se kemi të bëjmë thujse me të njëjtat interpretime që studiues të tjerë kishin sjellë shumë vite më parë³⁶. Mes këtyre po kufizohemi të përmendim vetëm Conrad Malte-Brun (Thisted, Danimarkë 1775 – Paris 1826), i cili në vëllimin e gjashtë të veprës së tij *Précis de la Géographie Universelle*, jo vetëm që rimori nga studiues të tjerë para tij teorinë e prejardhjes së shqiptarëve nga Pellazgët, por solli argumente të njëjta me ato që shfaqen më pas në paragrafin e cituar

seconda edizione per cura del figlio Pietro Atanasio corretta e riveduta dall’autore, Dalla stamperia e fonderia di Giuseppe Cutaneo, Napoli, 1857.

³⁴ Shih Girolamo De Rada, *Canti di Serafina Thopia principessa di Zadrina nel secolo XV. Poema Albanese volto in Italiano per Girolamo de Rada*, Napoli, Stabilimento Tipografico Domenico Capasso, 1843.

³⁵ Për historinë e tekstit të poemës shih Fiorella De Rosa, *Introduzione a Girolamo De Rada, Opera Omnia*, vol. III, *I canti di Serafina Thopia*, edizione critica delle tre edizioni a stampa 1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, soneria Mannelli, 2007. Për variantet e ndryshme në botimin e vitit 1843 shih Elio Miracco, “Varianti nella edizione del 1843 nei *Canti di Serafina Thopia* di Girolamo De Rada”, në *Miscellanea di albanistica*, a cura di Giuseppe Gradilone, Roma, 1997.

³⁶ Conrad Malte-Brun, *Précis de la Géographie Universelle, ou Description de toute les parties du monde, sur un plan nouveau, d’après les grandes divisions naturelles du globe; précédée de l’Histoire de la Géographie chez les Peuples anciens et modernes, et d’une Théorie générale de la Géographie Mathématique, Physique et Politique*, Tome sixième, imprimerie de Decourchant, 1826.

nga *Passeggiata*. Siç dihet, vepra e Malte-Brun (emri i të cilit njihej në mjedisin arbëresh sepse kishte botuar përkthimin frëngjisht të një shkrimi të famshëm të Angelo Masci-t³⁷) njohu botime dhe përkthime të shumta, një nga të cilat është përkthimi italisht botuar në Milano mes viteve 1815–1830 (vëllimi i gjashtë, kushtuar *Përshkrimi të Evropës Lindore* u botua në vitin 1828³⁸). Është interesante të vihet re se Malte-Brun sjell po ato etimologji emrash të hyjnive klasike³⁹ që prej gjysmës së dytë të viteve '40 të shek. XIX De Rada dhe Bidera përhapën në mjedisin arbëresh. Madje këta dy intelektualë arbëreshë nuk ishin as të parët që e përdorën veprën e gjeografit të madh danez. Në fakt, para tyre një tjetër studiues i shquar arbëresh kishte cituar botimin italisht të *Gjeografisë Universale*, prej së cilës vërtet kishte marrë disa etimologji, por njëherazi i kishte dhënë teorisë “pellazgjike” një kontribut të rëndësishëm dhe origjinal.

³⁷ Shih Angelo Masci, “Essai sur l’Origine, les Mœurs et l’État actuel de la Nation Albanaise par Ange Masci, traduit de l’italien; communiqué par M. Sonnini” në Conrad Malte Brun, *Annales des Voyages, de la Géographie et de l’Histoire, ou Collection Des Voyages nouveaux les plus estimés, traduits de toutes les Langues Européennes; Des Relations Originales, inédites, communiquées par des Voyageurs Français et Etrangers [...], publiées par M. Malte-Brun*, Tome troisième comprenant les cahiers VII à IX, chez F. Buisson, Paris, 1808, f. 145-234.

³⁸ Conrad Malte-Brun, *Geografia universale o descrizione di tutte le parti del mondo trattata su d’un nuovo piano e giusta le gran divisioni naturali del globo preceduta dalla storia della geografia presso i popoli antichi e moderni e da una teorica generale della geografia matematica, fisica e politica; fornita di carte, prospetti analitici, sinottici ed elementari, e d’una tavola alfabetica delle denominazioni de’ luoghi*, Traduzione dal francese. Tomo sesto, dalla tipografia Sonzogno e compagni, Milano, 1828.

³⁹ Ja një përmbledhje e ideve të Malte-Brun nxjerrë nga botimi amerikan i veprës *Précis*: «The Pelasgic character has been evinced by a curious and important fact, the names of several Greek divinities, according to Herodotus, are derived from the Pelasgic. Thus in the Albanian language, *deet* signifies the sea, hence probably Tethys the goddess of the ocean; *dee* the earth, hence *Deo* and *Demeter*, surnames of Ceres; *here*, the air, *Heré*, Juno; *dieli* the sun, *Delios*, a surname of Apollo, the god of the sun; *uranic*, a cloud, *uranos*, the heavens»: Conrad Malte-Brun, *Universal Geography or A description of all the parts of the World, on a new plan, according to the great natural divisions of the Globe*; accompanied with Analytical, Synoptical, and Elementary Tables. by M. Malte-Brun, improved by the addition of the most recent information, derived from various sources. Volume VI. Containing the description of Europe, Boston, Wells and Lilly- Court-Street and White, Gallaber And Write, New-York, 1828, f. 193.

2.– Nga Keta te Krispi

2.1.– Në vitin 1831 imzot Zef Krispi (1781-1859), arbëresh nga Palazzo Adriano, botoi studimin e gjerë me titull *Memoria sulla lingua albanese*⁴⁰, të cilin pesë vjet më vonë e përfshiu të plotë në veprën me titull *Opuscoli di letteratura e di archeologia*⁴¹.

Duke lënë mënjanë karakterin “parashkencor” që përshkon analizat gjuhësore e prej të cilit rrjedhin gabimet e shumta në shpjegimet etimologjike, kjo vepër përbën për studimet gjuhësore arbëreshe përpjekjen e parë organike për të shqyrtuar gjuhën shqipe në marrëdhënie me gjuhët e tjera të lashta të Ballkanit.

I nxitur nga prirja romantike për të dëshmuar natyrën primordiale dhe lashtësinë e shqiptarëve, Krispi nuk ngurroi të pohonte se shqipja ishte një gjuhë aq e moçme sa të mund të ballafaqohej me “hebraishten” (që asokohe mbahej si gjuha më e lashtë) e të “dëshmonte” se ajo rridhte drejtpërdrejt nga gjuha më e vjetër e tashmë e vdekur e “pellazgëve hyjnorë”. Madje, duke shkuar tej kësaj hamendjeje parimore, studiuesi arbëresh jo vetëm që u rrek të vërtetonte, bashkë me pararendësin Malte-Brun, lidhjen e ngushtë farefisnore mes shqipes dhe «gjuhës më të lashtë, më të papërpunuar, e më njërrrokëshe të pellazgëve», por edhe të pohonte se pikërisht në sajë të kësaj farefisnie gjuhësore, «prejardhja e gjuhës greke [...] do kërkuar më së shumti te shqipja» a, siç thotë qysh në titullin e veprës *Memoria*, se shqipja përvijohet «më së shumti si nëna e greqishtes».

Për të përligjur këtë lloj “revolucioni kopernikan”, që synonte të hidhte poshtë mendimin më të përhapur në studimet gjuhësore të kohës, Krispi solli në të mirë të tezave të tij një listë të gjatë etimologjish, që sot natyrisht dalin të gabuara e të papranueshme, shumë prej të cilave, siç pohon vetë, i kishte marrë nga veprat e pabotuara të mësuesit dhe pararendësit të tij në vendin e rektorit të Seminarit arbëresh të Palermos, Nikollë Ketës.

Me fjalë të tjera, spekulimet gjuhësore që gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XIX zunë të dilnin nga dorëshkrimet e pabotuara që ruheshin në atë Seminar, nuk ishin gjë tjetër veçse rezultatet e kërkimeve albanologjike që kishte nisur në Sicili at Gjergj Guxeta, vijuar pas tij nga Paolo Maria Parrino e përsosur nga Nikollë Keta, që mbetet pa dyshim studiuesi arbëresh më gjenial i shek. XVIII. Parë në këtë këndvështrim, vepra *Memoria* e Krispit jo vetëm që njoftoi publikun e gjerë për punimet gjuhësore,

⁴⁰ Shih Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese di cui se ne dimostra l'indole primordiale e se ne rintraccia la rimota antichità sino ai Pelasgi, ai Frigi, ai Macedoni e agli Eoli primitivi, che la costituisce in gran parte madre della lingua greca*, Palermo, presso Lorenzo Dato, 1831.

⁴¹ Shih Giuseppe Crispi, *Opuscoli di letteratura e di archeologia*, Palermo, presso Lorenzo Dato, 1836.

leksikografike e historiko-kulturore të Nikollë Ketës e të pararendësve të tij të shquar, por nxori në pah synimin e vërtetë të autorit: të shpjegonte fizionominë “kombëtare” të shqiptarëve përmes rindërtimit të prejardhjes historike të atij elementi që më mirë se çdo element tjetër dëshmon e ruan identitetin kulturor të një populli: pra të gjuhës. Jo më kot synimi i vërtetë i Krispit ishte të vinte në qendër të vëmendjes ruajtjen e gjuhës shqipe në përputhje me parimin romantik sipas të cilit «është gjuha e një kombi ajo që ruan zakonet e doket; nuk ka dyshim se Kombet jetojnë ose vdesin në atë masë që jeton ose vdes gjuha»⁴².

2.2.– Vepra e Krispit pati një meritë të dyfishtë: nga njëra anë, duke ndjekur gjurmët e pararendësve të tij e duke përqaftuar prirjet që sundonin në kulturën europiane të kohës⁴³, pra ato që qysh nga gjysma e parë e shek. XVIII kishin mbivlerësuar tej mase

⁴² Giuseppe Crispi, *Memoria sulla origine e fondazione di Palazzo Adriano colonia greco-albanese in Sicilia delle chiese ivi edificate, e dei litigj, che vi nacquero tra i due cleri da che vi s'introdusse parrocchia latina scritta dall'Ab. Giuseppe Crispi*, in Palermo, presso Lorenzo Dato, 1827, f. 31.

⁴³ Nuk është vendi këtu të rendisim titujt e librave të shumtë, që, nga gjysma e dytë e shek. XVIII deri në shekullin e shkuar, merren me pellazgët dhe mitet e krijuara për të dëshmuar prejardhjen e popujve europianë nga këta banorë të moçëm të Ballkanit. Në lëmin e kërkimeve gjuhësore të zhvilluara në kapërcyell të shek. XVIII-XIX «gjermanisti suedez Johan Ihre» në veprën e tij *Glossarium [Suiogothicum]*, 1769] bën disa krahasime mes suedishtes, latinishtes dhe greqishtes mbi bazën e bashkëpërkimeve fonetike duke përfaqësuar kështu një pikënisje metodologjike dhe dokumentare për studiuesin Rask, një nga themeluesit e gjuhësisë indoevropiane. Ihre shtie në punë metodën e rindërtimit të afrive gjuhësore bazuar në përdorimin e fjalëpërfjalshëm të të dhënave etnogeografike të autorëve klasikë, dhe në veçanti hedh hipotezën se qoftë popullsitë gjermanike, qoftë ato prej të cilave rrodhën grekët dhe latinët i përkasin grupit të përbashkët të Skitëve. Sipas kësaj hipoteze pellazgët përkojnë me popullsitë skite që paraprinë Greqinë historike». Me vonë «Adelung në veprën *Mithridates* klasifikon greqishten dhe latinishten si gjuhë që i përkasin së njëjtës familje trako-pellazge»: Leonardo M. Savoia, “Aspetti della linguistica di De Rada nel quadro delle ricerche linguistiche arbëreshe del ‘700 e dell’800” introduzione a Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. X *Opere grammaticali*, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007, f. 14. Jo më pak ndikues qe miti pellazgjik në kërkimet arkeologjike që u zhvilluan në Itali gjatë po asaj periudhe, veçanërisht në zonën e Toskanës, si edhe në kërkimet arkeologjike gjermane, çka u shpreh mbi të gjitha me zëvendësimin e ligjit “vitruvian” me atë “pellazgjik”: shih Michele Cometa, “Il canone pelasgico. Teoria dell’architettura e storia delle culture nell’età di Goethe” në Michele Cometa e Luca Crescenzi (a cura di), *Cultura e rappresentazione nell’età di Goethe*, Carocci, Roma, 2003, f. 275-302. Nuk mbetën prapa kolegëve europianë edhe studiuesit italianë, sidomos historianë e arkeologë, të

rolin e “Pellazgëve” në procesin e formimit të identiteteve kombëtare, u ofronte intelektualëve arbëreshë bashkëkohës një mjet për fuqizimin e Rilindjes; nga ana tjetër, duke shpluhurosuar studimet e kryera në Sicili, na jep sot në dorë kyçin për të kuptuar zhvillimet e historisë kulturore arbëreshe.

Idetë e Krispit qëlluan fatlume, qoftë kur aty nga gjysma e dytë e shek. XIX u rimorën në mënyrë kritike nga Dhimitër Kamarda, qoftë kur nga fillimi i atij shekulli u rihodhën në qarkullim të paprekura nga studiues të tjerë më pak të njohur. Mes këtyre të fundit vlen të përmendet arbëreshi nga Sicilia Gjon Skiro, që bëri të tijat idetë e Krispit në shkrimin me titull *Rapporti tra l'Epiro e il regno delle Due Sicilie* që u botua në Palermo në vitin 1834⁴⁴. Mund të themi me siguri se idenë e mitit pellazgjik dhe ideologjisë identitare që lidhet me të, De Rada nuk e mori në mënyrë të drejtpërdrejtë nga veprat e Krispit e të Skiroit, vepra që ndoshta as që i njihte, por nga bisedat e gjata që pati me Emanuele Biderën në kohën kur ishte në Napoli.

3.– Kush ishte Bidera ?

3.1.– Giovanni Emanuele Bidera lindi në Palazzo Adriano më 4 tetor 1784⁴⁵ nga dr. Pietro Atanasio dhe nga Anna Maria Dara, që rridhte nga ajo familje që qysh nga gjysma e dytë e shek. XVIII sundoi panoramën kulturore dhe letrare të qytezës arbëreshe të Sicilisë. I edukuar nga prindërit në ritin bizantin, i riu Bidera filloi studimet në vitin 1799 në Seminarin arbëresh ku, sipas Zef Skiroit, «dha prova talenti të jashtëzakonshëm»⁴⁶. Nga ato vite që kaloi në Seminar nuk kemi shumë të dhëna. Dimë me siguri se qëndroi në Seminar derisa mbushi tetëmbëdhjetë vjeç, kur pas grindjeve të

cilët në gjysmën e parë të shek. XIX u përpoqën të dëshmonin kalimin nëpër Itali, sidomos në trevat etruske, të pellazgëve që kishin marrë arratinë nga Greqia.

⁴⁴ Giovanni Schirò, *Rapporti tra l'Epiro e il regno delle Due Sicilie. Memorie*, Dalla Tipografia del Giornale Letterario, Palermo, 1834. Ky libërth, i hartuar nga disa pjesë të quajtura “memorie”, në pjesën e parë me titullin domethënës “De’ Pelasgi”, bënte një përshkrim të dokeve, zakoneve, besimeve e sidomos të gjuhës bazuar mbi rezultatet e kërkimeve të arkeologëve italianë e të huaj, mbi të dhënat e burimeve antike e, për sa i përket gjuhës, mbi diskutimet etimologjike të Zef Krispit. Kështu Skiro shkruante: «Le considerazioni del chiarissimo ab. Crispi intorno alle strette relazioni che la presente lingua nostra albanese (la quale nella massima parte è ancora l'antica Pelasga) ...»: *po aty*, f. 13.

⁴⁵ Sipas Zef Skiroit data e saktë do të ishte 4 dhjetori 1784: shih Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, Napoli, 1923 (r.a. Piana degli Albanesi-Palermo, 1986), f. XLII.

⁴⁶ Sipas Zef Skiroit data e saktë do të ishte 4 dhjetori 1784: shih Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, Napoli, 1923 (r.a. Piana degli Albanesi-Palermo, 1986), f. XLII.

shpeshta me të atin, – «aristokrat, autoritar dhe shumë krenar për prejardhjen e tij të fisme»⁴⁷ –, Emanuele, që ishte «shpirt rebel dhe i prirur kah ndjenjave liberale»⁴⁸, mori vendimin të braktiste Palermon dhe për një kohë të gjatë u end «lart e poshtë, duke e nxjerrë bukën e gojës me djersën e ballit»⁴⁹.

3.2.– Pas largimit nga Palermo Bidera i dha fund endjeve të deriatëhershme duke u vendosur përkohësisht në Napoli ku u regjistrua në Fakultetin e Drejtësisë⁵⁰. Në fakt, nuk jemi të sigurt nëse i ka ndjekur realisht studimet në atë fakultet, madje, po të mbajmë parasysh se ai tërhiqej kryesisht nga poezia dhe letërsia, ka gjasa që ndjekja e studimeve për drejtësi të ketë pasur si synim vetëm marrjen e një diplome dhe se interesi i vetëm në atë kurs studimesh të kenë qenë lëndët e që merreshin me artin e gojëtarisë dhe të deklamimit.

Në këtë periudhë të parë të qëndrimit në Napoli Bidera plotësoi formimin e tij kulturor, jo vetëm duke konsoliduar e zgjeruar atë që mori në Seminarin e Palermos, por duke e pasuruar më tej me njohjen e letërsisë italiane dhe evropiane, të veprave të iluministëve më të mëdhenj të kohës, si edhe të veprave që gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XIX promovuan në Itali prirjen e re romantike që Bidera do ta përqafojë pa rezerva. Ndryshe nga natyra e ndrojtur dhe e mbyllur e të riut De Rada, Bidera ishte tipi i intelektualit të angazhuar në kërkim të përhershëm, i ndjeshëm ndaj ideve të reja, i prirur të ndërronte mendje në emër të progresit kulturor. Bidera e la Napolin pas një periudhe vështirësish të mëdha ekonomike: «i kredhur në borxhe, u kthye në Sicili ku ia hyri punës së aktorit, duke dhënë prova edhe si scenograf. Atyre viteve zuri fill veprimtaria e tij si autor dramaturg»⁵¹.

Nuk dimë nëse Bidera ka botuar ndonjë vepër në Palermo. Ajo çka mund të themi me njëfarë sigurie është se teatri për të nuk ishte vetëm zbulimi i një interesi kulturor që përputhej me temperamentin dhe talentin e tij, por edhe një pasion i vërtetë që shpërtheu sidomos kur iu kushtua plotësisht veprimtarisë së libretistit, veprimtari që, me t'u rikthyer në Napoli ku do të martohet, do t'i hapte një herë e mirë dyert e famës

⁴⁷ Sipas Zef Skiroit data e saktë do të ishte 4 dhjetori 1784: shih Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, Napoli, 1923 (r.a. Piana degli Albanesi-Palermo, 1986), f. XLII..

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ Shih S. Sallusti, "Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)" në *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma, f. 361.

⁵¹ Shih S. Sallusti, "Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)" në *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma, f. 361.

dhe të suksesit.

3.3.– Qysh nga vitet '20 të shek. XIX Bidera shkroi dhe botoi shumë vepra, të gjitha të shtypura në Napoli. Disa prej këtyre veprave janë ngushtësisht teatrale, ndërsa të tjerat trajtojnë çështje nga më të ndryshmet. Ndër të parat, për të përmendur vetëm ato që u botuan gjatë periudhës me të cilën po merremi, kujtojmë ato që citon dhe komenton Sallusti:

«il dramma *La divisione de' beni*, in 5 atti, d'ambiente borghese; le commedie *I dilettanti comici de' piccoli paesi*, in 5 atti, dove è messa a frutto la sua esperienza personale, *Il castello del principe*, in 4 atti, *La tragicomania*, in 4 atti, edita a Napoli nel 1827; le tragedie *Alessandro re de' Molossi a Pandosia*, in 5 atti in versi, *I sibariti*, pure in 5 atti in versi, seguita da *Pochi pensieri sulla tragedia «I sibariti»*; il dramma *Corinna al Campidoglio*, in 5 atti, edito a Napoli nel 1827, che lo stesso Bidera dichiara rappresentato da C. Tessari, con esito felice, al Teatro dei Fiorentini di Napoli, e derivato da *Corinne ou l'Italie* di Madame de Staël. Nel 1828-29 uscì a Napoli in due volumi la prima opera importante di Bidera, *L'arte di declamare ridotta a principii per uso del foro, del pergamo, e del teatro*, che precedette di quattro anni le *Lezioni di declamazione ed arte teatrale* di A. Morrocchesi; come queste, essa risulta improntata ad un freddo decoro neoclassico: V. Monti, e soprattutto V. Alfieri, vi sono considerati modelli di stile, e una interessante esemplificazione è profusa nell'ultima parte del secondo volume. A Napoli Bidera aveva di nuovo trovato un ambiente congeniale; dai suoi incontri con i soci del circolo musicale dei Trascendentali e dal consiglio di F. Romani fu invogliato alla poesia melodrammatica: a Gaetano Donizetti fornì due libretti, *Gemma di Vergy*, in 2 atti, ricavato dalla tragedia in versi *Charles VII chez ses grands vassaux* di Alexandre Dumas padre, messo in scena al Teatro alla Scala di Milano il 26 dicembre 1834, e *Marino Faliero*, in 3 atti, ricavato dal dramma omonimo di George Gordon Byron, rappresentato al Théâtre Italien di Parigi il 12 marzo 1835 (la Miragoli afferma che questa è opera priva di originalità, ma dalla poesia corretta e decorosa). Divenuto librettista del Teatro San Carlo, Bidera collaborò, tra gli altri, con C. Coccia, G. Lillo e G. Balducci, per i quali scrisse rispettivamente *Marfa* (1835), *Odda di Bernaver* (1837) e *Bianca Turenga* (1838). Altri due libretti fornì ad E. Petrella, *I pirati spagnuoli*, e *Le miniere di Freinbergh* (rappresentati al Teatro Nuovo di Napoli il 13 maggio 1838 e il 16 febbraio 1839)... Oltre alle opere citate si ricordano: *Le due epoche ossia l'astuccio d'oro*, melodramma semiserio in 2 atti, Napoli 1839; *Ricciarda*, tragedia lirica, Napoli 1839; *Elena Castriota*, tragedia lirica in 3 atti, per la musica di A. Butera, Milano s.d.; *Le nozze di Messina*, tragedia lirica in 4

atti, per la musica di F. Chiaromonte, Milano s. d.; *I pirati*, dramma eroicomico in 2 atti, per la musica di O. Aspri Cenci Bolognetti, Roma 1843; *La saracena*, tragedia lirica in 3 atti, per la musica di A. Butera, Milano 1854; *Teatro edito ed inedito*, Napoli 1854 (contiene, oltre ai lavori già citati, le tragedie *Il giorno di Pesto*, in 5 atti in versi, e *Alarico primo re de' Visigoti*, pure in 5 atti in versi, e la commedia *I trovatori fanatici*, in 4 atti)»⁵².

Veprimtaria që Bidera zhvilloi në Napoli mes viteve '20 e '30 të shek. XIX ishte vërtet e dendur dhe suksesi që pati i dha famë si libretist, shkrimtar dhe poet. Nuk është vendi këtu të merremi me shqyrtimin e hollësishëm të veprave të tij, që gjithsesi meritojnë të studiohen më tej. Mjafton të themi se vepra i siguroi një sukses dhe famë të madhe, sidomos në Napoli, ku, siç kujtonte De Rada, u bë “shumë i njohur”.

Kjo famë u shtua sidomos edhe nga shkolla e recitimit që themeloi në Napoli aty nga fundi i viteve '20. Kjo shkollë, përveç se ishte një nga më të frekuentuarat nga të rinjtë e atij qyteti, u bë edhe një qendër e rëndësishme debatesh kulturore dhe ballafaqimi politik, ku takoheshin shpesh talente të reja që më pas do të korrnin sukses në fushat përkatëse. Ishte pra një qendër që ushqente shpresat e të rinjve më premtues, që i nxiste në kërkimin e përmasave dhe aftësive artistike individuale, që i shtynte të mateshin me publikun dhe ndonjëherë, si në rastin e De Radës, i ndihmonte të krijonin bindje politiko-kulturore të pavaruara, e madje të kapërcenin edhe vështirësi e probleme të brendshme e intime. Këto cilësi u vunë në dukje thujtë me të njëjtat fjalë të De Radës edhe nga Francesco De Sanctis, që në të njëjtën kohë kur De Rada i ri ndiqte atë shkollë, pati rast të merrte «mësime recitimi nga zoti Emanuele Bidera, që kishte botuar edhe një libër mbi artin e recitimit plot veçanti dhe hollësi»⁵³.

⁵² Shih S. Sallusti, “Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)” në *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma, f. 361

⁵³ Ja se ç’kujton De Sanctis: «Trovai in Napoli il colera un po’ rimesso. Gli studenti tornavano, le scuole si riaprivano; la novità era l’edizione fatta di fresco delle poesie di Giacomo Leopardi. Io ne andavo pazzo, sempre con quel libro in mano. Conoscevo già la canzone sull’Italia. Allora tutto il mio entusiasmo era per *Consalvo* e per *Aspasia*. Avevo preso lezione di declamazione dal signor Emanuele Bidera, che aveva stampato sopra la sua arte un volume, zeppo di particolarità e minuterie. Io era tra’ suoi scolari più diligenti, e quando c’era visita di personaggi, il primo chiamato ero io. “Fatevi avanti, signor De Sanctis, declamatemi l’*Ugolino*”. Quello lì era il mio Achille. E io, tesò e fiero, trinciando l’aria con la mano diritta, cominciamo: “La testa sollevò...”. Non mancavano i battimani; ma un uomo di spirito mi disse: “Piangete troppo”. Ricordo il motto, non ricordo la persona. Ed era un motto vero. Io peccavo per eccesso, volendo accentuare tutto e imitare tutto, suoni, immagini, idee. Consalvo mi fece dimenticare Ugolino. Lo andavo declamando anche per via, e parevo fin

Doemos që metoda e Biderës nuk ishte pa të meta e nuk ishte i tillë as edhe konceptimi i tij vetjak mbi artin e recitimit, konceptim që vetë De Sanctis nuk mënoi ta kritikojë⁵⁴, me gjithë entuziazmin fillestar dhe suksesin që pati falë mësimëve që mori prej asaj shkolle. Gjithsesi s'ka dyshim se Bidera ishte jo vetëm një nga personazhet kryesore të kulturës napolitane dhe italiane, por edhe një pikë referimi për studentët e rinj arbëreshë. I tillë ishte edhe për De Radën, të cilin e bindi dhe e ndihmoi të botonte *Milosaon* dhe ndoshta i shtiu ndër mend atë që sot quajmë “mit pellazgjik”, por që asokohe konsiderohej një temë me vlerë të madhe shkencore. Në fakt, ishte pikërisht Bidera ai që në çerekun e dytë të shek. XIX rimori “mitin pellazgjik” dhe e zhvendosi nga Palermo në Napoli selinë e përpunimit të ideologjisë së re. Kjo dëshmohet nga ky paragraf i nxjerrë nga vëllimi i parë i veprës *Passeggiata*:

«I Deucalioni, cioè quelli che *il mare avea lasciati* (chè così si traducono le parole albanesi *Deiti-i-ca-glioni*, cioè: *Deiti*, il mare; *i ca*, gli ha; *glioni*, lasciati), è tradizione de' greci scrittori che dopo il diluvio d'Ogige, posteriore a quello di Noè, discendessero dai monti Caucasei ove si erano salvati, fermando nella Macedonia il carro di Latona (*Jat-jona*, cioè *il carro de' padri nostri*), simbolo di loro civiltà. Ivi i Pelei fabbricarono Pella, o Pelia (che dir vuole in quel linguaggio *cavalla*), da cui uscirono poi quei famosi Pelasgi, o cittadini di Pelia, che recarono la civiltà greca in questi luoghi, e furono i fondatori di *Phalero* o *Paler*, che Palerpoli e poi Pale-poli fu detta, cioè città di Palero»⁵⁵.

Etimologjia e fjalës “Deucalione” është po ajo që propozon për herë të parë Nikollë Keta. Megjithëse ka shumë të ngjarë që Bidera ta ketë marrë nga veprat e botuara të Krispit e të Skiroit, nuk përjashtohet ta ketë dëgjuar drejtpërdrejt në Seminarin arbëresh të Palermos nga goja e mësuesit të tij, «rektorit të urtë Keta», për të cilin edhe

ebbro, come Colombo per le vie di Madrid, quando pensava al nuovo mondo. Lo declamavo in tutte le occasioni, e mi c'intenerivo. Sovente lo declamai in casa Fernandez, e mi ricordo che, per un delicato riguardo alle signorine, dove il poeta diceva “bacio”, io mettevo “guardo”»: Francesco De Sanctis, *La giovinezza. Memorie postume seguite da testimonianze biografiche di amici e discepoli*, a cura di Gennaro Savarese, Giulio Einaudi, Torino 1961, f. 85.

⁵⁴ De Sanctis shkruante: «D'altra parte avevo fatto molto progresso nell'arte del leggere, e ne avevo qualche obbligo a un tal Camilli, che teneva scuola di declamazione, dove, imparando a recitare con verità e naturalezza, avevo corretto quel po' di enfasi stridente e piagnucolosa, che m'aveva appiccicato il Bidera»: Francesco De Sanctis, *La giovinezza*, cit., f. 183.

⁵⁵ Giovanni Emmanuele Bidera, *Passeggiata per Napoli e contorni*, all'insegna di Aldo Manuzio, Napoli, 1844, f. 234-236.

40 vjet pas vdekjes ruante kujtime të mira⁵⁶. Sidoqoftë një gjë mund ta themi me siguri: Bidera ishte hallka lidhëse dhe ndërmjetësi intelektual mes studimeve albanologjike që u zhvilluan gjatë shek. XVIII në Sicili dhe atyre që do të zhvilloheshin gjatë shek. XIX me nismën e De Radës në Itali, Evropë e Ballkan. Napoli ishte qyteti ku takimet e rastësishme mes arbëreshëve që vinin nga krahina kulturalisht më të gjalla, u shndërruan në momente kyçe të zhvillimeve të ardhme të historisë kulturore arbëreshe.

4.– Bidera dhe De Rada në Napoli

4.1.– Faza e parë e marrëdhënieve mes Biderës dhe De Radës u ndërpre papritur për shkak të epidemisë së kolerës që pllakosi Napolin në gusht të vitit 1836. Kjo katastrofë jo vetëm që bëri kërdinë në popullsinë e Napolit dhe të Italisë së Jugut, por shkaktoi edhe kryengritje popullore sidomos në Sicili dhe Kalabri.

Bidera vendosi të qëndronte në Napoli ku vëzhgoi me vëmendje zhvillimet dhe në vitin 1837 botoi dy broshura dokumentare, përkatësisht të titulluara *I 120 giorni del 1837 ossia il riprodotto colera in Napoli*⁵⁷ dhe *Gli ultimi novanta giorni del colera in Napoli*⁵⁸, në të cilat me një mjeshteri të rrallë rrëfimi përshkruan historinë e epidemisë «jo me synimin për të trembur, por për të ngjallur shpirtërat, i shtyrë nga dëshira për të mos lënë në heshtje disa tipare të filantropisë dhe të kurajos së një populli të tërë bujar në fatkeqësinë e tij»⁵⁹.

Nga ana e tij De Rada, duke iu ruajtur infektimit, në tetor vendosi të kthehej në fshatin e lindjes, ku do të qëndronte gjatë gjithë vitit 1837. Poeti i ri që kishte marrë me vete kopjet e poemës *Këngët e Milosaos*, e cila ishte «gjykuar shumë mirë»⁶⁰, ia hyri krijimtarisë letrare, duke u rrekur të «ngrinte gjuhën tonë në nivelin e përfaqësimit të një jete të lartë në krijime mundësisht të vërteta dhe me pasione fisnike». Gjatë kësaj kohe pati rastin të takonte mikun Domenico Mauro, me të cilin zhvilloi biseda të gjata letrare, që arritën kulmin me shkrimin e poemës *Errico*⁶¹. Kjo periudhë paqeje pati jetë të shkurtër, sepse De Rada gati pa e kuptuar u përfshi në një përbetim të dështuar që u organizua nga karbonarët kalabrezë, të cilët, ndoshta të magjepsur nga fama e poetit të ri, e vunë të komandonte një skuadër kryengritësish.

⁵⁶ Giovanni Emmanuele Bidera, *Passeggiata*, 1845, cit., f. 70. Është rasti të kujtojmë se dy vëllimet e Biderës përmbajnë edhe të tjera etimologji “pellazgo-shqipe”.

⁵⁷ Shih Giovanni Emanuele Bidera, *I centoventi giorni del riprodotto colera in Napoli: nuovi racconti*, Tipografia di Federico Ferretti, Napoli 1837.

⁵⁸ Shih Giovanni Emanuele Bidera, *Gli ultimi novanta giorni del 1836 ossia Il colera in Napoli: racconti*, A spese di Raffaele De Stefano, Napoli, 1837.

⁵⁹ *Po aty*, f. 7.

⁶⁰ Girolamo De Rada, *Autobiologia. Primo Periodo*, cit., f. 21.

⁶¹ Girolamo De Rada, *Autobiologia. Secondo Periodo*, cit., f. 22.

Kjo ngjarje e zhgënjeu rëndë poetin e ri, duke i ngjallur gjykime negative jo vetëm mbi veprimtarinë e të përbetuarve kalabrezë, por përgjithësisht mbi idetë politike radikale, sidomos kundër ideve revolucionare të Mazzini-t. Këto gjykime ia shprehu edhe mësuesit të tij të vjetër pasi u kthye në Napoli në nëntor të vitit 1838:

«Conobbi presto l'ambizione cadaverica e l'imbecillità di Mazzini e dei militi suoi. Intanto io era affascinato dal miraggio della libertà greca e romana per non parermi arbitraria ed oppressiva ogni monarchia assoluta. E la mia anima era sì conversa al Costituzionalismo che una mattina d'aprile di quello anno Emmanuele Bidera – che voltemi sempre bene – ebbe a riprendermene seriamente nella Carteria di Fabris: “Ma tu De Rada (mi si volse) che avesti un Dio che ti parla nel seno, ti accomuni a famelici che non han di che vivere e cospirano ad impadronirsi della cosa che dicono pubblica”»⁶².

Bashkëpunimi mes dy intelektualëve arbëreshë rifilloi tashmë në rrafshin e ideve politike të përbashkëta, që, të nxitura nga kritikantët ndaj kryengritjeve me frymëzim laik dhe nga qëndrimi që kishte mbajtur De Rada gjatë dyvjeçarit të qëndrimit të parë në Napoli, do të përqafojnë në mënyrë të natyrshme vizionin neoguelfian që qysh prej vitit 1843 mbështetej fuqimisht nga Vincenzo Gioberti. De Rada do ta kujtojë këtë kthesë politike vendimtare, që ndodhi disa vjet pas botimit të veprës *Primato*, më saktë në prag të kryengritjes siciliane të vitit 1848, e cila e turbulloi aq shumë, duke iu referuar në mënyrë implicite idesë xhobertiane të federalizmit dhe duke përmendur hapur miratimin e mësuesit të tij vjetër:

«Mentre poco dopo i successi soprannarrati, si fece chiara l'aspirazione della Sicilia alla propria Autonomia amministrativa. Essa divenne all'imprevista l'incubo del vecchio mio Mentore Emmanuele Bidera, nativo esso pure di Palazzo Adriano. E pure a me sembrava giusta. Per reminiscenza della vita ellenica di cui mi avevano imbevuto i classici, io in cuore era Federalista»⁶³.

Kjo dëshmi që na ka lënë De Rada në *Autobiologjinë* e tij është e fundit që njohim dhe që na lejon të përcaktojmë kufirin kohor të marrëdhënieve mes dy arbëreshëve. Poeti i Maqit, edhe pse e përmendi në veprat e tij sa herë e deshi nevoja, nuk pati më marrëdhënie me mësuesin e vjetër, sikundër konfirmohet nga letërkëmbimi i tij i pasur ku pas asaj periudhe nuk ka më gjurmë të këtyre marrëdhënieve. Nga ana e tij Bidera pas vitit 1848 u tërhoq në Palermo, ku themeloi një shkollë recitimi dhe iu kush-tua kërkimeve filozofike e gjuhësore dhe ku vdiq pas dhjetë vjetësh, më 8 prill 1858.

⁶² Girolamo De Rada, *Autobiologia. Secondo Periodo*, cit., f. 4.

4.2.– Kontributi që i sollë Bidera përhapjes së “mitit pellazgjik” në Itali përqendrohet në veprën e tij më të madhe. Kjo vepër, që u paralajmërua në shtojcën e veprës *Passaggiata* e u paraqit si një roman fantastik me titullin *Storia ideale di Quaranta Secoli del Pelasgo Matn-eer*⁶⁴, tërhoqi vëmendjen e mjedisit kulturor arbëresh. Vepra *Quaranta Secoli* paraqet disa aspekte që përligjin këtë sukses të jashtëzakonshëm. Një rol të madh pati, fjala vjen, figura magjepsëse intelektuale e personazhit fantastik *Mant-eer*, me anë të të cilit delli romantik i Biderës u rrek «të hulumtonte shpirtin e kombeve»⁶⁵. Jo më pak i rëndësishëm është fakti se ajo vepër përmbante «disa vargje shqipe» që autori do t’i ketë marrë me gjasa nga dorëshkrime të arbëreshëve të Sicilisë. Por mbi të gjitha mbetet fakti se “romani fantastik” i Biderës, duke përruar një sistem shkrimi nga i cili do të ndikohej i riu De Rada⁶⁶, për sasinë e madhe të etimologjive “pellazge” që trajtoi bëri që Dorsa të vinte në pah këmbënguljen me të cilën «E. Bidera u mor vetëm me ata popuj që kishin marrëdhënie me pellazgët e lashtë»⁶⁷.

Pas veprës *Quaranta Secoli* Bidera botoi një shkrim të shkurtër, ku jo vetëm rimerrte analizën historiko-gjuhësore, por i shtriu hulumtimet “kulturologjike” edhe në botën e besimeve të lashta, përfshi atë hebraik, me qëllim që të zbulonte rrënjët e përbashkëta me politeizmin pellazg. Bidera synonte kështu të zbulonte përmes etimologjish pellazge atë «Prote fantastik» që në vizionin e tij romantik ishte “shpirti i përjetshëm” që shoqëroi njeriun përgjatë historisë. Ky shkrim, me titull *Monumento biblico della storia critica dei Pelasgi dichiarato per mezzo della lingua schipta*⁶⁸, që më

⁶³ Girolamo de Rada, *Un periodo della Autobiologia*, cit. f. 15.

⁶⁴ Giovanni Emmanuele Bidera, *Quaranta Secoli. Racconti su le Due Sicilie del Pelasgo Matn-eer pubblicati da Emmanuele Bidera italo-greco*, all’insegna di Aldo Manuzio Napoli, 1846-1850 (vepra përbëhet nga katër vëllime të botuara në vite të ndryshme: I: 1846; II: 1847; III: 1849; IV: 1850).

⁶⁵ Te figura e Matn-eer, për shembull, u mbështet Zef Skiroi për të hartuar poemën *Të mishëruarit të sprasëm të Mantnërit*, që na ka mbërritur e paplotë: shih Giuseppe Schirò, *Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. V: *Këthimi, Mino, Opere teatrali, Mantnër*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 1998.

⁶⁶ Është rasti të themi se De Rada e mori grafemën <ë> nga vepra e Biderës, i cili nga ana e tij e kishte marrë nga veprat e Krispit që e kishte trashëguar nga veprat e arbëreshëve sicilianë të shek. XVIII (nga veprat e Guxetës që e krijoi, të autorëve Brancato, Filja, Parrino, e, së fundi, Keta dhe nxënësve të tij, mes të cilëve ishte edhe Krispi).

⁶⁷ Vincenzo Dorsa, *Sugli Albanesi. Ricerche e pensieri*, dalla Tipografia Trani, Napoli, 1847, f. 8, n. 1.

⁶⁸ Shih Giovanni Emmanuele Bidera, “Monumento biblico della storia critica dei Pelasgi dichiarato per mezzo della lingua schipta” në *Il Poligrafo. Rivista scientifica, letteraria ed artistica per la Sicilia*, anno I, vol. I, Stabilimento tipografico dell’Armonia, Palermo, 1856, f. 17-28.

pas u përpunua e u përfshi në veprën *Triade* (ribotuar pas vdekjes së autorit në vitin 1877 në Napoli nga i nipi Ferdinando, që ishte një nga botuesit më të shquar napolitanë të kohës), përmbante përsiatjet e Biderës mbi filozofinë e Pitagorës, që më vonë plotësohen në disa vepra të tjera si p.sh. *Rapporti intorno alla Triade pitagorica e alla Trimurti indiana*, si dhe *Timeo di Locri*, e cila përmbante edhe një shënim mbi shqipen, që Bidera e shpallte si gjuhën e nënës. Me interpretimin e ri dhe origjinal që Bidera i bëri mitit pellazgjik, gjuha shqipe shndërrohej nga objekt në mjet analize që shërbente jo vetëm për të rindërtuar identitetin shqiptar, por edhe për të hedhur dritë mbi periudhat më të errëta të historisë njerëzore, duke nisur nga interpretimi i miteve të besimeve antike.

4.3.– Bazuar mbi çka u tha më lart, nuk ka dyshim se përsiatjet që zhvilloi De Rada në shkrimet e periudhës së pjekurisë ndjekin hullinë e ndikimit që ushtroi mbi të mësuesi i tij Bidera⁶⁹ qysh prej takimit të parë në Napoli në vitin 1836, po atë vit kur poeti i ri, i nxitur nga profesori i recitimit, vendosi të botonte kryeveprën e tij letrare⁷⁰.

Sikurse pohojnë vetë në veprat e tyre, këta dy arbëreshë i lidhte një miqësi e fortë dhe e sinqertë. Për De Radën profesori i recitimit përbënte një lloj mbështetjeje për

⁶⁹ «Mentre poco dopo i successi soprannarrati, si fece chiara l'aspirazione della Sicilia alla propria Autonomia amministrativa. Essa divenne all'imprevista l'incubo del vecchio mio Mentore Emmanuele Bidera, nativo esso pure di Palazzo Adriano. E pure a me sembrava giusta. Per reminiscenza della vita ellenica di cui mi avevano imbevuto i classici, io in cuore era Federalista»: Girolamo De Rada, *Un periodo della Autobiologia*, cit., f. 15.

⁷⁰ «Or avvenne che compagni mi traessero alla scuola di declamazione di Emmanuele Bidera, albanese di Sicilia, conosciutissimo a Napoli, e librettista della *Gemma di Virgy*. Ma ivi per due mesi, impedendomi vergogna, invece di declamarlo recitava con fiacchezza monotona il sonetto di Petrarca: Levommi il mio pensiero in parte ov'era quella *chi'io cerco etc.* Tanto che il Professore tratto di parte il mio compagno e congiunto Demetrio Strigari, suo discepolo egregio, ed oggi distinto avvocato di Napoli, gli significò il dispiacere della mia invalidità. Ma il difetto, com'oggi m'è avviso, era in parte nel sonetto medesimo, scipito ed impotente ad accendere che fuochi fatui nelle menti de' Retori. Nella seguente Domenica alzatomi alla mia volta leggeva invece e con l'amore onde l'avea creato, un brano della rifrazione in versi sciolti dell'*Odisse*. Il Professore fattosi presso al condiscipolo Luigi Terzi da Paternò, lo richiese se quelli eran versi di Lord Byron. "No, rispose il mio amico, sono suoi". Il vecchio rispettabile allora mi si piantò davanti e consideratomi, com'ebbe poi sciolta la scuola a sé mi rattenne; e uscimmo insieme. E come gli dissi de' miei esercizi in nostra lingua ed udì qualche ode del *Milosao*, non lasciò ragionamento che non usasse per indurmi a metterle in luce. E mi trovò ei stesso il tipografo, intanto ch'io facevamo venir da casa i denari per la stampa. Si pubblicò nell'agosto del 1836 quella cantica dedicata al Maresciallo di campo de Re, Demetrio

formimin e tij ende të brishtë, që zuri të ngjizej pikërisht në Napoli pasi kishte kaluar një krizë të thellë shpirtërore. Mbështetja dhe përkrahja e Biderës ishte po aq vendimtare sa edhe kredhja në atë mishmash kaotik plot jetë e gjallëri siç ishte qyteti i Napolit. Napoli asokohe kishte fituar një rol qendror për kërkimet albanologjike dhe për fazat e mëvonshme të zhvillimit të historisë kulturore arbëreshe duke u bërë kështu, selia natyrore për takimet, shpesh të rastësishme e të shkurtra, mes intelektualëve arbëreshë që vinin nga treva të ndryshme shqipfolëse të Italisë së Jugut. Po në Napoli, atyre viteve, veç të rinjve arbëreshë që ishin mbledhur rreth Biderës⁷¹, De Rada do të takonte Dhimitër Kamardën, i mërguar aty për shkak të ideve të shpallura kundër regjimit të Burbonëve. Pikërisht në këtë mjedis kulturor që gëlonte nga personalitete me përvojë dhe formim kulturor të larmishëm, De Rada poqi idenë për veprën “divinazioni pelasghe” dhe nëse ia doli mbanë, një meritë për këtë e pati sigurisht Bidera.

BIBLIOGRAFIA:

1. Altimari Francesco, “Il ruolo degli intellettuali arbëreshë nella *rilindja* albanese e nella storia culturale del Mezzogiorno” në *Riflessioni sul mezzogiorno. Comunità arbëreshe e risorgimento italiano*, a cura di Mario Brunetti, Collana dell’Istituto Mezzogiorno-Mediterraneo, 3, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2004.
2. Bidera Giovanni Emanuele, *Gli ultimi novanta giorni del 1836 ossia Il colera in Napoli: racconti*, A spese di Raffaele De Stefano, Napoli, 1837.
3. Bidera Giovanni Emanuele, “Monumento biblico della storia critica dei Pelasgi dichiarato per mezzo della lingua schipta” në *Il Poligrafo. Rivista scientifica, letteraria ed artistica per la Sicilia*, anno I, vol. I, Stabilimento tipografico dell’Armonia, Palermo, 1856.
4. Bidera Giovanni Emanuele, *I centoventi giorni del riprodotto colera in Napoli: nuovi racconti*, Tipografia di Federico Ferretti, Napoli 1837.
5. Bidera Giovanni Emanuele, *Passeggiata per Napoli e contorni di Giovanni Emanuele Bidera*. Per uso di guida a’ forestieri, seconda edizione per cura del figlio Pietro Atanasio corretta e riveduta dall’autore, Dalla stamperia e fonderia di Giuseppe Cutaneo, Napoli, 1857.
6. Bidera Giovanni Emanuele, *Passeggiata per Napoli e contorni*, all’insegna di Aldo Manuzio, Napoli, 1845.

Lecca, albanese esso pure»: Girolamo De Rada, *Autobiologia. Primo Periodo*, Cosenza, Tipografia municipale di F. Principe, 1898, f. 20.

⁷¹ Te *Matn-eer* Bidera, për shembull, përmend Domenico Mauro-n (I, f. 332 shën. 1) dhe Tommaso Pace-n (I: f. 333-334 shën. 1), që asokohe banonin në Napoli.

7. Bidera Giovanni Emmanuele, *Passeggiata per Napoli e contorni*, all'insegna di Aldo Manuzio, Napoli, 1844.
8. Bidera Giovanni Emmanuele, *Quaranta Secoli. Racconti su le Due Sicilie del Pelasgo Matr-eer pubblicati da Emmanuele Bidera italo-greco*, all'insegna di Aldo Manuzio Napoli, 1846-1850 (vepra përbëhet nga katër vëllime të botuara në vite të ndryshme: I: 1846; II: 1847; III: 1849; IV: 1850).
9. Cometa Michele e Crescenzi Luca (a cura di), *Cultura e rappresentazione nell'età di Gæthe*, Carocci, Roma, 2003.
10. Crispi Giuseppe, *Memoria sulla lingua albanese di cui se ne dimostra l'indole primordiale e se ne rintraccia la rimota antichità sino ai Pelasgi, ai Frigi, ai Macedoni e agli Eoli primitivi, che la costituisce in gran parte madre della lingua greca*, Palermo, presso Lorenzo Dato, 1831.
11. Crispi Giuseppe, *Memoria sulla origine e fondazione di Palazzo Adriano colonia greco-albanese in Sicilia delle chiese ivi edificate, e dei litigj, che vi nacquero tra i due cleri da che vi s'introdusse parrocchia latina scritta dall'Ab. Giuseppe Crispi*, in Palermo, presso Lorenzo Dato, 1827, f. 31.
12. Crispi Giuseppe, *Opuscoli di letteratura e di archeologia*, Palermo, presso Lorenzo Dato, 1836.
13. De Rada Girolamo, "Pelasgi ed Elleni" në *Fiamuri Arbërit*, anno II, 20 settembre 1885, n. 5, Cosenza, 1885
14. De Rada Girolamo, *Antichità della Nazione Albanese e sue affinità con gli Elleni e i Latini*, Napoli, Stamperia dell'Industria, 1864.
15. De Rada Girolamo, *Autobiologia. Primo Periodo*, Cosenza, Tipografia municipale di F. Principe, 1898.
16. De Rada Girolamo, *Autobiologia. Secondo Periodo*, Napoli, 1899.
17. De Rada Girolamo, *Canti di Serafina Thopia principessa di Zadrina nel secolo XV. Poema Albanese volto in Italiano per Girolamo de Rada*, Napoli, Stabilimento Tipografico Domenico Capasso, 1843.
18. De Rada Girolamo, *Conferenze su l'antichità della lingua albanese e grammatica della medesima*, Tipografia di Francesco Mormile, Napoli, 1893.
19. De Rada Girolamo, *Opera Omnia*, vol. X *Opere filosofiche e politiche*, introduzione di Anton Nikë Berisha, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007.
20. De Rada Girolamo, *Principi di estetica*, Stabilimento Tipografico de' Fratelli De Angelis, Napoli, 1862.
21. De Rada Girolamo, *Un periodo della Autobiologia*, s.l. (Cosenza ?), s.d. (pas 1898 ?).
22. De Rosa Fiorella, *Introduzione a Girolamo De Rada, Opera Omnia*, vol. III, *I canti di Serafina Thopia*, edizione critica delle tre edizioni a stampa 1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in

collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, soneria Mannelli, 2007.

23. De Sanctis Francesco, *La giovinezza. Memorie postume seguite da testimonianze biografiche di amici e discepoli*, a cura di Gennaro Savarese, Giulio Einaudi, Torino 1961.
24. Dorsa Vincenzo, *Sugli Albanesi. Ricerche e pensieri*, dalla Tipografia Trani, Napoli, 1847.
25. Gioberti Vincenzo, *Del primato morale e civile degli italiani*. Tomo I. Dalle stampe di Meline, Cans e compagnia, Brusselle, 1843.
26. Gioberti Vincenzo, *Del primato morale e civile degli italiani*. Tomo primo. Prima edizione napoletana fatta sulla seconda belgia. A spese di Saverio Matarazzo editore, Napoli, 1848.
27. Gioberti Vincenzo, *Il gesuita moderno*, Tomo primo, Dalla stamperia del Vaglio, in Napoli, 1848.
28. Hahn von Johann Georg, *Albanesische Studien*, F. Mauke, Jena, 1854.
29. Malte-Brun Conrad, *Geografia universale o descrizione di tutte le parti del mondo trattata su d'un nuovo piano e giusta le gran divisioni naturali del globo preceduta dalla storia della geografia presso i popoli antichi e moderni e da una teorica generale della geografia matematica, fisica e politica; fornita di carte, prospetti analitici, sinottici ed elementari, e d'una tavola alfabetica delle denominazioni de' luoghi*, Traduzione dal francese. Tomo sesto, dalla tipografia Sonzogno e compagni, Milano, 1828.
30. Malte-Brun Conrad, *Précis de la Géographie Universelle, ou Description de toute les parties du monde, sur un plan nouveau, d'après les grandes divisions naturelles du globe; précédée de l'Histoire de la Géographie chez les Peuples anciens et modernes, et d'une Théorie générale de la Géographie Mathématique, Physique et Politique*, Tome sixième, imprimerie de Decourchant, 1826.
31. Malte-Brun Conrad, *Universal Geography or A description of all the parts of the World, on a new plan, according to the great natural divisions of the Globe; accompanied with Analytical, Synoptical, and Elementary Tables. by M. Malte-Brun, improved by the addition of the most recent information, derived from various sources. Volume VI. Containing the description of Europe*, Boston, Wells and Lilly-Court-Street and White, Gallaber And Write, New-York, 1828.
32. Masci Angelo, "Essai sur l'Origine, les Mœurs et l'État actuel de la Nation Albanaise par Ange Masci, traduit de l'italien; communiqué par M. Sonnini" në Conrad Malte Brun, *Annales des Voyages, de la Géographie et de l'Histoire, ou Collection Des Voyages nouveaux les plus estimés, traduits de toutes les Langues Européennes; Des Relations Originales, inédites, communiquées par des Voyageurs Français et Etrangers [...], publiées par M. Malte-Brun*, Tome troisième comprenant les cahiers VII à IX, chez F. Buisson, Paris, 1808, f. 145-234.

33. Miracco Elio, "Varianti nella edizione del 1843 nei *Canti di Serafina Thopia* di Girolamo De Rada", në *Miscellanea di albanistica*, a cura di Giuseppe Gradilone, Roma, 1997.
34. Mitko Thimi, "Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora" në *Fiamuri Arbërit*, anno III, 20 aprile 1886, n. 12, Cosenza, 1886, f. VIII; n. 5, 15 maggio 1886, f. I-IV; n. 7, 15 novembre 1887, f. V-VII.
35. Rocco Emmanuele, "Recensione a *Passeggiata per Napoli e contorni* di Emmanuele Bidera, Napoli, 1844" në *Il Lucifero. Giornale scientifico, letterario, artistico, industriale*, anno VII, n. 28, mercoledì 1844, Stabilimento poligrafico S. Fergola e F. Cirelli Napoli, 1844.
36. Sallusti S., "Giovanni Emanuele Bideri (Bidera)" në *Dizionario biografico degli italiani*, Istituto della Enciclopedia Italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.
37. Savoia M. Leonardo, "Aspetti della linguistica di De Rada nel quadro delle ricerche linguistiche arbëreshe del '700 e dell'800" introduzione a Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, vol. X *Opere grammaticali*, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007
38. Schirò Giovanni, *Rapporti tra l'Epiro e il regno delle Due Sicilie. Memorie*, Dalla Tipografia del Giornale Letterario, Palermo, 1834.
39. Schirò Giuseppe, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, Napoli, 1923 (r.a. Piana degli Albanesi-Palermo, 1986).
40. Schirò Giuseppe, *Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. V: *Këthimi, Mino, Opere teatrali, Mantnër*, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 1998.
41. Shuteriqi S. Dhimitër, "Një rilindës e botues i parë i folklorit arbëresh në shek. XIX, Thoma Paçe" në *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1987.

Jani THOMAI

(Tiranë)

FJALORI I NJË GRAMATIKE NË SYRIN E NJË STUDIUESI

Jam vërtet i kënaqur të merrem me një nga punët e shumta shkencore të profesorit të zot Kolë Ashta, si edhe shumë krenar që kam qenë nxënës i tij në lëndën e gjuhës shqipe në fillim të viteve '50 të shekullit të kaluar, këtu në Shkodër, në Shkollën pedagogjike. E kam të gjallë në përfytyrim profesorin tonë, ashtu të gjatë, me fytyrë e buzëqeshje të ngrohtë dhe me zë të butë e të ëmbël. Tash që kam hyrë vetë në moshën e tretë, e ravijëzohj edhe më të plotë portretin e tij fizik, shpirtëror e kulturor, ia shoh më qartë formimin e gjerë dhe aftësitë shkencore e komunikuese. Pasqyrime të këtyre i gjej edhe te studimi për gramatikën e parë të gjuhës shqipe, hartuar nga Francesco Maria Da Lecce dhe veçanërisht te pjesa “Leksiku i nxjerrë nga gramatika e parë e shqipes e Da Leçes: *Oservazioni grammaticali nella lingua albanese*” (Vërejtje gramatikore në gjuhën shqipe), botuar në Romë më 1716⁷².

Në pjesën e fundit të vëllimit V të përmbledhjes së veprave të prof. K. Ashtës “Leksiku historik i gjuhës shqipe” përfshihet studimi për Da Lecce-n dhe për gramatikën e tij, me të dhënat më të fundit për vetë autorin e me përfundime të prof. K. Ashtës, që i nxjerr si arsyetime bindëse për ato përfundime. Studimi ka dy pjesë: në pjesën e parë flitet për autorin e gramatikës, për formimin e tij, për shtegtimet e shërbimet, për punët kryera. Në pjesën e dytë jepet fjalorthi i fjalëve të shqipes të

⁷² Prof. dr. Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, V, Shkodër, 2009, f. 193- 287 e veçanërisht f. 247-287.

nxjerra nga gramatika e Da Lecce-s.

Vetë autori i gramatikës, siç mendon prof. K. Ashta, “qysh i ri do të ketë pasur dëshirë a prirje për gjuhësi. Kjo intuitë shoqërohet me punimet mbi leksikun e gramatikën e shqipes”⁷³. Por Da Lecce, që përmendet për gramatikën dhe si përkthyes i mundshëm i “Kuvendit të Arbënit”, nuk është i huaj për leksikografinë. Dihet që në Mat ai pati hartuar një “Fjalor italisht - shqip”. E fjalori i gramatikës së tij, i sistemuar si i tillë nga prof. K. Ashta, i shtohet veprimtarisë leksikografike të Da Lecce-s dhe besojmë se ky fjalor i ri, nga lënda leksikore dhe nga parimet leksikografike nuk do të jetë pa lidhje me “*Dizionario italiano-albanese*” (Mat, 1702, dorëshkrim), mbase edhe me “Fjalorin shqip-italisht” (i panjohur). Prof. K. Ashta na kumton se “Da Leçe gjuhën shqipe e studion nga ana gramatikore e posaçërisht morfologjinë e saj e për anën leksikore nuk shënon gjë në veprën e vet. Por ai u dha edhe mbas leksikut të shqipes e për këtë do të vlente botimi i veprës së mbetur në dorëshkrim “*Dizionario italiano – albanese*”, i vitit 1702”⁷⁴.

Futja e gramatikës së Da Lecce-s si tekst mësimor në katedrën e shqipes, të themeluar në Romë më 1711, në kuvendin françeskan San Pietro Montorio, shfrytëzimi nga të tjerë studiues, që nxorën prej saj lëndë e shënime dhe i botuan si shkurtore gramatikore, si dhe përdorimi nga të huaj, që donin ta njihnin shqipen përmes teksteve, por edhe “për ata fratini qi vijnë për së largu me ju shërbyem e përse kët ndë dhe të Romësë s’kanë haber të giuhësë sate”⁷⁵, shërbeu natyrisht edhe për ruajtjen, përhapjen e mësimin e fjalëve shqipe që kishte kjo gramatikë. Thënë ndryshe, kjo vepër shërbeu si gramatikë e fjalor njëherazi, në kushtet kur fjalët e shqipes ndërfteshin si njësi të veçuara në tekstin e përgjithshëm italisht.

Për t’iu përmbajtur tematikës së kësaj konference, do të

⁷³ Prof. dr. Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, V, Shkodër, 2009, f. 193- 287 e veçanërisht f. 193.

⁷⁴ *Po aty*, f. 241.

⁷⁵ *Po aty*, f. 202.

kapërcejmë ç'është shkruar nga të tjerët për këtë gramatikë e do të ndjekim analizat sipas kërkesës së titullit të kësaj kumtese⁷⁶.

I. Prof. K. Ashta, me analizat fonetike e gramatikore të gramatikës së Da Lecce-s, ka nxjerrë shumë vlera gjuhësore, shkencore e historike të kësaj vepre, por edhe na krijon mundësinë të shohim më tutje në veçoritë e brendshme të këtyre analizave e të vetë veprës. Shkurt këtu mund të përmendim dy-tri raste të elementeve të metodës së analizës:

1. Prof. K. Ashta ka shfrytëzuar në analiza e interpretime kategori të ndryshme leksiko-semantike, jo thjesht të formës së fjalëve, të përbërjes fonetiko-gramatikore, por edhe të përmbajtjes, të kuptimit leksikor, sipas të cilit ai bën dallimet ndërmjet fjalëve. Kështu, duke u marrë, në rrafshin fonetik, me kalimin e zanores së patheksuar *ë* në *a*, ai kalon në rrafshin leksiko-semantik e vëren që “ndajfolja *këhá* “këtu”, që tregon gjendje në vend, u shkrua në gramatikën e parë të shqipes *kahá* VIII; por kjo të mos ngatërrohet me një ndajfolje tjetër, e njohur me trajtat *kah*, *kahá* “nga”, e cila dëfton lëvizjen me drejtim nga një vend”⁷⁷.

2. Prof. K. Ashta është marrë mjaft gjerë me interpretime fonetike të fjalëve të shqipes në gramatikën e Da Lecce-s dhe nëpërmjet tyre shkon drejt burimit dialektor a krahinor të kësaj lënde. Kështu, duke shqyrtuar shndërrimin e *h*-së fundore e në mes të fjalës te disa folje në *f* (*shoh* > *shof*, *i ftohtë* > *i ftoftë*), ai mbështet mendimin se “Da Leçe është bartës i kësaj dukurie të Shqipërisë së mesme, ku jetoi për 20 vjet, e sidomos i krahinës së Matit”⁷⁸. Me këtë dukuri është marrë edhe prof. E. Çabej, i cili e cilëson si dukuri të Shqipërisë së mesme dhe që i përket periudhës turke të shqipes⁷⁹. Por ja ku vijnë edhe të dhënat nga leksiku si mbështetje për këtë përfundim: në grupin e këtyre foljeve Da Lecce përfshin edhe *mih* / *mif*, që u takon kryesisht të folmeve të Shqipërisë së mesme. Në interpretimet e veta prof. K. Ashta gërsheton të dhënat fonetike me

⁷⁶ Një bibliografi të shkurtër e jep prof. K. Ashta, *po aty*, f. 243-244.

⁷⁷ *Po aty*, f. 209.

⁷⁸ *Po aty*, f. 212.

⁷⁹ Në BSHSH, 1955, 2, f. 97-98.

natyrën e veçantë të leksikut, që vjen gjithnjë në ndihmë për karakterizimin e gjuhës së gramatikës, si te fjalët që marrin një *n* fillestare, të tipit *nkthell*, *nvjerrë* etj., që kanë vlerë specifikuuese për veçoritë dialektore a krahinore të tekstit të dhënë.

3. Vijnë pastaj interpretimet gramatikore (morfologjike), gjithnjë me vërejtjet e korigjimet e nevojshme për çdo rast që Da Lecce nuk e ka ditur mirë e ka gabuar. Në hulli të kësaj kumtese na intereson të hedhim dritë mbi ato interpretime të prof. K. Ashës, që implikojnë edhe elemente a kategori leksikologjike. Edhe në analizat gramatikore ndërthuren strukturime sipas kategorive paradigmatiche leksikore, si në fillin e formës së fjalëve, ashtu edhe në fillin e kuptimit a të përbërësve të kuptimit.

Kështu dallon që autori në gramatikë pranon “lloje të emrit”: *primitiv* (= i parmë), *i thjeshtë* (= i prejardhur, “semplice”) e *composto* (= kompozitë), pra njeh një paradigmë fjalëformuese në sistemin e fjalëve. Por paradigmata me lidhje formale me kufij më të qartë e më të pasur janë grupet paradigmatiche fjalëformuese, që prof. K. Ashta i ka trajtuar në një nyjë të veçantë⁸⁰, duke e rindërtuar sipas fjalëve shqipe që janë sjellë si shembuj, sepse në gramatikën e Da Lecce-s nuk flitet gjë për formimin e fjalëve.

Da Lecce njeh një gjini të pestë të emrit, gjini e përbashkët për shumë veta o sende, që i përgjigjet kuptimit përmbledhës (*gjutetas*), pra i përgjigjet një përbërësi semantik leksikor, d.m.th. krijon një paradigmë leksikore me lidhje semantike. Të paradigmatës semantiko-leksikore mund të quajmë edhe grupet e klasifikimit të ndajfoljeve sipas asaj që shënojnë: ***kohë*** (*sod*, *nesërë*), ***vend*** (*tërmal* dhe lokucionet *ndjeri këtu*, *ndjer atje*), ***mënyrë*** (*hieshim*, *lumshim* ose *marrisht*, *trimnisht*, *urtisht*, *arbërisht*), ***sasi*** (*shqimb* “shumë”). Por më të qarta dallohen grupet paradigmatiche leksiko-semantike te pasthirrat, klasifikimi i të cilave bëhet qartazi sipas kuptimit leksikor: ***shqetësim*** (*eja* “përdoret për atë njeri që mendon shumë, por nuk nxjerr gjë në dritë”), ***dhimbje*** (*veme*), ***pëlqim*** (*aferim*), ***vaj***

⁸⁰ K. Ashta, *po aty*, f. 238-240.

(*he, he*), *fshamje* (*eeeh*), *çudi* (*hāj, haj*), *tallje* (*hū*), *fatkeqësi* (*i mjeri*), *përbuzje* (*hajde dreq*), *nxitje* (*deh pra*). Njohja e nuancave semantiko-emocionuese e shprehëse jep mundësi të një sistemi të tillë paradigmatic të pasur. Këtu analizohen formimet me parashtesa (*a-, b-, ç-, d-/dë-, h-, k-/kë-, l-/lë-, m-/mbë-/mbër-*), me prapashtesa (*-aj, -an, -ar, -as, -de, -eshë, -i, -isht, -itunë, -m/-ëm/-më/-ëmë, -naj, -nī/-ëni, -nuem/-ënuem, -os, -oshe, -tar, -të, -tuem, -tunë, -s, -shëm/-shim, -uem, -uer/-or, -unë, -z/-zë, -zuer*) dhe me kompozim (përbërje e përngjitje). Këtij zberthimi të imët të paradigmave fjalëformuese në nënparadigma sipas mënyrës së formimit dhe sipas mjetit fjalëformues, nuk kemi çfarë t'i shtojmë, veç të përsëritim vërejtjen e rëndësishme të prof. K. Ashtës se “të gjitha ato fjalë janë të formuara nga gjuha popullore, me përjashtim të fjalëve *bdeksi* 130, *diekëqish* 200, *katundsisht* 200, *kangës* 53 e ndonjë tjetër si këto që janë neologjizma të Da Leçes⁸¹.

II. Në pjesën e dytë të studimit prof. K. Ashta, me kujdesin e përgatitjen e një leksikografi, ka nxjerrë në sistem fjalori gjithë fjalët shqip që Da Lecce i ka vënë në gramatikën e tij si shembuj. Kuptohet, me fjalët që kanë funksionin e shembujve në një tekst italisht, fjalorthi del i vogël (rreth 670 fjalë), fjalët shqipe janë kryesisht të shtresës më të përgjithshme dhe me kuptimin e tyre kryesor. Prof. K. Ashta ka dalluar disa grupe shembujsh, si me ndërrim kuptimi, neologjizma të Da Lecce-s, huazime nga turqishtja, greqishtja, latinishtja, sllavishtja etj.⁸².

Fjalorthi vetë jep mundësi për karakterizime e shtresime fjalësh nga shumë anë. Këtë e lehtëson puna e imët e prof. K. Ashtës, i cili në këtë rast ka dhënë shumë nga vetja, sa mund të quhet autor i këtij fjalorthi, sepse, veç fjalëve si glosar të nxjerrë nga gramatika e Da Lecce-s, gjithçka tjetër është analizë e i interpretim i hartuesit të këtij fjalorthi: shpjegime kuptimore, të dhëna për burimin e fjalëve, për fushën e përdorimit, për dëshmimin historik (krahasimi me autorët e vjetër), për strukturën fjalëformuese, për veçoritë gramatikore, për vlerat krahasuese

⁸¹ K. Ashta, *Po aty*, f. 239-240.

⁸² *Po aty*, f. 241-242.

gjuhësore me gjuhë të tjera (me greqishten, latinishten, turqishten, sllavishten e italishten), për strukturën fjalëformuese e veçoritë fonetike, madje edhe për keqkuptimet në formën a në përmbajtjen e fjalëve. Me këto të dhëna shkencore të mjaftueshme, fjalorthi hyn në tipin e fjalorëve shpjegues e të arsyetuar (résonné), kurse shoqërimi i fjalëve me gjegjësen italisht, siç vepron edhe Da Lecce në gramatikën e tij, i jep fjalorit tiparin tipologjik të leksikografisë dygjuhëshe.

Po japim më tutje vetëm disa veçori të këtij fjalorthi nëpërmjet grupeve më të dallueshme të fjalëve sipas veçorive leksiko-semantike:

1. Si fjalor i nxjerrë nga shembujt shqip të një gramatike në italishte nuk pritej të kishte sistemin e plotë të terminologjisë gjuhësore gramatikore. Edhe ndër ata pak *terma* ka mjaft të huazuar: *ablativ, akuzativ, dativ, emën, femënë, fjalë, giuhë, gramatikë, gjenitiv, nominativ, primitiv, i thjeshtë, vokativ*.

2. Gjithsesi, siç është vërtetuar në studimin e prof. K. Ashtës, nga lënda shqipe e gramatikës dhe nga fragmenti hyrës në shqipe, ajo është shkruar në dialektin e Veriut, më ngushtë në të folmen e Matit, por *fjalët dialektore e krahinore (ose me burim të tillë të ndjeshëm)* nuk janë të shumta, edhe në përpjesëtim me numrin e përgjithshëm të fjalëve që janë nxjerrë në këtë fjalor: *asgjāmengu, keqan, kësajde, kiem* “tëharr hardhitë”, *majdjë, marrisht, mbërçelë, mengu, ndëjyem, nestrashë, ngiatunë, i ngratë, prashu, sdripunë, shej* (pasthirmë), *shkopitunë, tash, tëthuer, tinëzë, urtisht, zdripunë*.

3. Në shtresimin e brendshëm të leksikut që përmban ky fjalorth pa dyshim zotërojnë fjalët e përgjithshme të ligjëritit popullor e ndoshta kjo shpjegon edhe pse ndër huazimet leksikore mbizotërojnë *turqizmat*: *afrim, agë, allah, allaj, amanat* “amanet”, *araxhī, ashikuem, baç, bezdisun, bre, çardak, çark, duqen, ferk, haber, hajde, hem, hesap, hile, kollaj, pashë, qindi, sahat, sulldan, shatirë, xhenet*.

4. Në sistemin semantiko-fjalëformues zotërojnë emrat e mbiemrat *me kuptim veprues* më *-ues/- (ë)s*: *ardhës, bās, bdekës, britës* “brejtës”, *çelës,*

dās “ai që ndan”, *dashës, farkues, folës, hās* “ai që ha”, *hīs* “ai që hyn”, *kies, lexues, lidhës, mbajtës, mbetës, nvras, pās* “ai që ka”, *prekës, pyetës, shërbyes, shkrues*.

5. Po në këtë sistem zotërojnë gjithashtu **ndajfoljet** më *-shëm/-shim*, që kanë temë të njëjtë me mbiemrat e nyjshëm përkitazi me to: *ditshim, dhünueshim, fortshim, hieshim, lumshim, mishëriershim, nkthellshim, shëmptueshim, shkurtschim*. Një grup të tillë të zhvilluar e ndeshim edhe tek autorët e vjetër.

6. Janë për t’u përmendur natyrisht si një lëndë përtëritëse **neologjizmat** e Da Lecce-s ose të përdorura prej tij si të tillë: *barioshe* “bareshtë”, *barivashë* (<*bari* + *vashë*) “bareshtë”, *bdekës* “ai që vdes”, *bdirës / bdjerrës* “humbës”, *bijës* “ai që bie”, *çbām, çëfutisht* “sipas mënyrës hebraike”, *diekëqisht* “dhelpërisht”, *fratinisht, gjaurisht, hās* “ai që ha”, *hīs* “ai që hyn”, *magjupisht, ndënatë, pajëtore* “mbojtëse”, *i pāvëllazënë, përdhiem, përrjerrë* “tatëpjetë”, *përmal* “përpjetë”, *shkëndyem* “nxjerr shkëndija”.

7. Fjalët **polisemantike** janë shumë të rralla, shih p.sh. *anëkuem, ditë, dhanë, greqisht, kah, lābdi, mbë, i mirë, natë, nzanë, raxmuem* “bisedoj”(Bardhi); “flas keq për dikë”, *shkelunë, truem, zot*.

8. Së fundi po theksojmë se në këtë fjalorth dalin mjaft **variante fonetike e fjalëformuese** të fjalëve, si: *amanat / amanet, ament / amen, sajt / asajde, asgjāmengu / asgjamangu, askūr / askūrr, baç / bahçe, bdirës / bdjerrës, çilës / çelës, mordhe / morte, paradje / pardje, parandaj / prandaj, paravjet / parvjet, zotinī / zotēnī* etj.

Fjalorthi i hartuar nga prof. K. Ashta, me lëndë leksikore të nxjerrë nga gramatika e Da Lecce-s, i botuar tashmë edhe në këtë formë, i shtohet bibliografisë së leksikografisë shqipe me mbi 500 tituj⁸³ dhe përbën një burim gjuhësor të rëndësishëm për studime historiko-krahasuese të shqipes.

⁸³ Shih te “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 329-371.

Miaser DIBRA

(Tiranë)

**MENDIMI KRITIK I STUDIUESVE SHKODRANË NË
VITET 1939-1944 PËR LETËRSINË ARBËRESHE**

Shkodra, e cilësuar jo më kot kryeqendër e Veriut, ka dhënë kontribut të dukshëm ndër faza të ndryshme edhe në kritikën dhe studimin e krijimtarisë artistike letrare. Janë veçuar në këtë kumtesë vitet '39-'44 të shek.XX si mjaft të spikatura sa i përket kontributit të studiuesve shkodranë të artit letrar, posaçërisht vëmendja është përqëndruar në shkrime kritike e konsiderata për disa prej personaliteteve arbëreshe më të njohura në fushën e letrave. Vërehet se, për problemin në fjalë disa intelektualë shkodranë, kryesisht të rinj, me formim filologjik perëndimor, bashkëbisedonin e polemizonin në faqet e shtypit të kohës me elitën intelektuale shqiptare, duke mbajtur kështu një peshë të ndjeshme në mendimin kritik letrar.

Nga studimi i përqëndruar i këtyre shkrimeve kritike dalin përgjithësime të rëndësishme.

- Janë disa zëra të spikatur që shkruajnë vazhdimisht, ndërmjet të cilëve, për mendime interesante mund të nënvizohet kontributi i Arshi Pipës, Jup Kastratit, Filip Fishtës, Injac Zamputtit, Kolë Ashtës, Izet Bebeziqit e ndonjë tjetri. (Përmendja e autorëve të mësipërm nuk ka parasysh gjithë mendimin kritik për letërsinë shqiptare të dhënë nga studiuesit shkodranë në këto vite, por vetëm të atyre që kanë prekur probleme mbi artin letrar ndër shkrimtarët arbëreshë të Italisë).

- Pjekuria e mendimit të kritikëve të sipërpërmendur duket që në objektin e marrë për trajtesë. Tërheq vëmendjen fakti se në qendër të

studimeve nuk janë vënë figura minore, por më të shquarit e letërsisë arbëreshe të traditës. Gjatë analizave të tyre ka përqendrim në tematikën e trajtuar, nivelin artistik dhe origjinalitetin e veprës letrare. Kryesisht është shkruar për traditën e krijuar gjatë Rilindjes Kombëtare, në të cilën, për shkaqet e njohura të vendit, lëvizja kulturore gjeti terren të përshtatshëm në Italinë e Jugut.

Ka shkrime për Jeronim de Radën, Zef Seremben, Zef Skiroin etj. Bie në sy sidomos vëmendja e përqendruar te De Rada, nisur nga vendi qendror që zë ky autor në letërsinë arbëreshe të deriatëhershme, por edhe për faktin se në këta pesë vjet është përkujtuar në disa shkrime 40-vjetori i vdekjes së tij.

- Duhet theksuar niveli shkencor i analizave, kompetenca e diskutimit, polemizimi me penda të tjera të zgjedhura, të afirmuara në kritikën letrare të atyre viteve. Dhe kjo ndodh për faktin e njohur historikisht se, sidomos në vitet '20 të shek. XX shumë familje shqiptare, që kishin mundësi ekonomike, shkolluan bijtë e tyre në universitete të njohura evropiane.

Edhe studiuesit e sipërpërmendur shkodranë përgjithësisht i përkasin kësaj kategorie. Shkollimi në vende të zhvilluara perëndimore shpjegon njohjen e teorive bashkëkohore, sjelljen e metodave studimore të shkollave të ndryshme, duke krijuar një klimë diskutimi e debati të frytshëm, që e ndihmoi dhe e nxiti aktivitetin e penave krijuese dhe filloi të ndihmojë për të realizuar një farë hierarkie të vlerave letrare. Në shkrimet e tyre nuk ka diletantizëm e hetohet referenca ndaj kritikëve e teoricienëve me famë botërore, kur bie rasti për të argumentuar mendimin vetiak. Prandaj nënvizojmë se, ndonëse niveli i përgjithshëm zhvillimor në Shqipërinë e asaj kohe linte për të dëshiruar, një elitë intelektuale në fushën e letrave i kishte të dallueshme arritjet, si në krijimtarinë e autorëve, ashtu edhe në angazhimet e mendimit kritik ndaj këtij produkti letrar.

Krahas zërave dinjitozë që shkruanin letërsi, ngjallej diskutim e polemikë edhe ndërmjet kritikëve. Vënia e veprave letrare në fokusin e

një kritike të specializuar, ka ndikuar që trashëgimia artistike e krijuar në ato vite të kishte nivelin e lakmuar që njihet. Vëmendja e këtyre kritikëve natyrshëm është sjellë edhe ndaj shkrimtarëve arbëreshë, duke e konsideruar trashëgiminë e lënë prej tyre si pjesë të pandarë të letërsisë shqiptare.

Mendimet e dhëna më sipër dalin si konkluzion pas shqyrtimit të disa artikujve, të shkruar nga disa pena të spikatura, të cilat ndikuan në nivelin e shkrimit kritik dhe në përgjithësi në zhvillimin e letërsisë artistike.

Shquhen për nivelin shkencor disa artikuj të **Arshi Pipës**, i ri në atë kohë, i dalluar si pretendues dhe polemizues. Veçojmë, për thellësinë e mendimit dhe mbështetjen në teori filozofike të përparuara të kohës për të shpjeguar dukuritë letrare, atë me titull “*Zef Serembe. Zotit*”⁸⁴.

Ndërmjet shkrimeve të tjera të këtij autori spikat veçanërisht artikulli “*Vepra atdhetare e poetike e De Radës*”⁸⁵. Ky shkrim është bërë me rastin e 41-vjetorit të vdekjes së De Radës. Ka një paraqitje mjaft të plotë të profilit krijues dhe atdhetar të poetit të madh arbëresh. Nënvizohet dyzimi atdhe-art që përshkoi jetën, krijimtarinë dhe gjithë veprimtarinë e tij në emër të zgjimit kombëtar. Shkrimi bën të ditur raportet me rilindësit e shquar Kristoforidhi, Thimi Mitko, Spiro Dine. Theksohet kontributi i tij me botimin e gazetës “*Fjamuri i Arbërit*”. Përshkruhet veprimtaria letrare, duke u ndalur më shumë tek “*Milosao*”, më tej tek “*Kangët e Serafina Topisë*” dhe “*Skënderbeu i pafat*”, me tendencë ballafaqimin e vlerave të tyre. Është për t’u nënvizuar se autori i shkrimit kërkon të bëjë dallimin ndërmjet veprave të rilindasit të shquar sa i përket kërkesave për stil, përvijuar vepër pas vepre, për tematikë në shërbim të çështjes kombëtare, për realizim artistik në përputhje me synimet kombëtare të Rilindjes. Studiuesi ndalet në gjinitë e llojet, risitë

⁸⁴ Arshi Pipa, “*Zef Serembe. Zotit*”, “*Kritika*”, Tiranë, 1942, nr.1, f.14-17.

⁸⁵ Arshi Pipa, “*Vepra atdhetare e poetike e De Radës*”, “*Bashkimi i kombit*”, 1 mars 1944, f.3.

që karakterizojnë veprën e De Radës në aspektin artformues, raportin me traditën gojore, ringjalljen dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë shpirtërore të popullit shqiptar në botime konkrete. Mendimet mbi natyrën dhe origjinalitetin e veprës së poetit arbëresh vijnë përmes pjesëve të zgjedhura ilustruese. Me një kujdes të veçantë dhe me formim filologjik të lakmueshëm, ai pasqyron origjinalitetin e poetit, për sa i përket raportit të tradicionales me krijimin, të letërsisë italiane të kohës dhe ndikimin e saj në mënyrën e të krijuarit poezi nga arbëreshi atdhetar. Nënvizohen si tipare të stilit shprehjet eksklamative, konciziteti i krijimit e rimimi i vargjeve. E ndjen nevojë të veçojë ritmin e brendshëm që karakterizon vargjet e poemës “Milosao”, si një ndër aspektet më të spikatura të artit të poetit. Ky shkrim mbështetet në njohje të thellë të veprës dhe teorive efikase për analizën poetike profesionale.

Herë pas here në shtypin e atyre viteve shfaqet një zë që jep mendime interesante dhe që e ka objekt të disa shkrimeve kritike letërsinë arbëreshe, **Filip Fishta**.

Në artikullin “*Për një pjesëtim ma të drejtë të letraturës sonë*”⁸⁶, ai shtron mendime për një problem të trajtuar shpesh në ato vite, periodizimin e letërsisë shqipe. Duke përkrahur tezën e hedhur nga Namik Resuli në një artikull të botuar në “*Shkëndija*” nr.2, 1940, mbi ndarjen e letërsisë sonë të trashëguar në dy faza, një para Lidhjes së Prizrenit e tjetra pas saj, Filip Fishta këmbëngul për të marrë në konsideratë prodhimin letrar të Arbëreshëve të Italisë dhe mbështet mendimin e një periodizimi më të detajuar të trashëgimisë sonë në fushën e letrave. Megjithëse propozimet e tij për periodizimin e letërsisë shqipe në tërësi nuk i kanë rezistuar kohës, ajo që duhet vlerësuar është mendimi i drejtë për vendin e shkrimtarëve arbëreshë gjatë fazave të zhvillimit të kësaj letërsie, duke u shprehur se e kishte të pamundun *paraqitjen e veprimit letrar të kolonive italo-shqiptare në një pjesë të veçantë, mbasi shkrimtarët e tyne xan vend*

⁸⁶ Filip Fishta, “*Për një pjesëtim ma të drejtë të letraturës sonë*”, “*Shkëndija*”, Tiranë, nr.3, 1940, f. 12-16.

përgjithësisht ndër të tanë qindvjett, deri në të 19-in qindvejt. ⁸⁷

Ndërmjet të tjerave shprehet: “A nuk duhet kurrsesi në grumbullin e letratyres shqipe para Prizrenit të përfshijmë gjithë vepren e zgjedhun të shqiptarëve në Jug të Italisë? Prof. Markiano, Gualtieri, Skiroi e ndër të soçëm prof. Petrotta, na i kan qitë në shesh edhe kto prodhime letrare t’Italo-Shqiptarëve nga një herë të zgjedhuna, tue nisë prej N.Figlia-s e Brancato-s e tue ardhë deri te vepra letrare prirjesh apo fryme shqiptare e njëj De Radës, i cili deri në kohën e Lidhjes së Prizrenit e ka pas mbyllë një pjesë të randësishme të veprimt të vet letrar e kombtar. Botimi i parë i Milosaut... asht i vjetit 1836.” ⁸⁸

Ndërsa në artikullin “*Talente letrare në fuqi*”, botuar në “*Tomori i vogël*” me 15 shkurt 1942, Filip Fishta përmend, krahas Muhamed Çamit, Lumo Skëndos, Kolë Mirditës, Migjenit, V.Kokonës, si ndër novelistët e njohur që ndihmuan për të krijuar traditë të prozës edhe zonjën arbëreshe Kristina Gentile Schiro Mandala, në kundërshtim me mendimin e hedhur për të nga Vangjel Koça, për boshllëk në trajtimin e novelës në shqip (në “*Kuvendime të kohës*” dhe “*Një problem i madh*”, “*Tomori i vogël*”, Tiranë, 1942, nr.3, fq.2).

(Në vijim të kësaj polemike, në një artikull pasardhës të së njëjtës revistë (nr.5, 1 mars 1942) V.Koça saktëson se zonja Kristina Gentile Schiro Mandala nuk ka novela origjinale, por ka mbledhur “...*novela popullore ndër arbëreshët e Italisë...*” (*Mendimi letrar shqiptar*, v.e cit., fq.158)

Për argumentimin e mendimeve të tij ky autor përdor shpesh dokumenta të shfrytëzuara në arkivat dhe bibliotekat e Vatikanit.

Një zë tjetër, që ka filluar të ndjehet në kritikën e atyre viteve është **Jup Kastrati**. Në artikullin e tij “*Dramatika shqiptare*”, ⁸⁹ nënvizohet se vepra ma e parë dramatike shqiptare është “*Emira*” e Anton

⁸⁷ “*Shkëndija*”, nr.3, 1940, f. 16.

⁸⁸ Enver Muhametaj, “*Mendimi letrar shqiptar*”, Tiranë, 2009, f. 101.

⁸⁹ Jup Kastrati, “*Dramatika shqiptare*”, “*Revista letrare*”, Tiranë 1944, nr.11, f. 6-7.

Santorit. "...E para dramë shqiptare jo vetëm nga gjuha, po edhe nga fryma, nga ndjenjat, nga përshkrimet, nga zakonet..."⁹⁰. Studiuesi e konsideron këtë dramë si veprën më të bukur të Santorit. Ai bën historikun e botimit në "*Fiamuri i Arbërit*" të De Radës dhe nënvizon si shumë interesant përshkrimin e zakoneve të martesës të shqiptarët e Kalabrisë në rrjedhën e subjektit të kësaj vepre. Që në këto shkrime të para duket saktësia, korrektësia dhe kronologjia e informacionit, e cila do të karakterizojë edhe studimet e mëvonshme të këtij autori.

Ky studiues përmend shumë herë konsideratat e Gaetano Petrottës dhe vepërën e tij "*Saggio di bibliografia albanese*" (Palermo, 1931) lidhur me zhvillimet e dramaturgjisë shqiptare ndër kohëra.

Në vitet në vazhdim Jup Kastrati do të thellohet më shumë në studime të zgjeruara të veprës së De Radës.

Një zë tjetër shkodran, që duket hera-herës në faqet e shtypit të shkruar është **Izet Bebeziqi**. Spikat artikulli i tij me titull "*Shkrimtarët arbëreshë. Zef Serembe*"⁹¹.

Në këtë shkrim ky autor merr përsipër të ndriçojë vlerën e veprës së Zef Serembes, në përgjigje të ndonjë mendimi të hedhur në shtypin e kohës se ky poet nuk njihet sa duhet në Shqipëri. I ekzaltuar nga ndjesia që i shkaktonte krijimtaria e Serembes, ai shpreh konsideratën më të lartë për atë që lexuesi merr nga vepra e poetit "*fatcub*". Në këtë shkrim ai paraqet jetëshkrimin e Serembes, prejardhjen, shkollimin në Shën Mitër Koronë, nënvizon se ishte nxënës i De Radës. Në vijim autori e konsideron poetin si këngëtarin e madh të dashurisë njerëzore, të dashurisë për atdheun. Nënvizohen detajet dhe tiparet poetike që i japin veçanësi veprës lirike të tij. Në disa raste ka edhe ilustrime me vargje, të cilat i veçon si më tipike, për të dhënë karakteristikat dhe tipologjinë e poezisë së Serembes. Ky shkrim i kalon caqet e një artikulli, pasi është më

⁹⁰ Jup Kastrati, "*Dramatika shqiptare*", "*Revista letrare*", Tiranë, 1944, nr.11, f. 6.

⁹¹ Izet Bebeziqi, "*Shkrimtarët arbëreshë. Zef Serembe*", "*Revista letrare*" Tiranë, 1944, nr.12, f. 10.

tepër një studim përfshirës, ku zë vend jeta e vështirë e autorit, shëndeti i munguar, mosrealizimet jetësore, të cilat ndikuan edhe në karakterin elegjiak të vjershërimit. Nënvizohen ndikimet e poezisë italiane në tipologjinë metrike të vargjeve të Serembes. vlerësuar sidomos sonetin. E konsideron si poet të letërsisë së kultivuar, duke duke pohuar, se këtë autor “...Zana popullore arbëreshe nuk e ndikoi aq sa De Radën”⁹². Studiuesi njih publikun me faktin se shumë krijime të tij kanë humbur dhe nënvizon një përmbledhje me 39 vjersha, të titulluar “Vjershe”, botuar nga i nipi i poetit, Kosmo Serembe. Ky shkrim krijon një përfytyrim mjaft të sintetizuar mbi krijimtarinë e kësaj pene aq të njohur të letërsisë së shkruar ndër Arbëreshët e Italisë dhe padyshim materiali i përfshirë ka qenë një pikënisje e mirë për studiuesit e mëvonshëm, të cilët kanë realizuar studime të thelluara mbi poetin.

Injac Zamputti, filolog që do të jetë më vonë një zë me peshë në studimet gjuhësore shqiptare, në artikullin “Zef Skiroi këndon vdekjen e të birit”,⁹³ trajton zanafillën e njëres ndër poezitë më të njohura të Skiroit, atë për vdekjen e djalit, Minos. Ajo që e befason artikullshkruesin, ndjesi që kërkon t’ua transmetojë edhe lexuesve, është ndikimi i madh nga rapsoditë popullore në karakterizimin e figurës së të birit. Ai shkruan se poeti nuk vajton por këndon, me kërkesën që ta përjetësojë të birin si një kreshnik, nën shëmbëlltyrën e të kahershëmve. Për artikullshkruesin mbetet i rëndësishëm përgjithësimi i arritur nëpërmjet kësaj poezie, e cila i kalon kufijtë e vajtimit për birin e humbur. Është i qartë mesazhi i shkrimit të Zamputtit, kur përcakton *poetin baba* dhe *poetin shqiptar* që këndon për *vdekje frymëzuese*. Shkrime të tilla pretendojnë studim të thelluar edhe të një njësie të vogël krijuese, siç është një poezi. Merita e Zamputtit është se ka ditur të zgjedhë ku të ndalet, duke shpalosur me të vërtetë vlera të spikatura përfaqësuese në krijimtarinë e poetit arbëresh.

⁹² Enver Muhametaj, “Mendimi letrar shqiptar”, v.e cit., f. 306.

⁹³ Injac Zamputti, “Zef Skiroi këndon vdekjen e të birit”, “Tomori i vogël”, Tiranë, 1942, nr.19, f. 3.

Fillon të ndjehet ndër këto vite një zë, i cili në të ardhmen do të jetë njëri ndër studiuesit më të mirë të letërsisë e gjuhës shqipe, **Kolë Ashta**. Ka dy shkrime të tij me rastin e përvjetorit të vdekjes së Jeronim de Radës (një në “*Balli i rinisë*”, Tiranë, 1943, nr.6. dhe një në “*Shkëndija*”, “*Tue përkujtue katërdhetë vjetorin e vdekjes së Hjeronim De Radës, ndihmestari i Rilindjes letrare e kombtare.*”, Tiranë, 1943, nr.4, f.32-34.)

Karl Gurakuqi ka shkruar një artikull me titull “*Lotë malli nga arbëreshët e Sigelisë*” në *Hylli i Dritës*⁹⁴, ku flet për disa figura të njohura në arealin krijues arbëresh, vëllezërit Skiro, Gaetano Petrottën dhe Dhimitër Kamardën. Edhe Gurakuqi shquhet për aftësi vëzhguese dhe interpretuese të letërsisë së kultivuar.

Duke përfunduar mendoj se disa nga këto shkrime, bërë nga intelektualët shkodranë të asaj kohe, përkrah mendimeve të kritikëve të tjerë shqiptarë, kanë qenë ndihmesë konkrete në studimet tona të mëvonshme letrare, pikërisht se janë shkruar me akribi e skrupolozitet shkencor të respektueshëm. Autorët e sipërpërmendur nuk dhanë thjesht mendime personale të momentit, apo rrëmbime simpatish pa bazë por, siç u shprehëm që në fillim, këta artikuj shquhen për objekt interesant, përqendrim në disa prej figurave arbëreshe më në zë, të cilët mbetën në panteonin e veprave letrare shqiptare. Këta shkrime ndihmuan për t’i dhënë karakterin e duhur kritikës sonë letrare dhe metodologjinë e përshtatshme për të arritur qëllimin.

Natyrisht, përqendrimi vetëm në një periudhë kohore kaq të shkurtër nuk krijon dot një përfytyrim të plotë mbi atë që kritika letrare ka botuar për këtë pjesë të rëndësishme të letërsisë sonë. Kritika dhe mendimi teorik letrar mbarëshqiptar ka patur angazhim të vazhdueshëm ndër dhjetëra vjet për t’i dhënë vendin e merituar në hierarkinë e vlerave të letrave shqipe autorëve arbëreshë të Italisë. Por synimi i këtij shkrimi ishte të arrihej një njohje sa më vertikale e disa prej kontributeve të

⁹⁴ Karl Gurakuqi, “*Lotë malli nga arbëreshët e Sigelisë*”, “*Hylli i Dritës*”, Shkodër, 1942, nr.5-10, f.198-211.

shkodranëve gjatë një pesëvjetëshi mbi vlerësimin e shkrimtarëve arbëreshë. Ajo që u paraqit shërben si për të nënvizuar shkrime që në vitet '39-'44 bënë objekt trajtесе letërsinë e krijuar ndër Arbëreshët e Italisë, ashtu edhe thellon njohjen për një plejadë studiuesish shkodranë të rinj aso kohe, disa prej të cilëve, siç e dimë, e lidhën gjithë karrierën e tyre profesionale me studimet filologjike albanologjike.

Emil LAFE

(Tiranë)

FJALORI ARBËRISHT – SHQIP I KOLË KAMSIT SI BURIM PËR VËZHGIME GJUHËSORE

Kolë Kamsi (1886-1960) ka qenë një emër i njohur në filologjinë shqiptare, sidomos në fushën e studimeve arbëreshe, por një nga veprat e tij kryesore, “Fjalor arbërisht – shqip”, u botua vetëm 40 vjet pasi kishte mbyllur sytë autori. Është rasti të shënojmë 50-vjetorin e vdekjes së autorit dhe 10-vjetorin e botimit të veprës së tij, duke përgëzuar Sektorin shkencor të albanologjisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe të gjithë të tjerët që u kujdesën dhe bënë të mundshëm botimin e fjalorit.

Fjalori arbërisht – shqip i Kolë Kamsit është punë e një jete. Autori ka pasur fatin të ishte nxënës i Kolegjit të njohur të Shën Adrianit në Shën Mitër (San Demetrio Corone), në vitet 1904-1907. Këtu djaloshi shkodran iu ngjall edhe dashuria për Botën Arbëreshe. Gjithë jetën letërsia arbëreshe mbeti fusha e tij e pandarë e punës. Për ta bëtë më të afërt për nxënësit shqiptarë atë letërsi me vlera të larta artistike dhe atdhetare, ai pati idenë e mbarë që të hartonte një fjalor arbërisht - shqip. Është fat që veprën e la të kryer si autor. Siç ka vënë në dukje redaktori i kujdesshëm i fjalorit, prof. Ferdinand Leka, “një veçori e tij, e mund të thuhet edhe një meritë, është se autori ka pasqyruar një leksik të dokumentuar me saktësi në shkrimet arbëreshe, duke i ilustruar fjalët me citate origjinale e të zgjedhura, pa shtuar asgjë nga vetja, duke e bërë veprën një mjet pune të sigurt edhe për studiuesin e kulturës arbëreshe.” (Parathënie f. 3).

Deri në botimin e fjalorit të Kolë Kamsit në vitin 2000, kemi pasur në duar vetëm “Fjalorin e Arbëreshvet t’Italisë” të Emanule Giordanos, të botuar më 1963⁹⁵. Autori i tij, i mbushi të 90-at këtë verë dhe me këtë rast le t’i drejtojmë urimin që të arrijë edhe 100 vjet e më shumë! Fjalorët e këtyre dy autorëve kanë të përbashkët se paraqesin leksikun e arbërishtes. Por kanë edhe dallime. E. Giordano-ja e ka hartuar fjalorin kryesisht për Arbëreshët dhe shpjegimet i ka dhënë italisht, në mënyrë që përdoruesit arbëreshë, në përgjithësi me kompetencë më të plotë në italishte sesa në gjuhën e vet të shtëpisë, ta kapin më mirë e më qartë kuptimin e fjalës. Them kryesisht për Arbëreshët, sepse vetë autori ka theksuar në parathënie se vepra e tij u drejtohet edhe “vëllezërve nga ana tjetër e Adriatikut, të cilët sot studiojnë më shumë se kurrë shkrimtarët arbëreshë të Italisë.” (f. IX)⁹⁶. E. Giordano-ja ka futur në fjalorin e vet edhe një numër fjalësh të Shqipërisë, duke i dhënë karakterin e një fjalori shqip – italisht, me të cilin Arbëreshët mund të lexonin botime të Shqipërisë. Për këtë qëllim ai ka futur edhe zanoren y në një varg fjalësh dhe si shkronjë të veçantë në fjalor (*dy, dyllë, fyell, fyenin, fyt, grykë, ylber, yll* etj.), kur dihet se ky tingull mungon në të folmet arbëreshe.

Fjalori i Kolë Kamsit është hartuar për t’u përdorur nga Shqiptarët, prandaj ai përmban thuajse vetëm fjalë të dëshmuara te shkrimtarët arbëreshë e në botimet arbëreshe dhe shpjegimet e fjalëve jepen me sinonimet e shqipes. Kolë Kamsi ishte një veprimtar i arsimit kombëtar dhe fjalori i tij është një vepër gjuhësore, por edhe në shërbim të shkollës. Ai u drejtohet mësuesve të letërsisë dhe studentëve për t’i ndihmuar që të kapërcejnë vështirësitë gjuhësore në të kuptuarit e shkrimtarëve arbëreshë. Por, përveç dobisë praktike që ka si çdo fjalor, ai përfaqëson njëkohësisht edhe një material të përpunuar për vëzhgime e studime. Nëpër faqet e tij,

⁹⁵ Emanuele Giordano. *Fjalor i Arbëreshvet t’Italisë. Dizionario degli Albanesi d’Italia*. Edizioni Paoline. Bari, 1963, 592 f. Fjalorë të tjerë të mbetur në dorëshkrim i përmend E. Giordano në parathënien e fjalorit të vet (f. IX).

⁹⁶ Me sa jam në dijeni, me interesimin e vetë autorit një pjesë e mirë e tirazhit të këtij fjalori u dërgua në Shqipëri dhe u vu në shitje.

ashtu si edhe të fjalori i E. Giordano-s, gjejmë shumë fjalë me interes nga këndvështrime të ndryshme.

Në fund të kësaj kumtese paraqitet një pasqyrë e krahasuar e autorëve dhe veprave të vjela nga hartuesit e dy fjalorëve të arbërishtes. Nga ajo del se janë vjelë gjithsej 49 autorë: 18 prej tyre janë të përbashkët për të dy autorët, E. Giordano ka vjelë edhe 17 autorë të tjerë, ndërsa K. Kamsi 14 autorë. Kështu që këta dy fjalorë plotësojnë njëri-tjetrin dhe japin së bashku një pamje më të plotë të leksikut të arbërishtes. Ndërkaq me veprimtarinë kërkimore dhe botuese të Degës së albanologjisë në Universitetin e Kalabrisë, të drejtuar nga prof. F. Altimari, njohja jonë për leksikun e arbërishtes vjen duke u shtuar e saktësuar.

Një pjesë e mirë e leksikut të arbërishtes është e përbashkët me leksikun e përgjithshëm të shqipes. Por ka disa fjalë të përbashkëta që në arbërishte përdoren me një kuptim të ndryshëm nga i shqipes së këtushme, p.sh. *arëzë* atje ka kuptimin ‘bletë’ (fjala bletë mungon te Kamsi, kurse Giordano e ka me kuptimet ‘zgjua’ dhe ‘luzmë’; *greq* te Arbëreshët ka kuptimin ‘pirun’; *grikë* diku ka po atë kuptim si në shqipen *grykë*, por më fort ka kuptimin ‘gojë’ (fjalë e urtë: *Vrau më grika se shpata*); *çonj* ka kuptimin ‘gjej’ (*Miir se ju çonj!*), *ngastër* te Skiroi me kuptimin ‘lagje’ etj.

Një veçori tjetër të leksikut të arbërishtes e përbëjnë formimet e reja popullore ose letrare. K. Kamsi i ka dalluar shpeshherë me shënimin *neol.* (neologjizëm) fjalët e krijuara prej shkrimtarësh, p.sh.: *atëri* ‘atdhe’ (Dara); *ballnik* ‘prijës’ (Skiro, “Canti tradizionali”); *ditare* ‘gazetë, e përditshme’ (“Fiamuri Arbit”); *gjumës* ‘bar gjumësjellës’ (K. Serembe), *iktar* ‘i ikur, ikacak’ (Skiro, “Rapsodie”), *nënkrie* ‘nënkresë, jastëk’ (De Rada) etj. Por, sipas përshtypjes sime, jo pak neologjizma letrare kanë mbetur pa këtë shënim.

Te fjalori i K. Kamsit hasim mjaft fjalë që na bëjnë përshtypje për tingëllimin dhe kuptimet e tyre, si *afërmi* ‘afërsi’ (Skiro), *i barmë* ‘vend i veshur me bar’ (De Rada), *besërisht* ‘besnikërisht’ (Santori), *besor-i* ‘besojmë’ (Kamodeka), *duhie* ‘nevojë’ (Skiro), *i fluturm* ‘i shpejtë’ (De

Rada), *i harrroshëm* ‘harraq, i pakujdesshëm’ (Skiro), *ligjëri* ‘drejtësi’ (De Rada), *përvapet* ‘ngrohet’ (Z. Kamarda) etj.

Pa u zgjatur më tej me qëmtime shembujsh që ngjallin kureshtje, dëshiroj të theksoj se leksiku i arbërishtes është një fushë pune me shumë interes dhe pak e lëvruar. Dy fjalorët e botuar të arbërishtes janë një bazë e mirë materiale për të ndërmarrë hulumtime si tema punimesh për gradën master ose si disertacione doktorate.

Së pari, mund të ndërmerret një studim i krahasuar i të dy fjalorëve për të nxjerrë në pah veçoritë e tyre si vepra leksikografike, synimet e autorëve, dhe sidomos të krahasohet fjalësi i dy fjalorëve. Fjalori i K. Kamsit mund të ketë 10-11 mijë fjalë, kurse fjalori i E. Giordanos në botimin e parë, sipas vetë autorit përmban mbi 19 mijë fjalë. Është me interes të nxirret nga ky krahasim se cilat fjalë të K. Kamsit mungojnë te fjalori i E. Giordanos (dihet ndërkaq se E. Giordano ka futur në fjalorin e tij edhe fjalë të shqipes së Shqipërisë).

Së dyti, mund të studiohet fjalësi i K. Kamsit nga pikëpamja e burimit të fjalëve, duke përcaktuar: a) fjalët e përbashkëta me shqipen e atdheut - sipas E. Giordano-s (fq. X), përbëjnë rreth 45% të fondit leksikor të arbërishtes; b) krijimet e reja brenda arbërishtes mbi bazën e fjalëve shqipe; c) italianizmat (d.m.th. kalabrizmat, përkatësisht sicilianizmat); ç) greqizmat, duke bërë përpjekje për të dalluar greqizmat e përbashkëta me dialektet e sotme jugore të shqipes dhe greqizmat e reja, që kanë hyrë në arbërishte pas ndarjes nga trugu mëmë);

Së treti, mund të vështrohet fjalësi i K. Kamsit nga pikëpamja e fjalëformimit, duke synuar të nxirren në pah mjete dhe tipa karakteristikë të fjalëformimit të arbërishtes;

Së katërti, mund të hetohet e të vihet në dukje në mënyrë më të plotë neologjia e letrarëve arbëreshë, përpjekjet e tyre për pasurimin e leksikut të arbërishtes me formime vetjake;

Së pesti, mund të hetohen e të vihen në dukje fjalët që letrarët arbëreshë kanë marrë nga shqipja e mëmëdheut, duke u përpjekur për zgjerimin e mundësive shprehëse të arbërishtes letrare; te cilët prej tyre

vihet re më fort kjo dukuri - sipas E. Giordano-s fjalë të tilla zënë rreth 5% të fondit leksikor të arbërishtes dhe shkrimtarët që i kanë përdorur më fort janë Skiroi, Serembja, Gavril Dara dhe Santori (fq. X)⁹⁷.

Së gjashti, mund të krijohet një pamje më e saktë për përhapje gjeografike të fjalëve, pasi arbërishtja dëshmon se disa fjalë që sot kujtohen si të trevave veriore, do të kenë qenë të përhapura edhe në trevat jugore, prej nga e kanë kryesisht prejardhjen Arbëreshët.

Së shtati, mund të hetohen në një mënyrë sa më të plotë dallimet kuptimore të fjalëve të përbashkëta, si ato që u përmendën, për të përcaktuar edhe si e pse kanë ndodhur ato.

Së teti, mund të klasifikohet lënda sipas fushave tematike, duke dalë në pah cilat janë më të pasura e cilat më pak dhe duke kërkuar arsyet për këtë.

Së nënti, mendoj se në vështrim leksiko-gramatikor është me interes të studiohen në tërësi parafjalët dhe lidhëzat e arbërishtes.

Të gjitha këto do të ndihmojnë për të realizuar një detyrë më të hapët: kam parasysh ndërtimin e një **korpusi të leksikut të gjuhës shqipe të periudhës paraosmane e parabuzukiane**, që do të përfshinte fjalët e dokumentuara drejtpërdrejt ose tërthorazi si të asaj periudhe; krahas tij mund të ndërtohej edhe korpusi i shprehjeve frazeologjike e i fjalëve të urta deri në atë cak kohor. Kjo, mendoj, se ka rëndësi qoftë për historinë e

⁹⁷ Duke shfletuar fjalorin e E. Giordano-s, më ka tërhequr vëmendjen fjala **pakë-a sf.** grosso pezzo di grasso: *shtú dy galiqe krypë, shtú edhe dy barrë qepë, vú tri paka hjiromér...* pose due misure di sale, gettò due cariche di cipolla, infuse tre grossi pezzi di lardo (B. Bilotta, Opere indeite). Këtë fjalë e kisha dëgjuar për herë të parë gjatë ekspeditës sime dialektologjike në Nikaj-Mërtur (1960). E. Çabej, që e merr si huazim gjermanik ("Studime etimologjike në fushë të shqipes", VI, f. 127), jep si burim të parë të saj fjalorin e Bashkimit. Prof. F. Altimari, të cilit iu drejtova për të vërtetuar nëse kemi të bëjmë me një fjalë të vjetër të arbërishtes, m'u përgjigj se nuk e ka ndeshur kurrë këtë fjalë në mjediset arbëreshe, po ashtu dhe e shoqja e tij, që është prej Frasnite (fshati i B. Bilotës). Me sa duket, B. Bilota (1843-1918) e ka marrë këtë fjalë nga fjalori i Bashkimit. Shihet në këtë rast, ashtu si dhe në raste të tjera, përpjekja e letrarëve arbëreshë për të zgjeruar leksikun e shkrimeve të tyre duke u mbështetur te gjuha e atdheut të hershëm.

gjuhës shqipe në vetvete, qoftë për historinë tonë kulturore, pasi ato fjalë mund të shihen edhe si dëshmia e nivelit të qytetërimit e të kulturës shqiptare të kohës.

Kam përshtypjen se tematika gjuhësore e studimeve arbëreshe (duke përfshirë këtu edhe Arbëreshët e Greqisë), është lënë pas dore te ne. Le të vlejë kjo konferencë jo vetëm si një homazh për studiuesit shkodranë të Botës Arbëreshe, por edhe si një nxitje që tradita e studimeve arbëreshe në Shqipëri të gjallërohet, duke shfrytëzuar edhe mundësitë e bashkëpunimit me qendrat universitare e kërkimore arbëreshe.

Pasqyrë e krahasuar

Autorë dhe vepra të vjela nga hartuesit e dy fjalorëve të arbërishtes: Emanuele Giordano (1963) dhe Kolë Kamsi (2000)

Nr.	Autorë arbëreshë	Vitet e jetës	Giordano	Kamsi
1	Arcuri Costantino	1810-1871	+	
2	Argondizza Antonio	1834-1919	+	+
3	Bellusci Michele	1574-1806	+	
4	Bellusci Costa	1796-1867	+	+
5	Bilota Bernardo	1843-1918	+	+
6	Braile Salvatore	1872-1961		+
7	Brancato Nicola	1675-1741		+
8	Bugliari Gian Crisostomo	1876-1919		+
9	Bugliari M. A.			+
10	Cadicamo Francesco			+
11	Camarda Demetrio	1821-1882	+	
12	Camarda Zef	1831-1878		+
13	Camodeca C.			+
14	Camodeca Pietro	1847-1918	+	+
15	Capparelli Orazio	1852-1940	+	
16	Chidichimio Demetrio	1846-1922	+	+
17	Chinigò Alfonso	1859-1917		+
18	Chinigò Francesco	1866-1952		+
19	Cirese M. A.			+
20	Cremonese Enrico	1868-1901	+	

21	Crispi Giuseppe	1781-1859	+	
22	Crispi Glaviano Francesco	1852-1933	+	
23	Dara Gabriele (junior)	1826-1885	+	+
24	De Rada Girolamo	1814-1903	+	+
25	De Rada Giuseppe	1852 - 1883	+	+
26	Dorsa Vincenzo	1823-1885	+	+
27	Ferrari Josif	1913-1990		+
28	Figlia Nicolò	1693-1769	+	
29	Librandi Vincenzo	1867-1932	+	
30	Lorechio Anselmo	1843-1924	+	
31	Mandalà Christina	1856-1919	+	
32	Marchese Domenico-Antonio	1879-1926	+	+
33	Marchianò Michele	1860-1921	+	+
34	Marchianò Stanislao	shek. XIX	+	
35	Masci Angelo	1758-1821	+	
36	Matranga Luca	1560-1619	+	+
37	Parapugna Achile	1855-1883	+	
38	Pisarra G.			+
39	Ribecco Agostino	1867-1928	+	+
40	Santori Antonio	1819-1894	+	+
41	Schirò Giuseppe	1865-1927	+	+
42	Schirò Paolo	1866-1941		+
43	Scura Antonio	1872-1928		+
44	Serembe Cosimo	1879-1938	+	+
45	Serembe Giuseppe	1844-1901	+	+
46	Straticò Vincenzo	1822-1885	+	
47	Tamburi Francesco Saverio	shek. XVIII-XIX	+	
48	Tocci Donato	shek. XVIII-XIX	+	
49	Variboba Giulio	1724-1788	+	+
	Autorë joarbëreshë të Italisë			
1	Furiqi Petro	1875-1936		+
2	Mjeda Ndre	1866-1937		+
3	Xanoni Anton	1862-1915		+
	Albanologë			
1	Meyer Gustav	1850-1900		+

2	Rohlf's Gerhard	1892-1886		+
Fjalorë				
1	Bashkimi	1908		+
2	Fjalor i gjuhës shqipe (Tiranë)	1954	+	
3	Gazulli Nikollë	1941		+
4	Kristoforidhi Kostandin	1904	+	+
5	Leotti Angelo	1937	+	
6	Rossi (Roma)	1866, 1875	+	
Revista e vepra arbëreshe ose me materiale arbëreshe				
1	A Dora D'Istira – Gli Albanesi	1870	+	
2	Antologia albanese di G. De Rada	1896	+	
3	Arbri i Ri (Palermo)	1887	+	+
4	Fjala e T'Ynzoti (Palermo)	1912-1915	+	+
5	Fjamuri i Arbrit	1883-1887	+	+
6	Kalimere (Castrovillari)	1916	+	
7	La Nazione Albanese	1897-1905	+	
8	La Nuova Albania	1898-1904	+	
9	Letërsia e vjetër shqipe e arbëreshe (Tiranë)	1954	+	
10	Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912 (Tiranë)	1961	+	
11	Përpyjekja shqiptare (Tiranë)	1936-1939		+
12	Poezia popullore arbëreshe (Tiranë)	1957	+	
13	Rruzari i Zonjës Virgjër (Palermo)	1910, 1931	+	
14	Shêjzat	1957-1963	+	

Shaban SINANI

(Tiranë)

**BOTA ARBËRESHE DHE VENDLINDJA
NË VEPRËN E M. CAMAJT**

“Im ljaljë ish kundër prirjes në Atdhenë e lashtë. U nëng jam aq çot, njuant, thoji ai, të prirem ktje ka erdhtim, të vemi mbaptht si karavidhja, po ket ngami asaj anë ka ecën dielli. Im ljaljë e kish ndërmend të migronte në Merkë ... E ndëse nëng na përqen atje ... ket ikmi me diellin rro rro gjith botës dhe dalim tek Dheu i inë”.

Martin Camaj, “Karpa”, Roma 1987, f. 70.

“Arbëria matanë detit na kujton,
Se ne të huaj jemi te ky dhé.
Sa mote shkuan. E zemra s’e harron,
Se nga turku mbetëm pa atdhe”.

Zef Serembe, “Rrutullupë” (“Vrull”).

Bota arbëreshe është një nyje e qëndrueshme e programit krijues të Martin Camajt. Pas vendlindjes, arbëreshët, italo-shqiptarët, pa dyshim ishin bashkësia etnike që ai njihte më mirë në gjithë hapësirën historike-kulturore, ku kufijtë i cakton gjuha shqipe. Siç ka vërejtur me të drejtë

studiuesi M. Mandalà, “në dhé të huaj, arbëreshët dhe Camajt e kanë shkruar shumë herë historinë e tyre në pergamenën e kujtesës së tyre”⁹⁸.

Kodi tradicional i rregullimit të jetës në vendlindje, fillimet e gjuhës së shkruar shqipe, gjendja e Arbërit në epokën e humanizmit evropian, fisnikëria shqiptare që mërgoi në fillimet e periudhës otomane, arbëreshët me gjuhën, mitet, krenarinë për të shkuarën dhe dramën e kohëve të reja, janë argumente që sundojnë gjithë veprën e Camajt, shkencore dhe letrare, duke rregulluar dhe drejtpeshuar rendin e saj të brendshëm dhe duke i dhënë asaj karakter të njësuar.

Vendlindja, katundi prej lumit në bjeshkë, kthehet në veprën e Camajt si dominim i rinisë së hershme; kurse bota arbëreshe, me katundet e veta tradicionale të ndërtaura ngjashmërisht me ato të vendit të origjinës, e gjen hapësirën e vetes pas një përvoje njohjeje të drejtpërdrejtë në mesmoshën e shkrimtarit. “Ai ka lidhje të fortë me ato që janë aspekte tradicionale të letërsisë gojore shqiptare dhe letërsisë që njohu përmes arbëreshëve. Ishte ambientuar me botën arbëreshe dhe e ndiente shumë afër atë. Ishte bota shqiptare alternative e tij, sepse bota shqiptare e tij e mohoi, për shkak të regjimit. Ai i njihte vlerat e përbashkëta me botën arbëreshe”⁹⁹. Midis shqiptarëve të Italisë ai ishte më i veti se të vetët, sepse u bë më arbëresh se arbëreshët.

Më parë se në letërsi, interesimi i Martin Camajt për arbëreshët nis me kërkimet dialektologjike, folkloristike, etnologjike, si mbledhës i traditës së pashkruar nga goja e popullit. Rezultatet e këtyre kërkimeve ai i botoi në revista shkencore të njohura, si “Shêjzat”, “Studi albanesi”, “Südost-Forschungen”, “Zjarri”, në botimet Trofenik dhe në disa tribuna të tjera. Këto janë kërkime që provojnë se jeta e arbëreshëve dhe jeta e shqiptarëve nuk ka qenë e ndarë me kufij, ka pasur lidhje të vijueshme

⁹⁸ Shih: M. Mandalà, “*La vita d’un uomo in un palinsesto mai scritto*”, botuar në “*Wir sind die Deinen*”, përgatitur për botim nga B. Demiraj, Harrassowitz Verlag, 2010, f. 83.

⁹⁹ F. Altimari, “*Camaj më 1980: Nuk shkruaj kundër dikujt, por për fjalën shqipe*”, intervistë në “*Gazeta shqiptare*”, 16 tetor 2010.

ndikimi tek njëri-tjetri (përpjekjet e himariotëve dhe të bregdetasve në përgjithësi prej shekullit të 17-të e në vijim për të ndërruar vartësi administrative kishtare duke ruajtur ritin bizantin, misionarët basilianë me Nilo Katalanon në mbështetje të kërkesave të bregdetasve, Paolo Schirò si arkiveshkv i Durrësit në fillimin e shekullit të 18-të dhe letra e tij drejtuar Selisë së Shenjtë latinisht e shqip, kolegji Urban, kolegjet e tjerë në Kalabri e Siçili, ku u formuan klerikë e dijetarë arbëreshë e shqiptarë deri në gjysmën e parë të shekullit të 20-të).

Prej vitit 1957, kur Camaj boton “Nji prrallë arbëreshe”, bota e italo-shqiptarëve do të mbetej një përbërëse themelore e punës krijuese shkencore dhe letrare të tij si shkrimtar e dijetar. Njëra fazë përgatit tjetrën, prej reportazheve dhe përshtypjeve ekskursioniste të udhëtimit vijjnë relacionet për gjendjen e të folmeve arbëreshe, çështjet e tipologjisë së tyre, raportet për mbijetoja të folësve të arbërishtes jashtë arealeve të njohura, deri tek përfshirja e saj si një prej tri formave të të shprehurit shqip në “Albanian Grammar”¹⁰⁰, krahas shqipes së njësuar dhe gegërishtes, që është e vetmja gramatikë deri më sot, ku arbërishtja ofrohet për mësim për të huajt dhe vendësit. Më 1959 boton shkrimet “P. Gj. Schirò, Kryepriфт në Piana” (“Shêjzat”, 1-2, f. 63), “Ndër katundet arbreshe në Kalabris (përshtypje)” (“Shêjzat”, 7-8, f. 281-283) dhe “Festimet e Ungrës” (“Shêjzat”, 9-10, f. 332-334). Edhe në vitin 1960 vijojnë përshtypjet e udhëtimit, me relacionin “Udhëtim veruer nëpër Arbreshë të Kalabris” (“Shêjzat”, 7-8, f. 254-256). Faza e mëvonshme shenjon kalimin prej shënimeve të një reporteri në kërkime për traditën gojore, folklorike, etnozakonore dhe dialektologjike, midis të cilave veçohen: “Novellistica italo-albanese: testi orali raccolti dal. prof. Luca Perrone (“Studi albanesi” I/1967 dhe “Südost-Forschungen”, nr. 28, f. 436-437); “Gjurmë të popullsisë shqiptare në provincën e Piacenzës” (“Shêjzat”, 7-9/1969, f. 317-319); “La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino” (“Studi albanesi” IV/1971, f. 26), “Racconti

¹⁰⁰ “Albanian Grammar, with exercises, chrestomathy, and glossaries”, by Martin Camaj, translated and collab. Leonard Fox, Harrassowitz, 1984.

popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile (Barili) in provincia di Potenza” (“Studi albanesi” III/1972); sërish “Novellistica italo-albanese: racconti popolari di S. Sofia d’Epiro, S. Demetrio Corone, Macchia Alb., S. Cosmo Alb., Vaccarizzo, S. Giorgio Alb; me një hyrje nga G. Gradilone, mbledhur nga P. Gianpietro, E. Miracco, C. Bellucci dhe F. Mantranga” (“Studi albanesi” II/1970 dhe “Südost-Forschungen” nr. 31, f. 493); “Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell’Italia meridionale - bilinguismo e diglossia in Italia” (Centro di Studio per la Dialettologia italiana 1/1973, f. 5-13; “Die albanische Mundart von Falconara albanese in der Provinz Cosenza” - “E folura shqip e Falconara Albanese në provincën e Kozencës” (“Albanische Forschungen”, 16/1977); “Una frase in Arbëresh dell’anno 1483” (“Zjarri” 26/1979, f. 22-25); “Per una tipologia dell’arbëresh” (“Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia” - Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Università di Palermo, 1982, f. 151-158); “La parlata arbëreshe di San Constantino Albanese in provincia di Potenza” (Centro Editoriale e Librario dell’Università della Calabria, 1991); “Aspetti del plurilinguismo presso gli arberesh d’America” (“Zjarri”, I: 30/1986, f. 18-20; II: 33/1989, f. 136-147); “Il contributo degli italo-albanesi alla cultura europea” (“Albanica” 3-4/1992, f. 45-49).

Në revistat ku pati mundësi të botonte, shkroi recensione dhe vëzhgime kritike për studimet e filologëve arbëreshë: Giuseppe Schirò, Matteo Schambra, Francesco Solano, Francesco Altimari, Matteo Mandalà, Antonino Guzzetta dhe të tjerë. Mund të vërehet lehtë se Camaj u kushtoi vëmendje të posaçme botimeve e studimeve për të cilët nuk shkruhej në shtypin shkencor në Shqipëri e në Kosovë, sidomos letërsisë kishtarë, të traditës dhe asaj të re. Shkroi ndër të tjera për përkthimin “Mesha e Shën Jan Gojartit përkthyer shqip nga Em. Pal Schirò botuar me kujdesin e prof. Zef Schiroit” (“Shêjzat”, 7-10/1964), f. 454), “Shkrimi Shêjt - katër Ungjijt dhe Punët e Apostujvet - përkthye shqip prej teksteve origjinale nga Msgr. Dr. Joseph J. Oroshi” (“Shêjzat” 1977,

f. 376-377); për autorët dhe veprat e ndaluara ose të mënjanuara a të harruara¹⁰¹.

Me veprën letrare të Martin Camajt ndryshohet një prirje sunduese shekullore në letërsinë shqipe. Letërsia gojore arbëreshe, me ciklin e Gjergj Kastriotit dhe të heronjve fisnikë të epokës së qëndresës humaniste antiosmane, ruajti dhe madhështoi kujtimin e dheut të Arbërit. Letërsia humaniste romantike arbëreshe gjithashtu ishte e drejtuar në temën e qëndresës antiosmane shqiptare, të cilën e kishte si kohë epike; dhe lëndonte Shkodrën, Zadrimën, Himarën, Skurajt, Dukagjinët, Balshajt, Muzakajt, Arianitët dhe të tjerë¹⁰². Në letërsinë arbëreshe të shekullit të 20-të hyri dhe emri modern i Shqipërisë. Një prej protagonistëve parësorë të mendimit shqiptar në botën arbëreshe, Francesco Crispi, më 1892 projektonte daljen e Shqipërisë prej sundimit otoman duke zgjuar interesin e Italisë. Edhe në kohët moderne, malli i mëmëdheut dhe miti i origjinës diktuan që letërsia arbëreshe të shohë nga Shqipëria. Martin Camaj për herë të parë provoi përgjegjësinë e letërsisë shqipe për të zbuluar me mjetet e saj arbëreshët vetë, jo si dëshmitarë hershmërie të Shqipërisë mesjetare; jo si argument vlerash shpirtërore të popullit shqiptar në epokën humaniste; jo si pikë reference për të datuar ngjarje e zhvillime të mëhershme e të mëvonshme këndej Adriatikut, por si bashkësi që bën jetën e vet, një jetë që nuk është aspak idilike dhe as romantike si në realitetin e përfytyruar artistik, por ka shqetësimet e veta

¹⁰¹ Më shumë të dhëna në: Jonida Xhyra-Entorf, “*Verzeichnis der Schriften Martin Camajs*”, botuar në “*Wir sind die Deinen*”, përgatitur për botim nga B. Demiraj, Harrassowitz Verlag, 2010, f. 51-75. Gjithashtu dhe: Ledi Ikonimi, “*Një vështrim bibliografik veprës së Camajt*”, punim vjetor, Shkolla e Masterit dhe e Doktoratës, QSA 2010, f. 5. Gjithashtu nga ajo: “*Bibliografi e veprave të Martin Camajt*”, në “*Studime filologjike*”, nr. 1/1995.

¹⁰² Shih ndër të tjera F. Altimari, “*Miti i Skënderbeut ndër Arbëreshët e Italisë*”, në “*Skënderbeu dhe Evropa*”, përgatitur e redaktuar nga F. Duka, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2006, f. 306-313.

tronditëse ekzistenciale, dilemat e mëdha historike: të jetojë pa frikën e tretjes në mjedisin heterogjuhësor apo të ruajë me fanatizëm të shkuarën. Botës arbëreshe Camaj i kushtoi dy vepra, novelat “Shkundullima” dhe “Katundi me gjuhë të fshehtë”. Por arbëreshët dhe arbërishtja gjenden të pranishëm edhe në vepra të tjera të tij, në poezi¹⁰³, në dramatikë dhe në romanet ku hapësira dhe njerëzit janë të vendlindjes, si romani “Karpa”, ku Eseisti, arbëreshi i urtë, është i vetmi karakter që vullnetarisht e ka lënë peng lirinë e vet për të jetuar të njëjtin fat me bashkëkombësit e tij të kyçur në kopështin zoologjik, një farë “ferme kafshësh” ku eksperimentohet diktati i të parit, si në romanet e G. Orwell-it; me patriark të padiskutueshëm jo “Vëllain e Madh”, por Gjyshin e stërmoçëm. Nëse në përgjithësi i qëndron kritikës pohimi se në veprën e Camajt nuk ka karaktere pozitivë e negativë, heronj e kundërshtarë pllakateskë të tyre¹⁰⁴, si në letërsinë e realizmit socialist dhe përgjithësisht në letërsinë e virtytshme, karakteri i Eseistit arbëresh, që rikthehet në letërsinë shqipe në një formë tjetër edhe në romanin e Luan Starovës “Kurbani ballkanik”, me emrin Mario Dukagjini, bën përjashtim. Eseisti mban kryqin e mundimit të një tiranie që sundon në Karpë duke mos qenë vetë personalisht pjesë e dënimit, por si një figurë ideale, disi “outsider”¹⁰⁵, që fatalisht e sheh jetën e vet të kushtëzuar prej bashkësisë

¹⁰³ Shih, për shembull, poezinë “Gjarpijtë e zez”, në: Martin Camaj, “Gedichte”, Kyrill & Method Verlag, 1991, f. 82; gjithashtu nga “Nema”: “Diasporë - që vjen me thënë gjak i shprishur”; nga “Buellli” - “Rapsodi në letër”; nga “Palimpsest” - “Kuptimi”; nga libri “Njeriu më vete e me të tjerë” - “Pranvera në katundin arbëresh” dhe “Lutje për foshnjen në gjumë”; prej ciklit “Kangë të vjetra” - “Veshja arbëreshe”, “Dimni i Jeronim de Radës”; nga vëllimi “Lirika mes dy moteve” - “Valle arbëreshe” dhe shumë të tjera.

¹⁰⁴ Shih: Anton Berisha: “Vepra letrare e Martin Camajt”, Cosenza 1994, f. 50: “Në romanet dhe në novelat e tij nuk bëhet ndarja e personazheve në negative e pozitive”.

¹⁰⁵ Yrjet Berisha, “Pse novelat e botuara të Martin Camajt nuk janë marrë në shqyrtim”, në “Tema”, 4 dhe 7 shtator 2009: “Esteti (sic!), a si quhet ndryshe

së të parëve, ashtu si thuhet në Shkrimet e Shenjta, në të mirë e në të keq, në lumturi e në fatkeqësi.

Fati i Gjon Gazullit, në novelën me të njëjtin emër, tërthorazi ndërlihd e ndërthur gjithashtu vendlindjen e Camajt me botën arbëreshe. Gazullorët dhe Engjëllorët janë dy patronime shenjuese të prekjës humaniste të Arbërit në periudhën paraosmane, ashtu sikurse shumica e mbiemrave patronimikë të arbëreshëve edhe sot ruajnë kujtimin e kryehershëm të botës shqiptare. Është e njëjta kohë, e njëjta aristokraci, me të njëjtin ndriçim humanist evropian, që u ndërpre për shkak të krijimit të perandorisë ndërkontinentale otomane. Disa studiues shohin një paralele midis romanit “Gjon Gazulli” dhe romanit “Karpa”, i cili, pavarësisht propozimit prej autorit si një prospekt i së ardhmes, në thelbin e vet është një retrospektivë. Ky roman “është ambientuar në mesjetë: në kohën kur do të botohej ky libër, në Itali flitej shumë dhe për këto vepra mesjetare. Flitej sidomos për “Emrin e trëndafilin” të Eco-s. Ai insistoi që kjo vepër të kishte një lidhje të veçantë. Dërgoi 200 kopje - u bëra ndërmjetës - në abacinë e Grottaferrata-s, ku ka murgj arbëreshë në ritin ortodoks, abaci e njohur botërisht, sepse ka qenë laborator i librit të lashtë, të njohur jo vetëm në Itali”¹⁰⁶.

edhe Arbreshi, është plak i nderuar dhe tejet i zgjuar. Është ai që shkon me dëshirë në Kopshtin Zoologjik, kur Gjyshi, si zot i Karpës, e kishte hapur atë që quhet edhe kampi i izolimit për pleqtë e kastruar, që aty (në Kopsht) vendosen dhunshëm, tok me kafshët e egra. Esteti shkon të jetojë aty duke u solidarizuar me pleqtë e shumtë dhe u shërben si mjek psikiatër. Ai ishte i vetmi plak që kishte të drejtë të largohej nga Kopshti e nga Karpa, por ndjenjat humaniste nuk e lejonin të vepronte ashtu. Ai është i mençur, krenohej me lashtësinë arbëreshe, ishte ndër banorët e rrallë të Qytetzës (më mirë të themi të Kopshtit) që i fliste disa gjuhë të huaja, kishte njohuri brilante nga arti, nga kultura, dinte dhe i interpretonte mrekullueshëm shumë çështje e probleme nga filozofia, etika, psikoanaliza, psikologjia etj”.

¹⁰⁶ F. Altimari, “Camaj më 1980: Nuk shkruaj kundër dikujt, por për fjalën shqipe”, intervistë në “Gazeta shqiptare”, 16 tetor 2010.

Dy novelat e Camajt, “Shkundullima” dhe “Katundi me gjuhë të fshehtë”, mund të cilësohen si dëshmia më e rëndësishme letrare, etnografike dhe etno-psikologjike, se në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të në botën e shqiptarëve të Italisë përfundimisht mbyllet historia e ëndrrës së rikthimit, që do të thotë se ndodh kapërcimi përfundimtar prej romantizmit në ndërgjegjen kritike. Arbëreshët e këtyre dy novelave lavdinë e “motit të shkuar” e evokojnë tashmë vetëm si pjesë të kujtesës etnike, por jo si një nxitje për rikthim. Eseisti, Arbëreshi që u mbijeton shekujve në romanin-parabolë “Karpa” dhe shfaqet në vitin 2338 me cilësitë e një magu, një distari të traditës veriore shqiptare, thotë:

“Im ljaljë ish kundër prirjes në Atdhenë e lashtë, u shpjegon banorëve të Karpës Eseisti, arbëreshi vullnetar që është bërë banor i Qytezës. U nëng jam aq çot, njurant, thoji ai, të prirem ktje ka erdhtim, të vemi mbraptht si karavidhja, po ket ngami asaj anë ka ecën dielli. Im ljaljë e kish ndërmend të migronte në Merkë ... E ndëse nëng na përqen atje ... ket ikmi me diellin rro rro gjith botës dhe dalim tek Dheu i inë”¹⁰⁷. Kapërcimi i ndërgjegjes romantike dhe kthimi në realitetin e vërtetë në një anë bën që Shqipëria të jetë këndeje e tutje thjesht një atdhe poetik; por në anën tjetër bën të kuptohet më qartë udhëkryqi dramatik i një bashkësie, për të cilën zor se mund të thuhet se “dheu i të parëve” kishte shprehur ndonjëherë interes për mënyrën si jetojnë, për gjendjen e tyre në mjedisin alogjen. Martin Camaj shenjoin kthimin e vëmendjes tek arbëreshët nga qëllimet tradicionale shkencore-kulturore në shqetësime të mirëfillta njerëzore.

Cili është udhëkryqi i arbëreshëve? Kur vdes një shpresë, ose kur e humb fuqinë një ëndërr, siç ishte rikthimi në dheun e të parëve, “Il Ritorno” (1913), sipas titullit të poemës së njohur të G. Schirò-it, përmasa e së ardhmes tronditet, shkundullohet. “Çasti i ri” i jetës së tyre në novelën “Shkundullima”, një fjalë që Camaj e mori prej arbërishtes, me

¹⁰⁷ Martin Camaj, “*Karpa*”, Roma, 1987, f. 70.

kuptimin “tërmet”¹⁰⁸, por që në viset e vendlindjes së autorit gjithashtu u ruajt deri në kohët moderne, me një trajtë e kuptim tjetër, në formën “shkandull”, tronditje morale, si në gjuhët neolatine fjala “scandal”, është një çast në kapërcyell, një çast trans, prej një projekti shumëshekullor, që nis me kohën e lavdishme të qëndresës antiosmane, në realitetin e pandryshueshëm. Tashmë ata e dinë se, gjithnjë duke iu referuar një idiomë tjetër të G. Schirò-it, edhe kjo titull poeme, duhet të pajtohen për të jetuar “Te dhéu i huaj” (“Nella terra straniera”, 1900). Pyetja dramatike që shtron Camaj në këto dy novela është se nga duhet të drejtohet shikimi i arbëreshëve: nga “e shkuara e lavdishme” e kthyer në mit, e shprehur në formën e nostalgjisë për atdheun e humbur gjithnjë e më utopik, apo nga një e ardhme ndryshe, duke parë veten tek tjetri, duke mos e përfutur tjetrin si një rrezik për asimilim, por si qenie të së njëjtës botë. Sipas mendimtarëve të sotëm diskriminimi mbaron kur ndryshimi bëhet i pavërejtshëm: cilido qoftë - historik, gjuhësor, etnik, fetar, kulturor, racor. Duke e përjetuar gjakftohtësisht “dilemën e shekullit” të arbërve, Camaj shfaqet si një prej intelektualëve nismëtarë të shqiptimit të thirrjes së brendshme që ëndrra e rikthimit duhet të cilësohet një ide e mbyllur dhe hapja ndaj botës së madhe mbetet e vetmja formë mbijetese.

Pikërisht çasti në kapërcyell e bën jetën e arbëreshëve të “Shkundullimës” traumatike. Projekti i shumë breznive, “besojma” apo credo-ja e të parëve, ishte shembur, dhe kjo është pamja e parë e shkundullimës. Bashkësia i kthehet vetvetes, konservon të shkuarën, mbyllet në kurthin e traditës, refuzon ndryshimin, jeton si një provincë brenda provincës. Në këtë novelë shkrimtari ka zgjedhur si kryeshenjë të testimi të vetëdijes së bashkësisë së arbëreshëve ndërtimin e një ure. Një urë bashkëjetese në mjedisin e “Itirit”? Shenja e novelës së Camajt edhe këtë kuptim e bart mbi vete. Por ndërtimi i urës trazon ndërgjegjet e njerëzve, ngre kundërveprimin ndaj inxhinierit me emrin Vito, kthehet në thashethem ndaj tij dhe së dashurës arbëreshe, Ntonias, duke i dhënë

¹⁰⁸ Shih Emanuele Giordano, “*Fjalor i arbëreshëve t’Italisë*”, edizione Paoline Bari, 1963, f. 472.

situatës pamjen e një kurthi. Vetëm tërmeti, ashtu si në poemën e lavdishme të Jeronim de Radës, “Milosao”, mund të sheshojë muret e ngritur midis të vetëve dhe të tjerëve. Në një kuptim, ky është dhe udhëkryqi i vetë autorit. “Te viset e arbëreshëve, ku, ashtu si Koliqi, shkonte shpesh, gjente vërtet një spikamë të botës shqiptare, por kishte gjasë që, ndonëse e pabezdisshme prej doktrinës, ajo spikamë e zbehtë, më shumë se zëvendësuese, ishte thjesht një trishtim. E ka kuptuar se përderisa poeti Zef Skiroi, ndonëse i lindur në këto vise, i kishte quajtur megjithatë “te dheu i huaj”, aq më tepër do të ishin të tilla për të”¹⁰⁹. Ky pohim ka diçka të vërtetë, që lidhet me vetminë e shkrimtarit dhe me mungesën e botës së vendlindjes. Por pikërisht në ndryshimin e kësaj vetëdijeje qëndron fuqia e artit të Camajt. Në mesin e shekullit të 20-të shfaqen fillimet e modernitetit të letërsisë shqipe ndër arbëreshët (Dushko Vetmo). Zhvillohen paralelisht disa prirje. Carmine Abate shkruan italisht dhe bëhet fenomen i letërsisë italiane. Njësimi i shqipes letrare ndikon në “shqipëzimin” e arbërishtes (rasti i poezisë së Dushko Vetmos dhe G. Schirò di Maggio-s), por më shumë në “arbëreshizimin” e ligjërit poetik. Më shumë se “Arbëria përtej detit”, shqetësim i vetë letërsisë arbëreshe bëhet lokalja, parrokialja, kthimi tek vetja. Pikërisht në këtë kohë përftohet ideja pacifikuese për të mos e parë mjedisin arbëresh të jetës si mjedis të tjetrit, por si atdhe të dytë. Dhe Camaj, shkrimtari i botëve të ishullzuara, këshillon pikërisht hapjen ndaj këtij atdheu të dytë, duke u bërë një prej shkrimtarëve shqiptarë europeistë më të hershëm. Vetëveçimi është një gjendje sunduese edhe në novelën tjetër “Katundi me gjuhë të fshehtë”. Ardhja e mysafirit në Katund, që shkrimtari e quan me një emër të trefishtë: “I huaji”, Dijetari dhe Shtrigani, zgjon tek e dashura e dikurshme arbëreshe, Flora, jo ndjenjën e hershme të dashurisë, por dëshirën për të lartësuar lavdinë e dikurshme të të vetëve, duke u kthyer në një cicëronë të vërtetë të një bote që po arkivon të shkuarën.

¹⁰⁹ I. Kadare, “*Martin Camaj, shkrimtari i lartësive*”, hyrje në “*Camaj, veprat, vëllimi I-X*”, Tiranë, 2010.

Në dy novelat e Camajt përmes fatit të individit gjykohet fati i bashkësisë. Paraleleve subjektive, midis shkrimtarit dhe arbëreshëve, u shtohen paralelet historike dhe gjuhësore. Përkundër asaj që është pohuar në studimet folkloristike, që arbëreshët ruajnë si kujtim të fundmë të vendlindjes Morenë, në patroniminë historike dhe të sotme të tyre ruhet një mbresë e fortë prej veriut shqiptar, prej viseve ku krishtërimi roman prekej me krishtërimin pravosllav¹¹⁰. Këtyre u shtohen ngjashmëritë në zhvillimin historik-gjuhësor, duke përfshirë të quajturën paskajore analitike gegërishte të formës “me plus pjesore”, të vërejtur prej studiuesit F. Altimari, që rezulton pjesë e sistemit të arbërishtes së shkruar më së paku prej Codice Chieutino¹¹¹.

Katundin arbëresh dhe vendlindjen e autorit, në romanet “Karpa” dhe “Rrathë”, apo në novelat “Pishtarët e natës” dhe “Rrunga në mars” i bashkojnë shumë cilësi. Mbi të gjitha është mungesa e perspektivës, rreziku i shuarjes prej faqes së dheut. “Temali nuk shenjohej më në hartat e Shqipnisë”, pohonte me dhimbje Camaj¹¹². Pas më shumë se dy shekujsh sjelljeje ekzotike të udhëpërshkruesve perëndimorë, të etnologëve të huaj, të vetë shkrimtarëve shqiptarë, me malet shqiptare, me malësorët krenarë, me “bijtë e shqipeve”, me atë prirje që në vitet 1930 qe shqiptuar në formën: “Europa duhet ta kthejë malësinë e Shqipërisë në një muze të gjallë të vlerave kalorësiake, ku brezat të mund të shohin në sy të shkuarën e tyre”, Martin Camaj vendos ta shkatërrojë këtë hyjnizim, që në

¹¹⁰ Sh. Sinani, “*Botë arbërore veriore në letërsinë arbëreshe: rasti i patronimeve*”, në “*Midis dy Rilindjesh*”, Tiranë, 2010, f. 160-176.

¹¹¹ F. Altimari, “*Traces d’infinitifs anciens dans l’abanais d’Italie*”, në “*Wir sind die Deinen*”, përgatitur për botim nga B. Demiraj, Harrassowitz Verlag, 2010, f. 131 e vijim.

¹¹² Hans-Joachim Lanksch, “*Martin Camaj - një djalë bariu poet i rangut botnor*”, në të përditshmen “*Koha ditore*”, Prishtinë 2 dhjetor 1999: “*Temali, vendlindja e Camajt, nuk ishte ma në hartat e Shqipnis. Ky fakt e randonte shumë poetin, që kishte antena të stërhollueme ndjeshmënie. Me dhjetëvjetshe ishte, larg atyne që flasin si unë*”.

të vërtetë është hyjnizim i prapambetjes. Një sjellje e ngjashme kishte sunduar dhe letërsinë dhe studimet shqiptare për arbëreshët. Për gati dy shekuj ishin kryqëzuar një hyjnizim ekzotik i prapambetjes shqiptare prej vizitorëve europianë dhe një hyjnizim i lashtësisë së arbëreshëve prej homogjenëve të tyre në dheun e të parëve.

Përkundër kësaj tradite, asnjë shenjë neoekzotike nuk ka në dy veprat e Camajt. “Dritësimi alpin” i veprës së tij, “luksi gjeografik”¹¹³ që është përmendur, janë shenjat e mjeshtërisë së shkrimtarit, jo ndonjë lartësim i botëve të çuditshme kanunore dhe mesjetare. Ai i sheh me dhimbje dilemat e mjediseve të zgjedhura për shpirtëzimin e veprave të tij dhe i trondit lexuesit, në pamundësi për të shenjuar një zgjidhje tjetër, me dukuri të jashtëzakonshme të natyrës: botën arbëreshe - shkundullima dhe botën e të parëve të shkrimtarit - rrungaja.

Ishullzimi është tmerri i Camajt në mënyrën si i sheh vendlindjen dhe botën arbëreshe. Ishullzimi gjithnjë e më pak është një vetëzgjedhje për ta, gjithnjë e më shumë është një kushtëzim prej rrethanave të jashtme. Vetëruajtja, në vendlindjen e autorit prej ideologjisë kushtetuese dhe në botën arbëreshe prej asimilimit të shtetit të tjetrit, është ajo që nxit ishullzimin.

Mjediset e ishullzuara, katundet arbëreshe dhe katundet midis bjeshkës e lumit, shkrimtari nuk ua paraqet lexuesve për t’ua lëvdur bëmat e së shkuarës, por për t’i zgjuar e për t’i kthyer me fytyrë nga e ardhmja. Camaj është shkrimtari që tmerrohet prej vetëveçimit të njeriut shqiptar. Larg të vetëve, ashtu si dhe arbëreshët, ai sheh gati-gati një kompleks etnik në rruhdjen dhe pajtimin e shqiptarëve me mbijetesën e vështirë nën zhguallin e breshkës. A. Pipa e pati vërejtur me përgjegjësi që Camaj, në prozën poetike “Dranja”, “flet për fatin e jetës së vet, origjinën e tij fisnore, udhëtimet dhe vendosjen e tij jashtë atdheut, që janë momente shumë të randësishme në jetën e tij: kësaj here, megjithatë, uni i tij i dytë asht një kafshë, mjaft tipike për botën shtazore të Shqipnisë

¹¹³ I. Kadare, “*Martin Camaj, shkrimtari i lartësive*”, hyrje në “*Camaj, veprat, vëllimi I-X*”, Tiranë 2010.

së Veriut¹¹⁴. Së njëjtës mbyllje ndaj të huajit, Shtriganit, i trembet autori edhe në novelën “Katundi me gjuhë të fshehtë”.

Në thelbin e vet “gjuha e fshehtë” është një idiomë që nënkupton zhargonin, një kriptogjuhë e brendshme që mbyll kufijtë së jashtmi, që lidhet edhe me shkaqe historike-gjuhësore, me heteroglosinë e shumëformësinë e vetë të folmeve arbëreshe dhe me dallimet e brendshme midis njëra-tjetrës, që rrezikojnë kthimin në mure vetëdallimi jo vetëm me gjuhën e të huajit, por edhe midis të vetëve¹¹⁵.

Dikotomive të njohura të veprës së Camajt; dijetar dhe shkrimtar, vendës dhe i ikur, shqiptar dhe evropian, poet dhe prozator, lumë dhe mal, bjeshkë e vërrë, katund e farefisni, i shtohet dhe dikotomia vendlindje-botë e arbëreshëve, e cila gjithashtu herë-herë shtuhet e shkrihet në një, si gjithë dikotomitë e tjera të tij.

¹¹⁴ A. Pipa: “Poezia dhe poetika e Camajt”, në “Jeta e re”, 1996/1, f. 16.

¹¹⁵ Shih për më gjerë: F. Altimari, “Heteroglosia arbëreshe: të folmet dhe shqipja standarde”, në *Studime filologjike*, 2002/3-4, f. 55-67.

Bardh RUGOVA

(Prishtinë)

**STUDIUESIT SHKODRANË TË ARBËRISHTES,
VËSHTRUAR NGA ERIK HAMP**

Ky vit shënon dy përvjetorë të rëndësishëm për albanologjinë. Shënohet tetëdhjetëvjetori i lindjes së gjuhëtarit të shquar kosovar Besim Bokshi, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe nëntëdhjetëvjetori i lindjes së gjuhëtarit të shquar amerikan Eric Pratt Hamp, i cili, njëherësh dhe mes tjerash, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe për të folmet arbëreshe. Madje, në Itali sivjet është duke u realizuar edhe një përmbledhje punimesh për nder të tij.

Akademia e Arteve dhe e Shkencave e Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Fakultetit të Filologjisë dhe nën përkujdesjen e akademik Rexhep Ismajlit ka përmbledhur, përkthyer dhe botuar më 2007 një përmbledhje punimesh të profesorit Hamp. Vëllimi me titull “Studime krahasuese për shqipen” në format të madh ka 436 faqe dhe një shtojcë prej 12 faqesh, por përfshin kryesisht studimet e Hampit në fushën e gjuhësisë krahasimtare. Nuk janë të përfshira punimet e tij për të folmet e italo-arbërishtes. Hamp ka shkruar punimin e doktoratës për fonologjinë e Vakariçës, ndonëse në punime të mëvonshme do të pohojë se ka përdorur “një model teorik, të cilin tashmë nuk e pëlqen” (Hamp 2007:54).

Vëllimi hapet me vështrimin e Hampit “Shqipja” të fundit të viteve gjashtëdhjetë, në të cilin ai raporton dhe diskuton një pjesë të madhe të publikimeve të deriatëhershme mbi gjuhën shqipe. Brenda këtij punimi është një raport prej 5 faqesh, në të cilin ai trajton studimet mbi

arbërishten e Italisë deri në atë kohë. Pas një raportimi të përgjithshëm, Hamp sistemonte studimet sipas të folmeve. Në këtë punim ai përmend katër autorë shkodranë që janë marrë me italo-arbërishten deri në atë kohë: Martin Camaj, Kolë Kamsi, Karl Gurakuqi dhe Jup Kastrati.

Diskutimet e Hampit për këto studime, si edhe për të tjerat të paraqitura në artikull, janë telegrafike. Ai, siç e thotë edhe vetë, nuk e kufizon raportin e tij në një regjistrim neutral dhe e ofron atë më shumë për të indikuar ndërlidhjet dhe për t'i treguar lexuesit se ku mund të gjejë informacione dhe zgjidhje alternative, por komentet i lë të shkurtra.

“Në shumë raste, sasia e komenteve të përfshira do të varet nga shkalla, në të cilën mund të reduktohet në mënyrë të kuptueshme hapësira e dhënë... Njëherësh do të shihet se disa tituj, thjesht, janë lënë anash”, thotë Hamp (2007:28).

Ai thotë se janë lënë anash studimet që i janë dukur të parëndësishme.

Raporti i Hampit është raporti më i saktë dhe më përfshirës i studimeve të shqipes deri në atë kohë, prandaj edhe shërben si një pasqyrë e këtyre studimeve.

I pari nga studiuesit shkodranë të italo-arbërishtes që përmend Eric Hamp është Kolë Kamsi (1986 – 1960), i diplomuar në kolegjin e Shën Adrianit më 1907. Hamp nuk ka mundur ta përfshinte fjalorin e arbërishtes të Kamsit, veprën kryesore të këtij autori, pasi ai është botuar tridhjetë e shtatë vjet pas vdekjes, gati tridhjetë vjet pas botimit të artikullit të Hampit.

Kolë Kamsin e përmend në tre nënkapituj. Te gramatikat dhe manualët e përgjithshëm, veçon gramatikën e tij “Manuale pratico della lingua Albanese” të vitit 1930, ribotuar më 1940, pastaj te studime historike dhe krahasimtare diskuton studimin e tij për Frang Bardhin (Frangu i Bardhë) dhe dokumentin nga Shkodra të vitit 1744. Për “Manualin” thotë se kjo vepër dhe sintaksa e Rrotës janë të vetmet që vlejné të përmenden nga periudha mes dy luftërave botërore (Hamp

2007:36). Në pjesën për studimet e arbërishtes, Hamp shkruan për Kamsin:

“Një seri e gjatë e artikujve përshkrues nga aspekti gjeografik dhe etnografik – nuk pata mundësi të shihja tërë kompletin – e ka dhënë Kamsi (1934 - 39); shumë më vonë (1954) ai botoi disa këngë nga Plataci, Caraffa, Puglia dhe Barile”.

Karl Gurakuqi (1895 – 1971) përmendet nga Hampi te kapitulli për gramatikat dhe manualët. Punimin “Grammatica Albanese dell’uso modern” të vitit 1967, botuar në Palermo, Hamp e quan gramatikë pedagogjike të bazuar në mënyrë disi anakronike në gegërishten e jugut. Mirëpo, Hamp vlerëson punimin e Gurakuqit të vitit 1942. “Gurakuqi ka dhënë një pasqyrë të përgjithshme për fshatrat e Sicilisë”, shkruan ai (2007:55).

Një autor shkondran përgjithësisht më shumë i përmendur dhe i cituar nga Hampi është Martin Camaj (1925 – 1992). Mirëpo, në fushën e kontributeve për italo-arbërishten, Hamp veçon artikullin e Camajt ‘Jeronim de Rada për gjuhë shqipe’ botuar te ‘Shejzat’ më 1964.

Jup Kastrati (1924 – 2000) përmendet te kapitulli për arbëreshët, ndërsa vihet në pah punimi i tij i vitit 1959 për De Radën. Hampi (2007:31) Kastratin e përmend për bibliografinë e tij të vitit 1959, për të cilën thotë se është se është “bibliografi e përgjithshme” që “ofron vetëm një përfshirje të kufizuar në aspektin e gjuhësisë, por është e vlefshme për një periudhë kur shumë nga publikimet nuk dilnin jashtë shtetit”. Hampi përmend edhe kontributin e Kastratit për zanoren *ë* të shqipes. (2007:62) Megjithatë, kontributi i studiuesve shkondranë për italo-arbërishten deri në atë periudhë, nuk përmbillet vetëm me këta emra. Ndonëse nuk përmendet si emër, Ernest Koliqi (1903 – 1975) është pjesë e raportit të Hampit, nëpërmjet revistës “Shejzat”. Koliqi e ka botuar revistën nga viti 1957 deri më 1973 dhe ajo është njohur si revista më me ndikim për shqipen në atë kohë. Hampi (2007:52) vlerëson një varg artikujsh që prekin filologjinë “e kësaj ane” në “Shejzat”.

Hamp ka bërë edhe një raport të studiesve që kanë trajtuar tekstet e vjetra të shqipes, përfshirë tekstet e autorëve arbëreshë. Në këtë kapitull, Hamp përmend edhe tre emra të tjerë të autorëve shkodranë, Justin Rrotën (1889 – 1964), Kolë Ashtën dhe Injac Zamputin (1910 – 1998). Hampi përmend punimin e Rrotës “On the Catechism of Luca Matranga” të vitit 1931 dhe studimin e Ashtës për Doktrinën e Krishterë. Zamputi përmendet më shumë gjatë punimit, por për temën tonë hyn në punë punimi i tij i vitit 1963, shënimet dhe shtesat e tjera në Bibliografinë e letërsisë së vjetër shqipe të Shuteriqit.

Raporti i Eric Hampit përveç sasisë së informacioneve, është i rëndësishëm edhe për vlerësimet e bëra, ndonëse ato janë fare lakonike dhe shpeshherë të nënkuptueshme. Në këtë raport, janë përmendur 39 autorë të ndryshëm që kanë studiuar deri atëherë arbërishten e Italisë, prej të cilëve 30 janë autorë të huaj dhe 9 autorë shqiptarë. Brenda këtij numri, katër janë autorë shkodranë.

Katër të tjerë janë të përmendur brenda raportit për kontribute të tjera lidhur me arbërishten. Kjo e bën Shkodrën, si qendrën që ka dhënë më shumë kontribut për arbërishten.

BIBLIOGRAFIA:

1. Hamp E. (2007): Shqipja, te *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë.
2. Camaj M. (1964): Jeronim de Rada për gjuhën shqipe, *Shejzat* 8.332-336.
3. Kamsi K. (1956): Frangu i Bardhë, *BSHKSH* 4.104 – 115.

David LUKA
(Shkodër)

**“SHKRIMTARI MÂ I VJETRI I ITALO-
SHQIPTARËVE, LUKË MATRANGA (1592)”
NË VIZIONIN E ATË JUSTIN RROTËS**

Atë Justin Rrota, një ndër personalitetet shkencore të fuqishme të shekullit të kaluar, krahas studimeve për gjuhën shqipe e për gjuhësinë shqiptare¹¹⁶, ka dhënë një ndihmesë të madhe edhe në kërkimin dhe studimin e veprave të autorëve të vjetër të gjuhës shqipe. Qartë e saktë e ka dhënë këtë ndihmesë prof. M. Domi në nekrologjinë, shkruar me rastin e vdekjes së atër Justinit. Aty thuhet: “Merita të mëdha ka Justin Rrota në gjurmimin e botimin e autorëve tanë të vjetër. Ai qe një nga pionierët e studimit të tyre, që bëri shumë për t’i njohur ata dhe veprën e tyre në një rreth sa më të gjerë studiuesish. Solli i pari në Shqipëri kopje fotografike të “Mesharit” të Gjon Buzukut. Transkriptoi pjesë të zgjedhura nga autorë tanë të vjetër dhe i botoi me shënime e komente e studime hyrëse, si “Shkrimtari më i vjetër i italo-shqiptarëve D. Lukë Matranga” 1592 (Shkodër 1931, 1939) ... Transkriptime të autorëve tanë të vjetër ai dha edhe në monografinë e tij “Për historinë e alfabetit shqip” (1936). Në tekstin “Shkrimtarët shqiptarë” (pjesa I, 1941), Justin Rrota shkroi pjesën më të madhe të kapitujve mbi letërsinë e vjetër e pikërisht “Dokumentat e para të gjuhës shqipe”, “Shkrimtarë të vjetër të Veriut: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kuvendi i Arbënit” dhe ndër shkrimtarët arbëreshë

¹¹⁶ Shiko për këtë “Bibliografinë e shkrimeve të atë Justin Rrotës”, botuar në veprën “Gjuha e shkrueme ase Vërejtje gramatikore”, Shkodër, 2006, f. 509 v.

“Matrënga” e “Variboba”.¹¹⁷

Për autorët arbëreshë (L. Matrënga, J. Variboba, De Rada), J. Rrota do të shkruajë edhe në veprën postum, botuar tash së voni (Shkodër, 2006).¹¹⁸

* * *

Në *Hyrje* të studimit për L. Matrëngën, J. Rrota na njeh së pari me historinë e zbulimit të kësaj vepre. Ai shkruan: “S’ka shumë vjetë qi në bibliotekën Vatikane u hetue një dorshkrim me vlerë të madhe per në: “Catechismo Albanese di Luca Matranga”. Dorshkrimi në fjalë kje botue për mâ të parën herë në Grottaferrata prej filologut të zellshëm të shqypes M. La Piana B. M. vjetin 1912. E na, tue e paraqitë ketë dokument në gjûhë t’onë, kemi para sÿsh qëllimin t’a bâjm të njoftun gjithë intelektualvet e dashamirvet të shqypes, mbasi në tē kanë për të gjetun shembujt e djalektit të hershëm të Tosknís. Âsht e arsyeshme që krahas me shkrimtarët e vjetër të Gegnís, Buzukun, Bardhin, Budin, Bogdanin etj., t’i njihet emni edhe Matrangës, i cilli, përposë Buzukut, âsht mâ i pari ndër shkrimtarë shqypetarë, për të cillët kemi dijeni deri më sod.”¹¹⁹

Në vazhdim, J. Rrota na tregon se botimi i veprës daton në vitin 1592, se Matrënga është meshtar katolik italo-shqiptar, se ka lindur më 1560 dhe është rritur në *Piana dei Greci*, një koloni shqiptarësh e shpërngulur nga Shqipëria e Jugut dhe e themeluar në Provincën e Palermos që në vitin 1488.

Dihet se studimet së bashku me përgatitjen për rrugën e meshtarisë i ka kryer në Romë, në kolegjin grek të Shën Athanasit, themeluar në atë kohë prej Papës Gregori XIII, me qëllim që t’u shërbente katolikëve në

¹¹⁷ M. Domi, *Justin Rrota* (17.II.1889 – 20.XII.1964), në rev. “Studime filologjike”, nr. 1, 1965, f. 219.

¹¹⁸ Át Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ose Vërejtje gramatikore*, Shkodër, 2006, f. 97 e 108 v.

përgjithësi, por edhe shqiptarëve të vendosur në krahina të ndryshme të Italisë së Jugut. Më 1591 ngjan të jetë shuguruar prift, sepse më 1592 gjendet në detyrë e njëkohësisht u mëson katekizmin shqip të mërguarve nga Shqipëria. Bash për këtë qëllim shkruan shqip një doktrinë, duke përkthyer lirisht katekizmin e spanjolit P. Ladesma S.I. Me kohë bëhet kryetar i klerit të Pianës e në këtë post vdes në vitin 1619.

* * *

Dorëshkrimi ndodhet edhe sot në bibliotekën e Vatikanit, ndër tri kopje. Krejt dorëshkrimi ka 87 fletë (174 faqe). Kopja e parë nis me fletën 1 deri në fletën 48, e dyta prej fletës 52 deri në 71 dhe e treta prej fletës 72 deri në 87.

Kopja e parë ka në ballë një letër, me të cilën autori ia kushton veprën e vet Emzot Ludovik Torres II, arqipeshkv i dioqezës së Monrealit. Letra, që ka një vlerë të madhe historike, mban datën 20 mars 1592. Mbas kushtimit, vjen një këngë e përshpirtshme shqip, e përkthyer nga latinishtja. Më pas nis katekizmi me pyetje e përgjigje shqip, e aty edhe përkthimi në italishte.

Kopja e dytë mbyllet me këto fjalë: “*E mbsuame e kreshterë bërë prej të urtënë atë Ladesmë shoqriet Jesusit; e prierrë në gjuhë të arbërishtes prej Lekë Matrëngës, i mbsuam i Kolegjit grek të Romësë*”. Kopja e tretë ka në faqen e fundit shënimin: “*Originale dello stampato*”.

Kopja e dytë dhe e tretë kanë vetëm tekstin shqip, pa përkthimin në italishte e pa shtesat e tjera të kopjes së parë. Dorëshkrimi, sipas J. Rrotës, nuk qe botue asnjëherë.¹²⁰

¹¹⁹ Át Justin Rrota, *Për historín e alfabetit shqyp*, botimi II, Shkodër, 2005, f. 81.

¹²⁰ Për gjetjen e veprës së Matrëngës si botim e si dorëshkrim, si edhe për ndryshimet në mes tyre, shiko edhe K. Ashta, *Leksiku historik i shqipes*, II, Tiranë, 1998, f. 11 v. Një studim të plotë për veprën e Matrëngës e ka bërë edhe S. Riza në artikullin me titull “Disa teza mbi tre dorëshkrimet e Katekizmit të Matrëngës”, botuar në revistën BUSHT SSHSH, nr. 1, 1962, f.

* * *

Në vazhdim, J. Rrota do të merret me “gjuhën dhe ortografinë e Matrangës”. Është për t’u shënuar këtu se J. Rrota nxjerr përfundime me dorë kaq të sigurt, sa është vështirë të kundërshtohet. Ai jo vetëm është i saktë, por edhe i qartë e i besueshëm. Vetëm me katër rreshta ai jep të gjitha karakteristikat themelore të gjuhës së Matrëngës: “Libri është shkruar fjesht tosknisht, por me karakteristikat e posaçme të nëndjalektit të Çamëris, zbrû e nderlikue me trajtat fonetike të djalektit të shqyptarëvet t’Italís, sidomos të krahinës së Piana dei Greci.”¹²¹ Patër Justini vë në dukje se libri i Matrëngës, me gjithë greqizmat, tepër të vrazhda e shpesh edhe të panevojshme, ka rëndësi gjuhësore, mbasi është një ndër të paktat dokumente të gjuhës sonë të hershme.

Duke folur për alfabetin e Matrëngës, Rrota do të shprehet se ky përdorë vetëm alfabetin latin, me të cilin mundohet të shprehë të gjithë tingujt e shqipes. Me këtë mënyrë, kuptohet, shkrimi del “i mangët, i çuditshëm e i mbyllët; fort mâ i vishtirë se ai i auktorëve të hershëm të Gegnís.”¹²²

76 v. Prof. Riza, pasi merr në analizë mendimet e M. La Pianës në hyrjen e ribotimit *Il catechismo albanese di Luca Matranga* (“Roma e l’Oriente”, 1912), parashtron disa përfundime me vlerë, që hedhin dritë për të sqaruar problemet e ngritura, veçanërisht nga La Piana, por edhe të gjuhëtarëve të tjerë për dorëshkrimet në fjalë. Prof. Riza shkruan se “Në dorëshkrimet B dhe C Marco La Piana, si dhe studiuesit e mëvonshëm: Mario Rok, Justin Rrota, Mahir Domi kanë parë dy kopje të dorëshkrimit A”, (po aty, f. 77); se “... dorëshkrimi C praktikisht është kopje e dorëshkrimit B, i cili, përkundrazi, përbën ripërpunimin e dorëshkrimit A nga ana e një rishikuesi.” (po aty, f. 81), dhe se “Sidoqoftë është një fakt se na veprën e Lekë Matrëngës do ta kishim njohur tepër të gjymtuar në pjesët të saja përbërëse e njëherazi tepër të çfyturuar në paraqitjen e saj grafike, gjuhësore e brendore, sikur ajo neve të na ishte ruajtur vetëm në librin e shtypur simbas dorëshkrimit C, e jo njëherazi edhe në dorëshkrimin autograf e autentik të autorit t’onë, dmth, në dorëshkrimin A” (po aty, f. 81).

¹²¹ *Për historín e alfabetit ...*, po aty, f. 84.

¹²² Po aty, f. 85.

Pasi jep një pasqyrë historike të kolonisë së shqiptarëve të Piana dei Greci, Rrota do të paraqesë tekstin e pjesës shqipe të dorëshkrimit të Matrëngës, me shënime nën vijë.

Ashtu siç kemi thënë në një vend tjetër¹²³, ndër komentet e bëra spikat menjëherë personaliteti i fuqishëm gjuhësor i patër Justinin. Ai, tani, nëpërmjet këtyre shënimeve gjen vetveten si gjuhëtar i kompletuar që, me dorë të sigurt e me kompetencë të rrallë për kohën, shpjegon e komenton në të gjitha nënsistemet e gjuhës. Ka, së pari, këtu shpjegime për gramatikën e fjalëve, e vështruar kjo në dy pamje; diakronike e sinkronike, çka vërteton se patër Justinin zotëronte me themel jo vetëm gramatikën e gjuhës shqipe, të sotmen e atë historike, po edhe të gjuhëve të tjera ballkanike e më tej edhe evropiane. Siç do ta konkretizojmë në vazhdim, autori përqsas me dorë të sigurt format e Matrëngës me dialektet e shqipes, kryesisht me gegërishten, po edhe me të folmet krahinore. Dhe ky hulumtim nuk paraqitet si qëllim më vete. Autori, duke vënë në dukje përkime të kësaj natyre, ka për qëllim të tregojë se, në kohën e Matrëngës, ashtu si edhe në kohën e Buzukut, dallimet dialektore ndërmyjet toskërishtes dhe gegërishtes qenë shumë më të pakta se sa sot, ky një përfundim pionieri.

Për togun e fjalëve *xénchi i críchsae* (transkriptuar nga Rrota *Shenchi i kriqës*) jepet ky sqarim “Një metatezë e fjalës latine *signum* “shênj”, që perdoret gati nder të gjitha dialektet e gjuhës shqipe. *Shenk-gu* ndihet edhe sot në Piana e në Kalabrí. (Shif. “HD” vj. XI, f. 200). -i *kriqës*. Gjenitiv i femnores, si edhe sod; mjesa në të thanmen *bân kryq* fjalën e kemi mashkullore. Fenomen i çuditshëm, përpajnue në gjuhë t’onë që me kohë: Êmna mashkullore të theksuem në rrokje të mbrame, qi shkojn tue marrë, sidomos nder rasa të caktueme të njajsit, dezidencat e femnoreve e tue zbutë njiherit edhë bashktinglloren e fundit. Kështu: *shëndet – shëndedja; Lesh – Lezhja, Mjet – Mjedja.*”¹²⁴

Për *sherbesë* “send, punë”, Rrota do të shpjegojë: “Në ket

¹²³ D. Luka, *Studime gjuhësore VII*, Shkodër, 2002, f. 175 v.

¹²⁴ *Për historin e alfabetit ...*, po aty, f. 92 v.

veshtrim e kanë edhe sod shqyptarët e Italis. Fjala, perbâ prej verbit *sherbej*, rrjedhë prej lat. *servio*".¹²⁵

Për foljen *ndlëgon*, Rrota do të japë këtë shpjegim: "Si kahë trajta, si kahë veshtrimi këtu është perdorë në një mënyrë qi i afrohet mâ mirë fjalës latine *intellego*, prej kahë ka rrjedhë. Sod, me sá transformime fonetike, verbi ka marrë edhe kuptim mâ të hapët. Kështu, prej *ndëligoj*, *ndëlgoj*, *ndlëgoj*, *ndëgjoj*, *ndigjoj*, *kuptoj*, *vë veshin*, *shtrohem*".¹²⁶

Për trajtën të *mbëdhenj* të Matrëngës, Rrota jep një shpjegim të tillë, që të lë të kuptosh se ai ka njohuri të plota për etimologjinë e fjalës¹²⁷. Ai shkruan: "Ë në trajtë të shumësit është e drejtë, pse rrin në shperblim të zanores *a* të njajsit, hupun në shumë. Por nuk është e drejtë buztorja e fortë *b* mbas *m*-së së natyrshme të fjalës, shkaktue vetëm pse ndjekë një *ë*. Ket perdorim, perforcim të panevojshe e kemi vrojtë edhe ngjeti per ket shkak. Kështu *Embëri*, *mbësuum*. Në ket mënyrë zhvillohen sa perforcime të kota të perduruna edhe sod nder shkrimtarë: *I ëmbël*, *zëmbër*, *thëmbër*."¹²⁸

¹²⁵ Për historin e alfabetit ..., po aty, f. 91.

¹²⁶ Po aty, f. 92.

¹²⁷ Shiko për etimologjinë e kësaj fjale te D. Luka *Studime gjuhësore III*, Shkodër, 2003, f. 88 (Që nga G. Meyeri (EW 252) e këndeje përgjithësisht pranohet prejardhja e kësaj fjale nga një rrënjë indoevrop. **magh-* (përk. **meǵ-*). Martin Huld (*Basic Alb. Etym.*) rindërton për mbiemrin (*i*) *madh* të shqipes një trajtë **/magE₂-io-/*, që gjykohet nga B. Demiraj si "interpretim i mangët" (SF 3, 1990, f. 205). Vetë B. Demiraj, duke u përpjekur të shpjegojë *a*-në e mbiemrit (*i*) *madh* nëpërmjet një refleksi të *schwa sekundum* të apofonisë kuantitative, rindërton një bazë **meǵ/-ǵǵs/* që sipas tij, i plotëson idealisht kushtet fonetike në përqsasje me shqipen (*i*) *madh* (SF 3, 1989, f. 95). Krahasimi me **meǵ-*, sipas Demirajt, del disi e largët për punë të ruajtjes së *e*-së pa u diftonguar në *ie*. Veçse lidhja e (*i*) *madh* të shqipes e shkallën krahasore **meǵ/-ǵǵs/*, me të cilën shpjegohet lat. *magnus* "i madh" (përk. shkalla krahasore *maior* "më i madh"), mbetet gjithnjë e dyshimtë. Mundësia edhe këtu e një zhvillimi të mëtejshëm të **meǵ-* (përk. e zanores *-e-* deri në *-a-*), nuk është për t'u hedhur poshtë a priori (shiko hollësitë te Luka D. *Shënime rreth apofonisë ...* SF 1-4, 1997).

¹²⁸ Po aty, f. 94.

Hollësi të kësaj natyre janë të shumta në të gjithë shënimet nën vijë, ku patër Justini, me një kompetencë të jashtëzakonshme, shpalosë gjithë dijet e veta në lëmin e gjuhës shqipe, të kësaj së sotmes e asaj historike. Dhe, po të paraqitej mundësia për t'i rreshtuar këta shënime në vijë lineare në kohë e në hapësirë, mund të themi pa frikë e pa droje se do të na dilte një gramatikë historike e mirëfilltë e gjuhës shqipe.

Aljula JUBANI-BENGU — Emilia CONFORTI

(Tiranë, Itali)

DE RADA – CAMAJ, SHQYRTIME GJUHËSORE RRETH GJUHËS SË NJËSUAR SHQIPE

Rëndësia e gjuhës për identifikimin e kombeve dhe të shteteve është e njohur dhe e shprehur nga autorë dhe studiues të ndryshëm. De Mauro ka shkruar: *“L'idea, o meglio, il sentimento di appartenenza a una patria o a una nazione comune non sarebbe neppure immaginabile senza una lingua, parlata e scritta, in un determinato territorio, da una determinata società, in un determinato tempo storico più o meno lungo (o fortunato). D'altronde, il principale tratto distintivo che rende riconoscibile un italiano da un francese o da un inglese, o da qualsiasi altro cittadino straniero rimane pur sempre la sua madrelingua, prima ancora della carta di identità, proprio perché “gli stati nazionali hanno cercato di costruire anche forzatamente, come nella Francia giacobina, l'unità linguistica delle società raccolte in quello stato, e dove gli stati nazionali non c'erano, ma c'era una tradizione linguistica, si è cercata l'indipendenza politica di quell'area partendo dal senso di identità linguistica”.* (In principio c'era la parola?, Il Mulino, 2009).

Pikërisht, edhe De Rada ishte i ndërgjegjshëm për këtë vlerë të gjuhës dhe domosdoshmërinë që ajo kishte për shqiptarët. Gjuha e kombit është elementi thelbësor i identitetit nacional. Ideja për ta lidhur gjuhën me mentalitetin e një bashkësie gjuhësore, përbën edhe një nga pikat kyçe të ideologjive kombëtare, duke filluar me politikën gjuhësore të Revolucionit Francez, siç citon L. Savoia Renzi-n. Kjo prirje ishte e përhapur veçanërisht në shek. XVIII-XIX. Nisur nga këto ide të kohës dhe gjendja e shqiptarëve, De Rada shkruante: *“Di questo aspetto definitivo è*

forse preparazione provvidenziale lo svegliarsi della coscienza nazionale albanese, la quale ha bisogno di unificarsi nello studio della sua lingua, nella contemplazione operosa e imitativa delle glorie passate...”

(De Rada, 1964: 189).

Krahas kontributit të madh politik dhe veprave të arrira në letërsinë shqiptare, në mbledhjen e folklorit dhe në mësimdhënien e gjuhës shqipe tek arbëreshët, De Rada dha një kontribut të veçantë edhe me hartimin e gramatikave të gjuhës shqipe me anë të të cilave synonte standardizimin e gjuhës shqipe ose formimin e një gjuhë letrare për të gjithë shqiptarët. Ai hartoi tri gramatika të arbërishtes letrare: të parën më 1870, të botuar në emër të të birit, Zefit, të dytën të botuar në emër të vëllait, Kamil de Rada, dhe të tretën të botuar në emër të vet më 1894.

Il riformarsi della linguistic Albanese nell '800 corrisponde in sostanza a questi schemi, per cui la ricerca linguistica, in particolare le indagini etimologiche e gramaticali, è in stretto rapporto con la questione nazionale. (L. Savoia)

Që në parathënien e gramatikës së parë të botuar del i qartë synimi i De Radës për formimin e një gjuhe të përbashkët të njësuar për të gjithë shqiptarët. Gramatikat e De Radës kishin në qendër arbërishten e Italisë dhe ishin shkruar në gjuhën italiane. De Rada e shikonte me rëndësi të madhe arbërishten, pasi këto grupe emigrantësh, siç shkruante ai: *portovvi dialetti diversi, dal discorso popolare de varii gruppi in cui ella si divide, s'illustra pure la varietà dei modi dialettali; i quail, per quanto la loro estensione e differenza sia pur poca cosa ostano oggi alla chiara appariscenza del linguaggio Albanese*. Në këtë mënyrë duket se De Rada kërkon të përligjë të drejtën e arbërishtes për të qenë forma bazë e shqipes së njësuar, duke qenë se përfaqëson variantet e ndryshme dialektore, por edhe sepse të larguar nga vendi tashmë i pushtuar, ky variant i shqipes shfaqet për të edhe si variant më konservues i veçorive të saj.

Disa dhjetëvjeçarë pas botimit të gramatikës së fundit të De Radës, Camaj (në 1969) boton “Lehrbuch der Albanischen Sprache. Camaj ishte njohës i vëmendshëm zhvillimeve të kulturës shqipe kudo. Ai, njëjste, ndër

të tjera, kontributin e dhënë nga arbëreshët e Italisë dhe e vlerësonte atë.

Në një artikull për De Radën, të botuar tek Shejzat, shkruan: *De Rada është një nder fëtyrat tipike t' "inteligjencës" sonë në periudhën e Rilindjes kombëtare, që me pendën e tyre prekën të gjitha problemet e kulturës shqiptare... De Rada nuk është një gjuhëtar gjurmues e analizues i një tipi të Demetrio Cardës apo Vincenzo Dorsës. Ai është një poet në kuptimin e plotë të fjalës dhe si e tillë gjuha arbënore për të, është e pa dashur, në krijimtarinë e përditshme ishte bá një mjet për të shprehur ndjesi e mendime në mënyrë të bukur. Ishte shumë e vështirë pra që Poeti ynë ta shifte gjuhën shqipe në zhvillimin e fenomeneve të saja dhe të çmonte drejt natyrën e saj me paanëshmënin e një dijetari, apo të mirrej drejt për drejt, teorikisht me çashtje gramatikore dhe kështu ndërgegjeshëm të normalizonte me mirëdalje një gjuhë letrare.*

Angazhimi i Camajt ishte shumëdimensional, edhe në mësimdhënie në Katedrën e Albanologjisë, në München, ai e shpërfaqti këtë duke ndërtuar, siç thekson B. Demiraj, një program universitar, duke e përcjellë Albanologjinë si një shkencë komplekse me karakter ndërdisiplinar për të nxitur interesin edhe të studentëve të shkencave jogjuhësore, si historia, etnografia etj.

Gramatika e Camajt, si edhe gramatikat e tjera të botuara më parë, vjen në formën e një manuali për mësimin e gjuhës shqipe dhe shfaq njohuritë e gjera të autorit, qëndrimin e tij në lidhje me gjuhën shqipe si edhe sa përfaqësues duhet të jetë variant standard i saj.

Që në hyrje të librit, autori është i kujdesshëm t'i japë lexuesit një informacion sa më të plotë për gjuhën shqipe, dialektet e saj dhe veçoritë e tyre, së bashku me hartën e saktë të shtrirjes së gjuhës shqipe, kudo ku ajo flitet si gjuhë amtare. Duke nisur me paraqitjen e sistemit fonologjik, tregohet kujdes në paraqitjen e sistemit zanor e bashkëtingellor si të gegërishtes, ashtu edhe të toskërishtes, po kështu, edhe me dukuritë prozodike.

Dija e tij i bën të mundur që të sqarojë dukuritë e shqipes edhe

duke i krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit apo edhe më gjerë: *Wie das Rumänische und das Bulgarische besitzt das Albanische auch den nachgestellten Artikel, der die Substantiva genauso bestimmt wie die deutschen vorangestellten Artikel der, die, das. So hat jedes Wort im Albanischen eine unbestimmte Form (ohne Artikel: zjarr 'Feuer') und eine bestimmte Form (mit Artikel: zjarri).*

Siç shkruan edhe prof. Osmani, *Për Camajn një dialekt nuk i përmbush nevojat e një kulture. Gjuha duhet të pasqyrojë gjithë arealin gjuhësor.* Duket qartë se gjuha e përdorur nga Camaj priret drejt një “*gegërishteje letrare*”, siç e ka cilësuar dhe prof. Beci. Në letër të cituar nga prof. Osmani, Camaj ka shkruar: ... *unë këtë njoh ma mirë dhe këtë përdor, ndonëse për dike ngjan se me qenë kjo variantë “jashtë modës”.* Ashtu si për çdo shkrimtar, si edhe për De Radën vite e vite më parë, është më se e kuptueshme se varianti që zotëron e njeh më mirë, do të jetë edhe varianti në të cilin shkrimtari mund të shkruajë më natyrshëm. Me mençuri të madhe ai shprehet se *nuk kishte me qenë keq të vëhet në jetë parimi i para '68, të lehet e lirë varianta geqe në sende letrare, sidomos në lirikë.* Ky qëndrim i Camajt mbetet po aq i logjikshëm e koherent sot sa edhe kur Camaj e shkruante, po qe se edhe atëherë shoqëria shqiptare do të kishte lirinë e mendimit e të shprehjes.

Vehbi HOTI

(Shkodër)

LUIGJ GURAKUQI TEK ARBËRESHËT DHE PËR ARBËRESHËT

Luigj Gurakuqi (1879-1925) një nga personalitetet më të shquara të lëvizjes sonë politike, patriotike e demokratike, arsimore e kulturore në fundin e Rilindjes Kombëtare dhe fillimet e Pavarësisë ka pasë lidhje të veçanta, të gjëra e të shumanëshme me arbëreshët e Italisë. Ishin lidhje të njerëzve të një gjaku e të një origjine, ishin lidhje të një ndjesie të thellë shqiptarizmi e atdhedashurie, lidhje të një gjuhe e të një trashëgimie. Mjedisi arbëresh dhe mësuesi i tij i madh, De Rada kanë qenë faktorë të rëndësishëm në formimin e gjithanshëm të Gurakuqit si njeri e si qytetar, si studiues e shkencëtar, si patriot i madh dhe luftëtar i vijës së parë për gjuhën e kulturën kombëtare, për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë.

Lidhjet e Gurakuqit me arbëreshët e Italisë mund të shihen në shumë plane e drejtime, në disa prej të cilave po ndalemi në këtë kumtesë.

1. Luigj Gurakuqi - nxënësi i parë shqiptar në Kolegjin arbëresh të Shën Adrianos

Shkollën fillore e të mesmen jo të plotë Gurakuqi i ndoqi në Shkodër në Kolegjin Saverian. Më 17 tetor 1877, Jezuitët hapën në Shkodër kolegjin e Shën Françesk Saverit, i njohur shkurt “Kolegja Saveriane”.¹²⁹

¹²⁹ Të dhënat kryesore për shkollën i kemi marrë nga botimi jubilar “Kolegja Saverjane ndër 50 vjetët e para 1877/78-1927/28”, në faqen 60 ka edhe një fotografi të nxënësve të kolegjit të vitit 1892, ku në rreshtin e dytë është Luigj Gurakuqi. Në listën e nxënësve që botohen në këtë rast, emri i Luigj Gurakuqit është me numrin renduer 679.

Kolegja Saveriane ishte shkolla më e organizuar dhe më e kompletuar që kishte Shqipëria asaj kohe. Faik Konica, nxënës i kësaj shkolle në vitin 1884-85, në kujtimet e veta shkruan asaj kohe se “...të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e përgjithësisht të Europës munden të dëshmojnë se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë për t’u vënë në një me to”¹³⁰. Luigji që një nga nxënësit më të zellshëm të shkollës, i pëlqenin letërsia, sidomos poezia, gjuhësia, historia e gjeografia. Studionte me etje, me dëshirë dhe harrohej pas librave. Shumë shpejt shfaq prirje për letërsi, për krijime letrare. Vjershat e para i hartoi në kolegj, në italisht e latinisht, kur ishte 13 vjeç. Janë tri elegji të botuara tek “Lajmtari”.¹³¹

Nxënësit laikë të degës klasike të Kolegjit, që nuk do t’i nënshtroheshin rrugës së meshtarisë, për të ndjekur studimet universitare duhej të bënin plotësimin e kulturës së mesme në ndonjë shkollë të mesme të plotë. Për Luigjin sikur ishte parazgjedhur që gjatë viteve të Kolegjit ky vend tek arbëreshët e Italisë.

Pjetri, babai i Luigjit, kishte informacionin për Kolegjin Arbëresh të Shën Adrianos dhe ia rekomandoi të birit. Nga ana tjetër në Shkodër, Luigj Gurakuqi ishte njohur me poetin e talentuar arbëresh Leonardo de Martino (1830-1923), i cili që një nga propagandistët më të zellshëm të veprës deradiane dhe të traditave patriotike e kulturore të arbëreshëve.¹³² Ishte De Martinoja, ky “patriot i flakët dhe letrar, i shquar”,-siç shkruante Gurakuqi më vonë për të, -ai që e njohu i pari me veprën letrare të De Radës dhe e nxiti për ta lexuar e ta studiuar atë. Leximi i veprave të De Radës nxiti dëshirën e Luigjit dhe të shumë shokëve të tij për të vizituar arbëreshët dhe për tu njohun nga afër me poetin e tyre të madh.¹³³

Gurakuqi i ri mbeti i mahnitur nga mjeshtëria e pena e artë e De Radës. Ambientet e jetës të përshkruara nga De Rada, tepër të bukura e

¹³⁰ “Kolegja..”, vepër e cituar.

¹³¹ Arkivi i Shtetit, Tiranë, Fondi “L.Gurakuqi” Dosja 7 f.2 (më tej shënohet ASHFLG).

¹³² FESH, vepër e cituar, f.171. P. Tako, vepër e cituar f.15-18.

¹³³ P.Tako, *Luigj Gurakuqi, Jeta dhe vepra*, Tiranë, f.16, 1980.

joshëse, do të shkruante Gurakuqi më vonë, nuk mund të mos tërhiqnin vëmendjen e të mos e nxisnin kureshtjen tonë. “konceptetimet e tij plotë imagjinatë, -vazhdon Gurakuqi,- i linin përherë fushë të lirë fantazisë sonë rinore dhe... kështu dalngadalë na lindi dëshira që t’i vizitonin ato vende dhe të njihnim më mirë Orfeun e tyre. Dëshirë që për mua, më fatbardhë se shumë shokë të mi, nuk vonoi të realizohet”¹³⁴ .

Kështu, në vjeshtën e vitit 1897, Gurakuqi filloi studimet në Kolegjin arbëresh në Shën Adrianos të Shën Dhimitër Koronë, fshat në rrethin e qytetit të Kozencës, në Kalabri. (Liceu i Shën Mitër Koronës) “*Luigj Gurakuqi ka qenë i pari nxënës shqiptar që përmendet në regjistrat e atij kolegji, si dhe i vllerti poet arbëresh Jeronin De Rada, i pari mësues që drejtoi atë katedër të gjuhës shqipe, që u çel aty, nga atdhetaria e arbëreshëve të Kalabrisë, me ngulmë pranë qeverisë së Romës.*”¹³⁵

Me Luigj Gurakuqin hapet rruga për një numër jo të vogël nxënësish nga Shqipëria për të bërë a për të plotësuar arsimin e mesëm në atë kolegji. Në vitet 1898-1919 këtu u arsimuan më shumë se 100 intelektual shqiptarë. Studiuesi Kolë Kamsi në veprën e vet “Shqiptarët e Italisë” shkruan se “prej krahinave dhe qyteteve, të ndryshme të Shqipërisë së Veriut e të Jugut, por edhe prej të gjitha besimeve e shtresave shoqërore të vendit tonë, të rinjtë morën rrugën drejt kolegjes të Shën Adrianit në Shën Mitër Koronë të Kozencës.”¹³⁶

Pas Luigjit, këtë kolegji e mbaroi studiuesi Kolë Kamsi e më pas, nxënës të tjerë nga Shkodra, Gjirokastra, Elbasani, Tirana, Kosova dhe Çamëria, ndër të cilët Kristaq Cipo, Mehmet Vokshi, Sejfulla Malëshova, Avni Rrustemi, Zijaudin Kodra, Rexhep Dizdari, Pananjot Beçka, Tahir Hoxha, Halim Xhelo, Beqir Sinani, Luigj Prela, Zef Kurti, Hysni Lepenica etj.

¹³⁴ P.Tako, *Luigj Gurakuqi, Jeta dhe vepra*, Tiranë, f.16, 1980.

¹³⁵ Gjon Kasmi, *Në kolegjin arbëresh të Shën Dhimitër Koronoës*. Dorëshkrim, f.1.

¹³⁶ Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, 2006, f.136.

Kolegji i Shën Mitër Koronës qe një qendër e rëndësishme e kulturës sonë kombëtare, e ruajtjes së traditave shqiptare në dhe të huaj, e kultivimit të gjuhës shqipe, e përgatitjes së nxënësve me frymë atdhetare e liridashëse, e pajisjes së tyre me kulturë perëndimore.⁹

Shkrimtari Pasquale Villari do të shkruante se “Kolegjia e Shën Mitrit në Kalabrije ka qenë gjithmonë vend ku studimet klasike janë ba me përparim ma të madh se në çdo Institut tjetër t’ish mbretenis së Napolit. Kur nxanësit e kësaj shkolle paraqiteshin në Universitetin t’onë, për me dhanë provimet, me një herë njifeshin per shqyrtuesivet, të cilët i pyetshin: Mos jeni nxanës të Kolegjes së Shën Mitrit? E në i u përigjeshim po, u thojshin: Athere asht kot me ju pyet ma tepër në provim. Dhe i kalojshin, kaq ishte çmimi që mbas eksperiencës së gjatë kishin për atë kolegji”¹⁰

Në këtë kolegji Luigji studioi 2 vjet. Nxënësit e mësuesit e shkollës e rrethuan me kujdes e dashuri të veçantë jo vetëm sepse vinte nga dheu i të parëve të tyre, por edhe sepse, ai shpejt ra në sy për ndjenjat e zjarra të dashurisë për atdheun, për dijen e kulturën e gjerë që kishte, për pasionin e madh që kishte për studim. Shkolla dhe mjedisi arbëresh u dha shtytje të fuqishme dijeve dhe atdhetarizmit të tij. E këtu rolin kryesor e luajti një nga mësuesit dhe edukatorët më të mirë që pati Luigji gjatë jetës së vet, Jeronin de Rada.

2. De Rada - mësuesi, edukatori dhe frymëzuesi i shkëlqyer i L.Gurakuqit

De Rada nuk qe vetëm një edukator i vërtetë për Luigjin, por edhe

⁹ Jup Kastrati, *Jeronin de Rada*, Tiranë, si edhe “*De Rada për shkollën shqipe*”; “*Revista Pedagogjike*”, 1972, nr. 5, f. 145-155; Po ai *Katedra e gjuhës shqipe ndër arbëreshët themeluar nga Jeronin de Rada*, “*Revista Pedagogjike*”, 1977, nr. 3.

¹⁰ Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, 2006, f. 135.

një figurë që e frymëzoi për tërë jetën. Qëndrimin pranë arbëreshëve dhe figurës së De Radës, Luigji i ka kushtuar disa nga artikujt e tij më të bukur si: *“Dy koloni shqiptare n’Itali deritash të panjohuna”*,¹¹ *“Përparimi i shqiptarëve”*,¹² *“Jeronim de Rada në Shqipëri”*¹³ dhe *“Disa vjersha të Jeronim De Radës, me shënime.”*¹⁴

Po ku qëndronte forca dhe madhështia e De Radës? Para së gjithash, siç thoshte F. Konica, *“Në dashuri të nxehtë kurrë të palodhur për Shqipërinë. Ky plak 90 vjetësh kish edhe për atdhenë e shkretë një zemër 20 vjetësh.”*¹⁵

Me nota të një entuziazmi e mallëngjimi të thellë, të një respekti e mirënjohjeje të veçantë na përshkruan Luigji takimin e tij me De Radën. Ishte madhështia e veprës atdhetare e letrare deradiane që e kishte përpirë tërësisht atë. Ai shkruan se ka pasë nderin me u afrue e me u mbajtur pranë *“... prej plakut t’nderuëm Gjjirolamo De Rada, prej Nestorit arbëresh, që tash gadi 70 vjet punon pa pushue për Shqypëni. Tuj u gjetë përpara atij njeriut t’vjetër, përpara t’neltit e t’amblit kangëtar t’Milosaos, t’Skënderbegut paa – fanë, t’Serafina Topiës, tuj ndje qërtimet e këshillat e tija, tue ndigjue zanin e tij t’fikët, qi bahej ma i plotë e tuj pa syt e tij t’mekun kah ndezeshin e shkëlqeshin, tuj përmendë Shqipëninë, unë gjithë përmallue, nuk mujta me u ndalë pa lëshue, bashkë me dy pika lot, një t’puthun t’nxehtë mbi atë dorë, qi punoi sa e sa për Atdhe e që sot dridhet prej pleqënijet.”*¹⁶

Me nota shumë prekëse dhe emocionuese Gurakuqi ka përshkruar befasinë dhe zhgënjimin e madh që përjetoi nga takimi i parë me De Radën shkaktuar nga kontrasti në mes madhështisë veprës dhe paraqitjes së përvojatur, të lodhur e raskapitëse të tij. Gurakuqi u gjend përpara një

¹¹ “La Nazione Albanese”, 15 qershor, 1902.

¹² “Kalendari Kombiar”, Sofje, 1903, f. 61-66.

¹³ “La nuova Albania”, Napoli, 1 mars, 1904.

¹⁴ “Albania”, 1905, nr. 1, 2, 3.

¹⁵ Faik Konica, *Gjilamo De Rada*, “Vepra”, Tiranë, 1993, f. 78.

¹⁶ *Përparimi i shqypetarëve*, “Kalendari Kombiar”, Sofje, vj. VII, 1903, f. 64 – 65.

plaku shumë të varfër, të dërmuar dhe të këputur nga jeta, me sy të trishtuar e fytyrë të hequr. “Realiteti i ashpër,- shkruan Gurakuqi-, shumë larg nga idea e lartë e madhështore që kisha krijuar për gjendjen e poetit të pavdekshëm, m’i mpiu për një çast ndjenjat dhe më erresoi kujtesën: nuk arsyetoja më, më dukej sikur isha në endërr”.¹⁷

Tek De Rada, L. Gurakuqi nuk gjeti vetëm atdhetarin e flakët e poetin e madh, por edhe njeriun stoik, të pamposhtur nga peripecitë e jetës, nga varfëria e mjerimi, njeriun që për hir të idealit të vet nuk merrte parasysh asnjë sakrificë. Cilësi e virtyte këto që edhe Luigji vetë do t’i manifestojë gjatë jetës së tij. “Edhe ne – shkruante Gurakuqi – duhet të shpresojmë e duke marrë zemër nga shëmbulli i tij i ndritur të vazhdojmë të luftojmë deri në ditën kur ta shohim Shqipërinë tonë të lirë.”¹⁸

De Rada e mbajti shumë afër L.Gurakuqin. E ftonte herë pas here në shtëpi. I vuri në dispozicion bibliotekën personale dhe korrespondencën e tij të gjerë më shumë figura të shquara të Rilindjes Kombëtare e personalitetet e huaja. Aty lexoi gazetën “Fiamuri i Arbërit” të De Radës, veprat e tij dhe dorëshkrime të shkrimtarëve të tjerë arbëresh. De Rada e ndihmoi L.Gurakuqin të lidhej me lëvizjen patriotike jashtë Shqipërisë. Gjatë qëndrimit në Kolegjin Arbëresh dhe nën kujdesin e drejtpërdrejt të mësuesit të vet De Radës, Gurakuqi do të njihnte trashigiminë kulturore e letrare të vendit të vet, do të njihnte Bogdanin e Bardhin, A.Kulluriotin e N.Veqilharxhin, P. Zarishin e Z. Jubanin, N. Frashërin e V. Pashën, Th. Mitkon e K. Kristoforidhin, etj, figura të cilat, siç thonte L.Gurakuqi, do ta shtynin e do ti jepnin zemër për të bërë “...punë t’bukura, t’pelqyeshme e të vlefshme”¹⁹.

Të gjitha këto do ta lidhnin më ngusht Gurakuqin me atdheun dhe shpejt do ta ndjejë si obligimin e vet kryesor shërbimin ndaj tij. Ende

¹⁷ Jakin Shkodra (Luigj Gurakuqi), *Përparimi i Shqiptarëve*, “Kalendari Kombiar”, Sofjes, Vj VIII, 1903, f. 61-62.

¹⁸ P. Tako, vepër e cituar, f. 50.

¹⁹ Jakin Shkodra (Luigj Gurakuqi), *Përparimi i shqiptarëve*, “Kalendari Kombiar”, i Sofies, Vj VIII, 1903, faqe 61-66.

nxënës në Kolegjin e Shën Mitër Koronës fillon të merret me veprimtari patriotike e letrare. Të kësaj kohe janë dy poezitë e tij të para “*Gegë Postrippës – një mik prej Shkodret*”²⁰ dhe “*Shqypetarëve lidh n’besë.*”²¹

Që në bankat e Kolegjit Arbëresh, Gurakuqi filloi të angazhohej për problemet e gjuhës shqipe e të alfabetit të saj. Me interes është letra që ai i shkruan De Radës, më 20 nëntor 1899 nga Shën Mitër Korona.²² Gurakuqi i ri i shfaq mësuesit të tij mendime me interes për rrugën që duhet ndjekur për të zgjidhur problemet e gjuhës letrare shqipe, alfabetin e njësuar dhe gramatikën e gjuhës shqipe duke hedhur idenë për thirrjen e një kongresi a mbledhjeje të përgjithshme që do të merrej me këto problem “...mund të thuhet qartëm u shkruante ai De Radës, se përpjekjet tona do të shkojnë gjithnjë kot deri sa ne të mos vendosim që të mbajmë një kongres gjuhësor, në të cilën të mblidhen gjithë shqiptarët nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga Italia e Greqia, Rumania, Egjipti, etj se vetëm atëherë mund të vendosej për gjuhë letrare që do të përdorej dhe mbi bazën e saj mund të hartoheshim alfabeti e gramatika”.

3. L.Gurakuqi-njohës dhe propaganduesi i flaktë i trashëgimisë deradiane dhe traditave atdhetare e kulturore arbëreshe

Gurakuqi ishte nga të parët intelektualë që i ka vlerësuar traditat e shëndosha të së kaluarës sonë heroike, duke hedhur vështrimin drejt së ardhmes.

Thelbin e qëndrimit të tij në këtë fushë e përbën ideja se nuk duhen mohuar të parët, paraardhësit, sepse ndryshe nuk do të jemi shqiptarë, s’ kemi kujt t’i shkojmë prapa dhe prej kujt të frymëzohemi. “*Një komb – thoshte Gurakuqi – rron me tradisione, me gojëdhëna e ay popull kur kujton e nderon të parët e vet, asht më të vërtet një komb*

²⁰ “Albania”, Bruksel, 1898, nr. 4, f. 55.

²¹ Po aty, 1899, nr. 3, f. 35-36.

²² Shih Profesor Tomor Osmani, *Udha e Shkronjave shqipe. Histori e alfabetit*, Shkodër, 1999, faqe 395-405.

*trim.*²³

Në propagandimin e traditave luftarake, patriotike e liridashëse të popullit tonë, Gurakuqi kishte një synim të madh: shqiptarët të njohin vlerën e vet, të mos hidhen në zjarr e të mos vriten për fitimin e të tjerëve e humbjen e vet, të njohin e të çmojnë vlerën e gjakut të tyre.

Ai ishte njohës i thellë edhe i traditave arsimore e kulturore të popullit tonë, i traditës shkrimore shqiptare që nga më të vjetrat e deri tek më e reja.

Për traditat në këtë fushë e vlerat që ato mbartin, Gurakuqi është ndalur shpesh here; për to flet në disa artikuj sidomos në *“Përparimi i Shqiptarëve”*, që paraqitet si sintezë e mendimit të tij për këtë problem. Mund të themi se L. Gurakuqi është historiani i parë i traditës arsimore – kulturore shqiptare.

L.Gurakuqi shpreh gëzimin për gjallërimin e lëvizjes së shqiptarëve për çështjen kombëtare, për zhvillimin e mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe në rritjen e vetëdijes kombëtare.

Kërkon që të përmenden me nderim të gjithë ata që u përpoqën “me qitun n’dritë kombin shqiptar”. E për këtë ai në radhë të parë përmend shqiptarët e Italisë, “...t’cilët qenë t’ parët, që filluen me u zgjue e me i diftue Botës mbarë që kombi ynë rron”.

Gurakuqi është njohur nga afër, drejtpërsëdrejti, me përpjekjet e mëdha të bëra nga arbëreshët për ruajtjen e mbajtjen gjallë të zakoneve, të traditave e të gjuhës amtare. Unë vetë, shkruan Gurakuqi, e kam njoftë, kam jetue për dy vjet ndër ta e mund t’u them që në mes tyre jam gjetur porsì në Shqipëri. Në mes tyre, thekson ai, ka pas nderin të takohet me shumë atdhetarë të flakët e shkrimtarë të përmendur.

Ndonëse të mërguar gati 500 vjet më parë, arbëreshët “... e mbajtën gjithmon gjuhën e vet, i ruejtën të pandërueme veshjen e zakonet e veta, nuk e harruen kurr besën, fenë, kangët që muerën prej Shqipnije, nuk e humbën asnjëherë dashtënin për Atdhe, s’e mohuen kurr vetvedin, u

²³ “Bisedimet...”, Legjislatura e parë, viti 1921, mbledhja nr. 54, datë 28 shtator, f. 406.

thirrën e u deftuen gjithmonë Arbëresh.”²⁴

Jeronin de Rada është për Gurakuqin “*sotëpërsot vjershëtari ynë më i madh*”, dhe përulet me respekt të thellë ndaj këtij këngëtarit të “naltë dhe të ambël”, ndaj “*Nestorit Arbëresh*”. “*Ky, – shkruante Gurakuqi për mësuesin e vet, – filloi ma i pari me qitë në faqe shqiptarët e gjuhën e tyne, me krye punë të mëdha e të bukura, me mbledhë kangë të moçme; e qe ky qi qiti në dritë të parën të përkohëshme shqype “Flamurin e Arbënit.*”²⁵ L.Gurakuqi është ndër të parët që shkroi për opinionin shqiptarë për vlerësimet e larta që i kishin bërë poetit të madh arbëresh, shkrimtarë të njohur të vendit e të huajt. Disa nga këto vlerësime Gurakuqi i publikoi pas vdekjes së De Radës, mbi bazën e njohjes direkte që kishte të korrespondencës së mësuesit të tij, si Lamartini, Nikolla Tomazeo etj.

Njëkohësisht, Gurakuqi vlerëson edhe punën e gjithë atyre që e ndoqën rrugën e këtij burri të madh, si Gabriel Darën, Kamardën, Bilotën, Konfortin, Skiroin, Lorekion, etj, “qi tash pesë vjet po lufton e po bahet fort ndihmë më të përkohëshmen e vet “La Nazione Albanese” (Kombi Shqiptar)”.

Luigj Gurakuqi tërë jetën s’ka rreshtur së kujdesuri për të njohur e propaganduar përpjekjet e arbëreshëve për çështjen kombëtare, e për më tepër gjuhën amtare. Në këtë kuadër është me vlerë të theksojmë interesin që tregoi ai në Parlamentin shqiptar për botimin e “Mesharit” të Buzukut.

Po në këtë periudhë, Luigji kërkon nga Parlamenti miratimin e një kredie për të bërë të mundur botimin e “Mesharit” të Buzukut dhe sjelljen e tij në Shqipëri.

Monumenti më i vjetër i gjuhës shqipe; “Meshari” i Buzukut gjendej në një kopje në bibliotekën e Vatikanit. E pat zbuluar për herë të parë, më 1740, Gjon Kazazi. I lënë në harresë që atëherë, e rizbuloi, më 1909, Pal Skiroi, i cili punoi mbi bazën e kopjeve të fotografuara, të bëra me kërkesën e tij, nga biblioteka e Vatikanit. Më 1919 Skiroi bëri thirrje

²⁴ Jakin Shkodra, artikull i cituar.

²⁵ Po ai, po aty.

për të grumbulluar parat për botimin e “Mesharit”²⁶.

Luigj Gurakuqi ishte në dijeni të këtyre fakteve. Informacionin mund ta ketë marrë drejtpërsëdrejti nga Skiroi, me të cilin kishte marrëdhënie ose nga gazeta “Tomorri” e Elbasanit, që botoi më 1910 copa të zgjedhura e të komentuar nga “Meshari”, përndryshe nga përpjekjet që bëri Shtjefën Gjeçovi në vitet 1921-1922 për të mundësuar këtë botim.

Ai, pasi vë në dukje se gjendet vetëm një kopje e “Mesharit” në bibliotekën e Vatikanit vlerëson punën e bërë nga Skiroi për fotografimin e librit e përpjekjet për ta botuar atë. Thekson se libri është gati për shtyp, por mungojnë mjetet financiare. Prandaj kërkon miratimin e një kredije për këtë qëllim, duke u bërë garant për seriozitetin dhe ndershmërinë e Skiroit.

Ekzistenca e një libri kaq të rrallë e kaq të vjetër, i vitit 1555, përbën një krenari për Luigjin, për lashtësinë e shkrimit shqip. “*Kur kam qënë vetë në Romë, – deklaroi ai, – një romak më tha se ju jeni ma të lumë (lumtur – VH) se na, qi keni libra aq të vjetra.*”²⁷

Kjo dëshirë e Luigj Gurakuqit u realizua në vitin 1929. Me porosi të Mbretit A.Zogut, Ministria e Arsimit dërgoi në Romë J. Rrotën i cili bëri tri kopje fotografike të “Mesharit”. Njerën kopje ia dorëzoi Mbretit, A. Zogut i cili “... *diftoi gjith kënaqen e pëlqimit të vet*”. Kopjen e marrë drejtpërdrejtë nga origjinali ia dorëzoi Ministrisë së Arsimit dhe të tretën Bibliotekës Françeskane në Shkodër.²⁸

Gurakuqi është shumë i brengosur për faktin se De Rada dhe vepra e tij njiheshin tepër pak në Shqipëri. Pak janë në Shqipëni, shkruan ai, ata që kanë ndigjue emrin e De Radës dhe më pak akoma ata që kanë lexuar

²⁶ P. Justin Rrota, *Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe. D. Gjon Buzuku (1555)*. Copa të zgjedhuna e të komendueme për shkolla të mjesme, Shkodër, 1930.

²⁷ “*Bisedimet...*”, f. 1278.

²⁸ P. J. Rrota, *Copa të zgjedhuna e të komendueme për shkolla të mjesme*, Shkodër, 1930, f.6. Shih edhe: po ay, *Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndë Shqipni*, “Nëndori”, nr. 5, 1955, f. 76; Prof. Eqrem Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, Tiranë, 1968, pjesa e parë, f. 7.

veprat e tij, megjithëse ai sot për sot është “vjeshetari i ynë ma i madh”.

Ai përpiket të gjejë shkaqet e kësaj situatë. Ndër to ai përmend tre arsye e rrethana:

Së pari, se në Shqipëri mësimi, shkollimi është fort pak i zhvilluar dhe komunikimi në mes shqiptarëve në Shqipëri dhe i tyre me shqiptarët e shpërndarë nëpër botë, sidomos me arbëreshët e Italisë vazhdon të jetë tepër i kufizuar.

Së dyti, Gurakuqi vuri në dukje se De Rada ka përdorë në vepra të veta “nji shqype pak të vishtirme”, kjo jo për faj të tij, por sepse e kishte mësuar jo në shkollë, por nga e ëma pas 400 vjet mërgimi, kohë gjatë së cilës gjuha shqipe ishte “prishun e vorfënuë në gojë të gjyshavet të tij”.

Së treti, De Rada i ka përkthye veprat e tij në italisht, por siç e ka pranuar ai vetë dhe siç e pohon edhe Gurakuqi, De Rada, duke mos e pasur “gjuhë nënë”, nuk e përdorte mirë italishten dhe përkthimet nuk ishin të lehta për tu lexuar. Por këto vështirësi, shkruan Gurakuqi, nuk duhet të na bëjnë për të harruar De Radën, këtë “atdhetar të vërtetë, këtë shërbëtor të palodhun t’idhesë e të gjuhës kombëtare”.

Ai bën thirrje të rinjve shqiptarë që ashtu siç lodhen e djersinë për të shijuar të bukurinat e Homerit e të Virgjilit, durim e të djersinë edhe mbi vepra të botuara në gjuhën e vet.

Për këtë arsye Gurakuqi ndërmori hapat e parë për t’ia bërë të njohur opinionit shqiptar De Radën dhe veprën e tij. Që sot, shkruan ai “po zamë fill me i u dhanë me shijue këndojtoreset t’ “Albanies” copat ma të bukura të “Milosao-s” e, për ata, që dien italisht, kanji herë kena me sjellë edhe përkthimin në këtë gjuhë që bani zoti Gualtieri” (një nga njohësit më të mirë të De Radës që përkthen në italisht me mjaft mirë Milosaon dhe bëri punë të vlefshme që De Rada të njihej edhe jashtë Italisë).

Këtë e filloi Gurakuqi me artikullin “Disa vjersha të Hjeronim De Radës, shënime”, botuar në “Albania” në tre numra të vitit 1905, të cilin e hap me një fragment nga “Serafina Topia”, me shkrime sqaruese si dhe këngen e të XXIV të Milosao-s, po ashtu me shënime.

4. Gurakuqi për organizimin e studimeve mbi arbëreshët dhe traditat e tyre atdhetare, shkencore dhe kulturore

Ashtu siç ishte i shqetësuar për mos njohjen apo njohjen tepër të paktë të De Radës në Shqipëri, L. Gurakuqi tërhoqi vëmendjen për faktin se mungonin studimet e botimet shkencore në Itali. Ai kishte ndjekur me vëmendje e interes të madh çdo gjë që ishte botuar për arbëreshët, por ndër to nuk ka gjetur asnjë “që të mund të vërtet me autoritet e me peshë e që të vlejë tin a japë një njohje të gjanë, të qartë e të saktë e konkrete të këtyne kolonive”²⁹ Botimet e gjerëmësotme, qofshin edhe historitë e Tajanit, thekson Gurakuqi, janë të pamjaftueshme për të na dhanë “...një njohje të qartë dhe të gjanë dhe të na pikturojnë e të na paraqesin në tanësinë e vet e në manifestimet e veta gjeniale, jetën e këtyne kolonive”³⁰.

Për këtë arsye L.Gurakuqi shtron me forcë domosdoshmërinë e organizmit të studimeve serioze shkencore për kolonitë shqiptare në Itali, duke lënë mënjanë iluzionet dhe legjendat e vjetra mbi origjinën tonë, konsideratat dhe hipotezat e zbehta filologjike etnonologjike. Ai kërkonte që studimet të mbështeten në filologjinë e vërtetë e arritjet e saj, në të dhëna e në fakte shkencore historike për të shmangur hulumtimet e sipërfaqshme dhe deduksionet false, teprimet me legjendat e përrallat popullore.

Gurakuqi vetë jep një shembull të shkëlqyer të përpjekjeve për studime e hulumtime serioze shkencore për arbëreshët e Italisë.

Nuk asht e veshtirë, thonte ai, që të organizohen studime serioze e të mblidhen të dhëna të saktë lidhur me kolonitë shqiptare në Itali. Për këtë, sipas tij, do të mjaftonte që në çdo fshat shqiptar të gjendej të paktën një njeri me vullnet të mirë që të ndiqet shembullin e De Radës e të Z.Skroirit e të mblidhte “Këngët Kombëtare” dhe “Proverbat

²⁹ L.Gurakuqi, “Dy koloni shqiptar N’Itali deritash të panjohuna”, “La Nazione Albanese”, Anno VI-15 guigno 1902-Nr. 11, f. 5-7.

³⁰ Po aty.

Popullore”, të përshkruante me hollësi zakonet dhe kostumet, të tregonte numrin e saktë të banorëve të fshatit të vet e të përpiqej të përcaktonte e të saktësonte datën e themelimit të kolonisë së vet. Këtë rrugë Gurakuqi e shihte si bazë për të hartuar një vepër të qartë, të gjanë e të plotë mbi arbëreshët.

Në këtë drejtim, theksonte ai, jemi “si në terr” se, p.sh., numri i italo-shqiptarëve deri në 200 mijë, s’dihen mirë se cilët fshatra janë të ritit latin e të ritit grek, as se cilët e kanë ruajtur gjuhën të paprekur, cilët e kanë prishur, e cilët e kanë humbur. Edhe numri i fshatrave, shkruan ai, nuk dihet me saktësi, dikush thotë 70, dikush tjetër 80.

L.Gurakuqi na ka përshkruar me hollësi se sa punë këmbëngulëse bëri për të siguruar të dhëna të sakta rreth informacioneve që kishte marrë për ekzistencën e dy kolonive shqiptare deri atëherë të panjohura nga ai dhe të tjerë studiues të Pievetles në Komunës Castel S. Giovannit dhe një tjetër në krahinën e Trenzos.

Pasi kishte marrë informacionin për koloninë e Piavettës nga një mik italian në Shkodër, sapo kthehet në Napoli, pasi nuk gjen arsye të dhënë a dëshmi të shkruar për këtë koloni, hyri në korrespondencë me kryetarin e komunës e nëpër mes tij me mjekun e komunës, i cili me shumë dashamirësi i jep të dhëna të hollësishme për koloninë e Piavettës, numrin e banorëve, prejardhjen e tyre shqiptare, praninë massive të mbiemrit Albanesi, zakonet, dialektin me të cilin flasin, të dhëna të marra nga regjistri i famullisë etj. Po kështu Gurakuqi ishte në pritje të përgjigjes të komunës së Trevizeros për të vërtetuar ekzistencën e një kolonike arbëreshe në atë krahinë.

L. Gurakuqi tërë jetën e tij ka ndjekur zhvillimet ndër arbëreshët, arritjet e shkrimtarëve e të studiuesve arbëresh dhe është përpjekur të bashkëpunojë me ta. Ai është interesuar për çdo gjë që lidhej me arbëreshët.

L. Gurakuqi u njoh me përpjekjet e studiuesve arbëresh për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe, i studioi me vëmendje, i vlerësoi, por edhe u bëri vërejtje të sinqerta. Kështu ai vuri në dukje se alfabeti i De

Radës dhe i ndonjë arbëreshi tjetër nuk pasqyronin me besnikëri sistemin fonetik të gjuhës shqipe mbasi mungonin fonemat y dhe ll.³¹

S’bashku me Enriko Kremonesin bëjnë përpjekje për të përkthyer në gjuhën shqipe disa poezi nga letërsia italiane e kohës në të cilën u përdor një alfabet i ri i panjohur deri në atë kohë (1901) që sipas studiuesit Tomor Osmani duhet të jetë alfabet i Gurakuqit.³²

Gurakuqi shkroi parathënien e botimit të vitit 1907 të poemës idilike të Zef Skiroit “Mih e Haidhia”. Me ndërhyrjen, e rekomandimin e Gurakuqit, Aleksandër Xhuvani u emërua më 1906 mësues i gjuhës shqipe në kolegjin e Shën Adrianos.

L. Gurakuqi fitoi një emër të nderuar e shumë të respektuar ndër arbëreshët e Italisë. Në Kongresin e Manastirit për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe Gurakuqi ishte delegat përfaqësues edhe i arbëreshëve të Italisë.

L. Gurakuqi ishte ndër shqiptarët e parë që jetoi në mes të arbëreshëve, u shkollua e u edukua në gjirin e tyre, i njohu nga afër e i vlerësoi dhe i studioi, u përpoq që botën arbëreshe ta bënte njohur për opinionin shqiptar dhe më gjërë dhe që ndër të parët që u përpoq për të krijuar e forcuar marrëdhëniet e arbëreshëve të Italisë me ato të mëmedheut të të parëve të tyre.

³¹ T.Osmani, *vepër e cituar*, f. 398.

³² Po aty.

Bibliografi:

- Luigj Gurakuqi, *Vjersha, me një jetëshkrim të shkurtër prej Gjikas*, Bari (Itali), 1940
- Luigj Gurakuqi, *Vepra të zgjedhura. Mbledhë, redaktue, pajisë me një humje dhe shënime nga Mark Gurakuqi*, Tiranë, 1961.
- Vehi Hoti, *Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar*, Shkodër, 2002
- Paro Tako, *Luigj Gurakuqi, Jeta dhe Vepra*, Tiranë, 1980.
- Kolë Kamsi, *Shqiptarët e Italisë*, Shkodër, 2006.
- Bisedimet e Këshillit Kombëtar, "Senat"*, 1923.
- Tomorr Osmani, *Udha e Shkronjave shqipe Histori e Alfabetit*, Shkodër, 1999.
- Kolegja saveriane ndër 50 vjetët e para 1877/78-1927/28*, Shkodër, 1928.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Botim i ri, vëllimi 1,2,3, Tiranë 2008-2010.

Gjovalin SHKURTAJ

(Tiranë)

**DIALEKTOLOGËT SHKODRANË PËR TË FOLMET
DHE LIGJËRIMET ARBËRESHE**

Arbëreshët e Italisë dhe të folmet a ligjërimet e tyre kanë qenë pjesë e interesimit dhe e ndihmesave të disa studiuesve shkodranë, prej të cilëve duhet të përmendim sa kanë shkruar në rrjedhë të viteve, së pari, Kolë Kamsi, i cili edhe ka qenë një prej atyre që ka studiuar në Kolegjin Arbëresh të Shën-Mitër Koronës, pastaj Kolë Ashta, i cili, në kuadër të hulumtimeve të tij shumëvjeçare rreth leksikut të autorëve më të vjetër shqiptarë, u ka kushtuar kujdes e rreshta të vyer edhe autorëve arbëreshë e posaçërisht është marrë me leksikun e veprës “E mbësuarë e krishterë” të L.Matrëngës. Studime të drjetpërdrejta për disa prej të folmeve arbëreshe të Italisë, në vitet 70-80 të shekullit XX, do të kryente Martin Camaj, i cili pati mundësinë t’i vizitonte shpesh ngulimet arbëreshe, qoftë kur jetonte në Romë, qoftë edhe më vonë si drejtues i katedrës së shqipes në Universitetin e Munhenit, duke shkruar e botuar studime për disa prej të folmeve deri atëherë të pastudiuara, si Greçi i Avelinos, e folmja e Shën-Kostantinit etj. Ndihmesa për njohjen e të folmeve dhe onomastikës arbëreshe ka dhënë Jup Kastrati, pa dyshim, edhe me botimet e letërsisë arbëreshe dhe kthimin në gjuhën e sotme e pajisja me shënime rreth leksikut të disa autorëve arbëreshë, sidomos e veprave të Jeronim de Radës nga Jup Kastrati, i cili, gjithashtu, ka përfshirë në studimet e veta rreth historisë së albanologjisë e të gramatologjisë shqipe edhe autorët arbëreshë e sidomos gramatikën e Zef de Radës. Në kohët më të reja, me

studimin e të folmeve arbëreshe të Italisë, qysh nga ekspedita e parë e vitit 1973, gati pa ndërprerje, duke përfshirë edhe anketimet në disa pika të caktuara, do të merrej edhe shkruesi i këtyre radhëve, por për këtë, në mënyrë të hollësishme flitet në kumtesën e mikut tim, prof.as.dr.Thoma Dhima, që u mbajt në këtë konferencë dhe, sigurisht, i blatoj falënderimet e mia për vlerësimin e mirë që u bëri ai ndihmesave të mia modeste në këtë lëmë.

Më poshtë, po ndalem, pra, në ndihmesat e dy prej më të parëve studiues shkodranë që janë marrë me të folmet arbëreshe të Italisë: Kolë Kamsit dhe Kol Ashtës.

1.Kolë Kamësi për të folmet arbëreshe të Italisë

Arbëreshët e Italisë përbëjnë një diasporë të hershme historike, të shtrirë në rreth 50 vendbanime në krahinat e Kalabrisë, Puljes, Bazilikatës, Molizes dhe të Sicilisë, po edhe një shtresë të “diasporas së diasporës”, që ka depërtuar me kohë gati në të gjitha qendrat urbane të Italisë Jugore dhe në shumë nga metropolet e Italisë së veriut, si në Napoli, Romë, Milano, Torino, Firenze etj. Të shumta janë sot edhe “networket” arbëreshe edhe në vise të tjera të Evropës Perëndimore, sidomos në qytete e mëdha industriale të Gjermanisë, Francës, Zvicrës etj. si dhe në Amerikë e deri në Australi. Sipas disa studiuesve të autoritetshëm të antropologjisë sociale, sot në Itali janë rreth njëqind mijë arbëreshë, shumica edhe shqipfolës (albanofonë), si dhe gati po aq të tjerë që e pranojnë dhe e pohojnë se janë me origjinë etnike nga Shqipëria, ndonëse tashmë janë vetëm italishtfolës.

Mërgimi i arbëreshëve në Itali ka pasur arsye historike dhe është kryer, në fakt, fillimisht në kuadër të një bashkëpunimi e ndihme të ndërsjellë midis princit të famshëm shqiptar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, dhe mbretit të Aragonës, Alfonsit I, i cili, ia njihte vlerat dhe ia provoi nderet e forcën ushtrisë që i dërgoi asokohe për ta ndihmuar fqinji trim e bujar i përtej Adriatikut.

Porse valët e mërgimit të arbëreshëve drejt Italisë fqinje, sidomos

drejt Kalabrisë dhe Sicilisë, do të shtoheshin pas vdekjes së Skënderbeut (1468), kryesisht për shkak të rrënimit ekonomik dhe të dhunës e terrorit që ushtruan pushtuesit osmanë. Sidoqoftë, dyndja e arbëreshëve nga Shqipëria në Itali dhe përfshirja e tyre në jetën e bëmat e Jugut, gati gjithmonë të varfër e problematik, ku ata edhe u bënë qytetarë të përhershëm, ka qenë një **faktor pozitiv** dhe një **urë miqësie** midis Shqipërisë dhe Italisë.

Historia e Italisë në këta katër-pesë shekujt e fundit dëshmon se arbëreshët janë shquar gjithandej si bujq e punëtorë të mirë, si qytetarë të devoçëm dhe kanë rrojtur e rrojnë në harmoni të plotë me fqinjët e tyre italianë, ndonëse kanë ruajtur me krenari gjuhën shqipe dhe traditat kulturore e lidhjet shpirtërore me etninë prej nga e kanë zanafillën. Edhe sot, arbëreshët thonë se janë “*gjak i shprishur nga Albania*”, porse kjo gjë nuk i ka penguar ata për t’u përfshirë me plot dinjitet në rrjedhat pozitive të jetës në atdheun e tyre të dytë, në Itali. Ndhimesa e arbëreshëve të Italisë në shumë fusha (dhe në të gjitha periudhat historike me rëndësi për popullin Italian) ka qenë **i dukshëm dhe i njohur nga të gjithë**. Në mënyrë të veçantë mund të përmendet ndhimesa e tyre në luftërat garibaldine për bashkimin e Italisë, ku arbëreshët e Kalabrisë dhe të Sicilisë qenë në ballë të luftëtarëve më të shquar, aq sa vetë Xhuzepe Garibaldi i pat quajtur ata “*heronj të njëmijë luftërave*” dhe ofroi një shumë të madhe të hollash për mëkëmbjen e Kolegjit Arbëresh të Shën-Adrianit në Shën-Mitër Koronë.

Arbëreshët, gjatë periudhës tashmë pesëshekullore në Itali, kanë formuar edhe një fizionomi të tyre në lëmin e kulturës, të artit dhe, sidomos, të letërsisë. Nga kjo diasporë kanë dalë poetë dhe studiues të shquar të përmasave evropiane, si Jeronim de Rada, Vinçenc Dorsa, Zef (Giuseppe) Skiro Senior etj., të cilët mbeten figura të mëdha mendore, politike e kulturore të Rilindjes Shqiptare në shek.XIX. Këta burra të shquar italo-shqiptarë, veprat e tyre, si dhe jeta e puna e mëtejshme e bërë nga arbëreshët në hullinë e shembullin e tyre për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe e kulturën arbëreshe, meritojnë të bëhen të njohura jo vetëm në

librat studimorë për dialektet, folklorin dhe shkrimtarinë arbëreshe, por edhe nëpërmjet medias e sidomos me anën e dokumentarëve shkencorë¹³⁷. Të mirëpritur kanë qenë edhe librat për diasporën arbëreshe. Më 1984 në patëm botuar librin “Shpirti i Arbrit Rron”(Shënime e të dhëna për arbëreshët e Italisë), i cili asokohe u ble dhe u vlerësua mjaft nga kritika. Mjafton të përmendim se për vlerat e tij shkruan prof. Dh.S. Shuteriqi te “Drita” dhe prof. dr. Musa Kraja te “Mësuesi”, ndërsa në Kalabri shkrime dhe përgëzime patëm nga figura të dalluara si F. Solano, Vorea Ujko dhe një recension te “Zjarri” nga prof. Françesko Altimari. Revista “Mondo Albanese” në Horën e Arbëreshëve, përveç vlerësimeve e recensionit të poetit të njohur Zef Skiro Maji, botoi në disa numra pjesë të librit “Shpirti i Arbërrit rron”.

Pas më se tridhjet vjetësh, ndërsa kemi pasur rastin të shkojmë edhe shumë herë të tjera në ngulimet arbëreshe ku kemi thelluar njohjen, kemi përditësuar të dhënat dhe kemi parë se si po shkohet drejt disa synimeve të reja për mbrojtjen e gjuhës e të kulturës arbëreshe, në mënyrë të veçantë me ligjin e Parlamentit Italian që lejon dhe mbështet mësimin e shqipës në shkollat arbëreshe, si dhe me faqet e internetit që flet për arbëreshët e arbëreshësin, ku shquan sidomos “Arbitalia @ it”, menduam se, një version i ri, më i gjerë dhe më i thelluar i librit tonë mund të ishte me vlerë dhe se do të plotësojë një dëshirë të lexuesit të sotëm.

Përmbajtja kryesore e librit. Arbëreshët dhe kultura e tyre, shkurtoare e historisë së shpërnguljes dhe ngulimi në trojet italiane,

¹³⁷ Janë realizuar deri tashti jo pak të tillë, sidomos me rastin e vizitave të grupeve artistike shqiptare në mjediset arbëreshe, si dhe sa here në ato ngulime kanë vajtur për vizitë personalitete të larta të shtetit shqiptar, siç ka qenë rasti i vizitave të presidentit Berisha (1994), i presidentit Moisiu (2003) dhe i Kryeministrit Fatos Nano (prill 2004). Por ka pasur edhe dokumentarë me metrazh të gjatë si p.sh. filmi “Arbëreshët” me skenar e fjalë të Gj. Shkurtajt dhe regji të Halil Kamberit, prodhim i Kinostudios “Shqipëria e re” (1982) dhe “Ne jemi arbëreshë”, me katër pjesë, gjithashtu me skenar të Gj. Shkurtajt e regji të H. Kamberit e A. Dodës, prodhim i RTSH-së (1992). Ka pasur edhe sprovë të tjera dhe, në tërësinë e tyre, filmat me temë nga arbëreshët e Italisë dhe jeta e tyre kanë pasur kurdoherë interesim e mirëpritje nga shikuesi shqiptarë.

përjetimet dhe shqetësimet e kësaj diaspore arbëreshe në dhe të huaj, folklori, traditat dhe letërsia e krijuar në mërgim, burra të shquar arbëreshë dhe bëmat e tyre për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe. Ky kuadër historik, sigurisht, nuk është një gjë krej e re. Ka pasur edhe më herët njoftime, panorama dhe mëtime paraqitëse në librat e historisë së letërsisë shqiptare dhe arbëreshe, në monografitë kushtuar disa prej figurave madhore të diasporës arbëreshe si për De Radën, Santorin, Seremben etj. Prej tyre është formuar një kuadër historik dhe gjeografik i ngulimeve arbëreshe, janë sjellë edhe jo pak dëshmi e të dhëna rreth kohës e situatës së formimit të tyre, është hulumtuar jo pak nëpër arkivat krahinorë e qendrorë të Italisë së Jugut dhe, në një farë mënyre, së paku në rrethet e studiuesve shqiptarë, tashmë dihet shumëçka për botën arbëreshe, për dialektet dhe sprovat e tyre drejt një gjuhe të përbashkët letrare edhe para se të formohej gjuha shqipe standarde, pastaj edhe puna vullnetmirë e veprimtarëve dhe shkrimtarëve të sotëm arbëreshë për ta lëvruar gjuhën amtare duke iu përafuar sa më shumë variantit të përbashkët standard. Me interes ka qenë edhe puna që kanë bërë vetë arbëreshët e Italisë për t'ua bërë të njohur shqiptarëve dhe botës mbarë se çfarë ka mbetur e gjallë nga gjuha dhe kultura arbëreshe në Itali. Një rendësi të madhe ka pasur, ndër të tjera, harta e vendbanimeve arbëreshe shqipfolëse në Itali, realizuar nga Katedra e gjuhës shqipe dhe e dialekteve arbëreshe pranë Universitetit të Kalabrisë, ku janë dhënë me saktësi të gjitha vendbanimet tradicionale arbëreshe, duke shënuar me saktësi edhe emërtimet e tyre në dy forma: në arbërisht, siç i shqiptojnë dhe i përdorin vendasit arbërishtfolës, dhe në formën zyrtare në italisht, siç njihen në dokumentacionin e shkruar. Vlen të theksohet se viteve të fundit, në shumë nga katundet arbëreshe, me nismën e veprimtarëve të komunave vendore, janë shkruar në dy gjuhë (shqip dhe italisht) emrat e rrugëve kryesore dhe emërtime të tjera me rëndësi të shesheve, qendrave kulturore dhe deri të vetë qendrave administrative, si p.sh.: **Bashkia e Frasnitës-Comune di Frascineto**, **Bashkia e Shën-Mitrit - Comune di San Demetrio Corone**, **Bashkia e Qanës-Comune di Cerzeto** etj. Çdo katund a

qendër arbëreshe ka pasur dhe ka përfaqësuesit e vet në fusha të ndryshme të kulturës e të letrave me të cilët edhe mburren e krenohen faqe fqinjëve: Maqi (Machia Albanese) mburret se është vendlindja e burrave të shquar të tillë si Jeronim De rada, Mikel Markiano, Dhimitër mauro; Frasnita (Frascineto) krenohet me Vinçenc Dorsën, Bernard Bilotën, Françesko Solanon; Shën-Benedikti (San Benedetto Ullano) është vendi ku u themelua së pari Kolegji arbëresh i Shën-Adrianti, po edhe ku lindën burra të shquar si: Arisritide Manes, vëllezërit Rodatà, Axhesilao Milano etj. Dhe, kështu, **secili vendbanim arbëresh ka “idhujt” e vet të përparimit e të arbëreshësisë.**Në ngulimet arbëreshe të Sicilisë: Hora e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi) mban kurdoherë kokën lart pse aty kanë lindur shkrimtarë dhe figura të mëdha të kulturës e të letrave shqipe si Lekë Matrënga, Gjergj Guxeta, Zef Skiro (Senior), ashtu si Kundisa (Contessa Entellina) mburret se pati si bir Nikollë Ketën, apo Palac Adriani (Palazzo Adriano), ku kanë lindur e jetuar Darenjtë e famshëm: Andrea Dara, Gavril Dara Plaku dhe Gavrl Dara i Riu.

Edhe sot, çdo pothuajse katund arbëresh ka poetët, shkrimtarët dhe studiuesit e vet. Ka prej tyre emra tashmë shumë të njohur e përfaqësues të katedrave universitare apo të institucioneve albanologjike me famë, si: Josif Ferrari, që qe për shumë kohë titullar i katedrës së shqipes në Universitetin e Barit, studiues i dialekteve dhe i letërsisë arbëreshe, përfaqësues i arbëreshëve të Italisë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972); prof. Françesko Solano, që punoi për shumë vjet si titullar i Katedrës së shqipes në Universitetin e Kalabrisë, i njohur edhe si shkrimtar e poet nën pseudonimin Dushko Vetmo; prof. Nino Guxeta (Antonio Guzzetta) në Universitetin e Palermos, themelues e drejtor i Institutit Albanologjik “R. Petrotta”, Zef (Giuseppe) Gradilone në Universitetin “La Sapienza” të Romës. Hullia e tyre vijon edhe me ithtarë e zelltarë mnë të rinj, si: F. Altimari nga Shën-Mitër Korona, sot profesor dhe drejtues në Universitetin e Kalabrisë, Mateo Mandala nga Hora e Arbëreshëve, sot titullar i katedrës së shqipes në Universitetin e Palermos, Vito Matrënga nga Hora e Arbëreshëve kërkues në Institutin e Atlasit

Sicilian të Palermos, Italo K. Fortino nga Shën-benedikt Ullano, titullar i Katedrës së shqipes në Institutin e Gjuhëve Orientale të Universitetit të Napolit, Elio Mirako nga Shën-Sofia, pasues i Gradilones në postin e titullarit të gjuhës e të letërsisë shqipe në Universitetin e Romës.

Një brez i tërë poetësh dhe shkrimtarësh arbëreshë veprojnë në qendrat tradicionale arbëreshe të Kalabrisë, të Bazilikatës, të Molizes, të Sicilisë, po edhe në “*diasporën e diasporës*” arbëreshe. Kush nuk i njeh tashmë vjershat dhe botimet e Vorea Ujkos, poetit që kishte lindur në Frasnitë, por jetoi e veproi kryesisht në Fermë (Firmo), një nga lirikët më të dalluar të letërsisë së sotme shqipe, Lluka Perrone po nga Frasnita (Frascineto), mbledhës i shquar i novelistikës arbëreshe, po edhe poet i ndjeshëm e me merita, Karmell Kandeva nga Qana (Cerzeto), i njohur si pedagog dhe autor sprovash didaktike për mësimin e shqipes në mjediset arbëreshe dhe si poet; Pietro Napolitano nga Ferma (Firmo), poet dhe studiues, Vinçenc Belmonte nga Strigari (San Cosmo Albanese), i njohur si poet dhe si studiues i Serembes, po edhe si autor i Fjalorit të parë elektronik të shqipes; në anët e Katanzaros ose siç quhet ndryshe në Kalabrinë e Epërme, shquhet poeti e dramturgu Zef (Giuseppe) del Gaudio nga Shën-Kolli Psipër (San Nicolo dell’Alto) dhe poetesha Matilde Ferraro. Po prej atyre anëve, nga Karfici, janë studiuesi Aleksandër Kostantino dhe shkrimtari i shquar Karmine Abate, tashmë i mirënjohur për romanet e tij të shkruara italisht, por me tematikë nga jeta dhe traditat e arbëreshëve të Italisë.

Hora e Arbëreshëve, si një vatër e hershme dhe e pashuar e arbëreshësisë, ka edhe sot poetët e shkrimtarët e vet: së pari, dy Zefat: **Zef (Giuseppe Schiro di Modica)**, i njohur edhe me pseudonimin **Sdrubulla**, dhe **Zef Skiro Maji** (Giuseppe Schiro di Maggio), poet e komediograf i mirënjohur; po aty veprojnë edhe poetë të tjerë, si Paskal (Paquale) Renda, ndërsa në Shëndahstinë (Santa Cristina Gela) meriton të përmendet studiuesi Zef Kjaramonte (Giuseppe Chiaramonte). Në Kuntisë (Contessa Entellina) veprojnë studiueset dhe pedagoget e njohura arbëreshe Xhuzepina Kuça Lo Jakono dhe Guarino Tomaza in Çilufu. Në

ngulimet arbëreshe të Molizes janë për t'u përmendur poetë si Luis de Roza, Xhanino Mastronardi, si dhe gazetarë e veprimtarë kulturorë si Fernanda Puljeze (Pugliese), që boton revistën kulturore arbëreshe "Kamastra".

Mjaft nga autorët arbëreshë që përmendëm janë të njohur edhe në Shqipëri e në mjediset e tjera shqiptare në Ballkan e më gjerë, sepse vëllimet me vjersha, si dhe drama e tregime apo edhe studime të tyre janë botuar edhe ndër ne dhe janë përcjellë me interesim e me vlerësime të mira nga kritika dhe nga lexuesit shqiptarë. Mjafton të përmendim, ndër të tjera, se në Shqipëri e në Kosovë këta dhjetë-njëzet vjetët e fundit janë botuar shpesh vjersha të zgjedhura nga poetët arbëreshë në faqet e revistave letrare shqiptare, si dhe përmbledhje me vjersha të zgjedhura nga poetë arbëreshë si p.sh. nga Karmell Kandreva, Lluka Perrone, Agostin Xhordano (Buzëdhelprri), Zef del Gaudio, Vora Ujko, Zef Skiro Maji, Luis de Roza, Matilde Ferrara etj. teatri shqiptar i qytetit të Korçës ka shfaqur me sukses komedinë "Paja" të Di Maxhos, kurse Teatri Kombëtar i Operas dhe i baletit, disa vjet më parë, mbi po atë vepër ka hartuar libretin e një operete të suksesshme me muzikë të kompozitorit të shquar shqiptar Nikolla Zoraqi.

Të gjitha këto dëshmojnë se kultura dhe letërsia arbëreshe kanë një rreze të gjerë njohjeje dhe pëlqehen jo vetëm në kuadrin e diasporës arbëreshe, po edhe në hapësirat shqiptare e shqipfolëse, sepse janë vepra me vlera dhe të nivelit bashkëkohor. Bota arbëreshe është, prandaj, një botë e gjallë dhe jo "*pjellë katundarie*". Përkundrazi, ajo është një botë që, pavarësisht nga rrethanat dhe mungesa deri vonë e institucioneve favorizuese, sidomos me pamundësinë që të mësohej gjuha shqipe në shkollat e bashkësisë arbëreshe, megjithatë, si për mrekulli, deri më sot, kjo gjuhë vijon të jetë jo vetëm "**gjuhë e zemrës**", por edhe **gjuhë e gjallë, gjuhë e shprehjes letrare dhe artistike të një diaspore të tërë**. Një diasporë që, kundër asaj që paramendohej, se do të zhdukej e do të italianizohej krejt, vijon të lëshojë klithmat e fuqishme se arbëreshët përbëjnë "*një kulturë që ngë mend të desinj*"(që nuk mund të vdesë), ose

sikundër e thotë poetikisht Di Maxho në titullin e një komedie të tij: “*Ngë kemi nge të desim*”.

Shumë nga ngulimet arbëreshe ka edhe qendra kulturore, grupe folklorike, shoqëri kulturore arbëreshe, si dhe dalin (ose dilnin) revista e të përkohshme interesante, si “*Zëri i Arbëreshëve*” në Ejaninë, “*Zjarri*” në Shën-Mitër Koronë, “*Katundi ynë*” në Fermë (Firmo), “*Lidhja*” në qytetin e Kozencës, “*Mondo albanese*” në Horën e Arbëreshëve, “*Kamastra*” në ngulimet arbëreshe të Molizes (Kampobaso), “*Bazilikata katund arbëresh*” në anët e Potencës etj.

Në mënyrë të veçantë meritojnë të pasqyrohen e të bëhen të njohura përpjekjet e pareshtura të arbëreshëve të Italisë për mësimin dhe shkollimin në gjuhën shqipe, sidomos me anën e institucioneve të tilla me famë si Kolegji i Shën-Adrianit, së pari në Shën-Benedikt Ullano, pastaj i transferuar në Shën-Mitër Koronë; Seminari i Palermos, themeluar nga Gjergj Guxeta, si dhe puna e mëpastajme, që kanë bërë (e po bëjnë) arbëreshët deri në ditët tona për mësimin e gjuhës shqipe, qoftë me anën e nismave individuale e private, me botime të thjeshta doracakësh e fjalorësh, qoftë me punë më të mëdha e të nivelit universitar, siç janë themelimi i katedrave dhe institutive shkencore tashmë me zë në krejt qarqet albanologjike, siç janë Katedra e shqipes në Universitetin e Kozencës, Katedra e gjuhës shqipe dhe e letërsisë shqiptare dhe Instituti Albanologjik “R. Petrotta” në Palermo, katedrat e shqipes në një numër universitetesh italiane me zë, si në Universitetin “La Sapienza” të Romës, në Institutin e Gjuhëve Orientale të Napolit, po edhe në Leçe, në Bari, pa përmendur këtu edhe sprovat për lektorate të shqipes në Universitetin e Salernos, të Katanxaros, të Termolit etj., si dhe gjetkë, në mjedise jo mirëfilli arbëreshe, si në Trieste, në Firenze etj.

Së fundi, por jo për nga vlerat e rëndësia, duhet të themi se një punë të vlefshme për ruajtjen e gjuhës shqipe e të traditave të bukura kulturore arbëreshe në Itali ka bërë e vijon të bëjë me ngulm kleri arbëresh i Eparkisë së Ungrës (Lungro) dhe i Eparkisë së Piana deli Albanezit. Deri vonë, peshën më të madhe të punës për ruajtjen, vlerësimin dhe njohjen e

gjuhës shqipe e të vlerave kulturore të arbëreshëve e kanë përballuar kryesisht përfaqësues të klerit arbëresh. Nuk mund të mos përmendim, me këtë rast, vepra madhore të tilla si “Fjalor i Arbëreshvet të Italisë” (1963) nga Papas Emanule Giordano, gramatikat e shqipes të Papas G. Ferrarit e Papas F. Solanos , përkthmet dhe botimet e shumta të liturgjisë në gjuhën arbëreshe nga priftërinj arbëreshë, si dhe mbledhjen e botimin e folklorit arbëresh, ku, mbi të gjithë, në kohët ereja, është dalluar Papas Antonio Bellushi, së pari, me botimet në revistat e tij “Vatra jonë” dhe “Lidhja”, pastaj me vëllimet e shumta me lëndë etnofolklorike nga ngulimet arbëreshe dhe arbërore të Greqisë.

Ja, kështu, lexues e studiues të nderuar që do ta lexoni këtë libër, këto janë “bashtinat” kryesore të arbëreshësisë, të cilat në krrerët e këtij libri do të përpiqemi t’i “thurim” sadopak, duke bërë edhe disa tëhollime e shtjellime që mbështetn në të dhëna të mbledhura prej shumë vjetësh nëpërmjet hulumtimeve që kam bërë në ngulimet arbëreshe të Italisë. Po them vetëm se kam shkuar për herë të parë në maj të vitit 1973, për një ekspeditë gjuhësore përnjohesë njëmuajore, kryesisht në ngulimet arbëreshe të Kalabrisë, pastaj jam kthyer atje sërish më 1981, ndërsa më 1983, përveç ngulimeve arbëreshe të Kalabrisë kam vizituar e kam bërë anketime edhe në ngulimet e Katanzaros e të Sicilisë, për t’u rikthyer atje edhe shumë herë të tjera, herë për pak ditë, herë për kohë më të gjatë, duke mos lënë asnjë ngulim arbëresh pa shkuar gati derë më derë për të dëgjuar të folmen e tyre, po edhe për të njohur krijues e veprimtarë të atjeshëm. Në pamundësi për t’i përmendur të gjithë me emër, punë që do të kërkonte shumë faqe libri, po edhe nuk do t’ia dilja dot t’i kujtoja të tërë, sepse disa prej tyre edhe mund t’i kem harruar, po kufizohem me një falënderim e mirënjohje të plotë për të gjithë ata që më pritën, më shoqëruan për të gjetur informatorët e duhur, si dhe për miqtë e shumtë arbëreshë që më kanë dhënë libra, dokumente e të dhëna shumë të vlefshme për studimet e mia rreth botës arbëreshe. Të gjithëve sa janë dua t’u blatoj nderimin tim me këtë thënie në arbërisht:

“Të dashur miq arbëreshë, u erdha ndë katundet tëj sa të studhjarnja

dialektin arbëresh, ma ture mbetur keq shumë me arbëreshët, u bëra pure u një cik albëresh: Ju dua mirë gjithve e jam kutjend ndëse ka t'e dhjovasni këtë liver që fjet për gjithë sa di u për juve arbëreshët e Italisë. Rrofshin sa buka e vera arbëreshët e gjuha jonë e bukur, gjuha shqipe që është gjuha (ndoca e thonë edhe giljuha a gjufa) më e bukur e Dheut".

Vepër me vlera të shumta për filologjinë arbëreshe

**Kolë Kamsi, Fjalor arbërisht-shqip, Universiteti i Shkodrës
"L. Gurakuqi", Sektori i Albanologjisë, Shkodër, 2000, 377 faqe.**

Kolanës së botimeve të Sektorit Shkencor të Albanologjisë pranë Universitetit të Shkodrës "L. Gurakuqi" iu shtua tashti së fundi edhe një vepër tjetër shumë e mirëseardhur "Fjalor arbërisht-shqip", fryt i një pune shumëvjeçare dhe tepër të kujdesshme të të ndjerit Kolë Kamsi, një vepër sa e kërkuar aq edhe e dobishme për shkollarët, filologët dhe përgjithësisht për studiuesit shqiptarë që merren me të folmet, kulturën dhe letërsinë e arbëreshëve të Italisë.

Kjo vepër ishte shkruar para plot dyzet vjetësh (më 1960) dhe qe dorëzuar në atë kohë në Institutin e Shkencave me shpresë se aty, sektori i gjuhësisë dhe i letërsisë, do ta redaktonte e do ta përfshinte në planin e botimeve. Mjerisht, "Fjalori" zuri vend diku në mes dosjeve në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë ku u dergj për kaq vjet pa e kryer shërbimin për të cilin e kishte hartuar autori. Më në fund, siç i thonë fjalës "më mirë vonë se kurrë", Fjalori u nxor nga dosja ku flinte prej kaq kohësh dhe u redaktua e u gatit për shtyp nga prof. dr. Ferdinand Leka, duke pasur si recensues prof. dr. Tomor Osmanin dhe prof. dr. Simon Pepën, binom tashmë të mirënjohur për dashamirësinë dhe kujdesin që të nxjerrin në dritë punët e pabotuara të një vargu dijetarësh shkodranë. Libri është pajisur me një parathënie të thukët nga redaktori dhe me një fthillëzim bio-bibliografik me titullin "Kolë Kamsi për arbëreshët",

shkruar nga Villy Kamsi.

Miku im i mirë, dr. Tefë Topalli, ma dërgoi menjëherë këtë vepër me autografin penglënës “*si lëvrues i letrave dhe i botës arbëreshe*”, shoqëruar me një letër miqësore në të cilën më lypte me shumë mirësjellje “*në se gjeni kohë, këtu e deri në Vitin e Ri, mund të na dërgoni një shkrim për revistën “Phoenix”*”. Më vjen shumë mirë që, pikërisht në prag të Krishtlindjeve, i ndodhur në Kalabri, pikërisht në ato mjedise arbëreshe që aq këndshëm e me dashuri i pat paraqitur i ndjeri prof. Kolë Kamsi në veprat e tij të botuara e postume, gjeta kohën për t’ia plotësuar kërkesën mikut tim. I qofsha falë për zemrën e tij të bardhë e për fisnikërinë e tij të skajshme që shfaq ndaj pararendësve të shquar të dijes e të shkencës shqiptare

Kolë Kamsit, ashtu si krejt yjesisë së dijetarëve shkodranë të para Luftës së Dytë Botërore, iu vu këmba padrejtësisht dhe nuk iu botuan veprat në kohën e pritur. Bota shkencore, qoftë edhe me kaq vonesë, duke marrë në dorë librin “Fjalor arbërisht-shqip”, do të nxjerrë përfundimet e nevojshme etike (dhe politike) ndaj atyre që drejtonin shkencën shqiptare e linin pa botuar punime të atilla kaq të vyera.

1. Disa vlerësime më të përgjithshme rreth veprës “Fjalor arbërisht-shqip”.

Kolë Kamsi është një nga ata dijetarë shqiptarë që u njoh qysh herët me botën arbëreshe të Italisë dhe që, i prekur nga ajo “mrekulli” e ruajtjes së gjuhës e traditave të moçme shqiptare në mjediset arbëreshe në Itali, bëri peng të veprimtarisë së vet shkencore pikërisht mbledhjen e fjalëve, të frazeologjizmave e të folklorit arbëresh, hulumtoi dorëshkrimet dhe letërsinë arbëreshe të botuar, duke parë e vlerësuar aty shumëçka të vyer, qëmtoi të folmet e gjalla dhe fiksoi aso formash e fjalësh që atij i dukeshin të vlefshme për t’ua vënë në dorë historianëve të gjuhës shqipe, si lëndë krahasuese për të hetuar etimologjinë apo fazat e hershme të strukturës fonetike e morfologjike të shqipes.

Qëkur ishte nxënësi në Kolegjin Arbëresh të Shën-Mitër Koronës,

ku pati për mësues edhe prof. dr. Aleksandër Xhuvanin, djaloshi i ri nga Shkodra pati rastin të dëgjonte nga goja e arbëreshëve të Shën-Mitrit, Maqit etj. dialektin e ëmbël , ku shquanin dy dukuri të rëndësishme: **e para, përbashkësia me shqipen , njëjtësia në shumë pika të fonetikës e të morfosintaksës si edhe të fondit kryesor leksikor e frazeologjik, ndonjëherë duke shfaqur edhe forma e kuptime fjalësh më të moçme se ato të librit të parë shqip.** Kjo ishte një gjë shumë tërheqëse për cilindo shqiptar që ndeshej me arbëreshët e më shumë se pesë shekuj pas shpërnguljes së tyre në Itali. Ashtu si mësuesi i tij i Kolegjit, prof. dr. A. Xhuvani, që aq për zemër e pati qëmtimin e gurrës popullore shqiptare e arbëreshe, edhe Kolë Kamsi do të ndizej nga e njëjta dëshirë: të mblidhte sa më shumë fjalë e shprehje, të hulumtonte sa më thellë në ato mjedise dhe të jepte ndihmesën e vet për të ndriçuar sa më mirë pikërisht atë anë ruajtëse (konservative) të shqipes në dhe të huaj. Kush lexon veprën “Fjalor arbërisht-shqip” nuk mund të mos verë re pikërisht sasinë shumë të madhe të fjalëve e kuptimeve shqipe që kanë të folmet dhe letërsia e arbëreshëve të Italisë. Le të përmendim, ndër të tjera, sinoniminë e formave dialektore të fjalëve të moçme shqipe si : **ahiera, ahlierna, ahierthi** “atëherë”, **andijsha, andisha** “andej”, **ani, anith, ananithi** “tani”, **areshtë, areshëzë** “arushë”, **ardhi, ardhezë** “hardhi”, **atëljash, atëljosh** “gjysh”. Po kështu, fjalët e formuara mbi temën **bukur**: *bukurith(i,e), bukurazi, bukurane, bukureshtë, bukurezë* “xixëllonjë”, *bukurohem, bukuronj* etj. Me interes studimor të gjerë janë edhe fjalë e forma të tjera, si **bulk, bulqer, bulqëri** “bujqësi”, **buljar, buljereshtë, buljeri** “bujari”, **dashatar** “dashnor”, **dashurishtë, dejtari, dejtënor, dejtari, dejtëror, deljamirë** “bareshtë delesh”; fjala **kocë** “kokë” dhe formimet prej saj: *kocmadh; kurm* “trup” dhe **kurmërishtë**; formimet me parashtesën **mos-** : *mosgjë, mosnjë, mosnjëherë, mosnjeri* e shumë të tjera. Prej fjalësh të tilla mund të shihet qartë se arbëreshët kur u mërguan nga viset arbërore të këtej Adriatikut morën me vete një gjuhë të folur shumë të pasur dhe një trashëgimi etno-folklorike të atillë që do të përbënin një mbështetje të mirë për të mos u bjerrë lehtë as në dhe të

huaj. (Për këtë anë dhe përgjithësisht rreth vlerave të gjuhës, kulturës dhe lëtersisë arbëreshe, Kolë Kamsi pat shkruar në “*Dyndjet e shqiptarëve n’Itali*”, *Ndihma e Italo-Shqiptarëve në Rilindjen Italiane*” etj. Në mënyrë të veçantë meriton të përmendet studimi i tij i hapët me titull “*Shqiptarët e Italisë*”, botuar me vijime në disa numra të revistës “Leka” (1934-1944). Të gjithë ata që janë marrë e vijnë të merren me studimin e ligjërimeve të folura arbëreshe apo me gjuhën e shkrimtarëve arbëreshë të Italisë, ndonëse në periudha (e me metoda shkencore) të ndryshme (M. Lamberci, A. Xhuvani, E. Çabej, Z. Kodra, Dh. Shuteriqi, Sh. Demiraj, J. Kastrati, M. Camaj etj.) kanë shkruar kurdoherë në një kah të përbashkët: të gjithë, kush më shumë e kush më pak, kanë mëtuar të nxjerrin në pah pasurinë e tiparet e ruajtura të shqipes në diasporën arbëreshe, kanë regjistruar fjalë, kuptime e shprehje të shqipes të moçme e që, ndërsa ishin bjerrë në shqipen e këndeje Adriatikut, vijonin të ruheshin aq mirë në dialektin arbëresh. Të nisur nga kjo bazë e përbashkët e dukurive fonetike e morfosintaksore si dhe e një fondi të konsiderueshëm fjalësh të përbashkëta të shqipes, shumica e studiuesve të përmendur kanë shprehur edhe mendime rreth përkatësisë dialektore të të folmeve arbëreshe të Italisë në strukturën dialektore të shqipes, duke i konsideruar ato jo si një dialekt më vete, por si të folme të shqipes, me tipare kryesisht të tilla si të folmet e toskërishtes jugore, porse edhe shumë të ndikuara nga italishtja e dialektet e Italisë Jugore.

Dukuria e **dytë** e kësaj gjuhe shqipe ndër arbëreshët e Italisë, që nuk mund të mos bëhej objekt kundrimi e shqyrtimi nga studiuesit, ka të bëjë **me atë që i dallon prej shqipes së trojeve kompakte ballkanike**: pas mërgimit të arbëreshëve në Itali, Shqipëria pësoi pushtimin e gjatë pesëshekullor nga Perëndoria Osmane, gjë që solli me vete edhe huazime të shumta nga gjuha turke, ndërsa arbëreshët, të ndodhur në mjedisin e huaj italian, gjithashtu, për të përballuar jetesën në dhe të huaj, krahas përfshirjes në popullsinë e një vendi që kishte tjetër gjuhë, nuk mund të mos pësonin edhe ndikimin gjuhësor nga italishtja dhe dialektet e saj. Vepra “Fjalor arbërisht-shqip” pasqyron gjerë edhe këtë proces gërryerjeje

gjuhësore që kishte marrë udhë në të folmet arbëreshe dhe që pasqyrohet edhe në leksikon e shkrimtarëve arbëreshë. Në Fjalor ka shumë pak ose aspak fjalë turke, të cilat, ndërkaq janë të dendura në shqipen, porse ka aq shumë italianizma që janë bërë pjesë e fondit leksikor të arbërishtes së Italisë. Në të vërtetë, kur ndodh të takohen një shqiptar dhe një arbëresh, pjesa e pakuptueshme për arbëreshët janë pikërisht fjalët turke dhe sllave që kanë depërtuar në shqipen pas mërgimit arbëresh. Nga ana tjetër, për shqiptarin është e pakuptueshme ajo pjesë e fjalëve arbëreshe që kanë hyrë me kohë nga kalabrishtja e sicilishtja dhe që, duke u shtuar gjithnjë, e bëjnë përherë e më të vështirë të kuptuarit e ndërsjellë shqiptaro-arbëresh. Kjo rrethanë u është shfaqur qysh në krye edhe studiuesve shqiptarë të letërsisë arbëreshe. Ata gjenin aty një farë toskërishteje, të qëruar nga turqizmat, por të mbushur e të rënduar me italianizma. Duhet të themi se prof. Kolë Kamsi, ashtu si M. Lambeci, E. Çabej, K. Ashta etj., jo vetëm e konstatoi këtë dukuri, por edhe e hetoi mjaft gjerë atë, duke u bërë vend në fjalor, krahas fjalëve shqipe, edhe aq shumë fjalëve (emra, folje, mbiemra etj.) të huazuara nga dialektet italiane në ligjerimet e folura arbëreshe, apo nga italishtja letrare në gjuhën e shkrimtarëve arbëreshë. Fjalë të tilla janë, p. sh., foljet : *amarinj*, *avisonj*, *destinguir*, *difendir e difensar*, *dominar*, *fermar*, *furnonj e fërnonj*, *fraxhelar*, *kalarem*, *kapir* etj.; këtu mund të përmendim edhe emra, mbiemra e ndajfolje të huazuara nga italishtja, si: *arbur*, *arvur*, *cikonjë* “lejlek”, *cimbal* “buzuk”, *cukar* “sheqer”, *çot* “i marrë”, *animalj* “kafshë”, *anitrejla* “zog rose”; *alminu/ almenku* “së paku” e shumë të tjera.

Pasi i kishte ndjekur e hulumtuar me përkushtim të dyja këto anë të arbërishtes, dmth. duke ndjekur me përparësi **çfarë kishin “vljuar”** (=ruajtur) për kaq shekuj nga fondi leksikor e frazeologjik i shqipes së përbashkët, po edhe **duke mos i mbyllur sytë përpara sasisë shumë të madhe të fjalëve të huazuara nga italishtja**, të cilat edhe po shtoheshin përditë, Kolë Kamsi me veprën e tij “Fjalor arbërisht-shqip” u vjen në ndihmë lexuesve të shumtë e të ndryshëm.

Së pari, ai u drejtohet shkollarëve shqiptarë (nxënësve dhe

studentëve) si dhe studiuesve të letërsisë arbëreshe, duke u vënë në dorë një mjet të vlefshëm për ta lexuar e për ta kuptuar letërsinë arbëreshe të traditës, po edhe folkloin arbëresh, pa qenë e nevojshme që ta “kthejmë në gjuhën e sotme”. Ky, me sa duket, do të ketë qenë edhe qellimi kryesor i Fjalorit. (Shih: F. Leka, Parathënie, f.3). Prandaj, siç e kemi thënë edhe më lart, është për të na ardhur shumë keq që, një libër i tillë i vyer, mbeti për aq shumë kohë i pabotuar, i pashfrytëzuar as nga studiuesit, as nga komentuesit e letërsisë arbëreshe. Ndërkaq, siç e dimë, në mungesë të një veprë të tillë, e cila dergjej diku në raftet me pluhur të arkivit të IGJL-së, shumë filologë shqiptarë, ndër ta edhe njohës të mirë të letërsisë arbëreshe, kanë qenë të shtrënguar të kthejnë në gjuhën e sotme(!?) veprat e autorëve arbëreshë.(Shih: botimet e bëra ndër ne nga Dh. S. Shuteriqi, Z. Kodra, J. Kastrati, A. Varfi, Sh. Demiraj etj.). Madje, këtë udhë, disa po e vijojnë edhe në botimet e letërsisë së sotme arbëreshe. Natyrisht, një punë e tillë nuk ka qenë pa vlerë dhe ka kërkuar shumë mund e kohë nga ata që e kanë kryer përshtatjen e letërsisë arbëreshe në shqipen e sotme. Përshtatja, ashtu si përkthimi nga gjuha e huaj a shqipërimi, ndihmon për të njohur e kuptuar veprat letrare që janë shkruar në dialekt. Pra, ajo është një punë e bërë me qëllim të mirë, porse duhet të pranojmë se, përshtatja e poezisë së shkruar në dialektin arbëresh, në krahasim me leximin në origjinal, është gjithsesi një **vjershëri e tredhur**. Të kthyerit në gjuhën e sotme të një vjershe a poeme të shkruar në dialektin arbëresh (apo në cilindo dialekt të shqipes) mund ta lehtësojë punën për ta kuptuar atë, porse ka edhe anën e vet të keqe: përshtatja e zhvesh shprehjen nga origjinaliteti, e than frymën metaforike të vjershërisë, ia zbeh dhe ia bjerr dukshëm burkurinë dhe spontaneitetin që ia ka gdhendur autori.

Mendoj se, poezia shqiptare, qoftë në rastin e autorëve arbëreshë, qoftë të atyre që kanë shkruar e botuar në variantin letrar geg, para Çlirimmit të Shqipërisë e para se të formohej gjuha letrare shqipe e njësuar (standard), si p. sh. poezia e Gjergj Fishtës, e Mjedës, Migjenit etj. nuk ka pse të “kthehet në gjuhën e sotme”. Shkollarët duhen mësuar dhe ndihmuar që ta lexojnë e ta kuptojnë atë ashtu siç është shkruar. Natyrisht,

shkenca filologjike duhet të mendojë edhe për t' u ardhur në ndihmë atyre, duke hartuar vepra të tilla si “Fjalor arbërisht-shqip” i K. Kamsit për autorët arbëreshë, apo duke ndërmarrë botime me shënime e shpjegime të hollësishme për fjalë, forma e shprehje që sot mund të mos jenë të përdorshme e që duhen njohur nga shkollarët. Mendoj (dhe guxoj ta them shkoqur) se nuk ka shqiptar që të mos e kuptojë se kur arbëreshi thotë “**mbjothtëm dizë gjurshi**” është fjala për të mbledhur dy qershi. Prandaj, kurrë nuk më ka pëlqyer të mësoj përmendësh vargje të poetëve arbëreshë “*të kthyer në gjuhën e sotme*”, sado mirë të jetë bërë përshtatja. Përkundrazi, më kanë pëlqyer dhe i mbaj mend në origjinal vargjet e De Radës “*Ljis jeta kish ndërruar, ujë të ri ndë dejtit*”. Dhe rikthehem tek ajo që më intreson të theksoj: “Fjalor arbërisht-shqip” i K. Kamsit na jep për çdo fjalë a formë fjale shembuj të zgjedhur mirë, të fiksuar me saktësi nga veprat e autorëve arbëreshë, duke na dhënë aty me shkurtime edhe autorin e titullin përkatës. P. sh. *ljis-i* em. Shm. *ljis, ljise* (Ra.Lex). lis: *një ljis me fjeta*(Sku.32); *çukat e ljisvet* (Ra.pasq. n. n.9); *ljis jeta kish ndërruar* (Ra. Mil. 10). Mbi këtë bazë , edhe një herë shtrojmë pyetjen tonë : pse duhet “tredhur” vargu i De Radës, duke ndërruar lumbardhën me pëllumb, kur “Fjalor arbërisht-shqip” f. 155 i jep shkollarit apo studiuesit shpjegimin e duhur: “lumbardhë-a, ef. zvogl. lumbardhëz; pëllumbeshë: *lumbardh e Anakreontit* (Ra. Mil.).

“Fjalor arbërisht-shqip” përshkohet tejندانë nga ky mëtim dorëmbarë i autorit për ta pasqyruar sa më të plotë dhe sa më me saktësi gjithë atë leksik që ndejnë shkrimet arbëreshe, duke i ilustruar fjalët me citime në kontekste të plotvlershme e të zgjedhura nga veprat origjinale, pa shtuar asgjë nga vetja, duke e bërë kështu fjalorin një mjet pune të sigurtë dhe për studiuesit e komentuesit e letërsisë arbëreshe të traditës. Si i tillë, ky fjalor, ndonëse e “zbulojmë” me kaq vonesë, na jep mundësi të njohim jo vetëm atë fond të çmueshëm e të pasur të arbërishtes së folur, që autori e qëmtoi dhe e pasqyroj sa qe e mundur mbi bazën e të dhënave të folklorit dhe të hulumtimeve vetjake, po edhe frytet e atij përpunimi, tëhollimi e pasurimi që i bënë shqipes shkrimtarët arbëreshë. Ata u

përpoqën për ta lëvruar gjuhën, mëtonin sekush të ishte “i pari” në sendërtimin e një koineje që t’ u vlente të gjithë shqiptarëve e arbëreshëve dhe, fakti është se ata, kush më shumë e kush më pak, në përputhje me natyrën e vjershërisë e me stilin përkatës, krijuan edhe shumë fjalë të reja, të cilat, gjithashtu, janë me vlerë dhe K. Kamsi i ka pasqyruar gjerë në fjalor.

2. Disa kundrime të tjera më të veçanta rreth pasurisë leksikore të veprës “Fjalor arbërisht-shqip”.

Në “Fjalor arbërisht-shqip” autori u ka dhënë vend me përparësi fjalëve dhe formave që i ka ndeshur në veprat e botuara të autorëve arbëreshë si dhe në lëndën folklorike që kishte në dorë deri atëherë. Natyrisht ka përfshirë aty edhe fjalë që i ka dëgjuar vetë në mjediset arbëreshe. Kudo shquan besnikëria e saktësia e paraqitjes, pa shtuar e pa “ndrequr” asgjë. Në këtë mënyrë ai u ka dhënë dorë për studim edhe dialektologëve dhe historianëve të gjuhës shqipe. Po lejohem të përmend, pa u zgjatur, ndonjë nga dukuritë që ndejnë në planin dialektologjik disa trajta fonetike e morfologjike të fjalëve të këtij fjalori.

2.1. Krahas trajtave fonetike mbizotëruese që i japin “vulën” toske, në “Fjalor arbërisht-shqip” **ndeshim edhe jo pak forma që përputhen me gegërishten** apo që përkojnë me forma të moçme e të kryehershme të shqipes, para se të kryhej ndarja dialektore e gegërishtes dhe e toskërishtes. Të tilla janë: prania e fjalës **çë**: si përemër lidhor: “ajri çë ndreqi moon fritti ka dejti” dhe si parafjalë: “çë ahiera”. Këtë dukuri Kamsi e quante “çitaçizim i palatales q në ç” (f.324), por mund të mendohet se, ndoshta, kemi të bëjmë me një ruajtje të një forme të moçme pikërisht me çë e jo me që. Për këtë ne mbështetemi edhe në rrethanën se, formën me ç e kemi ndeshur gjithandej edhe në të folmet e Malësisë së Madhe, ku, edhe sot e gjithë ditën, thuhet: *ai ç i erth; ajo ç i foli; çather* “qysh atëherë” etj.

2.2. Në të folmet arbëreshe ndeshim gjerësisht përdorimin e prejfoljorëve të formuar nga pjesorja me mbaresën **-m (e)**, si në gegërishten (në vend

të formave me rotacizim të n-së në r): Ja disa shembuj nga fjalori: **çëmuam** (i,e): *gur të çëmuam*; **dbuam** (i), **dërmuamae** (e), **dishiruame** (e), **dorëshpuam**, **dorështrënguam**; **egërsuam** (i) etj. Po kështu edhe ; **film** (i), **filme** (e), **flagëme** (e), **druetëm-e** (i,e) , **grisme** (e), **përbaljtëmë** (e) etj.

2.3. Nuk mungojnë edhe formimet me prapashtesën –shëm, shme, të cilat, gjithashtu, janë tipike për gegërishten: **dorështrënguashëm**, **e ftilkuashme**, **dishëm** (i), **dishëme** (e) etj.

2.4. Në “Fjalor arbërisht-shqip”, sado e papritur dhe e çuditshme të duket, gjejmë edhe forma fjalësh që përkojnë me gegërishten veriore, si p. sh. Format me psh: kapëshonj “kafshonj”, kapëshore “kafshatë”. (Në Kastrat e gjetkë, nga brezi i vjetër thuhet :kapshoj, ka kapshua, kapshim dhe kapshore”buka e mëngjesit”(Kelmend). Kjo do të thotë se format me **p** në grupin **psh**, do të kenë qenë më të hershme se ato me **fsh**. Këtë mendim na e përforcon, sipas nesh, edhe mundësia e etimologjisë se foljes kapshoj (kafshoj) nga folja kap.

Me mjaft interes nga pikëpamja dialektologjike, po edhe më gjerë, sidomos për sa i takon historisë së evolucionit fonetik të shqipes, janë edhe disa fjalë të tjera të të folmeve arbëreshe që, përkojnë më fort me arealet anësore të gegërishtes veriore, si **ve-a** “vezë”, **terinj** “thaj rrobat”, **shpi** “shtëpi”, **na** “ne”, **miezdit** “mesditë” e **miesnatë** “mesnatë”, **veshkem** “fishkem, vyshkem”, **i veshkët** “i fishkur” etj. Për t’u bindur po japim më poshtë format e të folmeve të Malësisë së Madhe: veja, buk e ve t furguome; ter teshat, u terën kmishat; mjezdit, hagme mjezditën aty, nejme dej n mjesnatë tye knua; a veshk kollomoqi prej sushet; i veshkun si purrini etj.

Sigurisht, në forma të tilla që përkonë plotësisht me të folmet arbëreshe, më tepër sesa tipare mirëfilli gege e, aq më pak fryte të ndonjë prejardhjeje të drejtpërdrejtë prej anëve veriore, kemi të bëjme me ruajtje të dukurive të moçme, dikur panshqiptare që, me kohë, janë zbythur nga shqipja, por kanë mbetur ende të strukura në të folmet anësore dhe në ato të doasporës arbëreshe. Kjo ide na përforcohet më tej edhe nga ndonjë

dukuri fonetike dytësore e të folmeve arbëreshe që, gjithashtu, përkon me gegërishten veriore. P. sh. shtesa e një -na prapa disa ndajfoljve: andajna, andejna, ateina, atena, atjetejna, gjithasajtena etj.

Kjo, sigurisht, e shton interesin dhe vlerën e tyre për shpjegime të dialektologjisë historike.

3. Me rëndësi për studimet rreth leksikut e semantikës së shqipes janë edhe disa kuptime të ndryshme (dialektizma semantike) që i ndeshim në të folmet arbëreshe. P. sh. **çelinj** “ndez”: *i çeljin ljineret*; **çonj** “gjej”: *mir se ju çojmë, mirë se të çuam*; **grop** “pirun”, **i humbët** “i thellë, i fshehtë”; **petk** “pronë, tokë”; **i shpejtë** “i zgjuar”, **e shtrembër** “e majtë”, **thumbëz** “kopsë” etj.

Vepra “Fjalor arbërisht-shqip” mbyllet me një pjesë të titulluar “Shënime gramatikore rreth të folmeve të arbëreshëve të Italisë”, ku jepen dukuritë më kryesore fonetike e morfologjike të arbërishtes. Kanë kaluar shumë vjet dhe, tashti, për të folmet arbëreshe të Italisë janë shkruar e botuar shumë studime dialektologjike, çka do të thotë se këtë shënime nuk sjellin më ndonjë gjë të paditur, por ato, megjithatë, mbeten me vlerë dhe kanë vendin e vet në studimet rreth historisë së dialektologjisë arbëreshe e shqiptare. Për shkrimtarinë e autorëve shkodranë, kushtuar botës gjuhësore arbëreshe, siç jemi në dijeni, kanë prurje interesate edhe kolegë të tjerë, të cilët do të nxjerrin në dritë ndihmesën e çmuar të figurave të shquara të filologjisë shqiptare, Martin Camaj, Jup Kastrati e të tjerë, për ruajtjen dhe zhvillimin e arbërishtes në shekuj.

Imri BADALLAJ

(Prishtinë)

PIKËPAMJET E KOLË KAMSIT MBI ITALO-ARBËRESHËT DHE GJUHËN E TYRE

Vitaliteti për ta ruajtur gjuhën, folklorin, traditat, veshjet, doket e zakonet e moçme dhe mbarë karakterin e lashtë arbëror tregon qartë se italo-arbëreshët edhe pas pesë gjashtë shekujve, që u shkëputën përgjithmonë nga Dheu i tyre vazhdojnë të frymojnë thjesht arbërisht.

Kjo vetëdije e tyre kaq e fortë dhe me shumë dinjitet, bindshëm dëshmon për gjenezën dhe rrënjët e moçme të këtij komuniteti mendjendritur, të cilat nuk u thanë kurrë në dheun e huaj, dhe për krah shumë sakrificave ata krijuan një të ardhme pa u përkulur asnjëherë para sfidave të ndryshme, që ua solli jeta në mjedisin e paprovuar ndonjëherë tjetër. Mjedis ky, i cili rrezatonte dije, kulturë dhe civilizim në të gjitha sferat jetësore.

Pra, në këtë mjedis të ri arbëreshët me kohë kishin gjetur mënyrën për të çarë përpara, duke themeluar shoqata kulturore e arsimore dhe institucione shkencore. Këto nisma të tyre, që në fillim treguan dëshirën e madhe për t'i ruajtur virtytet dhe bujarinë, por mbi të gjitha gjuhën e të parëve e kurrë nuk e lanë në kufijtë e një përkujtese muzeale.

Tiparet e tilla arbërore për Kolë Kamsin, që në moshë fare të re vijnë e bëhen frymëzim dhe gurrë e pashtershme në punën e tij kërkimore-shkencore, ku si rezultat i këtyre hulumtimeve panë dritë një varg i gjatë i studimeve dhe veprave të disa karaktereve të dijes shqiptare, por penda e mprehtë e tij më fort ishte ngulitur, duke ndriçuar shumë segmente të

kulturës, të gjuhës dhe të jetës në përgjithësi të italo-arbëreshëve.

Ky pohim më së miri dëshmohet, kur merren e vështrohen gjithë ato studime e publikime me të dhëna të njëmenda, të cilat sollën dritë në korridoret e arbërishtes, që për fat të lig kishin filluar të pushtoheshin nga terri i dhëmbit të moteve.

Qëndrimi i tij i gjatë në trevat italo-arbëreshe, në mënyrë të veçantë mbolli dashurinë ndaj trashëgimisë gjuhësore, folklorike e letrare të këtij komuniteti, i cili përballoi shumë stuhi e shtrëngata të moteve dhe të situatave gjithfarëshe.

Këto ndihmesa, së paku të publikuara deri më sot, janë fokusuar në mbarë jetën dhe kulturën arbëreshe, por të folmet dhe sidomos leksiku, padyshim paraqet interes të veçantë, siç thoshte ai, sepse brenda tij ruhet një stad i hershëm i shqipes, kur edhe ndikimet e gjuhëve të tjera kanë qenë shumë më të vogla seç janë sot.

Në studimin e të folmeve arbëreshe Kamsi ka vërejtur dy dukuri të rëndësishme gjuhësore: për bashkësinë me shqipen dhe njëjtësinë në shumë segmente fonetike, gramatikore dhe në fondin leksikor e frazeologjik.

Ai duke qëmtuar me një zell të pashoq materie gjuhësore kudo që shkeli këmba e tij nëpër ngulimet arbëreshe, ka hetuar fjalë të moçme, të cilat datojnë edhe para *Mesharit* të Buzukut, që pa dyshim ky fenomen u bë shumë tërheqës për këtë filolog.

Krahas këtij fondi të vjetër fjalësh fort të begatë, ai hetoi në këto mjedise edhe këngë e valle burimore, veshje dhe zakone, që i dukeshin, se nuk janë prekur fare nga ndikimet e dheut të huaj. Thellësisht i mahnitur nga kjo larmi etno-folklorike dhe ligjërimore, që posedonte bota arbëreshe, këtë studiues e bëri sa kureshtar, aq edhe të përkushtueshëm, që të eksploronte sa më shumë fjalë, frazeologjizma e shprehje të rralla.

Të gjitha këto aspekte ky i vëzhgoi nga zanafilla, duke u nisur nga veprat e para italo-arbëreshe, që nga *E mbusuame e krështerë* e Lekë Matrëngës (1592), duke i parë në vijimësi edhe veprat e autorëve të tjerë, që panë dritë, kur edhe Kamsi vetë bënte shkollën e tij në Kolegjin e Shën

Adrianit.

Kërkimet shkencore, që ky i bënte, i mbështet dhe i krahason me publikimet e autorëve të tjerë arbëreshë dhe të huaj. Kjo mënyrë e punës kërkimore-shkencore ia mundësonte thellimin e analizave të mbështetura në argumente dhe arritje shkencore, që përkonin me kohën, kur Kamsi i kishte shtrirë vrojtimet e tij.

Në vështrimet gjuhësore, gjithmonë për bazë pati materialin faktik të të folmeve italo-arbëreshe, por dorëshkrimet e ruajtura nëpër arkiva dhe fonde private, kanë qenë një nxitje e veçantë, që në rezultate të jetë sa më i saktë.

Dëshmi e kësaj pune hulumtuese janë një mori shkrimesh, por dy vëllimet: *Shqiptarët e Italisë* (2006) dhe *Fjalor arbërisht-shqip* (2000), janë pasqyra më e ngjeshur dhe fort e thelluar në produktivitetin e tij shkencor mbi arbëreshët dhe gjuhën e tyre.

Ai kishte vërejtur se arbëreshët gjithmonë kishin qenë njerëz krenarë dhe të pajisur me një shpirt të fortë etnik, që si të tillë në të kaluarën nuk duronin prepotencën e baronëve, dhe nëse pësonin një padrejtësi ose edhe për t'iu mos u nënshtruar tatimeve dhe taksave të rënda, digjnin edhe kasollet e tyre dhe merrnin udhë për në toka të reja.

Mirëpo, kah fundi i shekullit XVI dhe nga fillimi i shekullit XVIII formohen bashkësitë e vërteta arbëreshe me ritin e tyre fetar kryesisht greko-bizantin dhe më pak në ato fillime me ritin latin.

Riti i tyre fetar, që e sollën nga mëmëdheu, pa dyshim që ndihmesa më e fuqishme për ta ruajtur gjuhën e të parëve të tyre, por doket, zakonet dhe festat që i përcillnin brez pas brezi, i mbanin ngushtë të lidhur mes vetes, duke mos pushuar kurrë së menduari për Arbërinë e lënë këndej deteve.

Të gjitha këto fakte, Kamsi i pasqyroj me dinjitet e pasion shkencor në dy vëllimet e zëna ngoje më sipër, por *Fjalori* i shtrirë në 377 faqe ngërthen një lëndë leksikore, që jo vetëm të zgjon kërkuesin, por ai të merr e të bën për vete në tërësi, që në asnjë mënyrë pa e studiuar, s' mund t'i ndahesh, nga se kjo vepër gjuhësore është pasqyra më e ndritur

dhe më e realët e integrimi të mbarë proceseve gjuhësore të komunitetit italo-arbëresh.

Identifikimi i fjalëve nga pikëpamja semantike, *Fjalorit* i jep dimension sa shkencor, aq edhe tërheqës për përdoruesit e tij, sepse materia leksikore e shtruar mbi faqet e tij është e mbushur me shprehje, fjalë të urta e frazeologjizma, që gjithsesi dukshëm shprehin mrekullinë e arbërishtes. Lirshëm mund të themi, se *Fjalori* i Kamsit paraqet një thesar gjuhësor fort të çmuar, që për ata të cilët bëjnë punë shkencore në fushat gjuhësore e më gjerë, është një shtysë për hulumtime edhe të tjera në ligjërimet italo-arbëreshe.

Edhe për mbarë shqipen vepra në fjalë paraqet një dhunti të veçantë, aq më tepër, kur dihet mirëfilli se vetë arbërishtja brenda letrave të saj, edhe sot e kësaj dite me një ambicie të paparë ruan fjalë e shprehje, që gjëkund s'mund t'i gjejsh.

Prandaj, ky erudit i vyer dhe fort i madh pas vetes ka lënë një produkt shkencor, që për të interesuarit, që të mësojnë mbi arbëreshët dhe gjuhën e tyre, paraqet një begati fort të rrallë shkencore.

Domenico CASSIANO

(Itali)

IL CONTRIBUTO DEGLI ALBANESI DI CALABRIA AL RISORGIMENTO

1. La funzione del Collegio di S. Adriano

Il contributo degli albanesi di Calabria richiede necessariamente un richiamo preliminare alla storia ed alla rilevanza – pedagogica e politica – del Collegio Italo-greco di S. Adriano. Senza l'opera di quel Collegio non sarebbe possibile dare una giustificazione plausibile alla massiccia partecipazione della popolazione albanofona ai moti risorgimentali per identificarne le profonde motivazioni di ordine culturale e politico, che determinarono l'irriducibile avversione all'assolutismo borbonico. Le carte processuali della Gran Corte Criminale di Cosenza registrano un dato assai significativo: sui seimila cittadini della provincia di Cosenza processati ed, in gran parte, condannati, ben millecentoventiquattro (1.124) erano albanesi, per lo più, studenti, sacerdoti e professionisti, educati in quel Collegio.

Il Collegio italo-greco svolse – e non solo tra gli albanesi di Calabria – l'essenziale e rilevante funzione di diffusione della moderna cultura napoletana, illuministica e riformatrice, educando i figli di quella borghesia rurale, emersa nel Decennio francese, ormai egemone. Saranno queste nuove generazioni che costituiranno i gruppi dirigenti e che attivamente parteciperanno a tutte le rivoluzioni del Mezzogiorno, dalla Repubblica Napoletana alla Spedizione dei Mille.

Tanto fu possibile per l'apertura culturale e progressista di vescovi-presidenti del Collegio, come monsignor Francesco Bugliari (1742-1806), assassinato dal sanfedismo reazionario, e come Domenico Bellusci (1774-1833) che, arrestato al tracollo della Partenopea e poi liberato, era ritornato nel Collegio per insegnarvi "*la scienza dei Locke, dei Condillac e dei Genovesi*". Furono questi prelati illuminati, dotti e tolleranti che, unici in Calabria, introdussero generazioni di giovani – e non solo delle comunità albanofone – alla conoscenza delle moderne problematiche culturali, politiche e religiose, mirabilmente conciliando con il Cristianesimo i principi di libertà e di uguaglianza, così anche realizzando, nei paesi arbresh, quella chiesa di popolo di

moderno sentire, inutilmente attesa dai cattolici-liberali, da Vincenzo Gioberti ad Ernesto Buonaiuti.

Il Collegio era un singolare centro di vivacità culturale che preparava promiscuamente i giovani che si avviavano al sacerdozio di rito greco e quelli che intraprendevano le libere professioni o l'insegnamento. Il contenuto culturale si ispirava al riformismo illuministico napoletano, agli ideali di libertà, giustizia e uguaglianza, corroborati dalla studio intenso della civiltà classica greco-latina.

Nel corso della Restaurazione – come sappiamo dalla testimonianza di Girolamo de' Rada, alunno in quel tempo – si era aperto alle *novità* europee dell'epoca. Vi erano studiati non solo il Foscolo, l'Alfieri “portato alle stelle”, ma anche i testi di madame de Stael ed i poemi del Byron, letteralmente divorati dagli studenti con vocazioni letterarie. Il perché lo spiega il de' Rada: quei giovani non volevano imitare il Byron, ma nelle sue opere avevano finalmente trovato un “modello” per esprimere la dura realtà calabrese del tempo. Così, agli eroi byroniani furono sostituite le gesta dei briganti della Sila, intessute di vendette contro le ingiustizie, di passioni violente, di morti tragiche e di amori delicati.

Si tratta di una letteratura sociale e realistica, nata con il caposcuola Domenico Mauro tra le mura di S. Adriano, e proseguita con le opere di Giannone, Baffi, Miraglia ed altri, che pure vi erano stati educati. All'interno della stessa scuola, nelle ore libere dagli impegni curriculari, i collegiali, costituitisi in accademia, leggevano a turno le proprie composizioni. Ebbe, in questo modo, origine quella che il De Sanctis definì la scuola del romanticismo *naturale* calabrese, che ebbe nel sandemetrese Domenico Mauro, il rappresentante maggiore, quello che “aveva più fantasia”.

Non è vero quel che riferì nella sua relazione il Visitatore Apostolico che, negli anni quaranta del secolo XIX, il Collegio di S. Adriano, più che un seminario, era diventato un convitto di chiara impronta laica, avendovi cercato – senza trovarlo – “un solo segno di Cristianesimo” ed avendovi, invece, potuto constatare la presenza di “molti libri di poesie e di letteratura, ma neppure uno solo di pietà”. La conclusione sconsolata, tratta dal Visitatore Apostolico, derivava dal fatto che il Collegio, retto da un vescovo e da sacerdoti di rito greco, più che un seminario, sembrava una scuola laica. Ed era, in realtà, tutt'e due le cose. L'errore, in cui era caduto il Visitatore Apostolico stava nel fatto che il suo giudizio era esclusivamente fondato sulle apparenze, dalle quali traeva argomento erroneo della pretesa inesistenza di una realtà “non parvente”. Volere dedurre dalla carenza dei *segni del Cristianesimo* l'inesistenza della fede e della pratica cristiana portava certamente a conclusioni fuorvianti.

Nel caso specifico, il Visitatore Apostolico – presupponendo che avrebbe dovuto trovare un seminario puro e semplice – non riusciva a cogliere la particolarità e la modernità della scuola, indubbiamente retta da un vescovo e da sacerdoti di rito greco e, quindi, non poteva non essere che ispirata ai valori e agli ideali cristiani, pur nella sua

apparenza di laicità. Il fatto è che il cristianesimo del Collegio – privo di segni religiosi - non era certamente identico al cattolicesimo tridentino, tipico della Chiesa ufficiale. Esso, invece, si ispirava ai Padri della Chiesa d'Oriente e praticava una religiosità essenziale e non aveva sposato la dottrina dell'unione del trono e dell'altare. Gli ecclesiastici di rito greco che dirigevano il Collegio, senza venire meno ai principi della fede cristiana, già al declinare del secolo XVIII avevano praticato un cristianesimo senza odi teologici, privo di fanatismi, conciliando i principi del movimento riformatore napoletano con il Vangelo, nella manifesta convinzione che gli ideali di uguaglianza e di libertà non erano in opposizione alle dottrine evangeliche.

In questo modo, il Collegio era diventato – caso unico nel Mezzogiorno – un vero e proprio laboratorio, dove l'insegnamento, severo e rigoroso, – lungi dal gesuitismo e dalla casistica – era ispirato alla ricerca ed all'apertura verso le *novità* culturali e politiche del tempo. Una simile scuola, che preparava anche al sacerdozio di rito greco i giovani che vi erano vocati, costituiva certamente un caso fuori dell'ordinario.

Ad un membro dell'*establishment* ecclesiastico, speditovi da Roma con funzioni inquisitoriali, non poteva sembrare un seminario perché non vi rinveniva i “segni” caratteristici di tale luogo. Parimenti, ad un rappresentante dell'assolutismo borbonico, inviato dal governo centrale, dopo l'attentato di Agesilao Milano, già alunno del Collegio, l'8 dicembre 1856, neppure sembrò una scuola, ma puramente e semplicemente una “cattedra di massime sovversive”, una “consorteria di orgia e di ateismo”, che bruciava “le menti e i cuori della fanatica gioventù albanese”. Per la verità, un funzionario di polizia era il meno adatto a capire e giudicare una istituzione culturale, come il Collegio italo-greco – *antico soggiorno delle Muse* - , all'epoca, unico centro di “vivacità culturale” nel Mezzogiorno, oltre che di iniziativa politica, impegnato nell'insegnamento laico e libertario, nel solco della tradizione riformistica e progressista e, cioè, della migliore tradizione meridionale e nazionale che, per ragioni ovvie, attraverso gli studenti, esercitava una larga e pervasiva influenza sull'opinione pubblica non solo dei paesi albanesi.

Una tale scuola preparava alla comunità albanofona la sua classe dirigente, laica ed ecclesiastica. E, nello stesso tempo, interpretava i bisogni e le aspirazioni della borghesia rurale che, in quella comunità, s'era venuta progressivamente formando nel corso del '700 e si era consolidata nel Decennio francese. I collegiali di S. Adriano erano i rampolli di questa borghesia paesana, guardata con sospetto ed in qualche modo emarginata durante la Restaurazione per i suoi trascorsi filo-francesi. Non potevano essi che aspirare alle *novità* politiche, educati in quel Collegio grazie al quale lo spirito e gli ideali del movimento riformatore e progressista napoletano erano sopravvissuti alla tragica fine della Repubblica ed ai disordini calabresi del 1806 – nel corso del quale il vescovo-presidente Francesco Bugliari era stato assassinato dal pugnale sanfedista – per

poi fruttificare durante la Restaurazione.

Fu proprio in quest'ultimo periodo, particolarmente dopo le stragi borboniche del 1799, che decapitarono il Mezzogiorno delle più eccelse intelligenze, che il Collegio – come hanno ricordato alcuni autori – divenne “un vivaio di giovani esaltati da sentimenti di libertà, da reminiscenze classiche e da un senso di idolatria per la rivoluzione francese” e “da un desiderio indistinto di tempi nuovi”. Né va trascurato il fatto che quei giovani collegiali, non rare volte, trovavano nei propri genitori, incarcerati per cospirazione politica, un modello educante di virtù civili, alimentate dalla stessa scuola nella quale erano anche presenti come docenti personaggi, non estranei alle congiure e partecipi attivamente alle organizzazioni settarie. Dopo i moti del 1821, il professore di matematica Gaetano Cerri, destituito dalla *Nunziatella*, venne ad insegnare in S. Adriano. Il vescovo-presidente, Domenico Bellusci, incarcerato nel 1799 perché in sospetto di giacobinismo, era legato da stretti rapporti di amicizia con Angelo Masci e Pasquale Baffi, illuminato di *Weishaupt*. Era attiva all'interno della scuola la setta *I Figliuoli della Giovane Italia*, fondata da Benedetto Musolino, alla quale sicuramente appartenevano anche alcuni studenti, come Girolamo de' Rada, Demetrio Strigari e Achille Frascino.

Attanasio Dramis, amico e compagno di Agesilao Milano, di Antonio Nociti e di Giambattista Falcone, ricorda nelle sue memorie di avere partecipato da “alunno del Collegio...dentro lo stesso convitto alle cospirazioni calabresi per l'unità italiana insieme a tanti altri miei compagni, tra cui specialmente Agesilao Milano”.

2. Il moto di Cosenza del marzo 1844

A Cosenza, nello studio dell'avvocato Paolo Scura di Vaccarizzo, nel febbraio del 1844, si tenne – con la presenza di Antonino Plutino, inviato dal Comitato Rivoluzionario di Napoli – la riunione per mettere a punto l'organizzazione dell'imminente sollevazione che sarebbe scoppiata in Calabria nel marzo successivo; fu stabilita la data dell'insurrezione per il 15 marzo, previa successiva conferma del Comitato di Napoli.

Incominciò subito dopo l'organizzazione delle bande. Raffaele Camodeca, Giuseppe, Federico e Scanderbeg Franzese, Gianfelice Petrassi, Antonio Raho e Giuseppe Cesareo ne assunsero l'incarico per i Comuni albanesi; Agesilao Mosciaro, Nicola Corigliano, Pietro Villacci, i fratelli Giuseppe e Francesco Valentini provvidero all'arruolamento dei volontari negli altri paesi della provincia.

Anche nel Collegio di S. Adriano non si attendevano passivamente gli eventi. Un convittore dodicenne dell'epoca, Giuseppe Mazziotti, alla vigilia del moto cosentino, vi nota un insolito fervore, di cui non riusciva a darsi ragione. “A quattro ore di notte – scrive – suonato il segnale del sonno, noi giovanetti dai dieci ai dodici anni, vedemmo

con meraviglia il nostro prefetto di camerata Stefano de' Mari che non andava a dormire e che puliva una sua pistola e preparava della polvere e del piombo". Il de' Mari si preparava a partire per Cosenza con altri congiurati di S. Demetrio per prendere parte a quella infelice insurrezione, conclusasi con un massacro e con diverse condanne alla pena capitale.

La polizia, venuta a conoscenza del progetto insurrezionale e non avendo forze sufficienti per contrastarlo, fece circolare la voce che alcune bande albanesi stavano per scendere in città per procedervi a saccheggi e devastazioni con il pretesto di inscenare una dimostrazione contro l'Intendente della provincia a causa della scarsità di viveri. Si raccomandava, perciò, ai cittadini di tapparsi in casa.

Il piano insurrezionale prevedeva di *"riunirsi a Settimo, porzione dei proseliti rimanere all'ingresso della città; altri arrestarsi alla Piazza Grande ed altri raggiungere il Palazzo dell'Intendenza; costringere l'Intendente a riconoscere la nuova forma di governo ed obbligarlo a dare ordini al Comandante della Provincia a fare depositare le armi alla forza pubblica e fare scarcerare, quindi, i detenuti politici"*.

Era nel frattempo avvenuto che i Comitati insurrezionali di altre province avevano disposto il rinvio della data di inizio del moto perché la polizia ne era venuta a conoscenza. La lettera con la quale Antonino Plutino comunicava a Domenico Fruguele di sospendere il tutto, dato che "per il 15 marzo non poteva mandargli i sigari e il tabacco", fu intercettata dalla polizia con la conseguenza che i congiurati cosentini non ne vennero a conoscenza.

All'oscuro della decisione del rinvio, nella notte del 14 marzo, convennero nei pressi di Cosenza ottanta patrioti, dei quali la metà proveniente dalle comunità albanesi. All'alba del giorno seguente, entrarono in Cosenza, dirigendosi verso il Palazzo dell'Intendenza; quivi furono raggiunti da un altro gruppo, condotto da Nicola Corigliano.

Tentarono di penetrare nel Palazzo dell'Intendenza, forzandone la porta. Furono, però, accerchiati dalla gendarmeria, comandata dal capitano Galluppi, figlio del celebre filosofo di Tropea. Il Galluppi, con la spada sguainata, cercava di convincere il notaio Francesco Salfi di ritirarsi. Nel momento in cui il Salfi si avvicinava al capitano, parlandogli in francese – "quasi per meglio dimostrargli la nobiltà dell'opera" – si incominciò a sparare da ambedue le parti. Rimasero "stesi al suolo" il giovane Galluppi e quattro degli insorti, il Salfi, Michele Musacchio, Francesco Coscarella e Giuseppe De Filippis, tutti da S. Benedetto Ullano, ov'era residente anche il Salfi che vi esercitava la professione di notaio; tre gendarmi furono feriti, uno dei quali morì dopo qualche giorno.

Seguirono arresti, processi e condanne. Ventuno furono le condanne alla pena capitale, inflitta a 15 arbresh e, precisamente: Raffaele Camodeca di anni 25, da Castoregio; Giuseppe Franzese di anni 44, da Cerzeto; Francesco Tavolaro di anni 26,

da S. Benedetto Ullano; Federico Franzese di anni 25, da Cerzeto; Gianfelice Petrassi di anni 24, da Cerzeto; Carlo Mosciaro di anni 21, da S. Benedetto Ullano; Vincenzo Barci di anni 30, da S. Benedetto Ullano; Francesco Tavolaro fu Gennaro di anni 21, da S. Benedetto Ullano; Giuseppe Tavolaro Costa di anni 25, da S. Benedetto Ullano; Giovanni Manes di anni 28, da S. Benedetto Ullano; Saverio Fullone di anni 22, da S. Benedetto Ullano; Antonio Pinnola di anni 35; Orazio Fullone di anni 22; Gaetano Barci di anni 34, tutti da S. Benedetto Ullano; Giuseppe Parisi di anni 24, da Cerzeto. Dieci furono condannati a trent'anni ai ferri e dodici ad anni venticinque.

Dei ventuno condannati a morte, ne furono giustiziati sei, secondo l'ordine venuto da Napoli, e, cioè, Nicola Corigliano, da Cosenza, Pietro Villacci, campano, Santo Cesareo, da S. Fili, gli arbresh Giuseppe Franzese da Cerzeto e Raffaele Camodeca da Castoregio; Antonio Raho preferì suicidarsi storicamente col veleno la sera prima della fucilazione. Offrì il veleno anche al Camodeca, che rifiutò e affrontò coraggiosamente la morte gridando: *“è questo il giorno più bello della mia vita! Viva l'Italia!”*.

Occorre opportunamente aggiungere che i condannati discussero a lungo se darsi volontariamente la morte col veleno – come sosteneva il Raho – per sottrarsi al boia. Camodeca e Franzese sostenevano che il suicidio era manifestazione di debolezza; soltanto il sangue versato per mano del nemico era seme fecondo per la Patria.

Successivamente fu condannato a morte anche il ventiduenne Scanderbeg Franzese da Cerzeto, che era riuscito a scappare; fu arrestato a Fuscaldo il 12 aprile 1845 per il tradimento di Lazzaro Manes, un patriota “pentito” e ben remunerato dalle autorità governative.

L'esecuzione delle condanne capitali avvenne nel Vallone di Rovito alle ore 18 del 10 luglio 1844. I loro corpi furono sepolti nella chiesa di S. Agostino e nel 1848 degnamente sistemati. Di lì a poco, il 25 luglio, nello stesso Vallone saranno eseguite le condanne a morte dei Fratelli Bandiera e dei loro sette consorti.

Cosenza ne ricordò il sacrificio nella lapide apposta al monumento della Libertà nella Piazza XXV Marzo: *“Della italica rivendicazione / a Cosenza / Iniziatori / Pochi ma magnanimi / Alla borbonica vendetta / Soccombettero / Santificando / Col sangue del martirio / il patibolo”*.

Quei giovani congiurati avevano studiato in S. Adriano. Il de' Rada, nella *Autobiologia*, ricorda particolarmente e dolorosamente, perché suoi amici, i fratelli Petrassi da Cerzeto e Raffaele Camodeca da Castoregio, “imputati di avere capitanato gli albanesi”.

Quando la triste notizia fu conosciuta nel Collegio, il vicepresidente e professore di greco, sacerdote don Antonio Marchianò, significativamente – come scrive il Mazziotti – “ordinò un'accademia sull'assassinio del vescovo Bugliari”.

Paolo Scura – nel cui studio faceva pratica forense Raffaele Camodeca – rimase profondamente scosso. “L'egregio patriota – scrive l'Andreotti – nel fiore degli anni

s'accorò siffattamente che il dolore lo tolse ai vivi prima che potesse vedere l'alba della riscossa". Si ritirò sconcolato ed affranto in Vaccarizzo, nel paesello natio, dove morì improvvisamente il 23 ottobre 1844, alla giovane età di trentadue anni.

Qualche storico non ha mancato di rilevare che il tentativo insurrezionale del 15 marzo 1844 fu un'azione precipitosa e sostanzialmente inutile degli albanesi di Calabria, che speravano di trovare nella popolazione calabrese gli stessi sentimenti comuni fra di loro. Tale giudizio mi sembra ingeneroso, oltre che non rispondente ai dati oggettivi. L'insuccesso dell'insurrezione non fu dovuto alla pretesa "precipitosità" degli albanesi, ma, invece, al mancato coordinamento dell'azione da parte dei gruppi dirigenti, che non provvidero a fermare con ogni mezzo l'iniziativa, una volta che le altre province avevano provvisoriamente sospeso ogni attività rivoluzionaria.

In ogni caso, quel tentativo generoso fu certamente utile alla causa nazionale. Alcuni anni dopo, Domenico Mauro, riflettendo nell'esilio su quei fatti, ne rivendicò il valore morale di rivelazione alla nazione stessa, che era, così, costretta a prendere coscienza "dei propri diritti e della propria servitù", ed agli stessi tiranni, che dovevano prendere atto "che il popolo era passato di cuore tra le schiere nemiche". Da quel momento – rileva il Mauro – il loro avversario non fu più "quel pugno di giovani che essi avevano dispersi e fatto cadere a colpi di moschetti, ed appesi alla cima delle loro forche, ma fu un essere fantastico ed immenso...fu l'immagine antica della tempesta, fu il popolo: questo popolo, che sotto l'immobilità apparente, potea nascondere il pensiero terribile di quei pochi; che, nel suo silenzio pensoso, poteva d'improvviso mandare dai suoi milioni di petti l'urlo di un uragano che, nella nudità di armi, poteva scrollare i troni e gettare al suolo le reggie".

Le piccole rivoluzioni, soffocate e disperse, come quella del '44, secondo il Mauro, rivelano che era sorta una nuova generazione, consapevole dei suoi diritti di libertà, e che "riprendeva il cammino troncato ai loro padri dalla prepotenza e dalle catene".

"Quel pugno di uomini – scrive il Mauro – che si sollevava di mezzo a una nazione sonnolenta e oppressa, per combattere chi l'opprimeva...quell'audacia improvvisa che rompeva il silenzio e la calma della paura universale...quella tromba di guerra, che di tratto in tratto mandava i suoi squilli...che si allontanava e si ascoltava in un altro punto, e percorreva un paese, e poi si ascoltava in un altro ancora...furono una grande rivelazione".

3. Domenico Mauro e l'appello al popolo

Domenico Mauro, fino al 1842, non si era occupato di politica attiva, ma di letteratura. Il suo poema *Errico* ed, in genere, la sua poesia, ha come sfondo la storia recente della Calabria. Proveniente da una famiglia della recente borghesia rurale, che

aveva consolidato le sue fortune economiche nel Decennio francese, egli fu il primo dei letterati meridionali che prese a cuore le sorti delle *minores gentes*, mettendone a nudo le condizioni di subalternità e la necessità del loro riscatto. Dalla letteratura approdò all'azione politica, avendo chiaro, sin dall'inizio, che quest'ultima avrebbe potuto essere efficace solo con l'appoggio ed il consenso popolare.

Fino al 1842 – scrive il Mauro nelle note autobiografiche, stese a Corfù dopo la sconfitta del '48 – “io vivevo una vita felice. Unito a molti giovani per la più parte miei compaesani parlavamo di lettere e di poesia, di classicismo e romanticismo, di storia e di filosofia, di quegli studi insomma che formano l'occupazione vivissima nel regno di Napoli, ma noi poco ci curavamo di sconvolgere l'ordine delle cose politiche. Non è che non ci occupassimo anche di politica, noi leggevamo tutti i fogli d'Europa; noi ci formavamo un concetto degli illustri uomini politici, quanto dei grandi letterati, filosofi e poeti; noi pensavamo alla Spagna, alla Grecia, all'Italia, sognavamo, come tutti i giovani, un avvenire, avevamo le nostre simpatie, le nostre parzialità per alcuni paesi e per alcuni uomini, ma la nostra azione presente non era là; noi pensavamo allora a scrivere poesie e drammi e poemetti. Io non aveva fede in quelli che macchinavano cospirazioni, e li aveva in conto di ciarlatani”.

Alla fine del 1842, l'incontro con Giovanni Mòsciario, albanese di S. Benedetto Ullano, grande proprietario terriero e tenace cospiratore, lo convinse a prendere parte attiva alla lotta risorgimentale. Mòsciario aveva partecipato, a Napoli, in casa Assanti, ad una riunione con i delegati delle varie province, in cui veniva programmato un vasto piano insurrezionale, che venne meglio definito nel corso del 1843. Il Mauro partì da Napoli per i paesi albanesi di Calabria, il 23 luglio del 1843. Come è noto, nel Mezzogiorno, in Puglia ed in Abruzzo, il moto fallì completamente, mentre ebbe un principio di esecuzione in Romagna.

In Calabria il fronte rivoluzionario era disomogeneo: comprendeva esponenti di orientamento diverso ed opposto. Domenico Frugiuele, Vincenzo Marsico, rappresentanti dei proprietari terrieri, avevano – come subito divenne assai chiaro – una difficile, se non impossibile convivenza a causa della diversità delle prospettive e delle visioni politiche moderate, con esponenti di tendenze estremistiche, democratico-repubblicane, come lo stesso Mòsciario, il Mauro, Vincenzo Franzese e Saverio Cribari. L'insurrezione fallì, in effetti, prima di nascere e prima che Mauro giungesse in Calabria. Il fronte proprietario rimproverava al Mòsciario di non essersi attenuto al mandato ricevuto; occorreva, quindi, sospendere il tutto in attesa di elaborare una nuova strategia. Mòsciario, protetto dai suoi affiliati – aveva arruolato ben 500 contadini e artigiani – riuscì a scappare; Domenico Mauro fu arrestato e rinchiuso nel carcere di Cosenza, dal quale poi fu trasferito in quello di Napoli.

Nel carcere, il Mauro analizzò la recente esperienza, dovendo realisticamente constatare che la rivoluzione non avrebbe potuto contare sul ceto proprietario perchè

infido e voltagabbana e che, invece, i cinquecento contadini, gli appartenenti alla “classe delle maestranze” ed alla “gente minuta”, arruolati dal Mòsciaro, non avevano ceduto. Questa alleanza di ceto medio, di artigiani, contadini e di popolo minuto, avrebbe dovuto costituire la struttura e la forza dell’organizzazione rivoluzionaria. Da qui l’*appello al popolo* perché “non restava a sperare che sul popolo...la mia speranza che io riponea nella cooperazione dei ricchi disparve”.

Di fronte alla evidenza dei fatti, il Mauro si era accorto, come scrive, che “i ricchi in Calabria non valgono a nulla” e, quindi, su di loro non si può fare affidamento per l’insurrezione perché “incapaci di occupare quel posto che li avesse fatti durare nel loro antico potere, e nella prima superiorità, poiché ignoranti come essi sono non valgono che ad accrescere il peso del loro scrigno e il numero delle loro bestie, a porre mente agli inchini che il povero popolo oppresso loro fa e in cui sta tutta la grandezza che possono raggiungere”.

Le classi agrarie calabresi sono inaffidabili. Quando esse, infatti, dimostrano di volere abbracciare le “idee di progresso”, o lo fanno nella speranza di trarne qualche personale profitto “o sperando che mai sarà per farsi nulla seriamente” o seguono “le velleità che vengono ispirate dal momento, e che si mutano quando meno l’aspettate”. La conclusione inevitabile è che “vi trovate abbandonati dai vostri campioni nel momento che il nemico vi sta alle spalle”. I contadini che avevano seguito Giovanni Mòsciaro, “guidati da uomini della loro stessa condizione popolare, o da gentiluomini per nulla potenti di ricchezza e di nobiltà”, la “classe delle maestranze” e la “gente minuta”, erano, invece, un sicuro e potente sostegno per la rivoluzione e dovevano essere un punto di forza e di riferimento costante. Essi avevano definitivamente convinto il Mauro a confidare e “sperare sul popolo”.

comandante delle truppe ottomane. Al giornalista italiano dichiarò che veniva dato un premio di centomila franchi d'oro, ad ogni testa italiana consegnata nelle sue mani. Si veda in proposito O. C. Mandalari, *Gl' Italiani per l' indipendenza della nazione albanese, cit.*, pp. 198-206.

⁵⁶ Il generale Ricciotti Garibaldi e Terenzio Tocci nel comunicare per lettera o per telegramma, utilizzavano codici aventi come termini d'intesa quali *commerciali*, sotto pseudonimo di *commerciale*, da indirizzarsi a un recapito *commerciale* di Scutari. Mentre il punto di sbarco sarebbe stato Scilizza nei pressi di San Giovanni di Medua, che era il punto più vicino al quartier generale del *Governo Provvisorio*. Cfr. Tocci, *Il Governo, cit.*, p. 48.

⁵⁷ In realtà la bandiera d'Albania fu inalberata per la prima volta sul monte Deçiç (sempre nell'alta Albania), alla fine di marzo del 1911 da Dedë Gjo Luli, un altro capo albanese. Si veda AA.VV. *Historia e Popullit, cit.*, p. 305.

⁵⁸ Nelle vicinanze di Alessio, poco lontano dalla fortezza sorgeva la cattedrale di San Nicolò, in cui si trovavano le spoglie di Giorgio Kastrioti Skanderbeg, e l'intero comprensorio aveva per gli *skjipëtari* una enorme rilevanza storica. Tocci, *Il Governo, cit.*, p.30.

⁵⁹ Prima di avviarsi per l'Italia, Tocci da Podgoritza scrisse due lettere indirizzate ai giornali romani la *Tribuna* e la *Ragione*, nelle quali dissuadeva “la gioventù italiana di correre alla frontiera albanese montenegrina perché in quel luogo- unico punto accessibile ai volontari *sparsi*- la rivoluzione era militarmente finita”. Cfr. Tocci, *Il Governo, cit.*, pp. 58, 59.

⁶⁰ Tocci, *Il Governo, cit.*, p. 55.

⁶¹ Tocci, *Il Governo, cit.*, p. 56.

⁶² *Ibidem.*

⁶³ Tocci, *Il Governo, cit.*, p. 57.

⁶⁴ *Ibidem.*

⁶⁵ Queste incomprensioni, tra Terenzio Tocci e la famiglia di Ricciotti Garibaldi, si chiarirono in modo definitivo nella primavera del 1942, quando il futuro Presidente della Camera albanese (Tocci fu eletto Presidente della Camera albanese nella primavera del 1940, ma si dimise nell'inverno del '42 a causa dell'indirizzo politico di alcuni gerarchi fascisti, che a detta di questi lo “disgustarono” molto), e Ricciotti jr. collaborarono assieme per “favorire un'insurrezione contro il fascismo”, e nell'unire il “popolo italiano [...] in nome del RE”. Cfr. R. Tocci, *Terenzio Tocci, cit.*, pp. 168-169.

⁶⁶ Tocci, *Il Governo, cit.*, p. 57.

⁶⁷ *Ibidem.*

⁶⁸ Tocci, *Il Governo, cit.*, pp. 59, 70.

A Podgoritza esisteva un comitato formato da vari capi albanesi, sorto dopo il disfacimento della *Lega di Prizren*. Lo scopo di questo comitato era di raccogliere viveri,

medicinali, denari e quant' altro servisse al popolo albanese. Preziosissimi furono gli aiuti distribuiti dalla scrittrice e agente segreto dell'impero britannico Edith Durham, la quale agiva come punto di contatto fra i vari *clubs* di istruzione albanese (in Italia aveva il suo centro di riferimento nel *Comitato torinese di soccorso per i rivoluzionari albanesi*), e come *missionaria* presso la popolazione degli albanesi settentrionali. È attraverso questo comitato montenegrino di esuli albanesi (assieme naturalmente ai suoi amici scutarini), che Terenzio Tocci e i suoi compagni poterono passare le frontiere del Montenegro e giungere nel cuore della *Ghegeria*. Si veda F. De Rada, *Il movimento albanese nel 1911*, Roma, stab. Tip. Moderno, pp. 44, 45; E. Vaina, *La Nazione Albanese* (2^a ed.), Catania, F. Battiato, 1917, pp. 188, 192.

⁶⁹Nell'appuntamento prefisso a Bari, si presentarono Simon Doda, nipote di Prenk Bibë Doda, con 12 capi mirditi e l'*arbëresh* Battista Groppa (Questi scrisse nel 1902 un opuscolo dal titolo *Quel che vogliono gli Albanesi*, e fece parte del comitato capitolino *Pro Patria*. All'epoca dell'incontro di Bari era componente del sotto comitato *Pro Albania* di S. Demetrio Corone). Francesco De Rada (nipote del vate *arbëresh*), chiamato d'urgenza da Groppa nel supplire l'assente Tocci, riferisce che all'incontro barese Simon Doda era "in uno stato di orgasmo indicibile", e impaziente nel muoversi al più presto per "rinfocolare la rivolta" in Albania. In questo stato di euforia *rivoluzionaria*, gli confidò inoltre che le alleanze con altri capi dell'alta Albania oramai si propagavano a macchia d'olio, e potevano contare su circa 35.000 uomini e su 5.000 fucili. Cfr. F. De Rada, *Il movimento albanese nel 1911*, cit., pp. 38, 39, 40; Tocci, *Il Governo*, cit., p. 65.

⁷⁰ Sulla base di organizzazioni *skjipëtare* sorte in passato, quali la *Shokeria e secs* (*Compagnia nera*), costituitasi nel sud dell'Albania nel 1878, composta da "uomini votati alla morte", e altre sorte nel nord del paese, le intenzioni di Tocci vertevano soprattutto nel convincere i capi dell'Albania, a unire il maggior numero di forze organizzative albanesi. Intanto da qualche anno nell'Albania meridionale erano sorte organizzazioni segrete e nuclei di guerriglieri denominati *cete*, che combattevano una guerra per l'indipendenza su più fronti, cioè sia contro milizie turche che *andartes* greci. Cfr. G. Castellan, *Storia dei Balcani XIV-XX secolo*, Lecce, Argo, 1996, p. 439; Tocci, *Il Governo*, cit., pp. 30, 65, 69.

⁷¹ Il Comitato *Pro Albania* di Roma venne fondato il 26 gennaio 1911. Alla sua costituzione aderirono i coniugi Albani, Anna Tondi Baggiani (sorella di Alina), i professori Trichieri e Ugo Della Seta, quest'ultimo membro nel 1897 del comitato mazziniano *Pro Cuba*, i dottori Codro Bucchi e Paolo Verdun di Cantugno, Ivanay Nicolas bey, Francesco Momina-Penna di Scicli, facente parte del Comitato centrale del *Partito Mazziniano Italiano*, e in via non ufficiale, a causa della loro mansione pubblica, i parlamentari Salvatore Barzilai ed Ettore Ferrari. Per una succinta e puntuale panoramica sui coniugi Albani in relazione alla spedizione garibaldina si veda F. Guida,

Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese, in “Archivio Storico Italiano”, Anno CXXXIX, Disp. 1, Firenze, Leo S. Olschki Editore, 1981, pp. 126-131

⁷² Tra le accuse rivolte a Tocci, dopo il mancato supporto garibaldino, compare quella di un *delatore*-informatore (di cui purtroppo non si menziona alcun nome), il quale fece sapere a Francesco De Rada che il *Governo Provvisorio* fu proclamato “facendo credere ai poveri montanari, che non sapevano né leggere né scrivere, che si trattava di un proclama che si trattava di chiedere aiuti pecuniari, cartucce e munizioni”. F. De Rada, *Il movimento albanese*, cit., p. 46

⁷³ Da una lettera del 10 aprile 1914 , indirizzata a Tocci, Nazario Sauro oltre a esprimersi come “amico albanofilo”, dava la sua piena solidarietà al popolo albanese per gli eventi che succedettero alla sua indipendenza, a causa di forti appetiti della Grecia, che sempre più voleva impossessarsi di altri territori nell’Albania meridionale. Alla fine della suddetta lettera Sauro pregava Tocci di inviare la lettera a Capodistria, ma senza “porre Austria “, che equivaleva per il giovane capodistriano a una vera onta, come lo scrivere ”ad un amico di Argirocastro ponendo sotto Grecia!!!”. T. Tocci, *Italia ed Albania*, Falerone, Tip. Menicucci, 1920, p. 17.

⁷⁴ G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, tip. Pontificia, 1932 ,

Riferimenti bibliografici:

1. AA.VV. *Historia e Popullit Shqiptar* (vol. II), Pristine, 1979.
2. Baldacci, A., *Albania*, Roma, Istituto per gli Studi Orientali, 1930.
3. Castellan, C., *Storia dei Balcani XIV-XX secolo*, Lecce, Argo, 1996.
4. Conforti, G., *L’Albania e gli Stati Balcanici*, Lecce, Stab. tip. Scipione Ammirato, 1901.
5. Crispi, F., *Questioni Internazionali*, Milano, Fratelli Treves Editori, 1913.
6. De Rada, F., *Il movimento albanese nel 1911*, Roma, stab. Tip. Moderno, 1912.
7. Del Re, E., *Albania punto e a capo*, Roma, ed. Seam, 1997.
8. Durham E., *Venti anni di groviglio balcanico*, Firenze, Felice Le Monnier, 1923.
9. Guida, F., *L’Italia e il risorgimento balcanico*, Marco Antonio Canini, Roma, Arti grafiche moderne , 1984.
10. Guida, F., *Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese*, in “Archivio Storico Italiano”, Anno CXXXIX, Disp. 1, Firenze, Leo S. Olschki Editore, 1981.
11. Hamdi, A., *Arna’udluq haqqinda* -in turco-, Costantinopoli, 1920 (cit. in E. Rossi, *Saggio sul dominio turco e l’ introduzione dell’ Islam in Albania*, in” Rivista d’ Albania”, anno III fasc. IV dicembre 1942.
12. Mandalari, O. C., *Gl’ Italiani per l’ indipendenza della nazione albanese*, Roma,

- Archivio dei Reduci di Guerra, 1936.
13. Mandalari, O.C., *L'Albania del 1939, pagine della vigilia di Terenzio Tocci*, Roma Archivio Storiografico dei Reduci di Guerra, 1940.
 14. Petrotta, G., *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, tip. Pontificia, 1932.
 15. Schirò, G., *Gli Albanesi e la Questione Balkanica*, Napoli, Bideri ed., 1904..
 16. Tamborra, A., *L' Europa centro-orientale nei secoli XIX e XX*, Milano, Vallardi, 1971.
 17. Tocci, R., *Terenzio Tocci mio padre*, Corigliano Calabro, 1977.
 18. T. Tocci, *Giovine Albania*(programma), s.l., s.d.
 19. T. Tocci, *Il Governo Provvisorio d'Albania*, Cosenza, Tipografia Operaia Forense, 1911.
 20. Tocci, T., *Il re degl'Albanesi*, Verona, Mondadori, 1938.
 21. T. Tocci, *Italia ed Albania*, Falerone, Tip. Menicucci, 1920.
 22. Vaina, E., *La Nazione Albanese* (2^a ed.), Catania, F. Battiato, 1917.

Përmbledhje

Terenc Toçi, një shembull mazianizimi revolucionar arbëresh për Shqipërinë (1897- 1901)

Terenc Toçi u lind më 9 mars 1880 në Strigari (San Cosimo Albanese), provincë e Kozencës. Jeta e tij nuk qe fort e qetë dhe e shtruar, pasi ai që fëmijë u shqua për prirje revolucionare dhe ideale të flakta. Që në rininë e hershme u aktivizua në partinë republikane, me besimin dhe idealet mazianiane dhe garibaldiane dhe ishte ndër të paktët arbëresh në fazën e ndërtimit të Rilindjes Kombëtare, duke u bërë kështu zëri aktiv e kritik i lëvizjes italo-shqiptare pro-shqiptare.

Viti 1896, shënoi për të riun Toçi, nisjen e një misioni që e udhëhoqi gjatë gjithë jetës, dhe që kultivoi tek ai idealet prioritare të emancipimit dhe të vetëvendosjes së popullit shqiptar.

Në fazën e parë idealiste, ashtu sikurse gjatë gjithë jetës, aktiviteti publicistik ishte shumë intensiv. Ai u paraqit me një seri të gjatë artikujsh në revista të përditshme të Evropës e Amerikës.

“Një shkrimtar autentik, polemist e kurajoz - e cilësonte atë Gaetano Petrotta- i cili nuk humbi asnjë rast për të shkruar artikuj në gazeta e revista në lidhje me çështjen shqiptare”

Në 1901 doli shkrimi i parë politik “Çështja shqiptare”, me reflektime politike-propagandistike albanofile, me qëllimin për të përhapur nevojat, jo vetëm politike të realitetit shqiptar, por edhe ato ekzistenciale.

Duke polemizuar në lidhje me politikën e trefishtë italiane, në çastin kur, normat diplomatike italo-austriake nga njëra anë siguronin një status quo në Shqipëri, e në Ballkan në përgjithësi, dhe nga tjetër i jepnin dorë të lirë propagandës së Austro-Hungarisë, në mënyrë gjithnjë e më të hapur, duke i falur kështu Italisë një politikë servile, dhe jo më një aleate sikur ishte parashikuar në traktatet politike.

Idetë për një Shqipëri të pavarur që filluan të konkretizoheshin me kalimin e viteve si dhe qëndrimet kritike të Toçit ndaj situatës politike të vendit amë, gjeneruan reflekse të ndryshme antipushtuese ndaj synimeve të shteteve fqinje (siç ishte rreziku pansllav).

Rrënjët e këtij qëndrimi antisllav, lidheshin me synimet malazeze, serbe e bullgare ndaj trojeve shqiptare, të cilësuar si ndër më të drejtpërdrejtat dhe të rrezikshmet, (krahas atyre greke e austro-hungareze). Një njohës i thellë i situatës politike shqiptare, ai theksonte dobësinë dhe pamundësinë e perandorisë osmane për të administruar situatën e rëndë të krijuar në vendet ballkanike.

Toçi njihte në mënyrë të drejtpërdrejtë një prej figurave kryesore të lëvizjes për pavarësinë e Shqipërisë, Ismail Qemalin, i cili synonte decentralizimin perandorak dhe arriti të shihte përtej mbulimit politik-administrativ të Perandorisë Osmane, duke shënuar problemet reale të dominimit të kësaj perandorie në Evropë.

Terenc Toçi vërejti një diferencë mes Perandorisë Osmane, që prej disa vjetësh po përshkohej nga transformime pozitive që po e orientonin drejt perëndimit dhe një lloj qëndrimi anakronik të një shteti teokratik turk, që e pengonte formimin e një republike moderne e demokratike, të bazuar mbi parimin e sovranitetit popullor.

- Një veprim garibaldin për Shqipërinë dhe Qeveria e përkohshme e Terenc Toçit (1911)

Si një njeri pragmatik, Toçi vuri menjëherë në diskutim komitetet dhe shoqëritë arbëreshe, duke i akuzuar për njëfarë mungese të sensit të realitetit. Ai parashitroi nevojën për të hartuar një lloj koordinimi mes gjithë organizmave kulturorë e politikë shqiptarë, me synime propagandistike e diplomatike, Toçi hyri në sintoni me arbëreshët e tjerë, por u shkëput shpejt prej tyre, sepse projektet morën formën e mendimeve platonike. Sjellja e tij ndaj këtyre organizmave politike-kulturore ishte mosbesuese, sepse mospërkimi mes idealeve të shfaqura dhe mjeteve të realizimit të tyre, ishte i dukshëm tanimë.

Formulimet politike të tij për problemin *skipëtar*o, u distancuan thelbësisht nga ato të aktivistëve të tjerë për pavarësinë italo-shqiptarë e garibaldinëve filo-shqiptarë.

Çështja shqiptare, në këtë pikë, bëhej çështje e revolucionit shqiptar dhe duhej gjetur rruga e duhur për të arritur në formimin e një shteti të bashkuar dhe të pavarur

shqiptar. Autonomistët ishin për një autonomi administrative, brenda perandorisë turke, dhe kundër një lëvizjeje të armatosur, nga frika se mos kalohej nga një ndikim i tillë, në një pushtim sllavo-atavik.

Toçi hyri në kontakt me pjesëmarrësit kryesorë të Rilindjes Arbëreshe, përmes korrespondencave aktive që shkëmbeu me ta, si Riccoti-n, F.Argondizza-n etj. Qëllimi ishte të krijohet një qendër a komitet, ku të ftoheshin hapur miqtë italianë të ndërhyshin, si dhe të realizohet një qendër aktive veprimesh në Shqipëri, me detyrën për ti paraprirë organizimit dhe ndërtimit të një boshti të hekurt të luftës për pavarësi, përndryshe çdo përpjekje do të kishte shkuar kot.

Këto ide u pasuan me një lëvizje të gjerë proshqiptare, si në tokën amë, ashtu edhe në trojet etnike të pushtuara nën Malin e Zi. Përpjekjet shkuan deri aty, sa Toçi u kërcënua me vdekje nga qeveria e Cetinës. Në Shqipëri, ai u përpoq të aktivizonte bajraqtet e Veriut (Mirditës, Shalës, Shoshit etj).

Revolucioni në Shqipëri, sidomos në Gegëri, sipas tezës së Toçit, mund të realizohet vetëm përmes një komunikimi të thjeshtë dhe një propagande politike e sociale (ose më saktë tribale), në një kohë kur duhet të ishin në kontakt të drejtëpërdrejtë me njerëzit, të cilët e kërkonin një pavarësi nga të huajt, por nuk mund ta arrinin të vetëm. Në këndvështrimin e Toçit e rëndësishme ishte të implementohej një Qeveri e përkohshme, sesa një Komitet revolucionar, në momentin që *“autoriteti i një komiteti, sidomos në nivel ndërkombëtar, nuk do të kishte vlerën e një Qeverie, po kështu edhe në situatën e brendshme, nuk do të kishte atë autoritet që mund të kishte një qeveri”*.

Së fundi, në këtë fazë të parë, ishte i domosdoshëm kalimi nga një qeveri e përkohshme, në një tjetër më të qëndrueshme, në mënyrë që fuqia të përqëndrohej në duart e një individi të vetëm, i cili do të zbatonte vendimet ekzekutive e legjislative.

Pas krijimit të një lëvizjeje të armatosur kundër forcave turke, në qytetin e Lezhës, por që u shua shpejt, ai u largua nga trojet shqiptare. Pak pas një udhëtimi në Itali, për të kërkuar mbështetje tek aleatët proshqiptarë, atij i erdhi lajmi i përpjekjes për të rrëzuar qeverinë e përkohshme.

Pas largimit në Itali, ai u përfshi në “Komitetin parlamentar proshqiptar”, për të cilin ai njoftoi edhe bajraktarët. Gjatë kësaj periudhe ai përndiqej shpesh nga policia, megjithatë ai arriti të vendoste kontakte me disa aktivistë që mbështesnin çështjen e tij, më saktë Ettore Sighieri dhe Eugenio Chiesa, të cilëve u kërkoi mbështetje si ushtarake, ashtu edhe financiare, por për shkak të komplikacioneve qeverisëse, nuk arriti të përfundonte asgjë.

Dështimi i fushatës garibaldine, ngjalli pakënaqësi në qarqet arbëreshe, sidomos ato të Kalabrisë, të cilët e kritikuan Toçin, si tradhtar të idealit mazinizan.

Së fundi, është e nevojshme që në këtë perspektivë teorike, të theksojmë meritat që i takojnë figurës së Toçit, në mënyrë që kontributi i tij të mos mbetet në heshtje. Ai vendosi në dispozicion të çështjes shqiptare gjithë entuziazmin e tij politik,

për një rigjenerim të situatës së nderë që ishte në dheun amë. Për gjithë kontributin dhe idealet e tij, duhet që të shmangim njëfarë revizionismi historik, që ka detyruar në zbehjen e ngjarjeve dhe personazheve që morën pjesë në to, duke u mbështetur në një materializëm dialektik ende rezistent ndaj historiografisë bashkëkohore. Pikërisht për këtë arsye, duhen rigjetur figura ‘të harruara’ nga historia si ajo e Terenc Toçit, i cili ka patur një meritë jo të vogël në historinë e vonë shqiptare, përmes impenjimeve politike, ideologjike e aktive në çështjen shqiptare.

Begzad BALIU

(Prishtinë)

**TIPOLOGJIA E KONTRIBUTIT TË PROF. JUP
KASTRATIT NË STUDIMIN E BOTËS MATERIALE
DHE SHPIRTËRORE ARBËRESHE**

**(Studime, vepra, komunikime, imazhe, vlerësime,
dokumente, dorëshkrime)**

Janë shumë rrethana që e arsyetojnë interesimin tonë për t'u marrë me studimet arbëreshe të Profesor Jup Kastratit, në një konferencë si kjo që i kushtohet *Kontributit të studiuesve shkodranë për arbëreshët e Italisë*. Vepra e tij është e gjerë në shumë anë të saj: si materie (disa mija faqe studimi, dokumente, letërkëmbim, fotografi etj.); si fusha studimi (gjuhësi, albanologji, letërsi, folklor, histori, pedagogji, publicistikë etj.); si lëndë (e botuar, në dorëshkrim, e përkthyer, e transliteruar, e përshtatur), etj. Ngado që të merren studimet e tij, ato paraqesin një mal të madh materialesh, problemesh e trajtimesh.

Në një hyrje për *Studimet arbëreshe të Profesor Jup Kastratit*, sinteza e thelluar shumëdimensionale as që mund të mendohet, por njëkohësisht ajo mund të paraqitet e plotë përmes një pasqyre të dendur dhe të plotë për lidhjet e Profesor Jup Kastratit me arbëreshët dhe me kontributet e tyre historike, gjuhësore, etnokulturore dhe letrare në përgjithësi. Sikur mund të shihet prej arkivit të tij, prej botimeve të tij dhe aktiviteteve të tij kulturore, arsimore dhe shkencore, ato janë të natyrës historike, kulturore, profesionale, personale dhe madje intime.

Sot, po të shikohet vepra shkencore dhe intelektuale e Prof. Jup Kastratit në linja sado të ngushta, studimet arbëreshe dhe deradiane gjithsesi do të nxjerrin krye, pavarësisht prej veprave të mëdha që ka dhënë në fushë të albanologjisë, të gramatologjisë, të letërsisë dhe të bibliografisë. Për disa dekada me radhë, nuk është zhvilluar asnjë manifestim, sado i vogël apo i madh qoftë, në të cilin të mos ketë qenë edhe Profesor Jup Kastrati. Për disa dekada me radhë, zor të gjendet një redaksi e botimit të letërsisë arbëreshe e sidomos vepërës letrare dhe shkencore të Jeronim de Rades, në të

cilën Profesor Jup Kastrati nuk e ka pasur vendin më të rëndësishëm, madje jo vetëm në Shkodër e Tiranë, por edhe më gjerë ndër arbëreshët e Italisë¹³⁸. Sot është vështirë të gjendet një fushë hulumtimi, botimi a studimi në fushë të studimeve arbëreshe, e cila nuk lidhet me emrin, me interesimin dhe më në fund me kontributin e Profesor Jup Kastratit.

Është e kuptueshme prandaj, pse edhe në këtë rast, kur këtu ne paraqesim një *hyrje* në *studimet arbëreshe* në përgjithësi dhe *studimet deradiane* në veçanti, e shohim të arsyeshme që të paraqesim edhe një pasqyrë sado të përgjithësuar të veprës së botuar, veprës së hulumtuar, arkivit dhe veprës në dorëshkrim të Profesor Kastratit.

Profesor Jup Kastrati ka shkruar shumë artikuj dhe studime monografike të karakterit shkencor, por në serinë e veprave të tij dhe sigurisht edhe në serinë e vëllimeve të botuara deri më tash vepra *Studime arbëreshe* mbetet jo vetëm një nga kryeveprat e tij, por edhe kryevepra më e plotë e studimeve arbëreshe.

Pse mund të thuhet kështu?

Hulumtimet, studimet dhe sintezat e Profesor Jup Kastratit për arbëreshët e Italisë, nisin që në dekadën e parë të kërkimeve shkencore dhe kulmojnë me sintezat e mëdha me emrin e shkrimtarit më të madh të kolonisë shqiptare në Itali, Jeronim de Rada¹³⁹. Prej këtij viti, për pesëdhjetë vjet me radhë nuk do të kalojë pothuajse asnjë vit e të mos botojë e ribotojë me dhjetëra artikuj brenda një viti, në të cilët dijetarët arbëreshë, veç e veç dhe historia, gjuha, letërsia, kultura, arsimit etj., si tërësi ose si sintezë nuk bëhen objekt kërkimi, studimi e vlerësimi¹⁴⁰, për të lënë edhe një mal dorëshkrimesh të pakrahasueshme në studimet e deritashme albanologjike.

¹³⁸ Anëtar i Redaksisë për botimin e Veprave të Jeronim de Radës; anëtar i Qendrës Kulturore për Kërkime Albanologjike ndër Arbëreshët e Italisë (Kozencë, 1991); Qendra e Studimeve Sociale në Lungro (Itali) i kërkoi “Veprat” e tij shkencore për Bibliotekën e këtij institucioni kulturor (10 shkurt 1984). Universiteti për të Huajt i Peruxhia – s (Itali) e ftoi të mbante një cikël konferencash shkencore për historinë e albanologjisë (23 maj 1997). Emri i tij ishte i pranishëm edhe ndër konferenca shkencore dhe ligjërime e botime të institucioneve shkencore në Universitetin e Kalabrisë (prill 1981), Institutin Oriental të Universitetit të Napolit (maj 1993); Universitetin e Salernos (dhjetor 1994). Bibliotekën Provinciale “Nicola Bernardini” në Lecce (18 tetor 1996) etj.

¹³⁹ *Mendime të Jeronim De Radës (për gjuhën shqipe)*, «Letrari i ri», Tiranë, 28 Shkurt 1953, V, 4 (90), 3. Për të dhëna të plota shih Diana Kastrati, *Bibliografia e botimeve të prof. Dr. Jup Kastrati*, “Albagen”, Shkodër, 2000, f. 228; ndërsa për sintezën e plotë të veprës bibliografike të tij shih Begzad Baliu, *Vepra bibliografike e Profesor Jup Kastratit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

¹⁴⁰ Veprat me temë arbëreshët e Italisë: *Autobiografia e De Radës*, Tiranë, 1999; *Bibliografi albanistike, I. “Era”*, Prishtinë, 2004; *Figura të ndritura të Rilindjes Kombëtare*, “Era”, (botimi i pare, Shkodër, 1963) Prishtinë, 2003; *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Bibliografi (1454 - 1835)*. Vëllimi I. Tiranë, 1997 (Bashkautor); J. De

Jeta dhe vepra e personaliteteve arbëreshe, vepra e tyre etnohistorike dhe sidomos gjuhësore dhe letrare, konceptet e tyre për identitetin dhe veçoritë materiale, shpirtërore e sidomos gjuhësore, etj., për më shumë se një gjysmë shekulli kanë qenë objekt studimi e referimi në shumë institucione kulturore, arsimore dhe shkencore, të themeluara nga arbëreshët në Itali¹⁴¹.

Kjo është arsyeja pse edhe veprat në të cilat është trajtuar kultura, tradita dhe historia gjuhësore e letrare e autorëve në radhët e arbëreshëve ka qenë e përmasave të ndryshme: traktate (*Histori e albanologjisë*)¹⁴², monografi (*Histori e gjuhësisë shqiptare*.

Rada, *Këngë të Milosaut*, Tiranë, 1956; J. De Rada, *Publicistika, Letërkëmbimi. Autobiografia*, Tiranë, 1987; J. De Rada, *Skanderbeku i pafanë*, Tiranë, 1987; Jeronim de Rada (*Jeta dhe veprat*). Botim i ripunuari vitit 1962. Monografi, Tiranë, 1979; *Studime për De Radën*, "Era", Prishtinë, 2003/New York, 2003 etj.

¹⁴¹ Shi veç tjerash, *La lessicografia albanese nel XVIII° secolo*. Istituto Universitario Orientale. Napoli: «Albanistica Novantasette», a cura di Italo Costante Fortino. Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale. 1997, pp. 95 - 115. Ndër të tjera, në këtë studim monografik analizohen edhe veprat leksikografike të autorëve: 1. Francesco Maria da Lecce (1702), f. 95; 2. Il Dizionario italiano e albanese per alfabeto della Badia Greca di Grottaferrata (1710), f. 99; Bonaventura Prucher (1752), f. 99; Giorgio Guzzetta (1756), f. 101; Nicolo Chetta (1779), f. 109-110.

¹⁴² Shih veç tjerash përfshirjen e arbëreshëve në traktatin "Histori e albanologjisë" I, si dhe në dy vëllimet tjera në dorëshkrim: *Historia e albanologjisë (1497-1997)*.

I. Vëllimi i parë (1497-1853). Shtëpia botuese «Argeta –LMG», Tiranë 2000. /Vëllimi i parë: «Periudha parashkencore e studimit të gjuhës shqipe (1497-1853)». / Në këtë vëllim janë këto materiale për arbëreshët: Gjergj Guxeta (para 1756), f. 314; Pal Maria Parrino (1765) (f. 321); Nikollë Keta (1763, 1779, 1803) (f. 348); Engjëll Mashii (1807) (f. 546); Andrea Dara (1830) (f. 562); Mikel Skutari (1825) (f. 569); Zef Krispi (1827, 1831, 1836) (f. 561); 5) Gjon Skiroi (1834) (f. 566); Jeronim de Rada (1834-1903) (f. 571); Emanuel Bidera (1844, 1845) (f. 595); Vinçenc Dorsa (1847) (f. 596).

II. Histori e albanologjisë (1854-1942). Vëllimi II. *Vëllimi i dytë përfshinë këta kapituj dhe studime për autorë arbëreshë: Kreu XVI: Gjuhësia shqiptare ndër arbëreshët e Italisë në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Hyrje: Xhusepe Anxhelo Noçiti (1855); Françesk Anton Santori (1855); Kermin Dhërmiu (1873); Vinçenc Librandi (1897); Kozmo Serembe (1898); Enrik Kremonezi (1898); Anton Krispi (1898); Françesk Kinigò (1899); Gjon Daka (1899); Xhan Krizostom Buljari (1897); Birnard Bilota (1899); Dy kongrese gjuhësore për shqipen ndër arbëreshët e Italisë. Pëmbyllje. Bibliografi. Kreu XVII: Shkencëtari më i madh i gjuhësisë shqiptare në shekullin XIX ndër arbëreshët e Italisë. Hyrje: Dhimitër Kamarda (1821-1882). Kreu XXVI: Gjuhësia shqiptare ndër arbëreshët e Italisë në gjysmën e parë të shekullit XX. Hyrje: Pjetër kamodeka (Pietro Camodeca) (1900); Zef Skirò – plaku (Giuseppe Schirò – sendor), (1901); Mark la Piana (Marco la Piana), (1912), Mikel Markianò (Michele Marchianò); Nilo Borxha (Nilo Borgia); Pal Skirò (Paolo Schirò); Gaetan Petrota*

*Pjesa e parë (1497 – 1944)*¹⁴³, *Gramatologjia e gjuhës shqipe*¹⁴⁴, *Dhimitër Kamarda*) studime (*Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Dr. Mikel Markiano dhe ndihmesa e tij në folklorin arbëresh, Arbëreshët për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë*)¹⁴⁵, studime të thelluara

(Gaetano Petrotta) (1939). Përmbyllje. Bibliografia.

III. Histori e albanologjisë (1943-1997). Vëllimi i tretë. Ishte planifikuar të botoheshin studimet për albanologët nga 1. Shqipëria dhe 2. Kosova (si dhe trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), si dhe 3. arbëreshët: Emanuel Jordano, Antonio Belushi etj.

¹⁴³ *Histori e gjuhësisë shqiptare*. Pjesa e parë (1497 - 1944). Kurs special në gjuhë. Material në ndihmë të studentëve. Instituti i Lartë Pedagogjik «Luigj Gurakuqi». Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë. Katedra e gjuhës shqipe. Shkodër, tetor 1989. 271 faqe të shaptilografuara. Në këtë vëllim trajtohen, ndër të tjerë edhe këta autorë arbëreshë të Italisë: Nilo Katalano (1637-1694), f. 32; Gjergj Guxeta (1682 - 1756), f. 60-62; Pal M. Parrino (1710 - 1765), f. 62-64; Nikollë Keta (1740 - 1803), f. 64-67; Engjëll Mashi (1807), f. 85-104; Mikel Skutari (1825), f. 105-104; Zef Krispi (1827), f. 115-121; Gjon Skiroi (1834), f. 122-127; Vinçenc Dorsa (1847), 128-153; Andrea Dara (1830), 154-155; Kamil de Rada (1847), f. 157; Jeronim De Rada (1834-1903), f. 156-181; Dhimitër Kamarda (1864, 1866, 1870, 1882), f. 211-213; Gaetano Petrotta (1913), f. 258; Marko la Piana (1912-1958), f. 260-262.

¹⁴⁴ **Histori e gramatologjisë shqiptare (1635 - 1944)**, “Rilindja”, Redaksia e botimeve. Prishtinë, 1980. Sasia: 5.000 copë. U shtyp në Shtypshkronjën “Rilindja”. Prishtinë, në tetor të vitit 1980. Faqe: XII + 486. (Libër. Monografi gjuhësore. Tezë doktorati. Është botuar vetëm pjesa e parë. Ka mbetur pa u botuar pjesa e dytë. J. K.) *Përmbajtja*: Në kapitulli III. Shekulli XIX: 1. Përpjekjet e arbëreshëve të Greqisë dhe Italisë për gramatikën e gjuhës shqipe (f. 15). Veprimtaria gramatologjike shqipe ndër ngulimet arbëreshë (f. 319), janë përfshirë studime të plota për botimin e gramatikave ndër arbëreshët e Italisë. Ndër të tjerë trajtohen edhe këta dijetarë arbëresh të Italisë: Nilo Catalano (1637-1694), f. 4-6. Dijetar Italian «i arbëreshizuar»; Kamil de Radës (1847), f. 85; Dhimitër Kamarda (1864), f. 85-87, 111-113; Zef de Rada (1870/71), f. 87-105; Andrea Dara (1872), f. 111; Anton Santori (1818-1894), f. 111; Jeronim de Rada, (1894), f. 201-218; Vincenzo Librandi, (1897); f. 223-225; Enriko Kremonezi, (1899), f. 225; Gaetano Petrotta (1913), f. 319; Marko la Piana (1917), f. 343-351.

¹⁴⁵ Në studimet albanologjike të gjysmës së dytë të shekullit XX, në dy nga konferencat më të mëdha shkencore të kësaj kohe, Profesor Jup Kastyrati përfaqëson mendimin historik, gjuhësor dhe kulturor të arbëreshëve të Italisë: *Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* (në librin) «Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878 – 1881», (12 - 18 qershor 1978), Akademia e Shkencave. Instituti i Historisë. Tiranë, 1979, f. 196 - 203; dhe *Dr. Mikel Markiano dhe ndihmesa e tij në folklorin arbëresh*, (në librin) «Çështje të folklorit shqiptar», vëll. 4, Akademia e Shkencave, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1989, f. 97 – 116; *Arbëreshët për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë*, “Studime historike”, Tiranë, 1976, XXX (XIII), 3, 91 – 106, etj

shkencore e paraqitje fejtunistike në shtypin ditor, botime me karakter shkollor dhe botime me karakter shkencor, përkthime nga gjuhët në të cilat kanë shkruar shkencëtarët dhe letrarët arbëreshë gjatë disa shekujve të veprimtarisë së tyre në Itali etj.

Jeronim de Rada dhe fillimet shkencore të Jup Kastratit

Nëse shënime për versionet dhe variantet e botimit të monografisë për Faik Konicën, si dhe botimin e veprës së tij, kemi pasur rastin t'i lexojmë për shkak se monografia e tij për Faik Konicën u botua atëherë kur Konica ishte një prej personaliteteve shumë të theksuara në jetën politike, shkencore dhe kulturore, shënime personale të tij rreth përpjekjeve për botimin e veprave të plota a të zgjedhura për Jeronim de Radën nuk i kemi gjetur, në mënyrë të veçantë, as nuk ia kemi dhënë rastin t'i tregojë në intervista ekskluzive ku ai do të sillte informacione më shteruese se sa shumë studiues në veprat e tyre shkencore. Sigurisht për shkak se veprën e plotë të Jeronim de Radës nuk arriti ta botonte të plotë, ashtu sikur e kishte planifikuar as në fillim të viteve '50, as diku në fillim të viteve '90, Profesor Jup Kastrati nuk ka shkruar apo sjellë përvojën e tij në mbledhjen, studimin, përkthimin, botimin dhe sintetizimin e veprës së Jeronim de Radës.

Mirëpo nëse i qasemi Arkivit të Profesor Jup Kastratit nuk të mbetet gjë mangut, pavarësisht nëse ke të bësh me ndërtimin e personalitetit të tij, apo me zhvillimet albanologjike të kohës kur jetoi ai. Prej arkivit privat të tij do të mund të kuptojmë se historia e interesimit të Profesor Jup Kastratit për arbëreshët e Italisë është e lidhur me emrin e Jeronim De Radës, prandaj është e kuptueshme pse jetën dhe veprën e tij do ta trajtojë shumë herë dhe do ta trajtojë në shumë vepra të tij, madje të botuara e të plotësuara¹⁴⁶. Pavarësisht nga botimi i parë i një monografie për jetën dhe veprat e Jeronim de Radës në vitin 1962 dhe botimit të dytë të plotësuar të vitit 1979, autori e ka përgatitur një dorëshkrim tjetër, i cili në shumë pika plotëson jetën e tij, trajton në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme veprën e tij diturake, historike, gjuhësore, letrare, arsimore, publicistike etj., ndërsa duke ju referuar parathënies së librit, kuptojmë se autori njëkohësisht punon edhe një vepër për studimet gati njëshekullore deradiane 1903-1993. Po të vlerësohet vetëm kontributi i madh i punës së Profesor Jup Kastratit në mbledhjen dhe botimin e veprës së De Radës, do të mund të shihet se vetëm në studimin e jetës dhe veprës së tij, ai ka ngritur një trilogji, të cilën deri më sot nuk e kemi bërë për asnjërin prej shkrytarëve tanë.

Dorëshkrimi *Studime për De Radën*, për herë të parë trajton në mënyrë

¹⁴⁶ *Jeronim de Rada* (Jeta dhe veprat). Tiranë, 1962; *Jeronim de Rada* (Jeta dhe veprat). monografi, Tiranë, 1979; Ribotuar në Prishtinë, 1980; *Autobiografia e De Radës*. Tiranë, 1999.

shteruese jetën, *Autobiologjinë* (autobiografinë) e tij, pikëpamjet kulturore, filozofike dhe sidomos politike, pa pengesat ekstrashkencore që i dilnin dikur, kontributin e tij për gjuhën shqipe: tezën pellazgjike të prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, te artikujt, *Hyjni pellazge* (1840), *Identiteti i pellazgëve me shqiptarët* (1846), *Lashtësia e kombit shqiptar dhe afri e tij me helenët dhe latinët* (1864), *Pellazgët dhe helenët* (1885), *Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe* (1893), *Pellazgo-shqiptarët* (1897), *Tiparet e gjuhës shqipe dhe përmendoret e saj në periudhën parahistorike* (1899), e cila njëkohësisht është edhe tezë kryesore e rilindjes kombëtare shqiptare në përgjithësi. Në këtë vepër autori ka trajtuar edhe disa probleme të toponimisë, një fushë gjuhësore e lëvruar kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit XX, por me të cilën, sikur ka vënë re Profesor Jup Kastrati, sado me koncepte të paragjykuara është marrë edhe De Rada, tek studimet *Toponimia historike shqiptare, Toponime për Lezhën në revistën «Fjamuri i Arbërit»* (1885) etj.

Ashtu sikur edhe rilindësit më të shquar jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të popujve të tjerë të Ballkanit, edhe De Rada do të merret me dy çështje themelore të gjuhës dhe të kulturës së popullit shqiptar: me alfabetin e gjuhës shqipe (*Çështje të alfabetit të gjuhës shqipe*), dhe me përpjekjet për të shkruar gramatikën e gjuhës shqipe (*Gramatikë e gjuhës shqipe*, 1870 dhe *Fonetikë dhe gramatikë e gjuhës shqipe*, 1894) me vlerat historike dhe gjuhësore të të cilave Profesor Jup Kastrati është marrë madje jo vetëm këtu. Përtej saj, Profesor Kastrati, do t'i qaset studimit të një vepre jo aq të njohur dhe jo aq të popullarizuar përgjithësisht edhe sot në studimet albanologjike (*Fjalori i Rapsodive*, 1884).

Duke këmbëngulur që të japë një pasqyrë sa më të gjerë dhe më të thellë, si të zhvillimeve gjuhësore ndër arbëreshët e Italisë, të lidhura me veprën e De Radës, ashtu edhe me kontributin vetjak të tij, profesor Kastrati do të shkruajë për ngjarje me rëndësi historike, për gjuhën dhe kulturën shqiptare ndër arbëreshët e Italisë (*Kongresi në Koriljano-Kalabro*, 1895; *Kongresi në Lungro* 1897), ashtu edhe për artikuj që De Rada i shkruante në raste nga më të ndryshmet (*Dinjiteti i gjuhës shqipe*, 1861; *Shqipëria përballë Evropës*, 1880, *Shënime gjuhësore* (1883 – 1884); *Tri fjalë shqipe*, 1884; *Vërejtje gjuhësore*, 1885; *Gjurmë të vendbanimeve tona të lashta që rrojnë endë*, 1887; *Mësime për gjuhën shqipe*, 1891), të cilët jo gjithnjë kufizohen brenda problemeve të ngushta linguistike. Kjo është arsyeja pse njërin prej studimeve të tij do ta përfundojë me këtë vlerësim: «De Rada ishte i pushtuar nga ideja fisnike që të ringjallte Atdheun e të parëve dhe kështu, nën shtytjen atdhetare, shkencën e ktheu në një fushë beteje, ku ai luftoi me zjarr, siç bën edhe rilindës të tjerë. Këtë ai e realizoi pothuajse në çdo vepër të tij. Pra, edhe në mes të lajthitjeve, vepra e tij gjuhësore do të mbetet në historinë e albanologjisë si një përpjekje fisnike e një shqiptari të madh, i cili, me gjithë mungesën e përgatitjes filologjike dhe linguistike, me gjithë mungesën e akribisë shkencore, me gjithë mungesën e anës materiale, me gjithë vuajtjet e mëdha shpirtërore dhe kushtet e

disfavorshme, arriti të zgjojë kureshtjen e botës shkencore të dijetarëve të kohës. Veprat e tij historiko-filologjike hyjnë në fondin e artë të traditës së shekullit XIX. Ato bëjnë pjesë në korpusin “Trashëgimi ynë kulturor – Monumente të gjuhës shqipe”, në historinë e mendimit shkencor gjuhësor shqiptar»¹⁴⁷.

«De Rada ka qenë jo vetëm mbledhës i këngëve popullore, por edhe studiues i hollë i tyre. Ky kontribut i vyer i tij në historinë e folkloristikës shqiptare nuk është vënë në dukje»¹⁴⁸. Kështu e mbyll kapitullin e studimit të tij për kontributin e De Radës dhënë folklorit shqiptar. Nëse ndihmesa e tij në këtë fushë deri më tash është parë kryesisht duke u nisur prej pasurisë etnografike dhe folklorike që sjellin veprat e tij letrare, studimi i Profesor Jup Kastratit, nisët nga artikujt programatik të De Radës (*Rapsodi të një poeme shqiptare*, 1861; *Rapsodi kombëtare*, 1883; *Hyjnizime etnografike*, 1886), vlera e të cilëve këtu kuptohet edhe prej ekstrakteve të shpeshta, me të cilët pasurohet kapitulli për këtë temë.

Rilindja kombëtare shqiptare, ka pasur shumë personalitete letrare e shkencore të cilët kanë qenë të përkushtuar ndaj arsimit kombëtar, por nuk besoj të kemi rilindës, i cili ka punuar me kaq përkushtim për organizimin jo thjeshtë të një *mësonjëtorje* shqipe për çuna a vasha, por për një shkollë kombëtare me të gjitha nivelet e nxënies së gjuhës dhe dijes. Është e kuptueshme prandaj pse Profesor Jup Kastrati një kapitull më vete ia kushton ndihmesës së De Radës për shkollën shqipe, për tu ndalur pastaj në mënyrë të veçantë në aktivitetet konkrete të organizimit të shkollës shqipe nga De Rada dhe bashkëkohësit e tij (*Themelimi i Katedrës së gjuhës shqipe*, 1849; *Kolegji arbëresh i Shën Adrianit*, 1861; *Manifesti i gjimnazit «Garopoli»*, 1868; *Kolegji arbëresh dhe ministrat e Italisë*, 1876, *Kolegji arbëresh*, 1884; *Kolegji arbëresh në Shën Adrian*, 1886; *Kolegji i Shën Adrianit*, 1887; *Rivendosja e Katedrës së Shqipes*, 1889), por edhe për ndonjë projekt të karakterit pedagogjik, sikur është ai: *Kolegji arbëresh i Shën Adrianit, a do të jetë Seminar Korsini apo Gjimnaz-licé italo-grek, me ndonjë degë universitare kishtarë?*, 1891 dhe manifesti *Katedra e shqipes në Shën Mitër Korone*, 1892. E kësaj natyre është edhe *Antologji shqipe*, 1896, dhe Proluzioni: *Ligjëratë për periudhën e vitit të ri shkollor*, 1902, me të cilat Profesor Jup Kastrati merret njëherë në mënyrë të veçantë me secilën dhe më pastaj me sintezën e tyre në përmbyllje.

Ashtu sikur edhe me veprat më të mëdha dhe më të vogla të gjuhësisë edhe me veprat letrare artistike të Jeronim De Radës, Profesor Jup Kastrati do të merret në shumë aspekte. Ndryshe nga gjendje e gjertashme e studimit të veprës së tij letrare, ku studiuesit e periudhave të ndryshme kanë hulumtuar, trajtuar dhe bërë sinteza kryesisht vetëm për veprat letrare të shkruara në gjuhën shqipe, apo edhe të përkthyer a transliteruara, në veprën e tij *Studime për De Radën*, autori është marrë me veprat e shkruara në gjuhën

¹⁴⁷ Shih dorëshkrimin, f. 301.

¹⁴⁸ Po aty, f. 348.

shqipe, me veprat letrare të shkruara në gjuhën italiane dhe me veprat e shkruara në gjuhën shqipe e italiane paralelisht. Duke u marrë me veprat letrare më të hershme (*Odiseu*, 1832, 1847; *Krutani i mërguar*, 1832 – 1833, 1841; *Disa poezi dhe proza ritmike*, 1834 – 1840), apo më të vona, më të vogla apo më të mëdha (*Këngë të Milosaut*, 1836, 1847, 1873; *Serafina Topia*, 1839, 1943); *Një pasqyrë shtegtimi njerëzor*, 1897), të botuara në një variant apo në më shumë variante (*Skënderbeu i pafat*, 1872 – 1884), ai njëkohësisht është marrë edhe me ngritjen cilësore letrare e artistike të veprës letrare të De Radës, me kulturën letrare dhe gjuhësore të tij, me konceptet moderne të kohës në letërsi, me vlerësimet e kohës për poezinë e tij etj. Duke u marrë me pikëpamjet letrare të De Radës, Profesor Jup Kastrati njëkohësisht do të merret më gjerësisht se deri më tash dhe mbase për herë të parë në mënyrë të plotë edhe me pikëpamjet estetike të De Radës (*Parime të estetikës*, 1861) etj.

Për të plotësuar botën diturake të Jeronim De Radës, Profesor Jup Kastrati në veprën e tij dorëshkrim *Studime për De Radën* ka hulumtuar dhe i ka bërë objekt trajtimi edhe dy gazeta të De Radës *Fjamuri i Arbërit* (1883-1887) dhe *Shqiptari i Italisë* (1848). Si gazeta e parë ashtu edhe e dyta dallohen për veçoritë e tyre historike, politike, kulturore dhe shkencore. *Fjamuri i Arbërit*, ka shkruar Profesor Jup Kastrati «është revista e parë letrare, kulturore, artistike, folkloristike, etnografike dhe publicistike në gjuhën shqipe. Organi luajti një rol të madh në fushën e politikës shqiptare, të lëvizjes sonë politike dhe asaj mendore»¹⁴⁹. Më këto fletore De Rada i ka vënë vulë lëvizjes së përgjithshme të Rilindjes Kombëtare jo vetëm ndër shqiptarët e Italisë por edhe në lëvizjen e saj përgjithësisht. Aty janë botuar pjesë nga veprat letrare të De Radës dhe të shkrimtarëve të tjerë të kohës. Artikuj publicistikë, kulturorë e politikë të ardhur nga e gjithë bota shqiptare, prandaj është e kuptueshme pse vlerësimet shembullore për gazetat e De Radës vijnë jo vetëm nga shtypi shqiptar i kohës në Shqipëri, në Kolonitë shqiptare të Rumanisë, Stambollit e Egjiptit, por edhe nga shtypi i huaj i kohës.

Vepra *Studime për De Radën* e Profesor Jup Kastratit mbyllet me kapitullin që ju kushtohet *veprave autobiografike të De Radës* (*Një autograf*, 1885; *Autobiografi*, I, II, III, IV, (1898 – 1899); *Testamenti politik*, 1902). Ndonëse për autorin ato ishin vepra të njohura, prej më shumë se tri dekadash, veprat autobiografike të De Radës, nuk ishte e mundur as të botoheshin të plota, as të bëheshin objekt trajtimi në të gjitha aspektet e mundshme. «Autori ynë ishte, aso kohe, 89 vjeç. Mbas pesë muajsh, më 28 shkurt 1903, ai u nda prej nesh, duke na lënë dhjatën e vet, në të cilën ishte sintetizuar gjithë veprimtaria e tij atdhetare, politike, letrare, gjuhësore, folklorike, publicistike, historike në shërbim të çështjes shqiptare, të gjuhës amtare, të kulturës kombëtare, të çlirimit të mëmëdheut të vet të dashur e të shtrenjtë»¹⁵⁰.

¹⁴⁹ Shih dorëshkrimin, f. 462.

¹⁵⁰ Shih dorëshkrimin, f. 544

Ashtu sikur veprat tjera e madje edhe studimet, edhe dorëshkrimi *Studime për De Radën* mbyllet me *Bibliografinë e veprave të De Radës, konsultuar, shqyrtuar e përdorur nga autori në monografi*, e cila zgjeron interesimet e studiuesve për kërkime të reja në fushë të studimeve arbëreshe në përgjithësi dhe në fushë të studimeve deradiane në veçanti.

Në kërkim të sintezave të mëdha

Një vend të veçantë dhe të përhershme për arbëreshët e Italisë paraqesin kërkimet e tij sistematike dhe sistematizuese në vëllimet bibliografike¹⁵¹. Veprat dhe studimet e tij, tashti janë bërë literaturë e përhershme referimi edhe në rrethet shkencore të institucioneve arsimore, kërkimore e kulturore të arbëreshëve të Italisë.

Profesor Jup Kastrati në dhjetë vjetshin e fundit të jetës së tij, qe bërë anëtar i shumë institucioneve kulturore të arbëreshëve të Italisë. Ka lexuar kumtesa në sesione shkencore, në mbrëmje përkujtimore (jubilarë), konferenca albanologjike, kongrese gjuhësore, kuvende studimore dhe ka bërë gjurmime bibliotekare për tekstet e vjetra shqipe në Romë, Napoli, Torino, Firenze, Salerno, Leçe, Kalabri, etj.

Ai ishte anëtar shumë aktiv i veprimtarive të veçanta dhe të përhershme kulturore e shkencore, i organeve kulturore e shkencore që botohen atje, duke dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë etnokulturore e gjuhësore, zhvillimin e saj dhe çuarjen përpara të kulturës bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë. Ishte anëtar i redaksisë së revistës *Lidhja* (L'Unione), Kozencë (1991 - 1992) etj. Punimet shkencore të Prof. Jup Kastratit janë përfshirë në përmbledhje dhe në vëllime studimesh, të botuara nga Universiteti i Napolit, Universiteti i Kalabrisë, Universiteti i Salernos etj.

Profesor Jup Kastrati në arkivin e tij ka sistemuar një letërkëmbim shumë të pasur me arbëreshët dhe madje me studiuesit Italianë të kulturës shqiptare në përgjithësi dhe të kulturës arbëreshe në veçanti, sikur janë: Giuseppe Ferrari, Giuseppe Schiro Juniori, Carmel Candreva, Francesco Salono, Carmine de Padova, Antonio Bellusci, Giuseppe

¹⁵¹ **Bibliografi albanistike I** (Veprat e plota), nën përkujdesjen e Mr. Begzad Baliut. "Era", Prishtinë, 2001. Në këtë vëllim janë këto materiale për arbëreshët: *Bibliografi për Jeronim De Radën, 1903-1993 (42-86)*.

Bibliografi albanistike II (Veprat e plota). Në këtë vëllim janë këto materiale për arbëreshët: Bibliografi speciale për disa shkrimtarë dhe dijetarë: Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzeta), Pal M. Parrino (Paolo Maria Parrino), Nikollë Keta (Nicolò Cheta), Engjëll Mashi (Angelo Masci), Gjon Skirò (Giovanni Schirò), Vinçenc Dorsa (Vincenzo Dorsa), Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda), Nilo Borxha (Nilo Borgia), Gaetano Petrota (Gaetano Petrotta), Marko la Piana (Marco la Piana), Mateo Shambra (Matteo Sciambra), Françesk Solano (Francesco Solano), Nilo Katalano (Nilo Catalano), Francesco Maria da Lecce, etj.

Bibliografi albanistike III (Veprat e plota). Edhe në këtë vëllim janë botuar mjaft njësi bibliografike për arbëreshët, por jo si njësi të veçanta.

Gradilone, Francesco Altimari, Italo Costante Fortino, Giovanni Battista Pellegrini, Giuseppe Retelli, Mario Bolognesi, Andrea Bellucci, Vincenzo Belmonte, Ernesto Tocci, Giuseppe Camillo De Rada, Francesco De Belsi, Emanuel Giordano, Agosto Mauro, Michele Rizzo, Addolanta Landi¹⁵² etj.

Ndonëse i penguar për shkaqe jashtëshkencore dhe pa mundësi për të botuar në mënyrë të rregullt në organet shkencore dhe kulturore të arbëreshëve të Italisë, Jup Kastrati ka botuar disa dhjetëra artikuj shkencorë dhe kulturorë ndër revista e periodikë që dalin në Itali nga shoqata dhe institucione shkencore, të cilat merren me studimet arbëreshë¹⁵³, si dhe në institucione arsimore, kulturore e shkencore të studimeve albanologjike në Shqipëri e jashtë saj¹⁵⁴. Në Shqipëri ndërkaq, ai ka botuar dhe ribotuar disa vepra shkencore, të cilat i janë publikuar gjithashtu edhe në Kosovë, për t'u bërë ndër veprat më të referuara ndër studiuesit e kësaj ane.

Dhe jo vetëm kaq. Hulumtimet e tij kurrë nuk kanë pushuar ndër arkiva të Ballkanit, Europës dhe veçanërisht ndër arkivat e arbëreshëve të Italisë, ndërsa pena e tij

¹⁵² Shih arkivin personal të Profesor Jup Kastratit në Shkodër.

¹⁵³ Shih, *Albanistica novantasette* (Napoli), *Quaderni del Dipartimento di Linguistica. Letteratura 2* (Università della Calabria), *Nuovi orientamenti oggi* (Lecce), *Atti del Quinto Convegno Internazionale di Studi sulla lingua albanese* (Salerno), *Lidhja - L'Unionem*, (Cosenza), *Zjarri-Il fuoco*, (San Demetrio Corone, Calabria) etj.

¹⁵⁴ Në revistat shkencore: *Studime historike*, *Studime filologjike*, *Kultura popullore*(Tiranë), *Buletini shkencor* (Shkodër); Në të përkohshmen kulturore: *Shqipëria e Re*, në botimin shqip dhe në edicionet e huaja (frëngjisht, italisht, anglisht, gjermanisht, spanjisht, rusisht dhe arabisht): *L'Albanie Nouvelle*, *La Nuova Albania*, *New Albanis*, *Neues Albanien*, *Albania Nueva*, *Novaja Albanija*, *Elbanije Xheditedu*; Në botime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë: *Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike* (1977), dhe te botimi frëngjisht: *La Conference Nationale des Etude Ethnographiques* (1977), *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878 – 1881* (I, 1979), *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij* (1988) dhe te botimi frëngjisht: *Problemes de la formation du peuple, de sa langue et de sa culture* (1985), *Fjalor enciklopedik shqiptar* (1985), *Çështje të folklorit shqiptar*, I (1982), II (1986), III(1987), IV (1089); Në botime të ndryshme të Universitetit të Kalabrisë: *Quadern del Dipartimenti di Linguistica* (1986); të Institutit Universitar Oriental të Napolit: *Albanistica Novantasette* (1997); të Universitetit të Salernos: *Atti del Quinto Convegno Internazionale di Studi sulla lingua albanese*, Fisciano (1994); të Shoqërisë Kulturore të Leçes: *Nuovi Orientamenti Oggi* (1990); të Qendrës së Kërkimeve Shencore «Gjergj Kastrioti» të Kozencës: *Lidhja-L'Unione*, (1991, 1992); të Qendrës Kulturore të Shën Mitër Koronës: *Zjarri-Fuoco* (1992); të Universitetit të Prishtinës: *Filologji* (2000); të Art Club të Ulqinit, revista *Lemba*, etj.; Në ndonjë gazete tjetër si: *Drita* (Tiranë), *Rilindja* (Tiranë), *Universale* (Tiranë), *Kombi* (Tiranë), *Bashkimi* (Tiranë), *Zëri i popullit* (Tiranë), *Flaka e vëllazërimit* (Shkup),

kurrë nuk ka pushuar së shkruari studime të ndryshme dhe së bëri sinteza nga më të mëdhatë për autorët, veprat dhe rezultatet shkencore të tyre. Ai ka një varg veprash studimore në dorëshkrim, që në të vërtetë paraqesin të arriturat më të mëdha në fushë të studimeve arbëreshe në përgjithësi dhe në fushë të studimeve deradiane në veçanti, duke filluar me vëllimet:

*Veprat historiko - filologjike dhe publicistike të Jeronim de Radës*¹⁵⁵. Shkodër, 1999, 1.850 f. të daktilografuara, në tre versione: italisht, në të folmen e arbëreshëve (transkriptim) dhe në përshtatjen e gjuhës së sotme shqipe.

Jeronim de Rada, Skanderbuku i pafanë, në tri versione: italisht, arbërisht (transkriptim), përshtatje në gjuhën e sotme. Vepra hapet me një studim introduktiv problemor dhe me aparat shkencor, Shkodër, 1999, 1.240 f. të daktilografuara.

Për të përfunduar me korpusin e madh shkencor, që përtej studimeve historike, gjuhësore, letrare, kulturore e publicistike, paraqet veprën jetësore të Profesor Jup Kastratit për qytetërimin arbëresh¹⁵⁶.

Dielli (Boston, Mass), *Liria* (Boston, Mass) etj.

¹⁵⁵ Sipas një njoftimi të *Këshillit shkencor të ILPSh-së, për vitin 1977*, botuar në *Kronikën e Shkodrës*, veprën “Veprat historike dhe filologjike të Jeronim de Radës”, Profesor Jup Kastrati e kishte të përfunduar që në vitin 1977. (^{leta} *shkencore në Shkodër* (korrik 1978- qershor 1979), “BSH”, Shkodër, f. 185-186).

¹⁵⁶ Studime arbëreshe. Monografi. 1.725 faqe dorëshkrim. Përmbajtja botohet për herë të parë: Redaktorë: Diana J. Kastrati – Mr. Begzad Baliu. Recensues: Prof. Dr. Tomorr Osmani, Prof. Dr. Artan Haxhi. Rekomanduar për botim: Universiteti I Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Pasqyra e lëndës: Kushtim, (6), Parathënie, f. 9. Kreu I: Çështje të historisë së arbëreshëve të Italisë: Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizenit (1878 – 1881), f. 13; Shqiptarët në Leçe (shek. XV – XVII), f. 32; Seminari Arbëresh i Palermos (1734), f. 40; Kolegji Arbëresh I Sh. Adrianit (1736), f. 45; Dy kongrese gjuhësore për shqipen ndër arbëreshët e Italisë (1895, 1897), f. 63. Kreu II: Çështje të etnografisë së arbëreshëve të Italisë. Arbëreshët e Italisë për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë, f. 79; Argalia ndër arbëreshët e Italisë, f. 99. Kreu III: Çështje të folklorit të arbëreshëve të Italisë. Fondi i përbashkët i poezisë popullore arbëreshe dhe I ciklit të këngëve legjendare të kreshnikëve, f. 107; Folkloristika arbëreshe në shekullin XVIII dhe në gjysmën e parë të shekullit XIX, f. 172; Dr. Mikele Markiano dhe ndihmesa e tij në folklorin arbëresh, f. 182. Kreu IV: Çështje të gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë. Në shekullin XVII: Nilo Katalano (1637 – 1694), f. 249; Lëvizja mendore gjuhësore në mjedisin arbëresh të Italisë në shekullin XVIII, f. 271; Gjergj Guxeta (1682 – 1756), f. 274; Pal M. Parrino (1710 – 1765), f. 300; Nikollë Keta (1741 – 1803), f. 346; Studimet e arbëreshëve të Italisë për gjuhën shqipe në shekullin XIX; Engjëll Mashë (1758 – 1821); Mikel Skutari (1762 – 1830); Zef Krispi (1781 – 1859); Xhusepe Angelo Noçiti (1831 – 1899); Dr. Gjon Skiroi (1835); Jeronim de Rada (1814 – 1903); Dhimitër Kamarda (1822 – 1882); Vinçenc Dorsa

Kontributi i tij në studimet arbëreshe përfshinë vepra monografike për autorë, personalitete të mëdha historike, shkencore dhe kulturore, si: Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Nikollë Keta, Vinçenc Dorsa, Vinçenc Librandi, Nilo Borxha, Gaetano Petrota, Marko la Piana, Françesko Solano (1914 – 1999) etj., pjesa më e madhe e të cilave ende nuk janë botuar. Vetëm monografia e tij për De Radën ka dy versione të botuara e të ribotuara dhe dy vëllime në dorëshkrim, të cilat përbëjnë tërësinë e kontributeve të tij për jetën dhe veprën e këtij kryerilindësi shqiptar jo vetëm në Koloninë arbëreshe të Italisë, por edhe për rilindjen shqiptare në përgjithësi. Ndonëse në dorëshkrim, dhe të përfshira brenda vëllimit *Studime arbëreshe*, edhe studimet për këta autorë paraqesin monografi më vete, si për hulumtimin dhe studimin e plotë të veprës së tyre ashtu edhe për vëllimin në të cilin janë trajtuar, nga 120-450 faqe dorëshkrimi për autor.

Duke hapur *Parathënien*¹⁵⁷ e shkurtër për një vëllim kaq të madh studimesh, madje të pazakonshme në përvojën e studimeve kastratiane, autori kujtonte se fjala është për një vëllim me studimet më të mira të shkruara nga viti 1956 deri në vitin 2000. Në të vërtetë ato përfshijnë studime të fushave të ndryshme, të cilat fillojnë me gjuhën, letërsinë, kulturën, historinë, folklorin, etnografinë etj., disa prej të cilave tashmë janë lexuar në konferenca shkencore, janë botuar në vëllime shkencore, në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare¹⁵⁸.

(1823 – 1859); Vinçenc Librandi (1897); Ç.) Dijetarë e gjuhëtarë arbëreshë të shekullit XX: Nilo Borxha (1870- 1942); Gaetano Petrota (1882 – 1952); Marko la Piana (1883 – 1958); Mateo Shambra (1914 – 1967); Françesko Solano (1914 – 1999); Anton Belushi (1934 -); Emanuil Jordani (1963). Kreu V: Çështje të gjuhës së arbëreshëve të Italisë; Të dhënat e të folmeve të arbëresh të Italisë për historinë e gjuhës shqipe; Gjinia asnjane në të folmet arbëreshe të Kalabrisë të Italisë; Gjuha e shkruar shqipe ndër arbëreshët e Italisë pas Luftës së Dytë Botërore. Kreu VI: Çështje të letërsisë së arbëreshëve të Italisë; “Këngë të Milosaut”: Parathënie (1956); “Jeronim de Rada” (monografi): Përmbyllje (1962); “Rassegna di Studi Albanesi”: Recension (1964); “Fjamuri i Abërit” (Çështja kombëtare): Parathënie (1967); Personaliteti i de Radës: Ligjeratë (në Macchia Albanese, S. Demetrio Corone, 1981); “Poezia e de Radës”: oponentë (1981); “Autobiografia” e De Radës: Parathënie (2001); Jeronim de Rada te “Fjalor Enciklopedik Shqiptar” (2001). Kreu VII. Publicistikë: Ndër arbëreshët e Italisë (Pështypje udhëtimi, 1981); Në Leçe të Italisë (artikull, 1991).

¹⁵⁷ Shkodër, më 15 shtator 2001.

¹⁵⁸ “Studime historike”, Studime filologjike”, “Kultura popullore”, “Buletin shkencor”, “Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike” (1977), dhe te botimi frengjisht: “La Conference Nationale des Etude Ethnographiques” (1977), “Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, 1878 – 1881 (I, 1979), “Konferenca Kombëtare për Formimin e Popullit Shqiptar, të Gjuhës dhe të Kulturës së Tij” (1988) dhe te botimi frengjisht: “Problemes de la formation du people, de sa

E shikuar nga një kënd tjetër, nga këndi i fushave të studimit, *Studimet arbëreshe* të Profesor Jup Kastratit trajtojnë tema:

- nga historia: reflektime dhe angazhime mbi Lidhjen e Prizrenit, Kongresin e Berlinit, Çështjen e pavarësisë së Shqipërisë etj.;

- nga historia e kulturës dhe letërsia: letërsi e vjetër, letërsi e rilindjes dhe përkimet e saj me letërsinë evropiane, letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX dhe letërsia bashkëkohore;

- nga folklori dhe etnologjia: autorë dhe vepra, si Markiano, De Rada, Antonio Belushi, Folklor arbëreshe dhe trashëgimia e saj etj.;

- nga gjuhësia dhe shkollat e fushat e studimit të saj (filologji -linguistikë-albanologji): historia e albanologjisë, filologjisë dhe linguistikës, dialektologjisë, gramatologjisë, sintaksologjisë, leksikologjisë e leksikografisë, morfologjisë, fonetikës dhe fonologjisë, ortografisë, transliterimit e transkriptimit, përkthimit e kulturës së leximit, kritikës gjuhësore, polemikës e letërkëmbimit;

- nga bibliografia e autorëve dhe për autorët: bibliografia e gjuhësisë, letërsisë, folklorit dhe publicistikës. Bibliografi të veçanta madje ka përgatitur për Gjergj Guxetën, për Pal M. Parrinon, për Nikollë Ketën, për Engjëll Mashin, për Gjon Skiroin, për Vinçens Dorsën, për Dhimitër Kamardën, për Nilo Borxhan, për Gaetano Petrotan, për Mark la Pianen, për Mateo Shambren; për Françesk Solanon, për Nilo Catalanon, për Francesco Maria da Lecce-n, etj.

Ka trajtuar në këtë vepër me një skrupulozitet të shumanshëm çështje të historisë së arbëreshëve të Italisë, rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878 – 1881), historinë e vendosjes dhe të jetesës së arbëreshëve në Leçe (shek. XV – XVII), historinë e themelimit dhe të punës së Seminarit Arbëresh të Palermos (1734) dhe Kolegjit Arbëresh të Shën Adrianit (1736), vijimësi e të cilëve në jetën nacionale, arsimore, kulturore e shkencore janë edhe dy kongrese gjuhësore për gjuhën arbërore ndër arbëreshët e Italisë (1895, 1897). Brenda një kaptine të veçantë autori

langue et de sa culture” (1985), “Fjalor Enciklopedik Shqiptar” (1985), “Çështje të folklorit shqiptar”, I (1982), II (1986), III(1987), IV (1089), “Quadern del Dipartimento di Linguistica” (1986); të Institutit Universitar Oriental të Napolit: “Albanistica Novantasette” (1997); të Universitetit të Salernos: “Atti del Quinto Convegno Internazionale di Studi sulla lingua albanese”, Fisciano (1994); të Shoqërisë Kulturore të Leçes: “Nuovi Orientamenti Oggi” (1990); të Qendrës së Kërkimeve Shencore “Gjergj Kastrioti” të Kozencës: “Lidhja” (L’Unione, 1991, 1992); të Qendrës Kulturore të Shën Mitër Koronës: “Zjarri” (Il Fuoco, 1992); të Universitetit të Prishtinës: “Filologji” (2000); të Art Club të Ulqinit, revista “Lemba”, revistat “Drita” (Tiranë), “Rilindja” (Tiranë), “Universale” (Tiranë), “Kombi” (Tiranë), “Bashkimi” (Tiranë), “Zëri I popullit” (Tiranë), “Flaka e vëllazërimit” (Shkup), “Dielli” (Boston, Mass), “Liria” (Boston, Mass), etj.

trajton çështje të etnografisë së arbëreshëve të Italisë. Fjala është për kontributin e arbëreshëve të Italisë për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar. Me po kaq përkushtim dhe thellësi autori hulumton dhe trajton çështje të folklorit të arbëreshëve të Italisë. Brenda këtij problemi hyjnë studimet që trajtojnë fondin e përbashkët të poezisë popullore arbëreshe dhe të ciklit të këngëve legjendare të kreshnikëve, folkloristikën arbëreshe të shekullit XVIII dhe të gjysmës së parë të shekullit XIX, si dhe ndihmesën e dr. Mikele Markianoit dhënë folklorit arbëresh.

Nëse trajtimi i historisë, etnografisë dhe folklorit të arbëreshëve të Italisë nga Profesor Jup Kastrati ka qenë pjesë e përkushtimit të tij për *Studimet arbëreshe* trajtimi i *çështjeve të gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë në shekullin XVII*, ka edhe shumë arsye të tjera. Historia e albanologjisë ka qenë dhe mbetet një prej fushave në të cilën është angazhuar shumë Profesor Jup Kastrati, ndërsa gjuha e arbëreshëve të Italisë ishte dhe është një prej vlerave të mëdha gjuhësore, kulturore dhe shkencore, pa studimin e të cilës nuk mund të arrihen rezultate të rëndësishme shkencore në fushë të albanologjisë. Në këtë fushë ai me përkushtim ka trajtuar periudha, autorë dhe vepra të rëndësishme shkencore, si: Nilo Katalano (1637 – 1694), Lëvizja mendore gjuhësore në mjedisin arbëresh të Italisë në shekullin XVIII, Gjergj Guxeta (1682 – 1756), Pal M. Parrino (1710 – 1765), Nikollë Keta (1741 – 1803).

Përtej një interesimi të Profesor Jup Kastratit për gjuhën e arbëreshëve të Italisë, si lëndë për studime krahasuese në fushë të dialektologjisë, leksikografisë e gramatologjisë etj., përkushtimi i tij do të lidhet me gjuhësinë si dije nacionale, e cila si askund ndër shqiptarët, tek arbëreshët e Italisë sillte përvojën e shkollës evropiane të kohës. Fjala është për studimet dhe studiuesit e arbëreshëve të Italisë të shekullit XIX: Engjëll Mashii (1758 – 1821), Mikel Skutari (1762 – 1830), Zef Krispi (1781 – 1859), Xhusepe Angelo Noçiti (1831 – 1899), Dr. Gjon Skiroi (1835), Jeronim De Rada (1814 – 1903), Dhimitër Kamarda (1822 – 1882), Vinçenc Dorsa (1823 – 1859), Vinçenc Librandi (1897); po edhe për dijetarë e gjuhëtarë arbëreshë të shekullit XX, disa prej të cilëve edhe sot vazhdojnë të hulumtojnë, trajtojnë dhe çojnë përpara përvojën shekullore të shkollës së arbëreshëve të Italisë në fushë të gjuhësisë: Nilo Borxha (1870- 1942), Gaetano Petrotta (1882 – 1952), Marko la Piana (1883 – 1958), Mateo Shambra (1914 – 1967), Françesko Solano (1914 – 1999), Anton Belushi (1934 -); Emanuil Jordani (1963).

Prej veprave gjuhësore kryesisht të karakterit filologjik e etnografik të brezit të parë dhe të dytë dhe prej veprave gjuhësore kryesisht të karakterit gjuhësor e lingvistik të brezit që sot vazhdon të merret me studimet albanologjike ndër arbëreshët e Italisë, Profesor Jup Kastrati jo vetëm e ka plotësuar veprën e tij me rezultate të reja, por në gjuhësinë shqiptare ka sjellë rezultate të reja, të cilat gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, përgjithësisht ia kemi atribuar gjuhësisë dhe studiuesve austro-gjerman. Kur një ditë të jetë botuar vepra e plotë e Profesor Jup Kastratit, përkatësisht sintezat e tij për

historinë e albanologjisë ndër arbëreshët e Italisë, në mjaft pika mendimi për shkollat, konceptet shkencore, domenet dhe nocionet e studimit të albanologjisë, si dhe tezat, sikur është ajo e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe, do të ndryshojë në interes të dijes shqiptare.

Njohësit e jetës dhe veprës së Profesor Jup Kastrati e dinë se si formim arsimor ai ishte dialektolog, prandaj është e kuptueshme pse përkushtimi i tij për dialektologjinë në përgjithësi dhe për të folmen veriore në veçanti, ishte plotësuar edhe me të dhënat për të folmet e arbëreshëve të Italisë, strukturën gramatikore të saj, disa veçanti morfologjike, gjendjen e sotme të shkrimit të saj etj.

Nëse me probleme të historisë, etnografisë e etnologjisë, folklorit e traditës përgjithësisht kulturore të arbëreshëve të Italisë Jup Kastrati merrej për të plotësuar korpusin e tij të madh të studimeve arbëreshe, me gjuhësinë dhe me letërsinë ai merrej për të ngritur dy nga majat më të larta të studimeve të tij: *Historinë e letërsisë shqiptare* dhe *Historinë e albanologjisë*. Në një rreth më të ngushtë, do të mund të shikohej edhe interesimi i tij për letërsinë e arbëreshëve të Italisë. Nëse interesimi i tij në *Studimet arbëreshe* lidhet sa me historinë, dijen si kulturë, gjuhën, folklorin, etnografinë etj., për të plotësuar sa njërën periudhë sa tjetrën dhe sa njërin autor sa tjetrin, interesimi i tij për letërsinë është i lidhur para se gjithash me përkushtimin dhe dimensionet e shumanshme të tij për Jeronim De Radën (Jeronim de Rada. *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, 2001), për jetën e tij, (*Jeronim de Rada* (monografi). Përmbyllje, 1962; *Autobiografia e de Radës*. Parathënie, 2001), për veprën artistike dhe letrare të tij (*Këngë të Milosaut*. Parathënie, 1956); për veprën diturake të tij (*Rassegna di Studi Albanesi*. Recension, 1964); për publicistikën e tij *Fjamuri i Abërit*, Parathënie, 1967) etj. I prirë për të parë nga shumë drejtime të kaluarën dhe të sotmen e arbëreshëve të Italisë, Profesor Jup Kastrati, më në fund do të shkruajë edhe oponenten (*Poezia e De Radës*: oponentë për Klara Kodrën (1981), përshtypje udhëtimi, reportazhe etj.

Pra, vepra e tij madhore, nga më të mëdhatë deri më tash në studimet arbëreshe këtej deti, kap një fushë të gjerë studimore, si: çështje të historisë së arbëreshëve të Italisë, çështje të etnografisë së arbëreshëve të Italisë, çështje të folklorit të arbëreshëve të Italisë, çështje të gjuhësisë dhe të gjuhës së arbëreshëve të Italisë, çështje të letërsisë së arbëreshëve të Italisë dhe çështje të publicistikës së arbëreshëve të Italisë.

Dhimitër Kamarda një nismë e pakurorëzuar e sintezave të mëdha shkencore

Nga fundi i jetë së tij, më 18 nëntor 2000 Profesor Jup Kastrati më shkruante nga Shkodra: “Monografinë “Dhimitër Kamarda 1821-1882 (jeta, veprat, idetë, roli i tij në lëvizjen mendore shqiptare të viteve 1864-1882, rëndësia dhe vendi i tij tejet e madhe në gjuhësinë shqiptare dhe në kulturën kombëtare, veprimtaria albanologjike e kohës)”, e kam projektuar për ta përfshirë në vëllimin e dytë të traktatit “Historia e albanologjisë”,

që përmban periudhën shkencore të studimit të gjuhës shqipe, që nga Franz Bopp (Berlin, maj 1854) e deri vdekjen e Norbert Jokl-it (Vjenë, maj 1939). Deri më sot (18 nëntor 2000) kam shkruar 300 (treqind) faqe të daktilografuara. Kaq vend do t'i jap Kamardes në këtë monografi. Por unë do të vazhdoj punën për viganin e gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë. Pasi të përfundoj së botuari vëllimin e katërt të veprës në fjalë (që përmban vetëm aparatën shkencor), unë do të vazhdoj punën për hartimin e monografisë shteruese: “Dhimitër Kamarda (1821-1882)¹⁵⁹”.

Pak vite më parë ndërkaq kishte përfunduar serinë e sintezave të gjëra për të gjithë gjuhëtarët më të rëndësishëm arbëresh, si kapituj të veçantë të “Historisë së albanologjisë”, por që zinin vend të merituar me studime përgjithësuese në projektin jetësor “Studimeve arbëreshe”, dhe përtej tyre mund të botoheshin edhe si monografi më vete. Në mesin e tyre ai shquante studimin e tij për Nikollë Ketën¹⁶⁰, nga dorëshkrimi i të

¹⁵⁹ Profesor Jup Kastrati, letër nga Shkodra, më 18 nëntor 2000, f. 5

¹⁶⁰ Përmbajtja e tij botohet për here të pare: *Nikollë Keta (31. 7. 1741 – 15. 11. 1803)*. Çështjet: I. Vendlindja: Contessa Entellina (Kundisa). Personaliteti. – Konsiderata përgjithësuese për Nikollë Ketën të shprehura nga Xhuzepe Spata (1869), Rozolino Petrota (1941, 1943), Eqrem Çabej (1968), Dhimitër S. Shuteriqi (1975, 1979), Ali Xhiku (1983), Mahir Domi (1986), Xhuzepe Skiro-i Riu (1988), Nikollë Keta – i Riu, stërnip i dijetarit me të njëjtin emër (1904), Kolë Kamsi (1912, 1943).

II. Literatura burimore dhe dorëshkrimet e Nikollë Ketës. – Mendime dhe opinione shprehur e botuar për këtë shkrimtar nga dijetarët: Xhuzepe (Zef) Krispi (1831), Nikollë Kamarda (1839), Spiridon Lo Jacono (1851), Dhimitër Kamarda (1864), Dora d'Istria (1867), Xhuzepe (Zef) Spata (1868), Alberto Stratiko' (1896), At. Mandala' (1902), Atanaz Skiro' (1902), Nikollë Keta – i Riu (1904), Giuseppe La Mantia (1904), Onofrio Buccola (1909), Kolë Kamsi (=Komneni, 1912), Antonio Skura (1912), Petro Skaljone (1921), Aleksandër Skiro' (1923), Zef Skiro' – Plaku (1923), Gaetano Petrota (1931, 1950), Rozolino Petrota (1939, 1941, 1943), Ziaudin Kodra (1959).

III. Xhuzepe (Zef) Skiro' – i Riu për Nikollë Ketën (1959, 1966, 1967, 1968, 1969, 1970, 1983, 1988, 1992).

IV. Disa studiues për Nikollë Ketën në vitet '60 – '70: Mateo Shambra (1963, 1964, 1965), Maria Colletti (1964), Gerhardt Rohlf (1967), Gjovalin Shkurtaç (1973, 1984), Eqrem Çabej (1974, 1975), Ali Dhrimo – Emil Lafa (1974), Calogera Raviotta (1978), Ali Xhiku (1983), Jup Kastrati (1983), Mahir Domi (1986), Engjëll Sedaj (1987), Francesco Giunta (1989), Hasan Hasani (1995), Xhuzepe Gradilone (1992), Ettore Paratore (1992), Paolo Di Giovine (1992), Luca Serianni (1992), Italo Kostante Fortino (1992), Elio Miracco (1992), Patrizia Figlia (1999).

V. Giuseppe Tommaso Gangale për kulturën arbëreshe dhe Nikollë Ketën: (1962, 1963, 1964, 1970, 1972, 1977, 1979); Titos P. Jochalas për Nikollë Ketën (1985); Dhimitër S. Shuteriqi për Nikollë Ketën (1965, 1975, 1976); Gunnar Svane për Nikollë Ketën (1985, 1986); Xhuzepe Spata për veprën e Nikollë Ketës: “Thesar njoftimesh mbi maqedonasit”; Veprat shkencore dhe letrare të Nikollë Ketës;

cilit nuk kishte botuar madje as edhe një fragment, . Po këtu mund të shqueshin edhe monografitë për albanologë të shquar arbëresh, sikur janë Pal Parrini e të tjerë. Dorëshkrim i pabotuar. Varianti i zgjeruar. Nga 140 faqe që ka teksti, janë botuar vetëm 20 faqe në: *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XIX ndër arbëreshët e Italisë*¹⁶¹, me shkruante mjeshtri im. Me këtë mënyrë dhe me këtë elan te pafundmë pune, bibliografia e botimeve shkencore të Prof. Jup Kastratit për kulturën kombëtare shqiptare të arbëreshëve të Italisë, vetëm për një periudhë 45-vjeçare (1953 – 2002), kap 236 zëra, si edhe shënimeve bibliografike për të.

Në vend të përfundimit: vlerësimet e Çabejt, Justin Rrotës dhe të botës arbëreshe

Në Arkivin e letërkëmbimit të pasur të tij me gjithë albanologët e kohës në Shqipëri dhe në botë, gjejmë edhe një dosje posaçërisht të vëllimshme, në të cilën është ruajtur letërkëmbimi me mikun e tij të jetës Profesor Eqrem Çabejn. Të sistemuara me kujdes sipas kohës së dërgimit, në të cilën ka jo vetëm letra përshëndetëse e kartolina urimesh për ndërrim motesh, po edhe diskutime, përshkrime, fragmente studimesh në dorëshkrim etj. Që në letrën e trembëdhjetë gjejmë të bashkangjitur me një letër që ka karakter personal edhe një dorëshkrim të Profesor Eqrem Çabejt, që në të vërtetë është recension/rekomandim për një dorëshkrim për botimin e veprave të zgjedhura të Jeronim de Radës¹⁶². Fjala është për veprat 1. *Këngët e Milosaut*, 2. *Një pasqyrë e jetës njerëzore*

Jetëshkrimi i Nikollë Ketës; Përmyllje. Rëndësia e Nikollë Spatës; Bibliografi speciale për Nikollë Ketën. Dorëshkrim i pabotuar. Shkodër, tetor 1997 – prill 1998.

¹⁶¹ **VINÇENC DORSA** (26 shkurt 1823 – 3 dhjetor 1885). Çështjet: - Hyrje; Personaliteti shkencor e letrar; Burimet bio-bibliografike; Jetëshkrimi; Veprat e botuara dhe dorëshkrimet; Formimi kulturor. Analiza e veprave: Letra romane (1845/1846); Mbi shqiptarët, gjurmime dhe mendime (1847); Studime etimologjike të gjuhës shqipe në përfaqje me latinishten e greqishten (1862); Ungjilli i Shën Mateut, përkthyer shqip prej greqishtes në të folmen arbëreshe të Frasnitës (1869); Elozh për Anton Serrën, shkrimtari i parë i politikës ekonomike (1870); Traditat greko-latine ndër dialektet e Kalabrisë Jugore (1876); Traditat greko-latine ndër doket e besimet popullore të Kalabrisë Jugore (1879, 1884). Artikuj të botuar tek e përkohëshmjia „Il Calabrese“; Folkloristi; Esteti dhe historiani i letërsisë shqiptare; Letërkëmbimi me Jeronim de Radën; Përmyllje; Bibliografi speciale mbi Vinçenc Dorsën. Vinçenc Dorsa, “Buletin shkencor“. ILP. Viti XXII, nr. 2 (38), fq. 21 – 40, Shkodër, Shkodër, 1985; Ribotuar te: Histori e gjuhësisë shqiptare. Pjesa e parë (1497 – 1944). ILP. Shkodër, 1989, fq. 128 – 153: Vinçenc Dorsa. (Dispensë)

¹⁶² Eqrem Çabej, *VEPRAT E G. DE RADES*. Transkribuar, kthyer në gjuhën e sotme të Shqipërisë e pjesërisht komentuar prej prof. dr. Jup Kastratit, Tiranë, më 12 prill 1953, 17 faqe të daktilografuara dhe të plotësuara në ndonjë rast me dorë.

(*Serafina Topia*), 3. *Skanderbekku i pa-faan*, 4. *Poezi shqipe*, 5. *Odiseu*, 6. *Rapsodi shqiptare dhe* 7. *Gramatika shqipe e Zef de Radës*, një pjesë e të cilave ishin të plotë, disa fragmentare dhe disa të tjera vetëm analiza.

Në dorëshkrimin e Profesor Çabejt, pas pjesës përshkuese për veprat e Jeronim de Radës, të planifikuara nga Profesor Jup Kastrati për botim, janë dhënë gjerësisht edhe gjykimet e përgjithshme, vërejtjet e veçanta me karakter parimor, vërejtjet rreth transkriptimit, vërejtjet për konsonantat, për përkthimin (parafrazën) e *Milosaut*, si dhe shënime rreth vërejtjeve (komenteve) të veprës *Milosaut*.

Këtë recension Profesor Çabejt e fillon: “M’u dhanë nga Instituti i Shkencave për shqyrtim këto vepra të De Radës përgatitur për botim nga ana e Prof. J. Kastratit, thuhet në fillim të recensionit të Profesor Eqrem Çabejt, për të vazhduar më tej¹⁶³:

1. *Këngët e Milosaut*, botim i parë:

- a) Parathënie
- b) Shënime mbi alfabetin e de Radës
- c) teksti origjinal (transkribimi)
- d) përshtatje në gjuhën e sotme me bazë dialektin toskërisht
- e) Shënime e komentime (vetëm I-XVI këngë)
- f) botimi i dytë. Vetëm transkribimi bashkë me përkthimin italisht prej vetë poetit.

2. *Një pasqyrë e jetës njerëzore (Serafina Topia)*:

- a) analiza e veprës (shkon vetëm gjer në f.14)
- b) teksti origjinal (transkribimi)
- c) përshtatje në të folmen e sotme
- d) shënime gjuhësore (3 ½ faqe)

3. *Skanderbekku i pa-faan*, vol. V, libri IV, historia IV:

- a) teksti origjinal (transkribimi)
- b) përshtatje në të folmen e sotme
- c) shënime gjuhësore

4. *Poezi shqipe*, 5 histori: Teksti origjinal. Vetëm transkribimi bashkë me

¹⁶³ Në studimin tonë, vërejtjet e përgjithshme po jap në mënyrë integrale brenda tekstit tonë (ndërhyrjet me laps në fusnotë) ndërsa vazhdimin e tekstit, për vërejtjet e veçanta gjuhësore, po në formë integrale do t’i jap në shtojcë.

përkthimin italisht të de Radës vetë.

5. *Odiseu, (3 faqe)*

6. *Rapsodi shqiptare*. Jepet një “analizë e veprës” që s’është tjetër veçse përkthimi i së dy prathënievet italisht.

7. *Gramatika shqipe e Zef de Radës*. Analiza e veprës, d.m.th. një përmbledhje e përmbajtjes së kësaj.

Gjykimi i përgjithshëm. Si shqyrtoam këtë punë nga kreu e gjer në fund, në përfundim të analizës që i bëmë kemi arritur në këtë gjykim të përgjithshëm:

Nuk është zbatuar sa duhet një metodë rigorozë filologjike kombinuar me kriterin literat, metodë që na duket e domosdoshme në punime të këtij lloji. Në mënyrë të veçantë do të kërkohej një zotërim më i plotë i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë. Veçse do thënë se të dyja këto janë punë të vështira, aq më shumë kur nuk kemi një studim rreth dialekteve të asaj treve.

Këto të meta kundërpeshohen më anën tjetër nga një vullnet i mirë, një dashuri për temën, nga përpjekja për të zotëruar lëndën dhe nga një kujdes i madh që tregohet në këtë punë.

Në këtë mënyrë është kryer një punë pozitive, që meriton të çmohet. Një meritë e veçantë është gatitja e këtyre teksteve për një rreth më të gjerë lexuesish, sidomos për shkolla.

Vërejtje të veçanta me karakter parimor

a) Për sa i përket përkthimit në shqipen tonë, ky që të dalë sa më mirë duhet të arrijë këto cilësi: të jetë poetik që të ruaj kështu frymën e poetit, po me anë tjetër të ruaj edhe ritmin e veçantë të poezisë së de Radës, më anë tjetër të kuptohet prej publikut të Shqipërisë, për të cilin destinohet gjithë kjo punë. Të jetë pra përkthimi dhe i kuptueshëm dhe i hieshëm, pa humbur nga bukuria poetike e origjinalit.

b) Sa kohë që përkthimi është bërë në toskërishten e sotme, të ruhen karakteristikat e këtij dialekti: si në fonetikë, si në ritëm, si dhe në fjalor.

c) Dihet se de Rada ka një fjalor të vetin, fjalë, të cilat na duket se s’kanë nevojë për shpjegim; përkundrazi ndonjë fjalë është rrezik të mos kuptohet, me gjithë se kemi përkthimin, p.sh. *kallëzoret* të Milosaoja. Po ajo që bie në sy këtu është sidomos fakti që shënime të gjuhësore janë përsëritur, shpesh dhe më së një herë, shpjegimet e fjalëve të vështira. Kështu p.sh. shpjegimi i fjalëve *gjellë, ruan, nëng, kopilje, ljinat, gardhi, garé, kurmi, i galjthër, u pruar*. Për t’i evituar këto përsëritje të mërzitshme thom se do menduar se mos nuk është më mirë të mblidhen këto fjalë në një glosar të vogël, i cili do të shërbente kështu për të gjitha rasat kur ndeshin në këto fjalë. E në shënime të shtjelloheshin të tjera sende.

d) Posaçërisht për *Milosaon* botuesi ka gatitur një botim të bazuar në edicionin e parë. Në edicionin e dytë de Rada sikundër dihet, ka shtuar disa këngë të reja. Prandaj si Gualtieri, si Resuli i kanë pasur parasysh që të dyja botimet. Le të shihet a mos nuk është mirë të shtohen në këtë botimin shqip edhe këto këngët e edicionit të dytë, të paktën si shtesë në fund.

dhe) Për mënyrën e Transkribimit sh. më poshtë. Këtu vetëm do të shënojmë se trajtesat e gabuara në tekstin e de Radës është më mirë të mos riprodhohen në këtë formën e gabuar si bie fj. *botta* për *bora* te kënga e I-e Milosaut, *Shugjeza*, për *shëngjeta* të XVII, po të vihet në tekst trajta e drejtë dhe gabimi të shënohet në shënimet.

e) Nga vërejtjet që kemi bërë rreth Milosaos dhe Serafina Topisë mund të shihet se si mendojmë ne për përkthimin e për shënimet edhe përsa u përket veprave së tjera të de Radës. Kështu po ato vërejtje themi se mund të hyjnë në punë dhe për këto vepra”.

E sollëm këtë fakt për arsye se del për herë të parë një dëshmi e Profesor Eqrem Çabejt për angazhimin e Profesor Jup Kastratit për të botuar veprën e Jeronim Deradës, të cilën nuk arriti ta botonte për të gjallë të tij, si dhe për të sjellë këtu dy aspekte të përpjekjeve të Jup Kastratit në fushë të veprimtarisë botuese: përpjekjen për botimin e veprës së tij dhe më parë se botimin e veprës së plotë të tij, botimin e plotë të trashëgimisë së albanologjisë në përgjithësi dhe trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të arbëreshëve në veçanti.

Mirëpo, siç dihet, në këtë kohë botohet vetëm vëllimi *Këngët e Milosaut*¹⁶⁴, ndërsa vepra më e plotë e Jeronim de Radës botohet vetëm në vitin 1987¹⁶⁵.

¹⁶⁴ *Jeronim de Rada, Poezi shqipe të shekullit XV. Këngë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës*. Translimeruar, përshtatur në gjuhën e sotme dhe komentuar. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve. Shtypur në Stabilimentin «Mihal Duri». Tiranë, 1956, 204 f. dhe ribotohet dhjetë vjet më vonë në Prishtinë më 1965 e më tej: *Jeronim de Rada, Këngë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës. Poezi shqipe të shekullit XV*. Translimeruar, përshtatur në gjuhën e sotme shqipe dhe komentuar. Enti i botimeve të teksteve. Shtypshkronja e Ndërmarrjes gazetare botuese «Rilindja». Prishtinë, 1965.

¹⁶⁵ Jeronim de Rada, *Vepra letrare*. Tre vëllime: Vol. I, 407 f.; vol. II, 403 f. Vol. III, 400 f. Gjithsejt: 1.210 f.. Shtëpia Botuese «Naim Frashëri». Tiranë, 1987: *Krijimtaria e Jeronim de Radës*. (Në serinë) Jeronim de Rada, *Vepra letrare*, vol. I, f. 3 - 62. Shtëpia Botuese «Naim Frashëri». Tiranë, 1987; *Jeronim de Rada, Skandërbeku i pafanë*. Histori të shekullit XV. Përshtatur në gjuhën e sotme nga Jup Kastrati. (Në serinë) Jeronim de Rada, *Vepra letrare*, vol. II, f. 3 - 377. Shtëpia Botuese «Naim Frashëri». Tiranë, 1987. (Përshtatje nga arbërishtja në gjuhën e sotme letrare shqipe, rreth dhjetë mijë vargje); *Jeronim de Rada, Vepra letrare 3*. SHB «Naim Frashëri». Tiranë, 1987; *Jeronim de Rada, Vepra, vëll. 6. Skandërbeku i pafanë*. Histori të shekullit XV. Përshtatur në gjuhën e sotme shqipe nga Jup Kastrati. Redaksia e botimeve «Rilindja», Prishtinë, 1988. 420 f. (Rreth 10.000 vargje); *Jeronim de Rada, Vepra. Vëll. 7*. Redaksia e botimeve, «Rilindja», Prishtinë, 1988. 391 f. (Në këtë volum gjenden këto

Dhe meqenëse për të gjallë të tij nuk arriti ta botonte as veprën shkencore të tij as atë pjesë të trashëgimisë letrare kombëtare, për të cilën kishte punuar një jetë të tij, sot mund të thuhet se e para si dhe e dyta sot janë testament i përbashkët i atij monumenti që i ka lënë këtij brezi.

Arsyeja për të sjellë pjesën hyrëse të recensionit të Profesor Çabejt, ka të bëjë edhe me një diskutim që është bërë viteve të fundit lidhur me botimin e letërsisë arbëreshe në Tiranë dhe në Prishtinë¹⁶⁶, që as në përmasën e studimit kritik as në kontekst të kërkimeve, nuk solli ndonjë kontribut të ri në studimet arbëreshe. Përkundrazi, vlerësimi i plotë për kontributin e Profesor Jup Kastratit në mbledhjen, botimin, sistemimin dhe studimin e trashëgimisë materiale dhe shpirtërore arbëreshe, nënkupton njohjen dhe botimin e disa dhjetëra recensioneve, studimeve dhe vlerësimeve të bashkëkohësve të tij, të botuara në shtypin ditor dhe atë shkencor apo të lëna në dorëshkrim.

Studime¹⁶⁷, recensione në dorëshkrim dhe të botuara janë shkruar për të gjitha botimet, duke përfshirë këtu edhe ato që Profesor Kastrati i kishte në dorëshkrim, si dhe për studime të veçanta¹⁶⁸ kushtuar personaliteteve apo temave të veçanta arbëreshe:

punime të Jup Kastratit).

¹⁶⁶ Këtij diskutimi i priu libri i Anton Nikë Berishës, *Gjymtime dhe shëmtime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, botoi “Shpresa”, Prishtinë, 2001.

¹⁶⁷ Shih, Seit Sokoli, *Dr. Jup Kastrati – studiues i kulturës arbëreshe dhe deradian i pasionuar*, (Përmbledhje) e lexuar në Sesionin shkencor “50-vjetori i veprimtarisë shkencore të dr. Jup Kastratit, Shkodër, 1991; Mira Sykja, *Studimet bibliografike të dr. Jup Kastratit* (Përmbledhje) e lexuar në Sesionin shkencor “50-vjetori i veprimtarisë shkencore të dr. Jup Kastratit, Shkodër, 1991; Begzad Baliu, *Vepra bibliografike e Jup Kastratit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005; Myrvete Dreshaj Baliu, *Konteksti i shkrimit*, “Era”, Prishtinë, 2004, etj.

¹⁶⁸ Shih, Nuri Gokaj, Recension për studimin e Jup Kastratit “De Rada dhe Kamarda”, për redaksinë e “Buletinshkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 1. 3. 1990, një faqe makine; Safet Hoxha, Recension për studimin e Jup Kastratit “De Rada dhe Kamarda”, për redaksinë e “Buletinshkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 19. 2. 1990, një faqe makine; Klara Kodra, *Recension për parathënien e Jup Kastratit “Krijimtaria e Jeronim De Radës”*, dorëshkrim në 12 faqe, Tiranë, 10 qershor 1984; &, *Recension për parathënin e Jup Kastratit “Krijimtaria e Jeronim De Radës”*, dorëshkrim në dy faqe, Tiranë, më 10 qershor 1984; &, *Recension Recension për studimin introduktiv “Krijimtaria e Jeronim De Radës”*, dorëshkrim në tri faqe, Tiranë, më 15. 8. 1985; Tomor Osmani, *Recension për studimin e Jup Kastratit “Gjuha e De Radës”*, për redaksinë e “Buletinshkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 28 maj 1990, dy faqe makine; & *Recension për studimin e Jup Kastratit “Mikel Skutari (1762-1830)”*, për redaksinë e “Buletinshkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 5. 7. 1989, një faqe makine; Simon Pepa, *Diskutim për librin “Jeronim de Rada”*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 4 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; &, Safet Hoxha, *Recension për studimin e*

Këngët e Milosaos (1956), monografinë e parë: *Jeronim de Rada - jeta dhe vepra* (1962), *Skënderbeu i pafan (...)*¹⁶⁹; *Autobiografinë* (1973/2003)¹⁷⁰ dhe në mënyrë të veçantë për monografinë *Jeronim de Rada – jeta dhe vepra* (1979)¹⁷¹. Për veprën

Jup Kastratit “Gjuha e Jeronim De Radës”, për redaksinë e “Buletin shkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 5. 4. 1990, një faqe makine; &, *Recension për studimin e Jup Kastratit “Gjuha e De Radës”*, për redaksinë e “Buletin shkencor” të Shkodrës, Shkodër, më 5 prill 1990, një faqe makine; Andrea Varfi, *Recension për studimin introduktiv “Krijimtaria e Jeronim De Radës”*, dorëshkrim në tri faqe, Tiranë, më 20 shtator 1985 etj.

¹⁶⁹ Shih, Andrea Varfi, *Recension për Skanderbeku i pafan*, tekst original në dialektin arbëresh të Jup Kastratit, dorëshkrim në tri faqe, Tiranë, 5 nëntor 1985 etj.

¹⁷⁰ Shih, Vehbi Bala, *Parathënie*, për librin e Jeronim de Radës, *Autobiografia*, (Përktheu Jup Kastrati), dorëshkrim, Shkodër, 10 shkurt 1973; Luigj Franja, *Recension për librin Jeronim de Rada*, *Autobiografia* (Përkthyer nga Jup Kastrati), dorëshkrim, Shkodër, më 8 tetor 1979;

¹⁷¹ Shih, Vehbi Bala, *Kontribut për studimin e jetës dhe veprimtarisë së Jeronim de Radës*. Mbi monografinë “Jeronim de Rada”, “Nëntori”, nr. 8, f. 46-53, Tiranë, gusht 1980; Safet Hoxha, *Recension për librin e Jup Kastratit*, “Jeronim de Rada” (Jeta dhe vepra), Tiranë, 1979, në “Buletin shkencor”, nr. 2/1979, Shkodër; Vili Kamsi, *Diskutim për veprën “Jeronim de Rada”*, dorëshkrim pa datë dhe vend, në tri faqe; Klara Kodra, *Jup Kastrati – studiues i pasionuar i letërsisë arbëreshe*, “Koha ditore”, 4 tetor 2004, f. 23; &, *Recension për librin “Jeronim de Rada-Jeta dhe vepra”*, “Zëri i popullit”, Tiranë, 26 nëntor 1982, f. 3; Kokonozi, *Një libër me vlerë për Arbëreshin e Madh*, “Drita”, Tiranë, nr. 2(998), f. 5-6; Faik Luli, *Monografia e doc. Dr. Jup Kastratit për Jeronim de Radën – kontribut i vyer për historinë e shkollës shqipe e të mendimit pedagogjik shqiptar*, “Revista pedagogjike”, nr. 1, f. 120-124, Tiranë, 1981; Kolë Ashta, *Recension për librin “Jeronim de Rada”*, 1979, dy faqe makine, pa date dhe vend shënimi. Fatbardha Fishta, *Diskutim për librin Jeronim de Rada*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 8 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Luigj Franja, *Diskutim për librin Jeronim de Rada*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 8 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Enver Gjylbegu, *Diskutim për librin Jeronim de Rada*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 4 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Thoma Goga, *Diskutim për librin Jeronim de Rada*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 4 faqe (1/2), Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Perikli Jorgoni, *Reçensë për veprën Jeronim de Rada të Jup Kastratit*, dorëshkrim në 5 faqe, Tiranë, më 20. XI. 1978; Nasho Jorgaqi, *Disa konsiderata mbi librin “Jeronim de Rada” të doc. Jup Kastratit*, dorëshkrim në 8 faqe i lexuar në Shkodër, më 3 dhjetor 1980; &, *Mendime rreth biografisë Jeronim de Rada*, të Jup Kastratit, dorëshkrim në pesë faqe, Tiranë, shkurt 1979; Palok Kraja, *Diskutim për librin “Jeronim de Rada”*, dorëshkrim i shruar me dorë në 4 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Ana Luka, *Mbi kontributin e monografisë “Jeronim de Rada”*, të Jup Kastratit, dorëshkrim në 6 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Fadil Podgorica, *Disa konsiderata mbi librin “Jeronim de Rada”*, të doc. Jup Kastratit, dorëshkrim në 7 faqe makine, Shkodër, 3. 12. 1980; Gjyljana Prenushi, *Diskutim rreth veprës së doc. Jup*

Studime për De Radën (2003)¹⁷², dhe *Studime arbëreshe*¹⁷³ vlerësimet dhe recensionet janë botuar madje disa vjet para se veprat të dalin nga shtypi.

Prej recensioneve për botimet e këtyre veprave dhe sidomos prej recensioneve në dorëshkrim për diskutimin e tyre në redaksitë e botimeve dhe institucioneve shkencore e arsimore, në të vërtetë, lexuesi veç të tjerash do ta kuptojë kohën e përgatitjes së tyre për botim.

Por t'i kthehemi edhe njëherë recensionit në dorëshkrim të Profesor Çabejt. Nga faqja katër e deri në të shtatën Profesor Çabej ka paraqitur vërejtje e tij "për sa u takon konsonanteve", duke i trajtuar ato në nga një, ndërsa nga faqja shtatë deri në trembëdhjetë, ka sjellë shembujt e veçantë të përkthimit, përkatësisht perifrimit të *Milosaut*, duke dhënë shembujt përkatës sipas këngëve: I (12), II (5), III (3); VIII (8), IX (7), X (5+1), XII (3+1), XIII (1), XIV (6+1), XV (8), XVI (3+1), XVII (4), XVIII (1+1), XIX (12), XX (4), XXI (4), XXII (5), XXIII (9), XXIV (4), XXV (7), XXVII (4), XXXVIII (13), XXIX (3).

Sikur mund të shihet, vërejtje e Profesor Eqrem Çabejt nuk kanë të bëjnë me të gjitha këngët. Prej tekstit të tij në dorëshkrim nuk është vështirë të shihet se leximi ishte

Kastratit "Jeronim de Rada", dorëshkrim në katër faqe, Shkodër, 1980; Jusuf Shpuza, *Diskutim për librin "Jeronim de Rada"*, dorëshkrim i shruar me dorë në 4 faqe (1/2), Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Fiqri Vogli, *Diskutim për librin "Jeronim de Rada"*, dorëshkrim i shkruar me dorë në 3 faqe, Shkodër, më 3 dhjetor 1980; Ali Xhiku, *Recension mbi librin "Jeronim de Rada" të Jup Kastratit*, dorëshkrim në 4 faqe, Tiranë, më 20. XI. 1978 etj.

¹⁷² Gani Lajqi, *Studime për Jeronim de Radën*, "Koha ditore", Prishtinë, 25 mars 2003, f. 16; Gani Lajqi, *Studime për Jeronim de Radën*, "Koha ditore", Prishtinë, 25 mars 2003, f. 16; Bahri Beci, rekomandim për librin e Jup Kastratit, *Studime për De Radën*, Tiranë, më 15 dhjetor 1994, 1 faqe; Shaban Demiraj, Rekomandim për librin e J. Kastratit *Studime për De Radën*, tekst në gjuhën angleze, 2 faqe, Tiranë, Decmber 15, 1994; Mina Gero, Vërejtje rreth dorëshkrimit të Jup Kastratit, *Studime për De Radën*, dorëshkrim, Shkodër, më 6 maj 1990; Bahri Beci, rekomandim për librin e Jup Kastratit, *Studime për De Radën*, Tiranë, më 15 dhjetor 1994, 1 faqe; Safet Hoxha, Recension për dorëshkrimin e J. Kastratit, *Studime për de Raden*, 12 f. dorëshkrim, Shkodër, më 25 dhjetor 1994; &, Recension për dorëshkrimin e Jup Kastratit, *Studime për de Raden*, 10 f. dorëshkrim, Shkodër, më 30 nëntor 1988; Rahmi Memushaj, *Recension për librin e Jup Kastratit "Studime për De Radën"*, 2 faqe dorëshkrim, Tiranë, më 23 shkurt 1989; Tomor Osmani, Recension për dorëshkrimin e J. Kastratit, *Studime për De Raden*, 8 f. dorëshkrim, Shkodër, më 3 janar 1995; & Recension për dorëshkrimin e J. Kastratit, *Studime për de Raden*, 6 f. dorëshkrim, Shkodër, më 30 nëntor 1988; Ali Xhiku, Një gjykim mbi veprën *Studime për De Radën*, të dr. Jup Kastratit, dorëshkrim në 2 faqe, më 16 janar 1989

¹⁷³ Shih, Artan Haxhi, Rekomandim dhe recension për botim të veprës së Jup Kastratit *Studime arbëreshe*, dorëshkrim në tri faqe, Shkodër, më 20 korrik 1998 etj.

shumë i kujdesshëm dhe vërejtjet dilyn nga një lexim i tekstologut që më parëse sa të merrej me leximin e dorëshkrimit të përgatitur nga Jup Kastrati, kishte njohur gjerësisht të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe më parë se ta bënte objekt vlerësimi dorëshkrimin e Jup Kastratit, kishte bërë objekt kritike edhe tekste të tjera letrare e gjuhësore të letërsisë së arbëreshëve ë Italisë¹⁷⁴ dhe madje kishte përgatitur edhe një dorëshkrim përbetë letërsi¹⁷⁵. Vërejtje të kësaj natyre nuk bëhen fare në këngët: IV, V, VI, VII, XI, XXVI. Brenda vërejtjeve të karakterit perifrazues hyjnë edhe ato të përgjithshme që Profesor Çabej i shënon me shprehjet apo sintagmat: “e errët”, “nuk është dhënë mirë”, “nuk shkojnë fort mirë”, “Gualtier e ka...”, “kjo shprehje nuk shkon tek ne”, “trajta e parë është gegërisht” etj. Pra, ndonëse gjen edhe ndonjë vërejtje të natyrës gjuhësore apo estetike, nuk shënon propozimin e tij në të gjitha rastet.

Duam të theksojmë këtu se pjesa më e madhe e vërejtjeve të Profesor Eqem Çabej kanë të bëjnë me anën dialektore të fjalëve, kuptimin e disa fjalëve dhe sidomos trajtat dialektore gege apo toske në të cilat duhet të mbështetet Profesor Jup Kastrati në perifrazimin e tyre.

Nga faqja e trembëdhjetë deri në fund (shtatëmbëdhjetë) Profesor Çabej ka radhitur shënimet rreth vërejtjeve (komenteve) të *Milosaut*. Fjala është për vërejtjet ekskluzivisht gjuhësore, të karakterit fonetik, morfologjik dhe madje etimologjik të disa fjalëve, të sjella sipas këngëve: I (5), II (4), III (1), IV (2), VI (4), VII (5), VIII (5), IX (3), X (shpjegime fjalësh të panevojshme), XI (shpjegime fjalësh të panevojshme), XII (1), XIII (2), XIV (2), XV (3), XVI (1). Duket se mungesa e vërejtjeve për fjalë apo shprehje të këngëve të tjera ka të bëjë me përsëritjen e të njëjtave fjalë edhe në këngët në vazhdim.

Kjo është arsyeja pse në studimin tonë po i sjellë edhe vërejtjet rreth e përgjithshme rreth transkribimit, të cilat në parim nuk kanë të bëjnë vetëm me anën gjuhësore të dorëshkrimit të Jup Kastratit, po edhe me letërsinë arbëreshe në përgjithësi, historinë e gjuhës, dijen e kohës në fushë të tekstologjisë dhe përpjekjet për botimin e letërsisë së vjetër shqipe në përgjithësi e të letërsisë së arbëreshëve në veçanti.

Këtë e ka theksuar që në paragrafin e nënkapitullit të tij edhe Profesor Çabej: “Ajo që vlen për transkribimin e veprave të de Radës vlen përgjithësisht për tekstet shqip të

¹⁷⁴ Shih, Eqrem Çabej, *Tekste italo-shqiptare* (Des textes italo-albanais), “Hylli i dritës”, Shkodër, prill 1935; sipas *Studime gjuhësore*, (Études linguistiques). IV. Nga historia e gjuhës shqipe. “Rilindja”. Redaksia e botimeve. Prishtinë 1977, 7-13.

¹⁷⁵ Në një letër të datës 24. VII. 1952, Eqrem Çabej i shkruante Jup Kastratit: “Kam bashkëpunuar me A. Xhuvanin në një tekst që pjesërisht ndryshe doli si “Letërsia e vjetër arbëreshe” (Eqrem Çabej, Letër Jup Kastratit, Tiranë, 24.VII.1963). Është fjala për librin “Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe”. Tekst për kl. e III-të të shkollave të mesme. Botim i Ministrisë s’Arësimit. Tiranë, 1952. 196 f. Redaktor: Ziaudin Kodra. N.I.Sh. Shtypshkronjave-Stabilimenti “Mihal Duri”, Tiranë.

Italisë. Transkribimi i këtyre nuk është një punë e lehtë, dhe ai kërkon një njohje të mirë të fonetikës së këtyre dialekteve, të mënyrës sesi e shqiptojnë këto shqipe. Ky shqiptim në shumë pika ndahet nga shqiptimi i gjuhës në të folët e Shqipërisë. Pesë shekuj zhvillimi të pavarur kanë përfutur këtu dhe atje sisteme fonetike mjaft të dalluara. Një transkribim i mirë do të synojë një besnikëri fonetike sa më të madhe. Pyetja parimisht më me rëndësi është se a do të bëhet një transliteracion apo një transkribim. Ndërsa e para konsiston në një riprodhim të shkronjës pa marrë parasysh tingullin që ajo përfaqëson, kjo e dyta, synon një riprodhim të shqiptimit, të tingullit që përmbahet në shkronjën përkatëse. Në besojmë se në tekste relativisht të reja siç janë shkrimet e De Radës, ku shqiptimi në më të shumtat e rasteve dihet, transkribimi do preferuar pa tjetër përpara transliteracionit. Përveç së tjerave, kjo ka dhe këtë dobi që gjithë riprodhimi i tekstit është më konsekuent, se evitohen shumë inkoherenca e keqkuptime, siç do të shohim konkretisht më poshtë. Veçse do përpjekur që të arrihet një besnikëri, fonetike sa më të madhe, një afrim sa më i madh i shqiptimit të dialektit të poetit¹⁷⁶.

Pikë së pari në të folët e kolonivet ruhet mirë edhe sot kuantiteti i silabave të theksuara. Vokalet e gjata shënohen te De Rada, siç dihet, me vokale dyfishë, po ashtu si të gjithë shkrimtarët e vjetër, të Shqipërisë e të kolonive: *Ui të rii, tedit ree, zakoon*. Theksi hundak si p.sh. në *Ljumravet* të Milosaut XIX, nga fjalët ku përdoret, mua më del se shënon një gjatësi pak më të vogël se vokali dyfish. Në asnjë mënyrë nuk mund të lihet në transkribim ky theks, se do të merrej si shenjë e natalitetit, kurse në ato dialekte natalitet nuk ka”.

Në këtë kontekst këtu po i sjellim edhe vlerësimet e disa studiuesve të tjerë, disa prej të cilave botohen nga dorëshkrimi dhe botohen për herë të parë.

Do të fillojmë me një gjykim e vlerësim shumë pozitiv për Jup Kastratin, nga nipi i Jeronim de Radës: Giuseppe Camillo De Rada, në një letër të dërguar më 20 dhjetor 1962¹⁷⁷, për të vazhduar me më të madhin filolog të kohës së tij dhe nga më të veçantit të sheullit XX, Pater Justin Rrota, i cili në një *Letër urimi për Milosaon* e De Radës, më 2. 5. 1957, në Shkodër i shkruante:

¹⁷⁶ Në mardhinë të këtij paragrafi, Profesor Çabej ka shtuar me dorë edhe një paragraf, të cilin ne po e shënojmë në fusnotë: “Për të qenë sa ma afër origjinalit, për t’i ndenjë besnik tekstit të vitit 1936, botimi i parë i *Milosaut*, kopje *shumë e rrallë*, që ne patëm fatin ta gjejmë, preferuam transliterimin dhe jo transkribimin. Kjo eviton edhe keqkuptimet e interpretimit.

¹⁷⁷ “Gli onori che Lei merita, Illustrate compatriota scrittore, Prof. Jup Kastrati, per la forte attività che state svolgendo nel mettere in chiaro nuovi apostolate su la vita di Jeronim de Rada e sul discernimento della sua molteplice opera dando un senso nuovo di risveglio letterario ai cultori della lingua Albanese ed un forte merito alla sua alta personalità. Le auguro molteplici successi con vero cuore e La prego di considerarlo anche la mia intera amicizia.

“Fort i dashuni Jup,

...Por pika kryesore, për mue po thom, është me t’u falë nderës, për ato dy librat e çmueshëm që më ke dërgue falë. E ma së parit, për botimin e bukur të *Milosut*. (...) Shumë kemi këndue dikur përmbi këtë poet edhe përmbi këtë pemë, Milosau por jithe për ne gjithnji një prodhim letrar i panjohtun. E njihshim vetëm nëpër pritmin e atyne shkrimtarëvet të letratyres shqipe, të cilët e kishin këndue si atë mënyrën kritike t’autorit, ma atë alfabet e djalekt teper larg nga këta tanët. E marrshim vesh ndonjë send, por ma fort nuk mbrrijshim t’ia grabisim poetit çka donte me thanë. Merita jote pra, ma e parë është kjo, pse na e ke prû në Shqipni, *“alla portata di tutti”* këtë poemë, për ne Shqiptarët këndej Adriatikut, të thuesh krejt të panjohtuem. (...) Sa për zhvillimin e introdukcionet të këtij poemi, jam i sigurtë se ia ke qëllue mirë. (...) Të lumtë!

(...) Fjalë tekstuale, që ti i thue për “Milosanë” e De Radës, i cili, hiq gjuhën e Arbëreshëvet, dhe diçka fluturimet poetike t’auktorit, mue, si nuk është vështirë t’a kuptojsh, nuk mund t’ishte aqë i tërhjekshëm!

Patër Justini”

Disa vite më vonë (1960), studiuesi i njohur i lagjes së arbëreshëve Giuseppe Gradilione, në studimin e tij *“Canti di Milosao di Gradilione de Rada”*, veprën e De Radës përgatitur nga Jup Kastrati e diskutonte katër herë:

- herë e parë, duke njoftuar për botimin e versionit të dytë të De Radës *“Këngë të Milosaut”*, Tiranë, 1956;

- herën e dytë, *“Il Kastrati nella sua recente edizione del “Milosao” conserva sia le doppie vocali che le doppie cononanti e l’accento acuto, con evidente svantaggio per una esatta lettura dell’opera”* (108);

- herën e tretë, duke veçuar dukuritë fonetike të transliterimit të veprës, *“Qui il Kastrati dimostra di non avere inteso il fenomeno fonetico e quindi i corrispondenti segni grafici del De Rada per cui, ce parer suo, gh =gh e g=g; come conseguenza egli interpreta erroneamente come velare tende k il gc (gk), usato invece del De Rada nella prima edizione (sostituito nella sekonda e senza da gch) con valore di velare media g (che chiama guturale rafforzata in “Fiàmuri Arbërit” per distinguerla appunto da quella derivata dalla li)”* (110); dhe

- herën e katërt, duke veçuar çështjet që kanë të bëjnë me alfabetin: *“Fino a questo punto si é parlato generalmento dell’alfabeto della prima adozione, il quale però subisce nelle successive dei mutamenti, per cui si avvicina di più all’alfabeto di Manastiri. Il Kastrati li ha trascurati, tenendo presonte soltanto quello della prima edizione”* (112)¹⁷⁸.

Botimit të veprës së De Radës *“Këngët e Milosaos”*, i ka bërë jehonë edhe bardit i

¹⁷⁸ Giuseppe Gradilione, *Studi di letteratura Albanese*, Urbinati, Ed. 1960, pp. 247.

kulturës arbëreshe Francesco Solano. Në studimin e tij “Osservazioni sulle parlate italo-albanesi”, veç të tjerash theksonte: “... e nell’ugualmenti recente edizione del *Milosao*, curata da J. Kastrati a Tirana, si è incorsi nell’errore di riprodurre in trascrizione le doppie usate dal De Rada affermando che un appunto fatto spesso a questi dai vicini italiani è proprio quelle di non pronunciare le doppie dell’italiano, e di professori delle nostre scuole medie ne sanno qualche cosa, dovendo correggere le composizioni dei loro alunni italo-albanesi”¹⁷⁹.

Le të jetë këto dëshmi të botuara dhe të lëna në dorëshkrim të veprës së Jup Kastratit dhe të vlerësimeve për veprën e tij, vetëm një prej arsyeve pse sot, pas më shumë se gjashtë dekadave vepra dhe kontributi i Profesor Jup Kastratit do të duhej të vlerësohen dhe të respektohen si një përmendore e veçantë e këndej detit për arbëreshët e Italisë, dhe madje jo vetëm për ta.

¹⁷⁹ Cfr. L’edizione del *Milosao*, curata da J. Kastrati, Tirana 1956, p. 112. Nè qui vogliamo parlare delle numerose inesattezze di questa sfortunata edizione. Ma un cenno va fatto circa l’uso delle doppie consonanti da parte dei primi scrittore italo-albanesi. Si possono segnalare due fattori principali: 1) l’influsso della grafia italiana; 2) la natura più intensa delle consonanti albanesi in confronto delle stesse pronunciate da italiani. Del resto non è uniforme l’uso di tali doppie, e uno stesso scrittore scrive la stessa parola con o senza raddoppiamento. Così, per fare un esempio, il Santori nel Canzoniere Albanese, a p. 8, str. 6, verso 2, scrive “trimma”, mentre a p. 24, ver. 4 e 13 ha “trimi” a p. 48 scrive “pathther” e a o. 56 “pather”.

Thoma DHIMA

(Gjirokastër)

**PROF. GJ. SHKURTAJ PËR DIALEKTOLOGJINË
DHE SOCIOLINGUISTIKËN ARBËRESHE**

Fillesa apo “shkëndija” e parë për t’u marrë me botën arbëreshe për Gj.Shkurtajn ka qenë një detyrë kursi a, sikundër quheshin më parë, një “temë vjetore” me titullin “Poezia arbëreshe e shek. XVIII”, me udhëheqës shkencor të ndjerin Ziaudin Kodra, docent e titullar i letërsisë arbëreshe, një nga filologët më të parë që u mor me arbëreshët, vizitoi ngulimet arbëreshe dhe, me shkrimet, po edhe me leksionet e tij, nxiti të merrej me botën arbëreshe edhe brezin e ri të dashamirëve të asaj letërsie, ndër ta edhe Gj.Shkurtajn, i cili, më se një herë, në raste ekspeditash e takimesh që kemi pasur me të, flet me nderim dhe ia di për nder doc. Zijaudin Kodrës atë përrudhje drejt botës arbëreshe. Zijaudini i dha nga biblioteka e vet personale vëllimin e Zef Skiroit “Poezia arbëreshe” dhe Shkurtaj, ende djalosh, por i zellshëm dhe i pakursyer, shkroi një fletore me vlerësime e hulumtime filologjike rreth autorëve arbëreshë, sidomos për Nikolla Ketën, Zef Barçën etj. Fati i tij i mirë ishte se dinte edhe italishten, që e kishte nxënë qysh në vitet e shkollës së mesme në Shkodër, natyrisht, pa mësues ose me njerëz që e dinin qoftë edhe jo thellë, por prapë italishte ishte dhe për atë kohë, madje, ishte edhe disi jashtë kërkesave të formimit shkollor. Kjo e ndihmoi për ta kuptuar më mirë sa thuhej e shkruhej nga Skiroi i Madh për autorët arbëreshë. Temën e realizoi me cilësi të mirë dhe udhëheqësi ia pëlqeu, por, kur ky, në vitin e katërt, do të merrte si temë diplome “Të folmen e Kastratit”

profesorit të letërsisë arbëreshe i “kishte mbetur hatri” pse nuk vazhdoi në fushën e letërsisë arbëreshe. “Hatërmбетje” kishte pasur edhe prof. Zihni Sako, i cili, duke qenë se Shkurtaç, qysh kur ishte student, kishte mbledhur shumë materiale folklorike nga Mbishkodra, kishte pasur idenë që ta drejtonte nga fusha e tij, duke i dhënë ndonjë temë nga Eposi i Kreshnikëve. Megjithatë, edhe pse zgjodhi drejtimin e dialektologut dhe asaj fushe iu përkushtua për gjithë jetën, prof. Shkurtaç, ndoshta edhe për hir të asaj keqardhjeje të dy profesorëve të tij të dashur, Ziaudin Kodrës dhe Zihni Sakos, nuk do t’i linte jashtë vëmendjes as arbëreshët, por as folklorin dhe kulturën popullore. Sikundër e thotë vetë ai me të qeshur, dialektologjinë e ka si arën kryesore, të folmet arbëreshe dhe folklorin e etnografinë i ka si kopshtije të gjelbëruara: “Si bujku që kur lodhet në arë, lë parmendën e shatin e bubërron një copëherë nëpër kopshtije...”

Mbas diplomimit, në vitin 1966-67, punon një vit si mësues në Bregun e Matës, përgatit për botim monografinë për të folmen e Kastratit dhe, për fatin e tij të mirë, pa u mbushur mirë një vit akademik, emërohet punonjës shkencor në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë. Lexon dhe formohet, shkruan monografitë e tij të njohura për të folmet e Malësisë së Madhe: për Hotin, Kelmendin, Rranxat e Mbishkodrës, pastaj për të folmet e Bregut të Matës etj.

Në vitin 1973, në kuadër të marrëveshjeve kulturore dypalëshe me Italinë, caktohet të shkojë në një ekspeditë gjuhësore përnjohëse në ngulimet arbëreshe të Italisë dhe, prej 1 majit deri më 6 qershor të vitit 1973, bashkë me leksikologun Miço Samara, pati dy gëzimet e tij të mëdha: doli për herë të parë jashtë shtetit, pa Romën e famshme, pastaj edhe qytetet e ngulimet e vogla arbëreshe të Italisë, u befasua nga ajo dashuri spontane dhe nga ai mall më se pesëqindvjeçar i arbëreshëve për Shqipërinë dhe shqiptarët, u njoh me miq të shumtë arbëreshë, midis të cilëve edhe me disa prej figurave të mëdha të asaj diaspore, si papas Emanuele Xhordano (Giordano), autor i “Fjalorit të Arbëreshëve të Italisë” (1963), me papas Françesko Solanon, i cili asokohe ende nuk e kishte themeluar katedrën e shqipes në Kozencë, por jepte mësimin e

shqipes në kaudër të teologjisë në shkollat e mesme të Frasnitës; me papas Xhuzepe Farakon, që sapo kishte themeluar revistën “Zjarri” (Il Fuoco) dhe Shkurtaj do të bëhej me të jo vetëm mik, por edhe bashkëpunëtor i revistës; me papas Vincenzo Selvaxhin (Selvaggi), mbledhës i zellshëm i folklorit arbëresh dhe që, gjithashtu, me një abetare të vjetër që dikush ia kishte sjellë nga Kosova, u mësonte fëmijëve të Vakaricos fjalë dhe shkronjat e shqipes. Në Shën-Mitër Koronë, ku flinin në konviktin e Kolegjit të dikurshëm arbëresh, njeh nga afër edhe shumë figura të tjera e sidomos dashamirë të Shqipërisë, si Nino Minishi, kryetar i Bashkisë së Mbuzatit (San Giorgio Albanese) dhe Anna Maria Chiodi, veprimtare e Shoqatës së miqësisë “Itali-Shqipëri”. Katër javët e ekspeditës së parë tek arbëreshët e Italisë kanë qenë një nga ngjarjet e paharrueshme për studiuesin e ri, i cili, sapo kthehet, shpërthen me artikuj në shtypin e kohës dhe me biseda në Radio-Tirana. Boton te “Drita” me vijime reportazhin e gjatë “Gjaku ynë i shprishur” (Shënime e të dhëna për gjuhën dhe kulturën e arbëreshëve të Italisë), bashkautor me kolegun e tij të ekspeditës, M. Samara, shkrim që pati jehonë të madhe në Shqipëri e jashtë saj. Revista “Jehona”, i vetmi organ në gjuhën shqipe në Maqedoni, e ribotoi të plotë këtë shkrim, por, duke mos e ditur se çfarë do të thoshte fjala “i shprishur” (= i përhapur, i ndarë andej këndeje) ia “përmirësuan” duke e shkruar “*Gjaku ynë i prishur*”. Te Radio-Tirana, në rubrikën e kulturës dhe sidomos në emisionet “për bashkatdhetarët”, për disa javë radhazi do të mbante një cikël bisedash me përshtypje nga udhëtimi tek arbëreshët. Me një frymë, si të thuash, boton edhe një artikull a kronikë përnjohëse te revista “Studime filologjike”(nr.3., 1973) me titullin “Ekspeditë gjuhësore tek arbëreshët e Italisë”, ku jep për publikun shkencor disa prej vijave kryesore të tiparizimit dhe situatës gjuhësore e mirëfilli dialektologjike të të folmeve arbëreshe të Italisë. Gazeta “Drita”, revista “Nëntori”, po edhe organe të tjera të kohës, sidomos revista “Ylli”, i drejtoreshin në ato vite studiuesit të ri për artikuj dhe shkrime nga bota e arbëreshëve dhe ai u përgjigjet me një sasi të madhe shkrimesh.

Ndërkaq, me krijimin e Universitetit të Kozencës në Itali, fillojnë edhe ardhjet e para të grupeve të studentëve arbëreshë për kurse verore të shqipes, së pari, nëpërmjet Prishtinës, pastaj edhe në Tiranë drejtpërdrejt dhe, për arsye të asaj njohjeje që kishte fituar tashmë, dialektologu i ri Gj. Shkurtaç do të ishte shoqëruesi i atyre grupeve, të cilëve ai edhe u jepte mësim të shqipes, porse, ndërkaq, me stilografin e tij të verdhë në dorë, ishte më fort ai një “nxënës” i ligjërimeve arbëreshe, aq sa, me të drejtë, muajt e shkollës verore të arbëreshëve për gjuhën shqipe, mund të thuhet me plot gojën, kanë qenë edhe kohë shumë e mirë për verifikime e plotësime të lëndës së të folmeve arbëreshe të Italisë. Nuk është aspak e rastit që shumë prej atyre studentëve do të bëheshin pastaj edhe studiues të shquar të gjuhës e të letërsisë arbëreshe, si Françesko Altimari, Matteo Mandalà, Vito Matrënga etj. Prof. Gjovalini ka qenë, pa dyshim, një mësues i tyre, por mbi të gjitha një mik e dashamirë i madh i tyre, gjithmonë i gatshëm për të mbajtur letërkëmbim me ta, gjithmonë i papërtuar për të shkruar e folur për veprat a botimet e autorëve arbëreshë, sidomos të F. Solanos, A. Bellushit, A. Guxetës, K. Kandrevës, Zef del Gauduios, Lluka Perrones etj. Ai do të krijonte marrëdhënie të frytshme edhe në lëmin shkencor. Nuk mund të mos njohim e të pohojmë edhe faktin që marrëveshja më e madhe shkencore e kulturore ndërmjet Universitetit të Kalabrisë dhe Universitetit të Barit me Universitetin e Tiranës është nënshkruar pikërisht në kohën kur prof. Gjovalin Shkurtaç ka qenë këshilltar i kulturës pranë Ambasadës Shqiptare në Romë, duke bashkëpunuar ngushtë me prof. F. Solanon, prof. F. Altimarin dhe prof. G. Damakon e Giovanni Gironen në Universitetin e Barit.

I etur për të ditur e regjistruar gjithçka nga të folmet arbëreshe të Italisë, që tashmë kishin pjesën më të madhe në pasionin krijues të tij, Shkurtaç ndjek me përkushtim dhe nuk lë asnjë rast pa u takuar me arbëreshë që vinin në Shqipëri: ai rri me orë dhe shkruan për Vora Ujkon, poetin e shquar frasnjot, që e kishte mik dhe me të cilin mbante letërkëmbim të rregullt, shoqëron Karmel Kandrevën dhe, për dy javë të qëndrimit të tij në Tiranë, tejshkruajnë, pajisin me shënime e shpjegime

dhe botojnë në “Studime filologjike” dorëshkrimin e panjohur “Satirat” të F. A. Santorit¹⁸⁰. Tashmë Shkurtaj po shkonte drejt pjekurisë së vet si studjues dhe ato që shkruan për Santorin në parathënien e botimit të “Satirave”, mbeten me vlerë dhe nuk mund të mos ngjallnin interesimin e studjuesve. Po citojmë vetëm një vlerësim të tij: “Françesk Anton Santori mund të quhet si një nga fjalëkrijuesit më të zellshëm të letërsisë arbëreshe. Ai është autori që pikërisht në këtë lëmë u dallua në mënyrë të qartë nga të gjithë shkrimtarët e tjerë bashkëkohës e pasardhës. Dhe kjo nuk qe një gjë e rastit, apo një “ves” a mani e Santorit. Duket qartë se kemi të bëjmë me një nismë e veprimtari të qëllimshme të tij, me një sprovë të guximshme dhe qëllimlartë për pasurimin e shqipes me fjalë e terma të krijuar me brumin amtar, duke u mbyllur shtegun fjalëve të huaja të panevojshme e sidomos bastardimit të arbërishtes nga ndërhyrja e italianizmave”.¹⁸¹

Në vitin 1978, i caktuar nga Ministria e Arsimit, Shkurtaj shoqëron grupet folkloristike arbëreshe të Kalabrisë dhe të Shën-Marcanos që morën pjesë në Festivalin II Kombëtar Folklorik të Gjirokastrës. Deri natën vonë, ndërsa arbëreshët këndonin e vallëzonin në Sarandë e në Gjirokastrë, studiuesi ynë shfrytëzonte rastin për të marrë shënim e regjistruar fjalë, këngë, proverba arbëreshe nga miqtë e tij tashmë të vjetër Karmell Kandreva, Kamillo Moshario, Aflio Moça, Rosalino Muzakio etj. dhe, sidomos, nga grupi i arbëreshëve të Shën-Marcanos, të kryesuar prej njërit nga miqtë e mëdhenj, të prof. Gjovalinit, prof. Karmine de Padova, arsimtar e veprimtar i dalluar arbëresh, atdhelëvdues e gjuhëruajtës me merita të shumta, i dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Fryt i materialeve të mbledhura në ato ditë e net vjeshte të vitit 1978, qenë edhe dy studime të

¹⁸⁰ Shih: Françesk A.Santori, *Satira, Transliteruar dhe pajisur me shënime nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaj*, “Studime filologjike”, 1982, nr.2, f.173-208.

rëndësishme të botuara në revistën “Studime filologjike”: *Shënime për të folmen arbëreshe të Shën-Marcanos* (1979, nr. 4, f. 113-141) dhe *Disa shënime e vlerësime për tiparet fonetike të të folmeve arbëreshe të Kalabrisë*.

Në vitin 1984, ndonëse e kishte ideuar e shkruar qysh disa vite më parë, Gj.Shkurtaj botoi librin “Shpirti i Arbrit rron” (Shënime dhe të dhëna për arbëreshët e Italisë), botim i Shtëpisë Botuese “8 Nëntori”. Libri kishte një përmbajtje të thjeshtë, ndoshta të thjeshtuar edhe më shumë se duhej, për arsye të kornizave politike të kohës, por edhe ashtu, ai u jepte dorë lexuesve masivë për të marrë të dhëna e dije me interes për botën arbëreshe, për ruajtjen e shqipes e përpjekjet e atjeshme për ta shkruar, studiuar e mësuar gjuhën e të parëve; për grupet artistike dhe revistat arbëreshe kushtuar shqipes e problemeve të historisë e të letërsisë shqiptare, për poetët dhe shkrimtarët bashkëkohorë të ngulimeve arbëreshe etj. “Shpirti i Arbrit rron” qe një libër i pritur shumë mirë nga lexuesit dhe nga kritika shkencore. Mjafton të themi se për atë libër autori pati vlerësime të larta nga penat më të mirënjohra të kohës, sidomos nga arbëreshologë të shquar si prof. Dhimitër S. Shuteriqi, i cili në një recension te “Drita”, ndër të tjera, shkruan: “**libri gjeti njeriun**”. Kurse prof.Vehbi Bala, në parathënien e librit të Shkurtajt ka shkruar: “Vepra që kemi në dorë është shkruar me dije e dashuri, është rrjedhim i qëmtimit të së sotmes në viset përkatëse dhe hulumtim i së kalaurës nëpër biblioteka e arkiva, na jep një parafytyrë të gjallë të kësaj përbashkësie me të vërtetë për t’u admiruar. Si e tillë, vepra do të luajë një rol të mirë njohjeje në masat e gjera punonjëse, që ndjekin me dëshirë të madhe ecjen përpara të vëllezërve të pandarë përtej Adriatikut. Si e tillë, gjithashtu,

¹⁸¹ Shih: Françesk A.Santori, *Satira, Translitteruar dhe pajisur me shënime nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaj*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë,1998.

vepra shpreh një peng nderimi e mirënjohjeje të thellë ndaj tyre”.¹⁸²

Recensione me vlerësime të larta për librin e Shkurtajt kanë shkruar edhe studiues të tjerë, si prof.dr. Musa Kraja në gazetën ”Mësuesi”, prof. F. Altimari në revistën “Zjarri”, shkrimtari i shquar arbëresh Zef Skiro i Majit në revistën e tij “Mondo albanese” etj. Madje, te “Mondo Albanese”, në disa numra radhazi Di Maxhio ka botuar me vijime gati të gjithë librin “Shpirti i Arbrit rron”, kurse etnografja Licia Konti, në ekspozitat e saj kushtuar veshjeve arbëreshe, të dhënat e këtij libri i ka përdorur si bazë për të dhënë shpjegimt historike e demografike të ngulimeve arbëreshe të Italisë. Po ashtu, “Shpirti i Arbrit rron”, meqë kërkohet nga shumë lexues në Kosovë, në pamundësi për ta ribotuar si libër, është botuar si fejtun në gazetën “Rilindja”, kur ajo gazetë dilte në Tiranë, sepse nuk lejohej shtypja e saj në Kosovën e pushtuar.

Periodha njëzetvjeçare 1981-2002 është për prof. Shkurtajn koha më e ngjeshur me vajtje-ardhje studimore tek arbëreshët e Italisë, si dialektolog për të kryer ekspedita për Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, si kumtues e referues në konferenca e seminare ndërkombëtare të Universitetit të Palermos, të Kalabrisë, të Barit, po edhe të Napolit, Romës, Bolonjës; si ideues e autor i skenarëve për filmat dokumentarë shkencorë “**Arbëreshët**” (1982), prodhim i Kinostudios “Shqipëria e re”, me regji të Halil Kamberit, fitues i çmimit të dytë në Festivalin Kombëtar të Filmit dokumentar (1984), të serialit “**Na jemi arbëreshë**” (1992), prodhim i TVSH-së, me regji të Halil Kamberit e A. Dodës, me katër pjesë, që janë dhënë shumë herë në valët e TVSH-së; si hartues i përmbledhjeve me vjersha të zgjedhura të disa prej autorëve arbëreshë më në zë, si Karmel Kandreva, Lluka Perrone, Buzëdhelpru etj.

Penës së Gj. Shkurtajt i përkasin, gjithashtu, recensione të shumta të botuara në shtypin shkencor (Studime filologjike, Gjuha jonë, Kultura

¹⁸² Shih: Gj.Shkurtajt, *Shpirti i Arbrit rron* (Shënime dhe të dhëna për arbëreshët e Italisë), Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1984, Parathënie e shkruar nga prof.Vehbi Bala, f.9.

popullore) për botime të rëndësishme të autorëve arbëreshë, shumicën si autor i vetëm, disa herë edhe në bashkëpunim me profesorë të tjerë të njohur, si me prof. Mahir Domin për gramatikën e F. Solanos, me A. Kostallarín për botime të D. Guagliardit, duke qenë kështu, autor ose bashkautor i një numri shumë të madh artikujsh, kumtesash e studimesh. Nuk dimë të jetë bërë ndonjë kongres, konferencë a seminar albanologjik në diasporën arbëreshe të Italisë në këto tridhjetë vjetët e fundit, ku të mos ketë marrë pjesë prof. Gj. Shkurtaj, prandaj edhe emri i tij figuron si emri i njërit prej kumtuesve e referuesve që ka studime të përfshira në përmbledhje të mëdha e të rëndësishme, si: vëllimet e kongreseve ndërkombëtare të organizuar e të drejtuar nga Prof. A. Guzzetta në Universitetin e Palermos, në aktet e kongreseve dhe seminareve ndërkombëtare të organizuara nga prof. F. Solano e prof. F. Altimari në Universitetin e Kalabrisë, në aktet e konferencave ndërkombëtare të organizuara nga prof. M. Mandalà në Universitetin e Barit e të Leçes, nga prof. F. Altimari në Universitetin e Napolit (1992), në aktet e Konferencave ndërkombëtare të Universitetit të Salernos, organizuar nga prof. A. Landi; në vëllimin e konferencave ndërkombëtare për përrurimin e ADGJSH-së në Universitetin e Napoli L’Orientale, nga prof. I. C. Fortino (2008) dhe në Greci të Avellinos etj. Në pamundësi për t’i përmendur këtu të gjitha, po theksojmë, kryesisht disa vlerësime që i takojnë prof. Gj. Shkurtajt për librin “Ligjërimet arbëreshe”, Tiranë, 2006, 292 faqe. Ky libër përmban, së pari, të dhëna për arbëreshët dhe kulturën e tyre, një shkurtoare të historisë së shpërnguljes dhe ngulimit në trojet italiane, përjetimet dhe shqetësimet e kësaj diaspore arbëreshe në dhe të huaj, folklori, traditat dhe letërsia e krijuar në mërgim, bëmat e burrave të shquar arbëreshë për ta mbajtur gjallë gjuhën shqipe. Përmenden me saktësi përfaqësuesit e çdo katundi a qendre arbëreshe dhe kontributet e tyre në fusha të ndryshme të kulturës e të letrave, me të cilët mburren e krenohen faqe fqinjëve. Ai përmend burrat e djeshëm dhe ata të sotëm arbëreshë që i dolën për zot identitetit të tyre, gjuhës dhe kulturës së tyre, të cilat i ruajnë e i zhvillojnë me aq krenari e dashuri sot. Nuk do të

përmend këtu listën e gjatë të njerëzve dhe të kontributeve të tyre që autori përmend në këtë libër, sepse do të duhen shumë faqe e shumë kohë, po dua të theksoj dashurinë me të cilën ai i ka prezantuar e paraqitur ata, respektin e thellë e mirënjohjen për të vjetrit e për të rinjtë arbëreshë, për veprën e tyre të pavdekshme. Ky libër është, padyshim, ndër më të mirët që janë shkruar deri sot për arbëreshët e Italisë. Diaspora që përshkruan Gj. Shkurtaç në këtë libër është një diasporë që vijon të lëshojë klithmat e fuqishme se arbëreshët përbëjnë “një kulturë që ngë mend të desinj” (që nuk ka ndërmend të vdesë).

BIBLIOGRAFI E GJ. SHKURTAJIT PËR TE FOLMET ARBERESHE

1. SHKURTAJ Gj., *Ekspeditë gjuhësore tek arbëreshët e Italisë*, në "St. fil", 3, 1973.
2. SHKURTAJ Gj., *Vështrim mbi trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës*, në "St. fil.", 2, 1975, f. 71-87.
3. SHKURTAJ Gj., *Shënime për të folmen arbëreshe të San Marcanos*, në "St. fil.", 4, 1979, f. 113-141.
4. SHKURTAJ GJ., *Shpirti i Arbrit rron. Shënime dhe të dhëna për arbëreshët e Italisë*, Tiranë, 1984.
5. SHKURTAJ Gj., *L' influenza dell' italiano sulle parlate arbëreshe d' Italia*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M. Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.
6. SHKURTAJ Gj., *Qualche particolarità delle parlate siculo-albanesi come dimostrazione della vitalità e della originalità della lingua albanese*, "Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del II Congresso Internazionale", Palermo, 1989, f. 235-241.
7. SHKURTAJ GJ., *Disa shënime për të folmen arbëreshe të Marçeduzës*, në "Studime për nder të A. Xhuvanit", Tiranë, 1986, f. 513-17.
8. SHKURTAJ GJ., *Eqrem Çabej për të folmet e diasporës shqiptare*, në "St. fil.", 3, 1988.
9. SHKURTAJ GJ., *Sull' antroponimia degli albanesi d' Italia*, në "Atti del XVI Congresso Internazionale di Studi Albanesi", Palermo, 1993, f. 99-106.
10. SHKURTAJ Gj., *Ndihmesa të prof. Shaban Demirajt në dialektologjinë dhe filologjinë arbëreshe*, në "Studime albanologjike", 2, 1996.
11. SHKURTAJ GJ., *Sociolingustika*, Tiranë, 1996.

12. SHKURTAJ GJ., *Shqyrtime sociolinguistike për emrat e farefisnisë dhe për emrat vetjakë të shqipes*, në "St. fil.", Tiranë, 1999, nr.3-4.
13. SHKURTAJ GJ., *Bigëzimet gjuhësore në onomastikë si tregues të bigëzimeve shoqërore: rasti I toponimeve dhe antroponimeve dygjuhësore në ngulimet arbëreshe*, në librin "Onomastikë dhe etnolinguistikë", SHBLU,Tiranë, 2001, f.161-176.
14. SHKURTAJ GJ., *Rreth etnonimit Scutari dhe disa gegizmave në të folmen arbëreshe të Shën_Kostantinit*, në librin "Onomastikë dhe etnolinguistikë", SHBLU,Tiranë, 2001, f.247-257.
15. SHKURTAJ GJ., *Gjuha dhe "shpirti i Arbërit" në veprën e Jeronim de radës (Shënime dhe vlerësime me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së poetit)*, në librin "Kundrime gjuhësore", PEGI,Tiranë, 2006, f.140-148.
16. SHKURTAJ GJ., *Perëndimi dhe Lindja në sociotipin shqiptar* në librin "Kundrime gjuhësore", PEGI,Tiranë, 2006, f. 43-52
17. SHKURTAJ GJ., *Vendi i të folmeve arbëreshe në ADGJSH.Anketat në të folmen e Grecit*, në Convegno Internazionale "L'Atlante Dialettologico della Lingua Albanese", Napoli, 30 ottobre 2008, Greci (Av), 31 ottobre 2008.
18. SHKURTAJ GJ., *Vendi i të folmeve arbëreshe në ADGJSH.Anketat në të folmen e Grecit*, në Vepra themelore në albanologji, Aktete e Konferencës Shkencore ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2009, f.77-85.
19. SHKURTAJ GJ., *L'arbëresh d'Italia come lingua scritta*, in "Le minoranze linguistiche", 4-7 Dicembre, 1985, f.181-191.
20. SHKURTAJ GJ., *Presentazione (parathënie) e lbrit të A.Bellushit, Ricerche e studi tra gli Arbëreori dell'Ellade*, Testi e documenti, Cosenza, 1994.
21. SHKURTAJ GJ., *Gjuha shqipe në ballkanin shumetnik e shumëgjuhës dhe në diasporën shqiptare*, në "Studi in onore di Antonino Guzzetta, Palermo, 2002.
22. SHKURTAJ GJ., *Gjuha shqipe në shtypin e sotëm të arbëreshëve të Italisë*, në "Zjarri, Rivista di cultura Albanese,1969-1989, annoXX-n.33, f.157-165.

Mimoza PRIKU

(Shkodër)

**“LUIGJ MARLEKAJ DHE KONTRIBUTETET
E TIJ NË STUDIMET ARBËRESHE”**

Kush ishte Luigj Marlekaj?

Luigj Marlekaj ishte një prej shumë intelektualëve shkrodranë që pati një lidhje të ngushtë e të veçantë me botën arbëreshe. Në shumë momente historike Shkodra dhe arbëreshët e Italisë kanë qenë mjaft pranë, ndaj Marlekaj renditet në vazhden e dijetarëve, si: L. Gurakuqi, E. Koliqi, M. Camaj, K. Kamsi etj., të cilët i përlligjën dhe u dhanë jetë këtyre raporteve të shkëlqyera.

Kjo marrëdhënie e L. Marlekajt nuk u referohet viteve të studimit (kujtojmë se një pjesë e intiligjencës shqiptare e asaj shkodrane u shkollua në kolegjet arbëreshe), por lidhet sidomos me misonin e tij si përçues i dijes, si profesor në disa universitete të Italisë, përvojë e cila e lidhi edhe më fort me arbëreshët.

Luigj Marlekaj i ndoqi mësimet e para në vendlindje, u edukua në Kolegjin Françeskan e më vonë u rregjistrua pranë gjimnazit “Illyricum” në Shkodër. Një ndihmesë të madhe gjatë gjithë viteve të studimit i kanë dhënë dy ish-profesorët e frymëzuesit e tij, J. Rrota e Gj. Fishta. Studimet e larta ai i mbaroi, së pari, për teologji, por më vonë Marlekaj u lauria për Gjuhë-Letërsi Moderne në Universitetin e Bolonjës dhe të dy këto drejtime do ta shoqëronin atë deri në fund të jetës.

Si mësimdhënës Luigj Marlekaj kishte filluar në vitin 1931, në

gjimnazin ku kishte marrë formimin e përgjithshëm. Ndërsa karrierën akademike ai e nisi më 1941 në Universitetin e Bolonjës vend në të cilin iu dha mundësia të bashkëpunonte me gjuhëtarin e njohur Vitore Pizani, për ta vazhduar këtë karrierë më pas në Universitetin “Sacro Cuore” të Milanos.

Një pikë shumë e rëndësishme në biografinë e Marlekajt është viti 1961, vit kur ai emërohet profesor i shqipes në Universitetin e Barit, duke u bërë “*misionar i përçimit të kësaj gjuhe e kulture në Universitetet italiane*”.¹⁸³ Ky moment shënon një pikë të fuqishme lidhëse mes tij dhe botës arbëreshe.

Për sa u takon botimeve me karakter shkencor mund të themi se ato shtrihen nga viti 1932-1989. Ato nisin si artikuj në organe të ndryshme që qarkullonin atëherë në Shqipëri e kryesisht në Shkodër. Për disa kohë Marlekaj u bë edhe drejtues i revistës “Zani i Shna Ndout”. Pas vitit 1944 publikimet në formë studimesh, recensionesh, shkrimesh etj. për arsye që dihen, janë realizuar jashtë Shqipërisë. Në diasporë emri i Marlekajt është përkrah E. Koliqit, M. Camajit për të mbajtur në këmbë revistën “Shejzat”, organ i përkushtuar kulturës shqiptare. Marlekaj ishte mjaft aktiv me botime në analet e universiteteve ku ai punoi, në pjesëmarrje konferencash shkecore etj.

Shkrimi i parë i Marlekajt me karakter shkencor i përket vitit 1932, botuar në revistën “Hylli i Dritës” dhe mban titullin “Karakter i Letratyrës kombtare”¹⁸⁴. “*Letratyra,- shkruan Marlekaj,- njëherit me hart është të shprehunt e shoqnis, emanacjoni moral i qytetís... E kombi qi nuk ka letratyrë me fizjonomi të veten, është i gjikuem me mbetë në një gjendje, e cilla nuk e nderon jo vetem, por e poshtnon, tuj e lânë pa vetin mâ të*

¹⁸³ T. Topalli & M. Priku, “Pedagogu i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitet italiane”, mbajtur në konferencën shkencore “Një misionar në shërbim të kombit”, botuar në *Dukagjini në rrjedhat e historisë*, Shkodër, 2007, f. 68.

¹⁸⁴ Marlekaj, O.F.M., P. Jakob, *Hylli i Dritës*, VIII/1932, Nr. 7-8, f. 337-341.

paren, qi sikur n'individua, thirret karakter".¹⁸⁵ Në këtë revistë shkrimet janë botuar në harkun kohor 1932-1934.

Shumë i pranishëm është Luigj Marlekaj edhe në revistën "Shejzat". Ai është shumë i informuar për zhvillimet me karakter gjuhësor edhe në Shqipëri. Në lidhje me ortografinë në një prej numrave të kësaj reviste ai shkruan: "*Instituti i Shkencave të Tiranës qi, para njezet vjetve, ka marrë përsipër barrën e njizimit t'ortgrafisë së gjuhës shqipe, nuk e pau t'arësyeshme ta rishikonte alfabetin, po u përpoq të parashtronte mënyren sesi do të shkruhen kategoritë e ndryshme gramatikore*".¹⁸⁶ Pas viteve '60 nga dora e mendja e Luigj Marlekaj dolën studime mjaft të rëndësishme, të cilat e bënë të pavidkeshëm emrin e tij. Përmendim "Scandebeg nelle tradizioni popolari albanesi" (1969), "Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo" (1989) etj. Kontributi i vyer i Marlekajit u bë i njohur për herë të parë në Shqipëri nga studiuesi i njohur Shefik Osmani në botimin "Një misionar në shërbim të kombit. Bota shqiptare në veprën e Luigj Marlekaj",¹⁸⁷ kushtuar jetës e punës së këtij dijetari shkodran. Prof. Sh. Osmani pati rastin dhe e njohu nga afër Marlekajn dhe gjithë punën e tij. Ndërsa nën kujdesin e prof. Matteto Mandalàsë, katedrës së gjuhës shqipe pranë Universitetit të Barit u mbajt një kuvend për kontributin e Marlekajit dhe aktet e tij u botuan në vitin 1999.¹⁸⁸

Luigj Marlekaj dhe lidhjet e tij me botën arbëreshe.

Kontributi i Marlekajit në studimet arbëreshe shtrihet në disa drejtime: në leksionet e mbajtura në aulat e universiteteve të ndryshme për gjuhën dhe letërsinë shqipe, në punimet që lidhen me gjuhën dhe kulturën arbëreshe, në temat vjetore e laurat e studentëve të udhëhequr nga ai vetë etj. Marlekaj është i pranishëm edhe në kuvendet shkencore të organzuara

¹⁸⁵ *Po ai, po aty*, f. 338.

¹⁸⁶ P. Marlekaj, "Gjuhësia shqiptare në dhetë vjetët e fundit (1957-1967). Ortografia e gjuhës shqipe", *Shejzat*, nr. 4-6, 1968, Romë, f. 235.

¹⁸⁷ Shtëpia botuese "Idromeno", Shkodër, 1996. fq. 134.

¹⁸⁸ *Studi in onore di Luigi Marlekaj* (a cura di Matteo Mandalà), Univesità di Bari, Istituto di lingue stranieri, Cattedra di lingua albanese, Adriadica, 1999, 592 pg.

sidomos në Palermo gjatë atyre viteve. L. Marlekaj dëshmohej edhe si një ruajtës i një pjese shumë të rëndësishme të epistomologjisë arbëreshe, siç është ajo mes J. de Radës dhe Anselmo Lorecchios, i cili për shumë vjet arriti të mbajë gjallë revistën “La Nazione Albanese”.

Më poshtë do t’i shohim pak më hollësisht këto kontribute të L. Marlekajt.

a. Leksionet për gjuhën dhe letërsinë shqipe

Leksionet mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe detyrimisht do ta fokusonin vëmendjen e Marlekajt edhe tek autorët arbëreshë. Në brendësi të tyre ai fliste për De Radën, Z. Skiroin etj., aktivitetin letrar, patriotik e atdhetar të tyre. Këto leksione ai i pasuronte çdo ditë me të dhëna e literatura të reja. Në lidhje me përfshirjen e studimeve arbëreshe në universitetet italiane, studiuesi i njohur arbëresh F. Altimari shkruan: *“Një tjetër pikë studimi në rrethin Universitar italian për dialektet shqipe të Jugut të Italisë janë Universitetet pulieze (Bari dhe Leçe) ku, para së gjithash nga pedagogët dhe punonjësit shkencorë të gjuhësosë romane dhe të dialektologjisë italiane, por edhe me nismën e katedrës së shqipes (e kemi fjalën këtu për prof. papas Sepa Ferrari dhe të Luigj Marlekaj, të Universitetit të Barit), duke nisur nga vite ’60 u është dhënë një hapësirë e gjerë studimeve gjuhësore dhe mbledhjes së materialit që ka të bëjë kryesisht me larminë dialektore puliezo-arbëreshe”*.¹⁸⁹

b. Botimet personale me karakter arbëresh

Lidhjet e para me arbëreshët përmes hulumtimeve shkencore i gjejmë që në vitin 1941, kur Luigj Malekaj mbrojti tezën e laurës me temën “Grafia shqipe përmes shkrimtarëve gjatë periudhës 1462-1908” dhe në mjaft zëra iu referua shkrimtarëve arbëreshë duke marrë në analizë kontributin e tyre për shkrimin e shqipes. Një ndër punimet e përmendura të Marlekajt për shkrimtarët arbëreshë është ai me titull “Giuseppe Schirò

¹⁸⁹ F. Altimari, “Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe”, në *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002, f. 116.

e le tradizioni popolari albanesi”¹⁹⁰ mbajtur si referat në 100- vjetorin e lindjes së shkrimtarit arbëresh. Marlekaj i bëri një analizë veprës “Canti popolari dell’Albania” të Sciroit dhe evidenton: “La sorprendente attività letteraria di Giuseppe Schirò è tutto imperniata sulle tradizioni popolari albanesi”¹⁹¹.

c. *Temat e laurave*

Një punë të mirë për të njohur e ruajtur gjuhën e kulturën arbëreshe, Marlekaj e ka bërë sidomos me studentët që ndiqnin kursin e gjuhës e letërsisë shqipe në Universitetin e Barit, duke i nxitur ata që të hulumtojnë pikërisht në këtë drejtim. Në monografinë e tij kushtuar Luigj Marlekajt, prof. Shefik Osmani shkruan: “*Vendosi që studentëve të tij arbëreshë t’u sugjeronte të shtjellonin si tema laure botën arbëreshe, duke i shtyrë ata në hulumtime e zbulime me karakter shkencor. Në këtë mënyrë do t’i sillte një shërbim të madh mëmëdheut*”.¹⁹² Ai arriti t’i finalizojë idetë e përpjekjet e tij në 40 tema laurash të mbrojtura nga studentët kryesisht arbëreshë.

Këta studentë vinin nga zona të ndryshme si Pulies, Kalabrisë, Sicilisë etj. Marlekaj shkruan me një ndjesi të veçantë për ta: “*..në jetën time universitare kam provuar kënaqësi të madhe sidomos në Bari, ku një numër i konsiderueshëm studentësh arbëreshë vinin nga vende të largëta, për të dëgjuar me dëshirë se si flitet sot gjuha e të parëve të tyre, të mërguar nga atdheu pesëqind vite më parë*”.¹⁹³

Këto kontakte e nxitën L. Marlekajn të vizitonte shumë fshatra

¹⁹⁰ *Annali della Facoltà di Magistero*, vol. 5, 1966 (Relazione letto a Piana degli Albanesi il 28 novembre 1965, al IV Convegno Internazionale di Studi Albanesi tenuto a Palermo nella ricorrenza del centenario della nascita del poeta sicoli-alabanese Giuseppe Schirò).

¹⁹¹ *Po ai, po aty*, f. 79.

¹⁹² Sh. Osmani, *Një misionar në shërbim të kombit*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1996, f. 41.

¹⁹³ cituar sipas Sh. Osmani, *Një misionar në shërbim të kombit*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1996, f. 58.

arbëreshë për të njohur kështu nga afër gjuhën, traditat e trashëguara nga brezi në brez. Në një letër që mban datën 23. XII. 1992 Marlekaj shkruan: “një numër i shënuar nxënësish arbëreshë vinin nga vende të largta për të dëgjuar me dëshirë se si flitet sot gjuha e të parëve të tyre të larguar nga Atdheu pesqinde vite më parë. Kjo më shtyri të vizitoja...të gjitha vendet arbëreshe: Montecilfonen, Ourin, Campomerinon, Chieutin, ...Spezzno Albanesen...”¹⁹⁴

Marlekaj i kishte orientuar studentët e tij jo vetëm nga pasuria gjuhësore, por edhe nga thesari etno-kulturor që arbëreshët kishin mundur të ruanin gjatë këtyre shekujve. Ata përmbanin jo vetëm hulumtime linguistike të përqendruara në leksik e dialektologji, por edhe në vjelje e në intepretim të folklorit arbëresh, dokeve e zakoneve arbëreshe. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar historisë së kulturës arbëreshe në përgjithësi, duke nxjerrë në pah ndihmesat e shumë prej dijetarëve arbëreshë që kontribuan në ruajtjen, kultivimin e pasurimin e këtij thesari gjuhësor e kulturor. Mes të tjerash shquhen figurat e Jul Varibobës, Zef Skiroit, De Radës, Vincenzo Dorsës etj.

Temat kishin përndarje të ndryshme si në tematikat që ato trajtonin, ashtu edhe sa u takon zonave e fshatrave të ndryshme, duke e zgjeruar edhe më shumë spektrin e këtyre studimeve. Përveç temave të laurave, Marlekaj i nxiti studentët drejt botës arbëreshe edhe në detyra të thjeshta kursi. “Studentët arbëreshë kishin tek profesori shqiptar një mbështetje të fortë,- shruan Sh. Osmani,- sidomos ata të gjuhë-letërsisë. Rreth profesorit shqiptar rrethi i studentëve arbëreshë kompaktësohej gjithnjë e më shumë. Gjeneratat e studentëve përcillnin nga njëri-tjetri simpatinë dhe konsideratat e tyre për profesorin shqiptar”¹⁹⁵

¹⁹⁴ cituar sipas Sh. Osmanit, “Miku im Luigj Marleka”, mbajtur në konferencën shkencore “Një misionar në shërbim të kombit”, botuar në *Dukagjini në rrjedhat e historisë*, Shkodër, 2007, f.49.

¹⁹⁵ Sh. Osmani, *Një misionar në shërbim të kombit*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1996, f. 49.

d) Pjesëmarrës në kuvendet arbëreshe

Në korrespondencat me emra të njohur të kulturës shqiptare, si E. Koliqi e ndonjë tjetër, shpesh objekt diskutimesh janë bërë studimet shqiptare në përgjithësi e ato arbëreshe në veçanti. Marlekaj ka qenë pjesëmarrës në disa kuvende shkencore të organizuara nga qendra albanologjike arbëreshe. Në një nga letrat që Koliqi ia dërgon Marlekajt, shkruhet pikërisht për një kuvend i cili do të mbahej në Palermo. Mes të tjerash ai i shkruan: *“I përnderti e i dashuni Mik..., Kuvendi i shqipes besoj se mbahet në Palermo kah fillimi i tetorit. Kam lypur datën e përpikët dhe pres përgjigje...”*.¹⁹⁶

Në disa kuvende arbëreshe që u mbajtën kryesisht në Palermo, Marlekaj ishte i pranishëm me shkrime interesante.

Si përfundim, mund të themi se Luigj Marlekaj dhe puna e tij shërbyen si një urë lidhëse mes botës shqiptare dhe asaj arbëreshe. Ky profesor *“njohu dhe çmoi forcën intelektuale dhe substratin arbëresh të mjedisit universitar, e shfrytëzoi me aftësi këtë forcë dhe e përfshiu, e bashkoi, i dha një drejtim të caktuar qëllimor, duke e bërë Departamentin që drejtonte ai në një qendër studimore e kërkimore të botës arbëreshe”*.¹⁹⁷

Biblioteka dhe arkivi personal i Luigj Marlekajt janë bërë sot pronë e Bibliotekës Franceskane në Shkodër, prandaj mendojmë se mund të bëhen humumtime të tjera për të nxjerrë në pah të gjithë kontributin e këtij personaliteti e sidomos lidhjet e veçanta që ai pati me arbëreshët.

BIBLIOGRAFI:

1. Altimari, F., *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002.

¹⁹⁶ cituar sipas “Letërkëmbim i Ernest Koliqit me Át Jak Marlekajn”, botuar në rev. *Hylli i Dritës*, Shkodër, 2012/1, f.60.

¹⁹⁷ Sh. Osmani, *Një misionar në shërbim të kombit*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1996, f. 63.

2. Konferenca shkencore “Një misionar në shërbim të kombit”, botuar në *Dukagjini në rrjedhat e historisë*, Shkodër, 2007.
3. “Letërkëmbim i Ernest Koliqit me Át Jak Marlekajn”, botuar në rev. *Hylli i Dritës*, Shkodër, 2012/1.
4. Marlekaj, L., “Giuseppe Schirò e le tradizioni popolari albanesi”, *Annali della Facoltà di Magistero*, vol. 5, 1966 (Relazione letto a Piana degli Albanesi il 28 novembre 1965, al IV Convegno Internazionale di Studi Albanesi tenuto a Palermo nella ricorrenza del centenario della nascita del poeta sicoli-alabanese Giuseppe Schirò).
5. Marlekaj, P., “Gjuhësia shqiptare në dhetë vjetët e fundit (1957-1967). Ortografia e gjuhës shqipe”, *Shejzat*, nr. 4-6, 1968, Romë.
6. Marlekaj, O.F.M., P. Jakob, “Karakteret e Letratyrës kombtare”, *Hylli i Dritës*, VIII/1932, Nr. 7-8, f. 337-341.
7. Osmani, Sh., *Një misionar në shërbim të kombit. Bota shqiptare në veprën e Luigj Marlekaj*, Shtëpia botuese “Idromeno”, Shkodër, 1996.
8. Kamsi, W., “Hylli i Dritës” 1913-1944. Bibliografi kronologjike, Botimet Franceskane, Shkodër, 2008.

Valbona KARAKAÇI

(Shkodër)

**ERNEST KOLIQUI DHE KANGJELET E RILINDJES,
PIKËTAKIM ME BOTËN ARBËRESHE DHE DE RADËN**

"Kangjelet e Rilindjes" apo "Këngët e Rilindjes" të shkruara më 1959, të prezantuara para lexuesit të kohës me një punim cilësor tipografik dhe të shoqëruara me shënime shumë të vlefshme, dëshmojnë për një rikthim të Koliqit në fushën e letrave pas një heshtjeje të gjatë poetike që bashkëshoqëroi mërgimin e poetit në Itali. Herë pas here, autori ishte prezantuar në shtypin e kohës me ndonjë poemth a poezi, por për një poet, që kishte arritur kulme letrare në dheun amë, shfaqet aty - këtu ishin mëse të pamjaftueshme.

Frymëzimi që ia kthjell ndjenjat e risjell tek Koliqi vargun është bota arbëreshe, ajo lidhje e pazgjidhshme që i ka mbajtur vazhdimisht të bashkuar në një aspiratë të vetme popullsitë e dy brigjeve, ligjërimi i individualitetit etnik të racës që ndajnë këto dy komunitete i shkrirë në një. Andaj këtë poemth autori ia dedikon shqiptarëve të Italisë, të cilët duke i mbetur besnikë për pesë shekuj, në tokë të huaj, gjuhës dhe traditave të etërve të tyre heroikë dëshmuan në mënyrë të shkëlqyer para gjithë botës që shpresa në fatet e atdheut nuk mund të tretet në vajin e mërgimtarëve.

Një botë a lidhje reale e transformuar në poezi

Është i njohur kontributi që dhanë italo-shqiptarët për kulturën dhe pavarësinë e atdheut të tyre të origjinës. Mes tyre, një kontribut i kudonjohur është dhe ai i Koliqit. Një punë e thellë akademike përmes

leximit të teksteve e dëshmime nga më të larmishmet të shpërndara në biblioteka të ndryshme; regjistrimi dhe mbledhja e vlerave e traditave popullore në shtegtimet nga Abruzzo në Basilicat, nga Kalabria në Siçili, vijim i punës nisur më së pari në Malësitë e Veriut, do t'i shërbenin si një truall i vetëmjaftueshëm për t'i ngjallur në shpirt turbullimin poetik të "Kangjeleve të Rilindjes".

"Prof. Koliqi, që njihte shumë mirë vitalitetin dhe pasurinë e popullit shqiptar e bazoi veprimtarinë e tij prej politikani e shkrimtari pikërisht mbi traditën popullore" .¹ Por duke mos ngelur në kufijtë e kerkimeve historike e kritike, Koliqi i vesh idetë me sharm duke i falur lexuesit atë botë që është bërë burim i gjallë poezie për këngën e tij: rigjetjen e kujtesës së lashtë të origjinës së njerëzve të vet që është ruajtur e paprekur dhe e freskët, e pastër në tiparet e veta ilirike, e mbajtur larg ngjarjeve nganjëherë aspak të lumtura historike të mëpastajme. Dhe ja se si shpalosen në vargje traditat e të parëve tanë: *"Dal' nga shpija qi m'perbujte/me oborr si t'stergjyshave/vetem udhes tue shetitun,/ m'tingulloi nji jon' ke veshi/me ba be se a valle Shkodre/qi shperthen nder shrrregulla/n'mes te dy Shengjergjave."*

Me arbëreshët Koliqin e lidh jo vetëm geni i lashtë e i përbashkët, por edhe udhët e fatit. Pas endjes së trazuar në tokë të huaj, pa e harruar për asnjë moment atdheun e njerëzit e vet, Koliqi mirëpritet nga një copëz e tokës italiane, e cila jetonte akoma në një të kaluar arkaike:

"Tuj u end kot masi kot/larg prej tokës teme/prej mallit i sflitun/pas dhjetë vjetsh ecejakesh lodhun/mbrrita nji buzmbamje kaltëroshe/te nji gurrë me uj' t'kullum./limfe jete gurra burote/e aty nji vajzë me sy si qilli/tek mbushte bucelën me ujë:/- Zanë dalë prej burimit /kjoftë fatlum takimi jonë/-Mirëseardhsh këtu , o burrë/-A e ke nji pikë uj me ma dhanë/-Gjith sa t'dojn zemra/E i bani grusht durt e ndezuna /e tuj mi zgjat m'dha uj me pi."

Pesë shekuj më parë arbëreshët detyrohen të braktisin atdheun e tyre për të gjetur strehë në Itali, pesë shekuj më vonë një tjetër re e zezë e ngarkuar me ngjarje tragjike ia beh "mbi bijt e Shqipës, mbi këta pinjojë të racës, mbi ajkën e gjakut shqiptar" ² duke e detyruar poetin që aq shumë e desh e aq

bukur i këndoi Shkodrës të mërgojë për të mos iu nënshtruar dorës së atyre që s'kanë respekt për lirinë ideologjike e kulturore të tjetrit.

Por Shkodra prap i këndon në shpirt, i mohuar nga toka që e lindi, bota e imazheve të ëmbla e të bukura të atmosferës së qytetit të vjetër, të shtëpisë plakë i rezonon në mendje duke e mbytur në gulçe malli për motrat, vëllain, miqtë; gulçe dëshpërimi për "nanën që s'pari e uli n'gjunj e i msoj lutjen e parë"; gulçe urrejtjeje për pabesinë e "gjarpnit t'kuq"; gulçe dhimbjeje për "varret e t'parve qi për ligj patën burrnin" .

*"...buz't qi njomi puthja e tyne
sot idhsohen n'lot mergimi"*

E gjithë kjo paqyrohet dhe në diktimin e formave që vijnë natyrshëm: "receptimi i dukurive dhe ndijimeve të ndryshme të jetës në dhe të huaj, realizohet përmes receptimit dhe perceptimit të botës shqiptare dhe botës shkodrane"³. Festat shkodrane për nderim të Zojës së Këshillit të Mirë kumbojnë edhe ndër arbëreshët e Italisë, të cilët edhe sot e kësaj dite adhurojnë legjendën e shkëputjes së Zojës nga muret e kishës bri "Rozafës", ndaljen e figurës së saj në Gjenacan, prej ku kulti i saj do kalonte në vendet italo-shqiptare të Kalabrisë. Ndërsa celebrimi i pashkëve në Frashineto, i sjell ndër mend kremtimet në qytetin e Rozafës.

Është i njohur respekti që kishin shqiptarët për festat dhe shkodranët për kremtimet fetare. Festa shqiptare ishte një "lum ngjyrash" që përfaqësonte mbijetesën dhe ardhmërinë. Ndaj dhe atmosfera festive që ngërthen këtë poemth është gjithashtu në shërbim të idesë përshkuese. Gjithnjë i kujdesshëm, autori s'ka harruar të përmendë dhe detajet më të spikatura të festës shqiptare: vallen, sofrat, gazmendin, mikpritjen e veçanërisht veshjen, përkujdesja ndaj së cilës në ditë festash ishte e veçantë dhe përbënte një nga demonstrimet më të bukura të pasurisë shpirtërore, por dhe materiale, si dhe përfaqësonte tipologjinë e krahinës që e mbante.

VESHJA E MALËSORES

Edhe ju , mori fisnike,
shtatvergjilta n'breza argjanti,
t'frytin gjoks mbulue me stringla

VESHJA E ARBËRESHES

Ari i ndritte i brezave
n'fafurin e dritave,
e valim i rizave
mrekullisht t'qindis

Autori dallon tek arbëreshët vëllezërit e gjakut, të dokeve e zakoneve, të dhimbjes e vuajtjes së përbashkët, të shpresës për ta parë atdheun të lumtur ndaj s'i vë fre këngës së tij e mund melankolinë e mërgimtarit e fillon t'i bierë " burisë shortare".

"Poetit të dëbuar nga atdheu i ishte rreshkur frymëzimi, fikur nxitja, shtysa që gëlon në zemrën e çdo artisti për t'i dhënë formë e jetë vizioneve që vibrojnë në zemër. Ai rigjen papritmas frymëzimin sapo bie në kontakt me atë botë të vogël shqiptare që akoma i rezistonte kohës në Kalabri. Dhe ideja të cilën mbase për vite e kishte përkëdhelur në intimitetin e shpirtit, por kurrë shprehur, për një Shqipëri unike, pa kufij kohe e hapësire, pa fraktura e kufizime mentalitetesh, ideologjish e rënkimesh të vjetra, formësohet në këto këngë , ku shpirti i Koliqit ngrihet në një vizion lartësor për një të ardhme plot shpresa përzier me një mallëngjim për kujtimet e largëta".⁴

De Rada dhe Koliqi

"Jeronim de Rada në shekullin e kaluar me veprën e tij largpamëse e të pashlyeshme i dha një ton zërit të italo-shqiptarëve, rizgjoi ndërgjegjen e tyre nëpërmjet zbulimit të etnicitetit shqiptar, e ngriti çështjen shqiptare në nivel europian. Fara që hodhi De Rada çoi në pavarësinë e Shqipërisë prej sundimit turk më 1912. De Rada evokon periudhën e Skënderbeut⁵ kur Shqipëria gëzonte liri të plotë, gati si të thuash, zhytet në këtë të kaluar duke "fshirë" një periudhë të gjatë nga kujtesa, zgjon zjarrin e një jete të re në ato njerëz me tradita të pasura autoktone.

Kur E.Koliqi zbriti mes shqiptarëve të Kalabrisë e ndjeu se kishte të bënte me një botë të njohur për të. Dalloheshin qartë në këtë botë gjurmët e një spiritualiteti që i përkiste një populli tjetër, një spiritualizëm i njëjtë me atë të malësorëve shqiptarë. Takimi i Koliqit me arbëreshët ishte një takim mes njerëzish që kishin pësuar të njëjtin fat."⁶

Këngët, që të mërguarit kishin mbartur me vete dhe ruajtur me xheloz, De Rada i mblodhi dhe interesimi i tij për to u bë zëdhënës jo

vetëm i anës teknike, i trajtave të jashtme, i vargjeve, por edhe i thelbit njerëzor të shpalosur në këngët e popullit. Me të njëjtën eksperiencë ishte mbraujtur edhe autori ynë, ndaj mund të shprehemi me bindje se takimi i këtyre poetëve me poezinë popullore lind poezinë e tyre të mirëfilltë me frymë spontane e tipare kombëtare. Prandaj një numër vargjesh janë ndërtuar mbi bazën e vargut tonë gojor, sidomos të lirikës gojore. Kështu nga "Kangjelet e Rilindjes " veçojmë:

*"si flutrim vidash mbi majë,
ju m'ia ndiellt' agimin dritës
Gushabardha të Frasnitës,
qi m'ringjalli n'hove uzdaje"*

Ndërsa mjaft vargje të tjera janë ndërtuar mbi vargun e poezisë gojore arbëreshe dhe atij deradian.⁷Aq e dukshme është kjo sa vargjet hera-herës janë thujse krejtësisht të njëjta, por kjo duket të mos e ketë shqetësuar fort Koliqin psh:

KOLIQI

"Ngjyrë e fille ndrrue kish jeta:"

DE RADA

"Bota kish ndërruar lisa"

Por Koliqi shkon akoma më tutje, veç përdorimit të së njëjtës metrikë, rimarrjes së shprehjeve e vargjeve të De Rades, ai huazon nga "Këngët e Milosaos" edhe imazhe apo motive. I tillë është p.sh motivi i takimit të vashës me djalin në krrua, ku ky i lyp vajzës një pikë ujë për me shu rreshkjen, psh

KOLIQI

"-Mir' se t'gjeta vasha e lume.

-Mir' se vjen, ti lum zotnija.

-Nji pikë uj a e ke për mue?

-Sa t'dishron ty zemëra"

DE RADA

"Trimi

-Vajzë, a m'ep ti një pikë ujë?

Vajza

- Sa të dush ti, bir zoti "

Doket jetësore apo elementët etnografikë ,me të cilat është e mbushur

poema e De Radës e që perbëjnë dhe strukturën e jashtme të "Këngëve të Milosaos" i gjejmë edhe tek "Kangjelet e Rilindjes", të tilla janë:

-festat: tek De Rada gjejmë festën e Shën Merisë Mesoporite apo Zonja e Kostandinopolit , ndërsa Koliqi na sjell atmosferën e festave të Zojës së Shkodrës e të Pashkëve;

-vallet: tek De Rada ato janë pjesë funksionale e strukturës, si kori në antikitet, ndërsa tek Koliqi pjesë e atmosferës dhe "vallataret" zëdhënese të asaj tradite që s'njohu mort, por vetëm qëndresë për pesë shekuj me rrallë;

-veshjet: tek De Rada njihemi me detaje të uniformës shqiptare si "jetullëza", "keza", "guna e kuqe" etj , ndërsa tek poema e Koliqit me "minzat", "stringla", "riza" etj.

Po cila është arsyeja e këtyre përngjasimeve?

Romantizmi aktiv i De Rades i kishte shkuar për shtat arbëreshëve, ndërsa synimi i Koliqit ishte të rikrijonte atë atmosferë italo-shqiptare me të cilën arbëreshët ishin familjarizuar, por dhe që i shërbente qëllimit të tij. Ky qëllim, që lidhet me besimin e tij të patundshëm në Shqipëri, sigurisht, dhe pjekuria artistike bëjnë që pasi zgjedh si formë për shtjellën e mendimeve të tij traditën popullore dhe vlerat më të mira deradjane, t'i tejkalojë këto. Më poshtë citohen mendime mjaft të vlefshme të Pietro Tamburit në lidhje me këto kalesa letrare, që shprehin një evolucion estetik brenda një vepre të kufizuar në përmbajtje për ta bërë këtë. Megjithatë Koliqi ia ka dalë mbanë:

" Në fakt, Koliqi imiton kastile, disa këngë të "Milosaut" të De Radës, për të vazhduar pastaj me formën rapsodike të këngëve popullore shqiptare. Këtë ngjitur e bën për të realizuar në mënyrë ideale bashkimin e rracës shqiptare. Rezultati është me të vërtetë i shkëlqyer, pasi poeti e tejkalon këtë lojë imitimi të jashtëm duke i dhënë të gjitha këngëve atë vulë thellësisht personale që tashmë e dallon nga të tjerët. Nga ana tjetër zgjedhja e formave popullore dhe stilit të De Radës tregon se ai, si artist i vërtetë që ishte, mund të lëvizte lirshëm në kërkim të formave të vjetra por duke i dhënë atyre një shpirt të ri ". Më tutje, Tamburi shprehet se momenti i mrekullueshëm që ka fiksuar mjeshtri s'mund të formësohej përveçse me atë formë që ai përzgjedhi. Frymëzimin për këtë formë duhet t'ia kishte

sugjeruar vetë bota arbëreshe e cila ndonëse mbijetonte, akoma shfaqte në mënyre inkoshiente frikën e zhdukjes përgjithmonë.

"Kjo atmosferë, që poeti ka ditur ta krijojë me një mjeshtëri të hollë, e shoqëron lexuesin deri në këngën e fundit. Duke gjetur një pjesë të vetvetes mes vargjeve që rrjedhin gjithmonë me ritmin e rapsodive mbushemi me kënaqësinë e të zhyturit në lumin e frymëzimit që i ka dhuruar këngën poetit" -, përfundon Pietro Tamburi.

Një nga meritat kryesore të De Radës është fakti që ai e ngriti të folmen e katundit të tij Maqë, në lartësinë e gjuhës letrare. Edhe Koliqi, i cili kishte studiuar për shumë kohë veprat e D'Annuncios e Carduccit, kishte jetuar mes malësorëve dhe arbëreshëve duke mbledhur gjuhën e gjallë të tyre, i ishte përkushtuar për vite me rrallë studimit të teksteve të autorëve të vjetër e atyre arbëresh. Ai arrin ta çlirojë shqipen nga fraza e zakonshme, i jep muzikalitetin formal, i nxjerr në pah të gjithë bukuritë e fshehta dhe duke iu përmbajtur vazhdimisht formës së ashpër rapsodike që e kishte përzgjedhur vetë, i jep vargut një rrumbullakosje magjepëse.

Gjuha personale është e reja që Koliqi ka futur në letërsinë shqiptare, por që gjithsesi qëndron në vazhden e përpjekjeve të traditës letrare shkodrane perfaqësuar nga Mjeda, Gurakuqi, Fishta etj.

Së fundi, Koliqi jo ratësisht nga autorët arbëresh zgjedh pikërisht De Radën si udhërrëfyes. De Rada për të është "i pari shqiptar modern në pionierët e '800-ës". Ky shqiptar e shkrimtar i civilizuar ishte njëkohësisht dhe mesazhier i ringjalljes politike: *"Qysh me veprën e parë, De Rada do të paraqitet si një poet me ndergjegje kombtare... E gjithë popullsia arbëreshe që për shekuj mbeti e paprekur nga ndotjet barbare aziatike në thelbin e vet etnik, nëpërmjet De Radës hodhi, në gjysmën e parë të '800-ës, drejt qiejve të errët të atdheut të origjinës mesazhin e parë që lajmëronte një ringjallje jo të largët politike."*⁸

Vlerësim

Një nga vlerësimet që mbështet dhe nga Tamburi në analizën që i bën kësaj vepre është se autori priret natyrshëm nga ndërtimi logjik i

krijimeve të veta poetike, në një kohë që poezia është ajo që më pak se çdo lloj tjetër mund ta mbartë këtë procedim artistik.

"Në fund të fundit,- shprehet Tamburi,- autori paramendon çdo efekt dhe me vetëdije meditative e end të tillë vargun që të frenohet që në lindje në vrullin e tij, që shpesh mund të na duket si i dhënë falas, por që në ekonominë e kompozimit poetik shërben për t'i dhënë frymëmarrje e çlirim të brendshëm poetit si dhe trupëzim sensacioneve që lëkunden në mes racionalitetit dhe iracionalitetit"

Po hamendësojmë këtu për një nga vargjet që autori instalon në Këng IV: "Eja,gjaku inë i shprishur", varg i cili krijon marrëdhënie organike me atmosferën poetike të kësaj kënge.

Dihet se autori e shkruan poemën e tij në 1959. Po këtë vit në revistën "Shejzat" (Korrik-Gusht '59, Nr 7-8, f. 288-289), në artikullin "Zanafilla e një fjalës historike", Koliqi shkruan:

" Fjalija "Gjaku i ynë i shprishun" qi në premin e vet plot vështrim të theksuem e të thekshëm përfshin mbarë gjinden arbnore nuk asht hartue prej J.de.Radës, sikurse përgjithësisht mendohet, por duket se asht e rëndomtë ndër fshatra të Lukanjs ku edhe sot flitet shqipja". Me pas Koliqi citon De Radën në shpjegimin e hajtjes së kësaj fjale nga drejtori i "Omnibus-it" (fletore letrare) Vinçenz Torelli dhe përdorimin e saj dhe nga të tjerë si zonjusha Concetta Maria Torris në thezën e doktoratës së vet "Le tradizioni popolari degli Albanesi di Lungro".

Duke pasur një origjinë të tillë kjo shprehje e ka të sigurtë receptimin për rrjedhje dhe efektin tek lexuesi, aq më tepër po të merret parasysh edhe konteksti përfshirës. Por kjo s'i mjafton Koliqit, në kushtet e promovimit të veprës së tij ai kërkon të rikonfirmojë origjinën e kësaj "fjalie historike", si një njohje për ata që s'e dinë dhe si një kujtesë për ata që e kanë harruar. Kështu vlera funksionale dhe emocionale e shprehjes ridimensionohet.

Kjo përkujdesje racionale ndihet jo vetëm tek "Kangjelet e Rilindjes" por dhe në mbarë veprën koliqiane.

SHËNIME

- ¹ Fortino. C. Italo, "E Koliqi e gli "Arbereshe".
- ² Kështu i quan Koliqi shqiptarët.
- ³ Shprehet A. Berisha tek "Koliqi poet dhe prozator".
- ⁴ Citat i Piero Tamburit tek artikulli, "Kangjelet e Rilindjes del Koliqi".
- ⁵ Të njëjtën gjë por me më realizëm bën Koliqi në veprën e tij të parë "Kushtrimi i Skënderbeut", cituar nga Fortino.C. Italo "E.Koliqi e gli "Arbereshe".
6. Të njëjtën gjë konstaton Berisha .A , "Lloje e struktura vargësh të ndryshme", f. 55 , "Koliqi poet e prozator".
7. Koliqi. E., "Tre poetet më të mëdhenj të Shqipërisë", Romë, 1961.

LITERATURA:

1. Koliqi. E., "Kangjelet e Rilindjes", "Shejzat", 1959.
2. Berisha, A., "E. Kolqi, Poet dhe Prozator", Tiranë, 1997.
3. Fortino. C. Italo, "E Koliqi e gli "Arbereshe", numër special i "Shejzave", 1978.
4. Tamburi.P., "Kangjelet e Rilindjes del Koliqi", "Shejzat", 1959.

Rrezarta DRAÇINI, Rezearta MURATI
(Shkodër)

“HYLLI I DRITËS” PËR ARBËRESHËT

Gjuha dhe kultura kanë një rol shumë të madh në krijimin e indentitetit kombëtar. Nevoja për forcimin e këtij identiteti tek shqiptarët brenda dhe jashtë vendit ka bërë dhe bën të domosdoshme kërkesën për një shkëmbim kulturor, shkencor dhe shpirtëror. Uniteti i një kombi arrihet kur çdo kombas ndërgegjësohet për tërësinë e vlerave që i përkasin. *“Nëse këto vlera mbetën të copëtuara, nëse nuk njihen dhe nuk bëhen pjesë e përbashkët e gjithsecilit, ky unitet mbetet abstrakt”¹⁹⁸*. Shqiptarët arritën të mbijetonin të ruanin gjuhën dhe identitetin kombëtar sepse ishin të vetëdijshëm për vlerat që trashëgonin. Jemi këtu pikërisht për këtë qëllim, për të vënë në dukje lidhjen shekullore mes shqiptarëve dhe përpjekjet e përbashkëta për kombin dhe gjuhën shqipe, të cilat nuk njohën as kufij shtetëror e as ndarje politike.

Shkodra, një nga qendrat e zhvillimit intelektual në Shqipëri nga njëra anë dhe arbëreshët përtej kufirit si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së kulturës dhe gjuhës shqipe nga ana tjetër janë dy boshte shumë të rëndësishme në kalvarin e gjatë të luftës dhe përpjekjeve për një gjuhë, një komb si tërësi e identitetit shqiptar.

1. Revista “Hylli i Dritës”

Duke pasur parasysh këto të përbashkëta mes intelektualëve shkodranë dhe atyre arbëreshë jemi ndalur konkretisht tek *“Hylli i Dritës”* e cila ka qenë e para revistë e botuar në Shqipëri, me një program të qartë atdhetar, politik dhe kulturor, duke u bërë kështu tribunë e një plejade

¹ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 221.

letrarësh, gjuhëtarësh e studiuesish të çështjes shqiptare. Në “Fjalorin Enciklopedik shqiptar” të botuar më 2008 nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, shkruhet kështu ndër të tjera për revistën “Hylli i Dritës”: “... *Revista pati një numër të madh bashkëpunëtorësh , kryesisht të klerit katolik, por edhe të studiuesve të besimeve të tjera fetare. Solli studime e të dhëna me vlerë në fushën e historisë së Shqipërisë , të së drejtës zakonore shqiptare, krijimtari të shumta letrare, folklorike, gjuhësore etj...*” .

Në punimin tonë jemi ndalur në botimet e “Hyllit të Dritës” të cilat ndahen në dy periudha të saj (nisur nga klasifikimi që ka bërë studiuesi Willy Kamsi). Periudha e parë përfshin vitet 1913-1914. Është një periudhë prove pasi për herë të parë në Shqipëri botohet një revistë periodike me një nivel të tillë kulturor. Në këto vite tek “Hylli i Dritës” trajtohet aftësia e shqiptarëve për të organizuar shtetin e tyre, marrëdhëniet mes fesë dhe shtetit, marrëdhëniet mes individit dhe shtetit. Nuk mungojnë shkrimet me sfond historik, kulturor e gjuhësor duke vënë në dukje problemet e gjuhës shqipe. Politika ndërkombëtare dhe roli i fuqive europiane mbi Shqipërinë zënë një vend të rëndësishëm në shkrimet e kësaj periudhe nisur dhe nga koha e botimit. Periudha e dytë përfshin vitet 1921-1924. Janë vitet kur u shënuan një zhvillim në fushën kulturore dhe jo vetëm. Temat që trajtohen në këtë periudhë vënë theksin në ruajtjen e shtetit të rilindur shqiptar si nga faktorë të brendshëm ashtu dhe të jashtëm. Dalin në pah probleme të legjislativit dhe ekzekutivit siç janë parlamenti dhe qeveria. Në plan të parë në këto vite vendoset rilindja shpirtërore e individit dhe ideali shqiptar. Tashmë bëhen objekt artikujsh të veçantë studime në fusha të ndryshme: gjuhë, arsim, studime inxhinierike, hartime tekstesh, studime historike etj.

2. Hylli i Dritës për arbëreshët

Revista “*Hylli i Dritës*” që nga vitit 1913 kur doli numri i parë i saj ka trajtuar probleme të rëndësishme që lidhen me çështjen shqiptare në përgjithësi, dhe në veçanti me gjuhën, letërsinë, historinë, folklorin e

politikën. Në tërësinë e kësaj tematike shumëplanëshe si pjesë organike përfshihen edhe emrat e intelektualëve arbëreshë me botimet dhe kontributin e tyre. Një fakt të tillë e vë në dukje dhe studiuesi Willy Kamsi si njohës i mirë i kësaj reviste. “*Nji vend të dukshëm kanë arbëreshët. Kujtohet e shtrohet rishtas në vemendjen e lexuesit vepra e kaq arbëreshve që dhanë ndihmesën e tyre për riejtjen e atyne vlerave shpirtnore, që kanë të mundun mbijetesën e tyre në një ambient krejt të huej.*”¹⁹⁹ Këtë pohim të Kamsit ne e kemi hulumtuar konkretisht në faqet e revistës duke sjellë pasqyrimin real të arbëreshëve tek “*Hylli i Dritës*”.

Që në numrat e parë gjejmë emra të autorëve arbëreshë dhe të botimeve të tyre duke treguar kështu që “*Hylli i Dritës*” do të ishte gjithëpërfshirës. Kështu në numrin e nëntë të saj (*Qershuer 1914, Fq.283*) e përkohshmja boton një poezi të **Zef Sqiro** “*Nga Mirdita Ekscelences s’Tii Prenk Bibdodës*”. Zgjedhja që u bëhet autorëve dhe veprave të tyre nuk është e rastësishme, por është pjesë e qëllimit të vetë revistës. Citojmë një fragment nga poezia e lartpërmendur: “*Ju të lumtë, o bij të Shqypes,/ Që lavdiën me gjakun bleet,/ Tue kalzue nga e cila rrenjë/ Te ky vent i yni u leet!*”

• Gjuhësi

Në një periudhë kur drejtshkrimi i gjuhës shqipe ishte në një udhëkryq, studiuesit brenda kufijve ndërsa trajtojnë probleme të ortografisë i referohen edhe traditës së autorëve arbëreshë. Në numrin 8 të revistës, *Maj 1914 (Fq.242)* kemi shkrimin “*Përdorimi i Ë n’shkrimit t’gjuhës shqype*” me autor Vorf Dukagjinin (pseud. P.Pashko Bardhi) i cili përmend veprën “*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*” **P. Francesco Maria da Lecce**. Në këtë shkrim gjithashtu gjejmë emrat e **Kamardës** e **De Radës** të cilët sipas Vorf Dukagjinit e përdorën ë-në fundore sipas traditës së autorëve të vjetër.

Në korrik të 1921 P.Ambroz Marlaskaj në punimin e tij “*Mbi ortografi të sotshme*” (*Korrik 1921, fq.114*) i referohet Kamardës me veprën e tij “*Saggio di Gramatologia comparata sulla lingua albanese*” .

¹⁹⁹ Willy Kamsi, “*Hylli i Dritës*”, Bibliografi kronologjike, Shkodër, 2008, f. 6.

P. Marin Sirdani në numrat e ndryshme të revistës ka një rubrikë të tijën “Shqyphtarët e hartet” ku bie në sy referimi i shpeshtë që i bën ai autorëve arbëreshë për çështje historike, gjuhësore dhe letrare. Sirdani dallohet si një njohës shumë i mirë i studiuesve arbëreshë madje në një shkrim të vetëm të tijin gjejmë disa referenca nga botime arbëreshe. Kështu në shkrimin e prillit të vitit 1922, (fq. 181) ndeshim një pohim të **Emzot Crispit** marrë nga libri “Memoria sulla lingua albanese” i cili shprehet se “*Alfabeti i shqipes përbëhet prej tridhjetë germash dhe i ngjason alfabetit të gjuhëve të vjetra, disa germa i ka të ruajtura prej alfabetit shumë të hershëm që përdorej në Iliri, Maqedoni e Epir.*” Në po të njëjtin artikull përmendet edhe Kamarda me “Discorso preliminare all’Appendice al saggio di Gramatologia Comparata sulla lingua albanese”. Sirdani vazhdon artikullin duke u ndalur tek një tjetër arbëresh, **P. Francesco Maria da Lecce** për të cilin shkruan: “*Francesk Maria prej Lecce përmbledhi disa vrime gramatikore “Osservazioni Grammaticali – Nella Lingua Albanese”, botuar në Romë 1716.*”

Fruer 1923, fq.62 Gaspër Gurakuqi në shkurt 1923 në artikullin “Shë Hieronimi i illyras” duke trajtuar çështjen e trashëgimisë gjuhësore iliro-shqiptare i referohet **P.E. Guarnerio** me librin “Le origini neolatine” botuar në vitin 1920, duke e cituar se: “Shqypja, gjuhë indo-europeishte asht një jetë-giatesë e illyrishtes”.

Redaksia e revistës nuk ia lë rastësisë trajtimin e autorëve arbëreshë, por herë pas here ndërhyr vetë me shkrime për ta. I tillë është rasti i shkrimit me rastin e 100-vjetorit të lindjes së albanologut **Dhimitër Kamarda (1821-1921)** në Piana dei Greci. Ky shkrim paraqet aktivitetin e organizuar nga **Zef Skiroi** për kremtimin e këtij rasti, duke përfshirë më pas edhe një jetëshkrim të plotë të jetës dhe veprës të Kamardës. (*Dhjetuer 1921 fq. 356*)

- **Histori**

Emrat arbëresh nuk mungojnë as kur flitet për historinë dhe çështjen kombëtare. Në dhjetor 1921 gjejmë artikullin “*Duke kënduar një libër*” që është recensë që Lumo Skëndo (Mithat Frashëri) i bën librit “*Histori e*

Shqipëtarëve t'Italisë” të **Pietro Scaglione**, botuar në New York, 1921, një volum me 101 faqe. (*Dhjetuer 21 fq. 34*). Lumo Skëndo shprehet se kjo vepër na mbush një mungim e një nevojë sepse për pesë shekuj të gjatë të dy palët rronin në mosnjohje të njëri-tjetrit. Por arbëreshët kanë mbetur besnik në shpirtin e gjyshërve të tyre. Në të njëjtin shkrim ai përmend edhe emrat e disa shkrimtarëve të tjerë arbëresh si: **Stratico** me *“Manuale di Litterarura Albanese”*, **Vincenzo Dorsa** me *“Ricerche e Pensieri”*, **Kamardën** dhe **De Radën** për të cilët thotë se shumë prej lexuesve tanë u dinë vetëm emrat.

Artikulli “Dyndja e Shqiptarëve t'Italisë” (Qershuer 1921) bën një historik të shkurtër të ngjarjeve që ndoqën vdekjen e Skëndërbeut dhe u shoqëruan edhe me eksodin e madh të shqiptarëve drejt brigjeve italiane. “Hylli i Dritës” vë në dukje se në këtë libër paraqitet një dokument i botuar për herë të parë nga De Rada në 1866 në “Rapsodie d’un poema albanese...” i nxjerrë nga një dorëshkrim rreshtuar nga **Agostin Toci** (shqiptar prej Shën Kozmit) që jetoi në gjysmën e parë të shekullit XVII. Ky dokument përshkruan peripecitë e udhëtimit dhe të ngulimit të shqiptarëve në trojet ku sot e kësaj dite vazhdojnë të jetojnë. Artikulli mbyllet me këngën e përmallshme “O, e bukura More” në versionin e marrë nga libri i Kamardës.

Në Gusht 1922, fq.381 në artikullin “Besa e Trimnija shqiptare” të **P. M. Sirdani** kemi një referencë të librit “Conferenze su l’antichita della lingua albanese”, Napoli, 1893. Në të njëjtin artikull shohin edhe shënimin “*Edhe shqiptarët e Itales diftuen nji trimni të pashoqe me Garibaldin*”.

Në numrin *Ndanduer 1921* (fq. 331) ndeshim referencën historike të **emz. Zef Crispi** në librin e tij “Memorie storiche di talune costumance appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia”,

Në botimin e *Qershuer 1923*,(fq.274) **P. Marin Sirdari** në artikullin “Flamuri komtar” shqyrton çështjen e flamurit si simbol të kombit i referohet **Giuseppe Schiro** me “Te dheu i huaj” dhe “Piana dei Greci, Guida illustrata delle Colonie Albanesi di Sicilia” 1922, të përkohshmes

“Flamuri i Arbërit”, Cosenza, 1885.

- **Letërsi**

Nanduer 1922, fq.540 A. Marin Sirdani në serinë e tij “Shqiptarët dhe Hartet” (Poezija) shkruan se kur në vitin 1866 u shtypën “Rapsodijet Shqiptare” të mbledhura nga **G. De Rada** autori mori përgëzime nga Antonio Parato në “Guida di Torino” dhe nga poeti i madh francez Lamartine. Autori cilëson: “*Nder poetë të perlindjes shqiptare dahet në shej Hjeronim De Rada, kryevepra e t’cilit asht “Kangët e Milosaut”, ai diti të përmbledhë më së mirë ndjesitë dhe shprehjet më të bukura të rapsodive të italo-shqiptarëve dhe qe i palodhur në shkrime e në lëvrimin e gjuhës amtare si dhe nxiti të tjerët të merren me këtë çështje.*

Dhjetuer 1922, fq. 571 Artikulli është vazhdim i numrit të mëparshëm autori i referohet “Antologia albanese” të **Girolamo de Rada** dhe përkthimit të disa këngëve të përkthyer nga **P.Camarda**. Rreth viteve 1860-90 **P.Francesk Antonio Santori**, italo-shqyptar botoi disa vjersha të cilat janë vlerësuar por për arsye se Sirdani nuk i ka pasë në dorë parapëlqen të mos japë një vlerësim për to.

Në numrin e *Gusht 1922, fq.381* po aty citoj: edhe në kohë të tashmë kemi poetë mjaft të mirë si: **Giuseppe Schiroi** me veprën “Milli e Haidhia”

- **Bibliografi**

Në secilin numër revista ka rubrika të veçanta të titulluara “Bibliografi” dhe “Kan mrrijtë në drejtim” në të cilat pasqyrohen botimet më të fundit brenda dhe jashtë kufijve. Në Shkurt të 1922 (fq. 96) lajmërohet botimi i veprës “L’Albania” me autor **Anselmo Lorecchio**, e cila sipas redaksisë trajton ngjarjet më të rëndësishme të katër vjetëve të fundit që i përkasin zhvillimit politik të çështjes shqiptare. Në mars 1922 (fq. 143) paraqitet vepra e **Primaldo Coco** “Casali albanesi nel Tarentino”. Për të cilën shkruhet se është një vepër që vjen për të sqaruar historinë tonë kombëtare dhe më saktësisht dyndjen e shqiptarëve në Itali duke përfshirë edhe 18 dokumente me rëndësi të nxjerra nga Arkivi

Shtetëror i Napolit, Lecces dhe të Kurjes Arqipeshkvore të Tarantit. Dy muaj më pas (*Maj 1922, Fq. 248*) gjejmë sërish njoftimin që **Primaldo Coco** ka botuar “Vestigi di Grecismo in Terra d’Otranto”. Në po të njëjtin numër lajmërohet se **P.Francesco Fazio** ka botuar “La Madonna Odigitria”, libër për shqiptarët në shqip, greqisht dhe italisht, një libër i vogël me 24 faqe që trajton historinë e shqiptarëve të Italisë.

- **Lajmërimet për shoqëri ose organe**

Element shumë i rëndësishëm tek “Hylli i Dritës” është informacioni i shpejtë dhe në kohë reale që jepet për organizimet e shqiptarëve përtej Adriatikut si dhe për shtypin arbëresh të kohës duke u bërë kështu një pasqyrë e gjithçkaje që ndodhte atje. Në Gusht 1921 (*fq.192*) redaksia jep vlerësimin e saj për “La Nazione albanese”, drejtuar nga **Anselmo Lorecchio**, duke e cilësuar si një organ i unjisimit komtar. Pas disa muajsh në numrin e Dhjetorit 1921, (*fq.36*) përgëzohet ngritja e qendrës së manastirit Grottaferrata afër Romës e cila merrej me kërkime historike dhe letrare mbi Arbëreshët dhe Shqiptarët dhe që në revistën e saj “*Roma e l’Oriente*” ka botuar studime me rëndësi të vërtetë. Në po atë numër (*f.47*) lajmërohet ngritja e një shoqnie studentësh shqiptarë me emrin “Naim Frashëri” në Napoli, kjo shoqëri synonte të krijonte një bibliotekë dhe të botonte një të përkohshme. Madje “Hylli i Dritës” në emër të tyre kërkonte ndihma nga bashkatdhetarët me libra dhe mjete të tjera. Një vit më vonë në Mars 1922, (*f. 144*) gjejmë informacionin se Shoqëria e studentëve në Itali botoi numrin e parë të organit të përmuajshëm “Shpresa e Atdheut” që nga redaksia u cilësua si një prezantim shumë i mirë i kësaj shoqate.

3. Përfundime

Asgjë nuk ndodh rastësisht, pa pasur një taban ku të zhvillohet, ndaj nuk është rastësi që “Hylli i Dritës” një nga revistat më të rëndësishme të gjysmës së parë të shekullit të 20-të, e botuar në qytetin e Shkodrës pasqyron gjithçka ndodh përtej Adriatikut, tek arbëreshët. “Hylli

i Dritës” ishte një revistë që kishte në qendër të saj problemin e gjuhës shqipe , të kombit shqiptar, kishte një program të qartë atdhetar, politik e kulturor. Arbëreshët gjithashtu kishin krijuar traditën e tyre në përpjekjet për një gjuhë shqipe, për kombin dhe kulturën shqipe. Tabani për t’u zhvilluar kjo urë lidhjeje mes studiuesve shkodranë dhe atyre arbëreshë kishte baza të forta: gjuhën, kombin, kulturën.

BIBLIOGRAFI:

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, “Fjalorin Enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 2008.
2. Rrokaj, Sh., “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007.
3. Kamsi, W., “Hylli i Dritës”, Bibliografi kronologjike, Shkodër, 2008.
4. Hylli i Dritës , seria e botimeve.
5. Jup Kastrati, “Studime Albanologjike”.
6. Mandalà, “Gjurmime Albanologjike” (Për letërsinë e vjetër shqipe), Tiranë, 2006.

Orjeta BAJA, Merita HYSA

(Shkodër)

SHTRESA E HUAZUAR NË FJALORIN “ARBËRISHT-SHQIP” TË KOLË KAMSIT

Kolë Kamsi, një njohës i mirë i kulturës shqiptare në përgjithësi, por edhe i asaj arbëreshe në veçanti, shkroi shumë vepra të një rëndësie të veçantë për kombin shqiptar. Si një nga ata dijetarë shqiptarë që u njoh qysh herët me botën arbëreshe të Italisë, i prekur nga ajo "mrekulli" e ruajtjes së gjuhës e traditave të moçme shqiptare në mjediset arbëreshe në Itali, vuri në fokus të veprimtarisë së vet shkencore mbledhjen e fjalëve, të frazeologjizmave e të folklorit arbëresh, duke dhënë kështu ndihmesën e tij në evidentimin sa më mirë të ruajtjes së shqipes në dhe të huaj. Vepra e tij kryesore, së cilës iu kushtua për një kohë të gjatë dhe që mund të konsiderohet si një dëshmi e gjallë dhe e pakundërshtueshme e vlerës së arbërishtes, qe *Fjalori arbërisht-shqip*, të cilin, prof. Eqrem Çabej do ta cilësonte si *më të mirin në këtë lëmë*.

Në këtë Fjalor prej rreth 8600 fjalësh, autori u ka dhënë vend me përparësi fjalëve dhe formave që i ka ndeshur në veprat e botuara të autorëve arbëreshë, si dhe në lëndën folklorike që kishte në dorë deri atëherë. Natyrisht, ka përfshirë aty edhe fjalë që i ka dëgjuar vetë në mjediset arbëreshe, duke pasqyruar një leksik të dokumentuar me saktësi:

Grafik 1



Kamsi ilustron fjalët me citate origjinale e të zgjedhura, pa shtuar asgjë nga vetja, duke e bërë kështu Fjalorin ... një mjet pune të sigurt për të gjithë shqiptarët, në mënyrë të veçantë për nxënësit, që të lexojnë më me lehtësi letërsinë e pasur arbëreshe, folklorin e shkrimet e shumta të autorëve arbëreshë, por edhe për studiuesit e komentuesit e letërsisë arbëreshe në shpjegimin e fjalëve, që janë bërë thujse të pakuptueshme për lexuesin bashkëkohor.

Themi ‘fjalë të pakuptueshme’, sepse, në këtë vepër, kemi të ruajtur jo vetëm thesarin e trashëguar me fjalë shqipe, por edhe shumë fjalë të huazuara e fjalë të reja të krijuara sidomos me rrugën e kalkimit (për ta shpëtuar arbërishten sa ishte e mundur nga huazimet e panevojshme e për t’i ruajtur origjinalitetin), interferimi dendurisht i të cilave ka çuar në përfitim të një varieteti gjuhësor më vete.

* * *

Në këtë kumtesë vjen si objekt studimi pikërisht shtresa e fjalëve të huazuara, nëpërmjet *Fjalorit arbërisht - shqip* të Kolë Kamsit, duke u ndalur posaçërisht tek ndikimi i atyre italiane (meqë kanë numrin më të madh) në leksikun e arbërishtes.

Të gjitha gjuhët kanë fjalë të huaja në leksikun e tyre, por në shqip (arbërisht) ato janë të shumta, si rezultat kryesisht i pushtimeve të ndryshme për një periudhë të gjatë. Kujtojmë këtu që gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e atyre (gjuhës dhe kulturës) latine, greko-bizantine, sllave e turke, duke lënë kështu në shqip fjalë me origjinë nga këto gjuhë. Takimi i shqipes me latinishten dhe me gjuhët romane (neolatine) kishte nisur që shumë shekuj para se të ndodhte shpërngula e arbëreshëve nga Shqipëria.²⁰⁰ Gjurmët e takimeve të shqipes, qoftë me latinishten ballkanike, qoftë me latinishten letrare e me gjuhët e tjera romane i shohim në një numër të mirë latinizmash e italianizmash në këtë fjalor, si p.sh.: *turp/tyrp* (lat. *turpis*), *urdhër* (lat. *ordo-ordine*) etj. Kjo shtresë fjalësh duhet dalluar nga huazimet dhe ndikimet e mëvonshme.

Përveç ndikimeve gjuhësore të vendeve pushtuese, të cilat i mbartën me vete, arbëreshët, të ndodhur në mjedisin e huaj italian, për të përballuar jetesën në dhe të huaj, krahas përfshirjes në popullsinë e një vendi që kishte tjetër gjuhë, nuk mund të mos pësonin edhe ndikimin nga italishtja dhe dialektet e saj. Takimi i të folmeve arbëreshe me italishten pas shpërnguljes nga Shqipëria, u bë në rrethana krejt të tjera, të cilat me kohë sollën edhe dygjuhësinë arbëresho-italiane, pastaj shumëkund edhe bjerrjen e plotë të gjuhës amtare. Është me rëndësi të theksohet se *rrallë gjen ndër arbëreshët e Italisë dygjuhësi të përsosur*²⁰¹. Deri relativisht vonë *arbërishtja ka mbajtur kurdoherë vendin e gjuhës së parë (L1), ndërsa italishtja ka mbetur gjuhë e dytë (L2)*²⁰².


²⁰⁰ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1960, f. 129.

²⁰¹ Gj. Shkurtaç, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f. 37.

²⁰² R. Titone, *Bilinguismo precoce e educazione bilingue*, Armando Editore, Roma, 1972, f. 254 – 257.


Vepra "Fjalor arbërisht-shqip" pasqyron gjerë këtë proces gërryerjeje gjuhësore që kishte marrë udhë në të folmet arbëreshe dhe që pasqyrohet edhe në leksikun e shkrimtarëve arbëreshë. Në Fjalor ka shumë pak ose aspak fjalë turke (meqë si rezultat i pushtimit (osman), arbëreshët u larguan nga vendi i tyre), të cilat, ndërkaq janë të dendura në shqip, porse ka aq shumë italianizma që janë bërë pjesë e fondit leksikor të arbërishtes së Italisë. Prof. Kolë Kamsi, jo vetëm e konstatoi këtë dukuri, por edhe e hetoi mjaft gjerë atë, duke u bërë vend në fjalor, krahas fjalëve shqipe, edhe aq shumë fjalëve (emra, folje, mbiemra etj.) të huazuara nga dialektet italiane në ligjërimet e folura arbëreshe, apo nga italishtja letrare në gjuhën e shkrimtarëve arbëreshë.

Nga rreth 8600 lema që përmban leksiku i këtij fjalori, rezulton se 1568 prej tyre janë huazime italiane, pra afro 20 % (e leksikut të arbërishtes):



Grafik 2

Huazimet italiane që gjenden në këtë Fjalor, studiuesi Kamsi i ka ndarë në dialektet përkatëse: friulan, napolitan, siçilian, venet, kalabrez; të gjithë këto dialekte të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, por jo plotësisht të kuptueshëm reciprokisht. Ndër to (1568 it.), 960 i përkasin gjuhës standard (e bëjmë këtë pohim duke iu referuar faktit se në fjalor nuk i është shënuar krahas dialekti, siç ndodh me fjalët e tjera, por vetëm përcaktimi si italiane (*it.*), 591 i përkasin dialektit *kalabrez*, 31 i përkasin dialekteve: *friulan* (1), *napolitan* (11) (2 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera), *sicilian* (17) (12 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera), *venet* (2):



Grafik 3

Fondin e huazimeve italiane mund ta grupojmë në:

1- Italianizma të përbashkëta për shqipen dhe të folmet arbëreshe të Italisë, që kishin hyrë në shqip *para se të niste shpërngulja* e arbëreshëve

për në Itali e gjetkë, si: *forca, fund, grup, birra, kundër, mars, engjëll, mik, bukë, qiell, këmbë (geg. kamb), femër, festa, fik* etj. Këto huazime, zakonisht dallohen nga prania e të njëjtës trajtë fonetike, si në shqipen ashtu edhe në të folmet arbëreshe të Italisë. Por, ka edhe shumë raste që italianizmat e të folmeve arbëreshe dallohen fonetikisht nga ato të shqipes së sotme. Për këtë arsye, siç vihet re në Fjalorin në analizë, një numër i madh i huazimeve, edhe pse rrjedhin nga e njëjta gjuhë dhe si të tilla kanë të njëjtën rrënjë, dallohen në realizimin fonik të tyre, duke pasur në të folmet arbëreshe gjurmë më të dukshme të shqiptimit në dialektin italian prej nga janë marrë;

2- Italianizma që ndeshen vetëm në të folmet arbëreshe dhe që mungojnë në gjuhën e sotme shqipe, të cilat kanë hyrë në të folmet e arbëreshëve të Italisë *pas shpërnguljes* së tyre, si: *destinguir, difendir, dominar, fermar, kapir, animalj* etj. Gjatë kësaj periudhe (menjëherë pas shpërnguljes), përmendim si më të fuqishëm ndikimin e leksikut të italishtes dialektore mbi të folmet arbëreshe të krahinave përkatëse, për arsyen e ditur se edhe situata gjuhësore italiane e kohës (që përkon me vendosjen e arbëreshëve në Itali të Jugut) karakterizohej nga përdorimi i gjerë i dialekteve, ndërsa gjuha e përbashkët italiane kishte vend më të kufizuar. Hyrja e tyre është bërë në masë e shkallë të ndryshme në të folme të ndryshme arbëreshe. Duke ndjekur këtë kategori huazimesh leksikore, mund të njohim njëkohësisht edhe bjerrjet e fjalëve shqipe që ekzistonin më përpara.

Duke iu referuar gjithmonë përcaktimit që i bën vetë autori fjalëve në fjalor, pasi mënjanojmë 1568 italianizmat, nga 8600 fjalët e përfshira në fjalor, pjesa tjetër prej 7032 fjalësh i përket *shtresës vetjake* të arbërishtes dhe *shtresës së huazuar* me prejardhje të ndryshme, si: latine, bullgare, frënge, greke, gjermane, perse, rumune, sllave e turke, ku numri i këtyre të fundit (i huazimeve joitaliane) nuk është i konsiderueshëm:

Grafik 4



Është e vërtetë që shqipja, apo në rastin konkret arbërishtja, ka pësuar ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet ato, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Këto huazime rrallë i ndeshim në formën e tyre të pastër; ato, zakonisht, janë përfshirë në sistemin fonetik e morfologjik të arbërishtes, duke iu shtruar një procesi të njohur “shqiptarizmi”. Kështu, gjatë periudhës që vendi ynë, kultura jonë, gjuha jonë ishin nën influencën e kulturës e të gjuhës latine, greko-bizantine, sllave e turke, gjuha shqipe ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë indoevropiane me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë, duke vazhduar si e tillë edhe pas shpërnguljes së shqiptarëve në Itali, me ndikimin italian. Natyrisht, një proces i tillë, në të folme të ngulimeve të ndryshme, nuk ka qenë kudo i njëjtë: diku ai ka qenë më i thellë dhe më i shtrirë, diku më i lehtë, gjë që ka arsye të veta gjuhësore e jashtëgjuhësore.

Mund të themi se leksiku i arbërishtes, parë nëpërmjet këtij fjalori, sado që i ndikuar nga huazimet, kryesisht ato italiane, prapëseprapë ka ruajtur një pasuri të vyer fjalësh të njëjta me ato të mbarë shqipes ose së paku me ato të ndonjë të folmeje, kryesisht jugore, të saj. Megjithatë, gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqitet si një varietet më vete, që nuk është plotësisht i njëjtë me asnjërin dialekt të shqipes në trojet kompakte ballkanike. Sipas studiuesit Gjovalin Shkurtaç, *po të vështrojmë elementet strukturore dhe fonetike themelore të ligjërimeve arbëreshe, rezulton se ato i përkasin toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamërishtes e të labërishtes, po edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë; nga ana tjetër, - pohon Shkurtaç -, ato ligjërime paraqesin edhe dukuri e tipare të reja (inovative) (sidomos në fushën e leksikut), që përcaktohen e kushtëzohen nga takimi i ngushtë gjuhësor që kanë pasur për kaq shekuj me italishten, qysh prej shek. XV – XVI e këtej.*²⁰³

* * *

Identiteti i Arbëreshëve u trashëgua për shekuj me radhë në mënyrë të mahnitshme, në kushte shumë të vështira, kur mungonin edhe mjetet mbështetëse të çdo lloji. Ndjenja që u diktonte përkatësinë në një kulturë të veçantë ka qenë e përgjithshme dhe e trashëguar me zili. Identiteti i Arbëreshëve në nivelin popullor u shfaq nëpër shekuj me një larmi dukurish, ndër të cilat shkëputëm *gjuhën*: gjuha, edhe sot e folur në shumicën e komuniteteve me origjinë arbëreshe, të formuara në Italinë jugore pas vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, përfaqëson një dukuri shumë të fortë që prek si ata që e flasin ashtu edhe dëgjuesit, italianët, që i kanë pritur arbëreshët si mysafirë. Procesi i asimilimit ka ndjekur ligjet e veta, por Arbëreshët i bënë ballë me një qëndrim dinjitoz dhe të fortë duke u prirë gjithmonë nga fuqia e identitetit të tyre.

²⁰³ Gj. Shkurtaç, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f. 17.

Megjithatë, realiteti arbëresh sot, po tregon se situata gjuhësore atje po ndryshon: Shqipja e arbëreshëve të Italisë po merr karakteristikat e gjuhës vartëse në një situatë diglosie. Kështu, elementi gjuhësor arbëresh po dobësohet duke i lënë vend më tepër elementit italian, si rezultat i kalimit më lehtë tashmë për ta në gjuhën italiane, sidomos nga të rinjtë, duke çuar në përfitim të një varieteti gjuhësor ndryshe prej atij të viteve 1960, kohë në të cilën përfundoi së realizuari *Fjalori arbërisht - shqip* i autorit Kolë Kamsi, leksikut të të cilit iu referuam në këtë kumtesë.

BIBLIOGRAFI:

1. K. Kamsi, *Fjalor arbërisht - shqip*, Shkodër, 2000.
2. Gj. Shkurtaj, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006.
3. Gj. Shkurtaj, *Shpirti i arbrit rron*, Tiranë, 1984.
4. E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1960.
5. R. Titone, *Bilinguismo precoce e educazione bilingue*, Armando Editore, Roma, 1972.
6. I. G. Ascoli, *Colonie straniere in Italia. Frammenti albanesi*, në “*Studi critici*”, I, Milano, 1961.
7. *Bilinguismo e diglosia in Italia*, Centro Studi per la Dialettologia Italiana, Pacini Editore, Pisa, 1974.
9. *I dialetti italo-albanesi*, Roma, 1994.

Arben PRENDI

(Shkodër)

KOLË KAMSI PËR FOLKLORIN ARBËRESH NË VEPRËN “SHQIPTARËT E ITALISË”

Kultura dhe letërsia arbëreshe ka qenë një faktor i rëndësishëm dhe me ndikim në kulturën shqiptare të paktën që nga “Këngët e Milosaos” (1836) të J. de Radës. Si e tillë ajo gjithmonë ka nxitur vëmendjen dhe interesin e studiuesve dhe shkrimtarëve shqiptarë sot e kësaj dite. Pse jo studiuesit i janë drejtuar asaj edhe për të gjetur përgjigje që kultura dhe letërsia shqiptare për shkak të shumë arsyeve, nuk ka mundur t’i japë apo t’i argumentojë.

Ndër këta studiues mund të vlerësojmë edhe studiuesin shkodran Kolë Kamsi, me një aktivitet të gjithanshëm shkencor në fushën e gjuhësisë, letërsisë, folkloristikës dhe historisë shqiptare. Interes të veçantë ai pati veçanërisht për historinë, kulturën dhe letërsinë, folklorin e arbëreshëve të Italisë.

Vlen të theksojmë këtu se Kamsi në mënyrë shkencore e drejton vëmendjen ndaj folklorit shqiptar, që me veprën “*Goja e popullit tonë*” 1943, përmbledhje me proverba; “*Lirika popullore*” 1948, apo me punimet për etnografinë, po ashtu edhe me mbledhjet në terren të këngëve të ndryshme popullore, të cilat i boton në organe të ndryshme.

Duke qenë student i Kolegjës së Shën Mitër Koronës arbëreshe, një njohës dhe studiues sistematik i kulturës së arbëreshëve të Italisë, Kamsi i kushtoi vëmendje edhe folklorit arbëresh, të dhënave që ai vetë i regjistroi në terren por edhe kontributin dhe mendimin e studiuesve arbëresh për mbledhjen dhe studimin e këtij folklori si një arkiv i pasur i

kulturës arbëro-shqiptare. Këtë përkushtim në studimin e kulturës dhe historisë së arbëreshëve të Italisë, e dëshmon edhe vepra: “*Shqiptarët e Italisë*” e botuar pjesë - pjesë për dhjetë vite në revistën “Leka” në Shkodër (1934 -1944), botuar përfundimisht në vitin 2006 në Shkodër, nën kujdesin shkencor të Universitetit të Shkodrës, Sektori Shkencor i Albanologjisë dhe “Phoenix”.

Studimi i folklorit, etnografisë dhe letërsisë gojore arbëreshe në këtë vepër nuk është një qëllim më vete, por pjesë e qëllimit që bota arbëreshe të paraqitet në kompleksitetin e saj, ku elementi folklorik, etnografik dhe ai i letërsisë gojore, kanë një vlerë të veçantë sepse e lidhin këtë botë me dheun prej të cilit u shkëput si dhe me traditën e saj, e cila gjendet për autorin në një moment të shturjes dhe zhdukjes përfundimtare si rezultat i procesit të natyrshëm të marrëdhënieve dhe ndryshimeve sociale të epokës moderne. “*Të pajisun me një karakter të fortë mbeten për plot katër pesë shekuj shqiptarë me gjuhë, me veshë, me tradita e me doke. E ket lidhni gjaku me ne nuk e treguen vetëm tue rruajtë me ma të madhin kujdes e me një qëndresë të rrallë që shihet veç në popullin e Izraelit, vetit e karakteristikat e veçanta të rracës s’onë, por e çfaqen ma së miri edhe me dashuni ndaj Shqipnjin, dashuni që e treguen jo veç me fjalë, por edhe me punë, tue i sjellë shërbime të mëdha letrësis shqipe e rilindjes s’onë kombtare*”²⁰⁴. Në një kohë kur nën pushtimin turk, thotë Kamsi, shqiptarët e Shqipërisë kishin nisë me bjerrë ndjenjën e mvehtësisë, kombësisë e gjuhës, “*shqiptari i Siçiljes, i Kalabrjes e i Basilikatës qindronte besnik i patundun i traditave të rracës së vet e me kryelartësi e quente gjithmonë vedin Arbresh, faqe të huejvet. E me ket qindresë e shpirtë konservativ mbriji me flije të mëdha me u ba ballë rrymavet të ndryshme me cilsit etike të kombit shqiptar edhe një tjetër visar të çmueshëm: gojëdhanat e kangët tradicionale të kohës së Skandërbegut, të cilat përbajnë faqen ma të bukur të historisë s’onë*

²⁰⁴ Kamsi, Kolë, “Shqiptarët e Italisë”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Sektori Shkencor i Albanologjisë, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 27.

kombtare, e janë një pasqyrë e gjallë dhe e vërtetë e dokeve t'etenvet t'onë."²⁰⁵.

Krahas informacioneve të natyrës historike, gjeografike, mbi dyndjet dhe vendbanimet e arbëreshëve në Italinë e Jugut, Kamsi herë pas here jep përshkrime të folklorit, etnografisë dhe letërsisë gojore të kësaj popullate të vendosur në zona të tilla, si: Kalabria, Bazilikata, Apulje, Molise, Abruzzi, Campania, Siçilia etj.

Në studimin e botës së arbëreshëve Kamsi veçon ato elemente që i kanë qëndruar kohës dhe janë elemente që ruajnë identitetin e tyre si shqiptarë. Ja si e përshkruan tipin e arbëreshit për nga bota e tij morale, shpirtërore, psikologjike:

*"Fjalën e kanë fjalë e besën besë, nderimin e mënin që kanë për ndokend e çfaçin sheshas, mikun e duen e e nderojnë si mik, janë t' urtë, por edhe gjakxehtë kur i përqeshë dhe i fyen kush, e nuk barin as shpoti as dhunë. Fjalën e vrazhme e dhunen e mbajnë mend, bakeqin e anmikun nuk e falin kollaj e ku i lypë nderi e burrnija janë t'idhtë e gjakmarrës."*²⁰⁶.

*"Të përmendun janë edhe për pritje të mikut. Përbujtnia e tyne, si e Shqiptarit të maleve t'ona, asht e shujtë e legjendare. Mikun e presin me andë; me gjithë zemër i a shtrojnë bukën e e gostisin. Jo vetëm farefisi, por edhe udhëtarët e huej që kanë vu kambën ndër tokë të tyne kanë gjetë gjithherë nderime, bujari zemre e stimë."*²⁰⁷.

*"Kanë bindje e nderim për prind, dashuni per vllazen e për motra e një një mënyrë të veçantë nderojnë edhe vllan e madh që në vend të prindes mbarshton dhe këqyrë punët e shtëpis. E kjo lidhje dashunije midis pjestarvet të një familjeje shtrihet edhe në një rreth ma të gjanë, përfshin deri gjinin e farefisin."*²⁰⁸.

²⁰⁵ Po aty, f. 28.

²⁰⁶ Kamsi, Kolë, "Shqiptarët e Italisë", Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Sektori Shkencor i Albanologjisë, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 73.

²⁰⁷ Po aty, f. 73.

²⁰⁸ Po aty, f. 74.

Kamsi i kushton rëndësi edhe përshkrimin të veshjes së gruas arbëreshe, për të cilën thotë se përveç ndonjë elementi të ri veshja e saj është e ngjashme me veshjen e kohës së mërgimit të arbëreshëve. Për petkat më të bukura e më të stolisura vlerëson ato të Piana. “Grat e Piana-s zakonisht bajnë tri fill petka: petkun qi mbajnë ndër dit pune: petkun e së dielës e petkat e mira që veshin ndër dasma e ndër te kremte të mëdha, si në Javën e Madhe, ndër dit Pashkësh e ndër festa të Pajtorvet të vendit.”²⁰⁹. Pastaj bën edhe një përshkrim të hollësishëm të këtyre veshjeve si petkat e mira: linja, krahët, ncilona, brezi i argjendtë, keza, skjepi, etj. Kamsi vë në dukje se deri në këtë kohë veshjet e grave janë ruajtur mirë, ndërsa ato të burrave jo.

Ndërkaq në përshkrimin e martesës Kamsi vë në dukje se ndër arbëreshë është trashëguar tradita zakonore shqiptare e martesës. Martesat deri vonë, thotë autori bëhen ndërmjet arbëreshëve pastaj në kohët më të reja, edhe me vendasit. Në Greci, thotë Kamsi, deri vonë këndohej prej plakave: “Gjegj ç’të thotë mema ti/ Mirr Arbresh, jo një Ljëti.”²¹⁰. Sikurse në traditën zakonore shqiptare dasma arbëreshe shoqërohet me rite, ceremoniale e këngë e valle të veçanta, për momente të veçanta. Këngët që sjell Kamsi me këtë rast, për dasmën e Kalabrisë citohen nga “Fjamuri i Arbërit” e De Radës, ndërsa ato për Sicilinë, nga vepra e Z. Schiro “Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia”. Kamsi veçon ndër të tjera gjurmë të martesës me rrëmbim, apo grabitje në ndonjë fshat të Kalabrisë. Martesa arbëreshe ruan sipas këtyre përshkrimeve ende gjurmë të ritualit, deri në përfundim të saj, ndërsa natyra e këngëve është lirike, nuk mungojnë as këngë të epikës historike si këngë për Gjergj Kastriotin, apo të epikës legjendare si *Kostandini i vogëlith*. Pasuria e përshkrimeve të dasmës, nxjerr në pah edhe një herë përkushtimin e autorit për të regjistruar një spektakël që edhe te arbëreshët është në zhdukje.

²⁰⁹ Kamsi, Kolë, “Shqiptarët e Italisë”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Sektori Shkencor i Albanologjisë, Phoenix, Shkodër, 2006, f. 76.

²¹⁰ Po aty, f. 80.

Edhe për mortet Kamsi shënon se arbëreshët kanë ruajtur doket e të parëve të tyre dhe i sheh ato të ngjashme me viset e Labërisë. Edhe këtu është e fortë fryma e ritualit dhe e përjetimit tragjik të vdekjes, sikurse në mortet dhe vajet e tjera shqiptare. Ndër të tjera ai vë në dukje edhe ritin e vjetër të vendosjes së një monedhe në xhepin e rrobës së të vdekurit, duke shtuar se ky zakon njihet edhe në Dukagjin e Labëri ku të vdekurit monedha i vendoset në gojë, para se të varroset. Apo shuarja e zjarrit në vatër, porsa vdes ndonjë pjesëtar i familjes.

Po ashtu e dhëna që përshkruan Kamsi, për *Vlamjen*, tregon se ky rit zakon është i njohur ndër arbëreshë, si mes djemve ashtu edhe mes vajzave, dhe është i trashëguar nga atdheu i tyre, në një formë më arkaike se ajo që ruhet në Shqipëri *vllamëria*, apo *probatinia*. Vlamja arbreshe shoqërohet me një sërë elementesh ritualë në përfundim të të cilëve të gjithë vajzat e djemtë që kanë marrë pjesë në këtë ceremoni njehen *vlamë* e *motërma*, në një lidhje të fortë miqësie. Pjesë e botës zakonore e rituale janë edhe ceremonialet Uji i bekuem, Kremtja e karnevaleve, Sh’Lazri, Java e Madhe, Pashkët, Rrëshajet, Shna Prendja, Shën Mërija e Kostandinopullit, Shën Kolli, Kshnellat; në të cilat janë të pandame festa, hareja, riti, besimi fetar me vallen e këngën e popullit arbëresh.

Kamsi në studimin e tij nuk len jashtë vëmendjeje as bestytnitë e lojë të arbëreshëve. “*Në popullin e imtë të këtyne kolonive mbahen shumë bestytni të cilat janë thuejse krejt pors besimet e popullit t’onë e të popujve të tjerë të vjetër. Katundaret e sidomos plakat u besojnë fateve, shtrigave, a magarevet, dreqëzivet a driadeve, drangojt, orkut, synit të keq, influksit të hanës e shumë prrallave të tjera.*”²¹¹.

Mbasi vë re shprishjen e traditës gojore Kamsi thekson ndikimin së pari nga braktisja e kishës së ritit bizantin, përqaftimi i ritit latin dhe ndikimin nga kultura moderne italiane.

Në këtë vepër Kamsi pothuaj për të gjithë kolonitë dhe katundet

²¹¹ Kamsi, Kolë, “Shqiptarët e Italisë”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Sektori Shkencor i Albanologjisë, Phoenix, Shkodër, 2006, f.114.

arbëreshe jep herë pas here të dhëna të shkurtra për gjendjen e folklorit dhe traditës popullore, duke shprehur edhe shqetësimin për zhdukjen e tyre, dhe mungesën e dokumentimit të plotë të kësaj tradite, me rëndësi për studimet e kulturës shqiptare në tërësi.

Një e dhënë tjetër, e vlefshme nga studimi “*Shqiptarët e Italisë*” janë edhe cilësimi i kontributit të studiuesve arbëreshë si J. de Rada, Dh. Kamarda, M. Markiano, A. Santori, G. Petrota etj., përmes botimeve dhe studimeve mbi traditën gojore, folklorin dhe letërsinë gojore arbëreshe.

Shumë të dhëna të studimit “*Shqiptarët e Italisë*” tashmë janë bërë pjesë e studimeve për folklorin dhe studimin e traditës zakonore morale arbëreshe dhe përbëjnë ende një burim të vlefshëm në përjasjet e kësaj tradite me atë shqiptare, apo të popujve të tjerë të Ballkanit. Kjo edhe për arsye se në studimet tona folklori, etnografia dhe letërsia gojore arbëreshe janë parë edhe si arkiva të ruajtjes së kulturës origjinale gojore shqiptare të paprekur nga pushtimi turk dhe kultura e pushtuesit; dhe si të tilla përbëjnë një dëshmi edhe në dobi të argumentimit të lashtësisë dhe originalitetit të folklorit dhe letërsisë gojore shqiptare.